REPUBLIKA E KOSOVËS

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra



Programi Kornizë Mjedisor i Sida-s për Kosovën

C8
A8.03
D8.03.01

Programi Mjedisor i Kosovës

(2016/07076)

Fjalor Terminologjik Shqip-Anglisht i Sektorit të Ujërave (FSATSU)

28 Shkurt, 2018

Sweden
Sverige

Titulli i Projektit:	Programi Mjedisor i Kosovës (PMK)
Financuar nga:	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida)
Nr. i Referencës:	2016/07076
Data e fillimit:	4 Korrik 2016
Data e mbarimit (Kohëzgjatja):	3 Korrik 2020
Numri i Kontratës:	C00045
Autoriteti Kontraktues:	Ambasada Suedeze në Prishtinë Z. Fatos MULLA, Zyrtar i Programit Rr. Perandori Justinian, Nr. 111, Pejton – 10000 Prishtinë Tel.:+381-(0)38-245795, ext.8221 Fax:+381-(0)38-245791 Email: fatos.mulla@gov.se
Përfituesit:	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) të Kosovës Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujëra Z. Muhamet MALSIU, Drejtor i Departamentit dhe Koordinator i Projektit Ish Pallati i Rilindjes, Kati i 15të – 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel.:+381-(0)38-20033222; Fax:+381-(0)38-517558 Email: Muhamet.Malsiu@rks-gov.net Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra (KNMU), Zyra e Kryeministrit Z. Baton BEGOLLI, Këshilltar Ndërtesa e Qeverisë– 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel.:+377-(0)44-503914 Email: Baton.Begolli@rks-gov.net
Kontraktori:	FCG Swedish Development (Kompania Udhëheqëse e Konsorciumit) Z. Per GIERTZ Dalagatan 7 – 11123 Stokholm (Suedi) Tel.: +46-(0)8-4067627 / Mob.: +46-(0)70-6749191 Fax: +46-(0)8-210269 Email: per.giertz@fcgsweden.se Në konsorcium me: EPTISA Servicios de Ingenieria S.L. (Kompania Partnere në Konsorcium) Z. Juan RUANO MOHALES Emilio Muñoz, 35-37 – 28037 Madrid (Spanjë) Tel.: +34-915-949500 Fax: +34-914-465546 Email: jruano@eptisa.com
Drejtor i Projektit:	Jorge MALUENDA FCG Swedish Development Dalagatan 7 – 11123 Stokholm (Suedi) Tel.: +46-(0)8-4067627 Fax: +46-(0)8-210269 Email: Jorge.Maluenda@fcgsweden.se
Menaxher i Programit / Përfaqësues i Kontraktorit:	Z. Giuseppe RAZZA Zyra e Projektit: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës Ish Pallati i RIlindjes, Kati i 15të– 10000 Prishtinë (Kosovë) Tel.:+377-(0)44-908421 Email: giuseppe.razza@yahoo.it / grazza@eptisa.com / Giuseppe.razza@fcgsweden.se
Titulli i Raportit:	**Fjalor Terminologjik Shqip-Anglisht i Sektorit të Ujërave (FTSASU) [C8-A8.03-D8.03.01]**
Data e përgatitjes:	28 Shkurt 2018
Autorët e Raportit:	Znj. Mihaela POPOVICI, Udhëheqëse e Ekipit të Komponentës (CTL 6-8); Znj. Virginia VILLANUEVA CALDERÓN, EKSH Ndërkombëtare Seniore për Fjalorin e Sektorit të Ujërave Znj. Blerta GASHI, EKSH Rajonale/Lokale juniore për Fjalorin Ship-Anglisht e Sektorit të Ujërave
Përgjegjës për kontrollin e cilësisë:	Z. Giuseppe RAZZA (Udhëheqës i Ekipit të Programit) Z. Baton BEGOLLI, Këshilltar për Politika Ujore, Sekretariati i Këshillit Ndër-Ministror të Ujërave (KNMU)

Mospranim Përgjegjësie
Opinionet e shprehura në këtë Raport u takojnë vetëm autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë opinionet e Ambasadës Suedeze në Kosovë apo të ndonjë organizate tjetër të përmendur. Prandaj, këto do të verifikohen përpara zbatimit të cilit do rekomandimi që ky Raport e përmban

PËRMBAJTJA

Faqe

1 HYRJE 1

2 KORNIZA INSTITUCIONALE 3

3 METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË FJALORIT ANGLISH-SHQIP DHE SHQIP-ANGLISHT TË SEKTORIT TË UJËRAVE (FTSU) 5

3.1 OBJEKTIVAT E FJALORIT TERMINOLOGJIK SHQIP-ANGLISHT TË SEKTORIT TË UJËRAVE 5
3.2 QASJA E PËRGJITHSHME E METODOLOGJISË 5
3.3 SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT, I POLITIKAVE DHE RREGULLOREVE TË BE-SË, SHQIPËRISË DHE KOSOVËS 6
3.4 GRUPIMI I TERMEVE NË GRUPE TEMASH QË LIDHEN ME SEKTORIN E UJËRAVE 11
3.5 PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT 12
3.6 FORMATET E FJALORIT TË SEKTORIT TË UJËRAVE 13

4 SHQIP-ANGLISHT FJALORI I SEKTORIT TË UJËRAVE 15

4.1 AA 15
4.2 BB 21
4.3 CC 24
4.4 DD 25
4.5 DHDH 29
4.6 EE 30
4.7 FF 33
4.8 GG 36
4.9 GJGJ 37
4.10 HH 38
4.11 II 41
4.12 JJ 44
4.13 KK 45
4.14 LL 53
4.15 LLLL 59
4.16 MM 60
4.17 NN 65
4.18 OO 70
4.19 PP 72
4.20 QQ 84
4.21 RR 85
4.22 RRRR 91
4.23 SS 94
4.24 SHSH 103
4.25 TT 107
4.26 THTH 112
4.27 UU 113
4.28 VV 119
4.29 XX 123
4.30 YY 124
4.31 ZZ 125

5 REFERENCAT 127

FJALORI I SHKURTESAVE

Shkurtesat	Domethënia
BE	Bashkimi Evropian
DKU	Direktiva Kornizë për Ujëra
DPSIR	Korniza e Forcës Lëvizëse, Presioneve, Gjendjes, Ndikimeve dhe Përgjigjeve/Reagimeve për analizën mjedisore
DU	Departamenti i Ujërave
EUR	Euro (monedha evropiane)
FTSASU	Fjalori Terminologjik Shqip-Anglisht i Sektorit të Ujërave
FTSU	Fjalori Terminologjik Sektorit të Ujërave
IED	Direktiva mbi Emisionet (Shkarkimet) Industriale
IMPRESS	Identifikimin e Ndikimeve dhe Vlerësimin e Presioneve në kuadër të Karakterizimit të Trupave Ujorë
INF	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
KD	Komiteti Drejtues
KE	Komisioni Evropian
KK	Kuvendi i Kosovës
KNMU	Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MP	Menaxhimi i Projektit / Programit / Menaxher i Programit
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
PMK	Programi Mjedisor i Kosovës
QK	Qeveria e Kosovës
RB	Pellg Lumi (Basen Ujor)
RBD	Rajon i Pellgut Lumor (Rajon i Basenit Ujor)
RBMP	Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor (Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor)
SCM	Standardet e Cilësisë Mjedisore
Sida	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SPI	Strategjia e Përbashkët e Implementimit
ShA	Shtet Anëtar
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
TMD	Teknikat më të Mira të DIsponueshme
TeR	Termat e Referencës
TUNU	Trajtimi i Ujërave të Ndotura Urbane
UA	Udhëzim Administrativ
UEK	Udhëheqëse e Ekipit të Komponentës
UEP	Udhëheqës i Ekipit të Programit
UNU	Ujërat e Ndotura Urbane
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor



Këshilli Ndërministror i Ujërave (KNU) siguron forumin për grumbullimin dhe vlerësimin e përvojave pozitive në sektorin e ujit, por edhe të meta në zbatimin, komunikimin dhe bashkëpunimin. Për më tepër, ajo ofron një platformë për zhvillimin e politikave për reformimin e sektorit të ujit duke marrë parasysh perspektivat e ndryshme, nga përdoruesit e ujit tek ofruesit e shërbimeve të ujit. Gjithashtu, KNU zhvillon dhe miraton politikat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e reformave dhe investimeve në sektorin e ujit.

Në këtë kuadër, KNU përfaqëson një nga institucionet kryesore referuese për donatorët ndërkombëtarë që po kontribuojnë në zbatimin e politikave të ujit dhe projekteve në Republikën e Kosovës.

Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndëkombëtar (SIDA) kohët e fundit ka financuar Programin Mjedisor të Kosovës (PMK), duke synuar, midis objektivave të tjera, të mbështesë Këshillin Ndërministror të Ujërave përmes zbatimit të disa detyrave dhe aktiviteteve. Një prej tyre ishte zhvillimi i një Fjalori terminologjik Pan-Shqiptar për Ujin dhe për të regjistruar terminologjinë e ujit gjatë dekadave të fundit, të përgatitura në dritën e dëshmive të reja të dokumentara dhe zhvillimeve moderne ligjore në Europë.

Ky fjalor termonologjik gjithëpërfshirës është një mjet i rëndësishëm referimi për të gjithë ata që janë të interesuar për shkencën dhe studimet e ujit dhe mjedisit. I shkruar në një stil të qartë dhe të kuptueshëm, fjalori përfshin deri në 800 përkufizime të organizuara në rend alfabetik dhe gjithashtu të grumbulluara në grupe "tematike".

Kuptimet në këtë fjalor për fjalët shkencore janë identifikuar nga gjetjet e dokumenteve të ndryshme relevante.

Fjalori ka për qëllim të citojë referencat nga politikat, legjislacioni dhe direktivat europiane, të cilat janë të qasshme për lexuesit në Shqipëri, Kosovë dhe në vende të tjera fqinje ku ka pakica shqiptare.

Fjalori nuk ka për qëllim të ofrojë një terminologji të ngurtë (rigjide) ose këshilla përfundimtare se si të përdoren përkufizime të ndryshme që lidhen me tema të ujit. Përkundrazi, ky dokument përfaqëson hapin e parë dhe synon të zhvillohet më tej dhe të përditësohet vazhdimisht në vitet në vijim, ndërsa kërkesa të reja dalin edhe njohuritë përmirësohen. Jemi gjithashtu të sigurt se puna e ngjashme mund t"u interesojë sektorëve të tjerë ekonomikë dhe teknikë në të ardhmen.

Ky projekt nuk do të ishte i suksesshëm pa punën e një numri njerëzish profesionist që punuan për implementimin e komponentave të ujit në PMK. Unë dua të shpreh vlerësimin tim të thellë për një ekip të tillë pune dhe në veçanti për Udhëheqësin e Ekipit të Programit, Z. Giuseppe Razza, i cili menaxhoj dhe koordinoj asistencën e përgjithshme teknike të Programit Mjedisor të Kosovës, Udhëheqësen e Ekipit të Komponentave të Ujit, Znj. Mihaela Popovici e cila identifikoi dhe kontrolloj terminologjitë në gjuhën Angleze të Fjalorit në përputhje me Direktivat e BE-së dhe Znj. Blerta GASHI, që u kujdes për terminologjitë ne gjuhën Shqipe dhe kontrollin e cilësisë, duke marrë gjithashtu parasysh legjislacionin Kosovar dhe Shqiptar të sektorit.

Baton BEGOLLI
Këshilltar i Kryeministrit
Këshilli Ndërministror i Ujërave

1 HYRJE

Në **qershor të 2015-së** Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor të Kosovës (MMPH) bashkë me Këshillin Ndër-Ministror për Ujëra (KNMU) të Republikës së Kosovës, finalizuan "***Programin Mjedisor të Kosovës***", që në tekstin e mëposhtëm do të quhet "Programi" apo "PMK", të cilin ia propozuan Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) për të pranuar burimet përkatëse financiare të nevojshme për zbatimin e këtij programi.

Në **tetor të 2015-së** Suedia e përfaqësuar nga Sida nënshkroi një "**Marrëveshje Specifike**" me Qeverinë e Kosovës të përfaqësuar nga MMPH-ja, duke e konfirmuar kësisoj financimin e PMK-së, i cili do të zbatohej me shfrytëzimin e burimeve financiare që rrjedhin nga dy linjat kryesore buxhetore në vijim:

1) Programi Kornizë i cili ofron Shërbime të Asistencës Teknike, ashtu siç parashihet në PMK, nga një Konsultant i pavarur i cili do të identifikohet nëpërmjet një procedure të hapur tenderuese;
2) Plani i Prokurimit i cili ofron shërbime të prokurimit, furnizimin me pajisjet e identifikuara dhe implementimin e punëve specifike.

Në përputhje me Termat e Referencës (TeR), qëllimi i Programit është të mbështesë KNMU-në si dhe të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të MMPH-së, të Komunave, dhe të palëve të tjera të interesit në monitorimin dhe menaxhimin mjedisor.

Mbështetja në zhvillimin e kapaciteteve të tyre përfshinë edhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale për barazi gjinore. Për arritjen e objektivave të mësipërme, PMK-ja është ndarë në 8 Komponentet e mëposhtme:

Komponentet e PMK-së
1. Fuqizimi i kapacitetit të AMMK-së për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mjedisor
2. Ruajtja e biodiversitetit përmes Librit të Kuq të llojeve të kafshëve në Kosovë
3. Fuqizimi i menaxhimit të zonave natyrore ndërkufitare
4. Themelimi i rrjetit të monitorimi të ujërave nëntokësore në Kosovë
5. Fuqizimi i kapacitetit për implementimin e legjislacionit mjedisor në nivelin qendror dhe lokal
6. Hulumtimi i ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Drin
7. Plani i menaxhimit të Pellgut të Lumit Drin
8. Mbështetja e Këshillit Ndër-Ministror për Ujëra

Komponenta e 8-të e PMK-së është dizajnuar për të mbështetur Këshillin Ndër-Ministror për Ujëra dhe përfshinë një varg detyrash afatshkurtra që në mes tjerash përfshijnë edhe zhvillimin e një Fjalori Terminologjik Anglisht-Shqip dhe Shqip-Anglisht të sektorit të ujërave, i cili paraqet edhe fokusin e këtij raporti.

Në kuadër të Komponentës së 8-të është kërkuar të realizohet detyra specifike A8.03 bashkë me aktivitetet e saja përkatëse si më poshtë:

A8.03	Zhvillimi i një Fjalori Panshqiptar Terminologjik Anglisht-Shqip i Sektorit të Ujërave në koordinim me donatorët e tjerë
A8.03.01	*Vizita hulumtimi në institucionet akademike dhe me palët e interesit të sektorit të ujërave me qëllim të grumbullimit të dhënave dhe diskutimit të kësaj iniciative*
A8.03.02	*Ndërlidhja me projektet e tjera të ngjashme, në veçanti me projektin e GIZ-it në Shqipëri*
A8.03.03	*Identifikimi dhe analiza e procedurës dhe e adresës më të mirë për ta shtyrë këtë iniciativë përpara deri në përfundimin dhe shtypjen e fjalorit*
A8.03.04	*Sugjerimi dhe themelimi i një grupi punues*
A8.03.05	*Hartimi dhe përgatitja e fjalorit për shtypjen e tij përfundimtare*

Ky Fjalor Terminologjik shqip-anglisht i Sektorit të Ujërave paraqet një dokument të prodhuar si rezultat i implementimit të detyrave dhe aktiviteteve të lartpërmendura.

Andaj, kur i referohemi një termi, fjale dhe përkufizimi në gjuhën shqipe, kjo nënkupton se i referohemi një termi, fjale dhe përkufizimi i cili përdoret në Shqipëri dhe Kosovë, d.m.th. në gjuhën që flitet dhe shkruhet nga popullata shqiptare e këtyre dy shteteve. Kurdo që ka ndryshim ndërmjet këtyre dialekteve shqiptare për një term, fjalë apo përkufizim të caktuar, atëherë në tekstin e fjalorit do ta gjeni të shënuar në mënyrë të dallueshme territorin në të cilin përdoret termi, fjala apo përkufizimi përkatës.

Për shkak të zhvillimit të shpejtë të legjislacionit si në nivelin kombëtar ashtu edhe në nivel të BE-së, sektori i ujërave karakterizohet me një larmi të termeve dhe përkufizimeve që përdoren në literaturën shkencore si dhe në kontekstin teknik e atë legjislativ. Termet e thjeshta si 'hazard - rrezik', 'potential impact - ndikimi potencial' dhe 'potential risk - rreziku potencial' përdoren shumë shpesh në kontekste të ndryshme. I njëjti term mund të ketë kuptime të ndryshme varësisht prej përdoruesit të këtij termi si dhe nga qëllimi se për çfarë po përdoret, pastaj varësisht nga audienca, nga gjendja aktuale, perspektiva, rrethanat, vendi, gjuha, kultura, si dhe nga konteksti në përgjithësi. Për shembull, Direktiva Kornizë për Ujëra (2000/60/EC) flet për '*hazardous substances - substancat e rrezikshme'*, ndërsa Direktiva SEVESO II (96/82/EC) i përcakton '*dangerous substances - substancat e rrezikshme*', kurse Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës i përkufizon '*harmful water impacts - efektet e dëmshme të ujërave'* si veprimet e ujit të cilat dëmtojnë pronën dhe paraqesin rrezik për njeriun, apo '*hazardous materials - materiet e rrezikshme*' si substanca apo grup substancash helmuese që janë të qëndrueshme dhe substancat me veti bioakumuluese si dhe grupet e substancave të cilat shkaktojnë nivel të njëjtë të rrezikut.

Edhe nëse një term përkufizohet shkencërisht me përpikëri apo ligjërisht saktë, i njëjti term mund të ketë përkuzime të ndryshme në fusha të ndryshme shkencore apo në pjesët e ndryshme të legjislacionit, dhe këto përkufizime mund të ndryshojnë me zhvillimin e njohurive shkencore si dhe me zhvillimin e shoqërisë. Përkufizimet shkencore janë në dispozicion nëpër librat shkollor dhe në hulumtimet e publikuara shkencore, ndërsa përkufizimet ligjore gjenden në dokumentet ligjore si p.sh. në Direktivat e BE-së.

Andaj duke marrë shkas nga kjo që u tha më sipër, ka nevojë që të shqyrtohet terminologjia e cila përdoret tani në sektorin e ujërave, si dhe të zhvillohet një fjalor koherent i termeve dhe përkufizimeve të këtij sektori. Për këtë punë duhet të bazuar në shqyrtimin nga aspekti terminologjik të *Acquis* së BE-së që lidhet me sektorin e ujërave. Termet e përkufizuara në legjislacionin përkatës paraqesin termet me prioritet për t'u shqyrtuar. Po ashtu rekomandohet që puna e bërë në këtë raport për Sektorin e Ujërave të zgjerohet edhe më tej ashtu që të përfshijë të gjithë Sektorin Mjedisor.

2 KORNIZA INSTITUCIONALE

Qëllimi i PMK-së është të mbështesë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Këshillin Ndër-Ministror për Ujëra (KNMU) në monitorimin dhe menaxhimin mjedisor, si dhe të mbështesë zhvillimin e kapacitetit të MMPH-së, të komunave dhe të palëve të tjera të interesit mu për këtë qëllim. Komponenta e 8-të është dizajnuar posaçërisht për mbështetjen e Këshillit Ndër-Ministror për Ujëra.

Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra (KNMU) e ka zanafillën e vetë që nga viti 2008 kur Qeveria e Kosovës themeloi Task Forcën për Ujëra (TFU) për të avancuar reformën e sektorit të ujërave në vend. Task Forca e Ujërave ishte një trup vendimmarrës ndërministror me detyrë që të avancojë sektorin e ujit dhe kornizave të politikave dhe strategjive lidhur me planet e veprimit dhe i cili shërbente edhe si platformë e koordinimit të përpjekjeve nga ana e palëve vendore dhe ndërkombëtare në reformimin e sektorit. Për të transformuar këtë TFU të suksesshme në një institucion të përhershëm, një Këshill Ndërministror për Ujërat u prezantua në Nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-147 "*për Ujërat e Kosovës*" i cili u miratua më 2013.

Në pajtim me Nenin 17 të po këtij Ligji për Ujërat, funksionet kryesore të KNMU-së janë:

- Të propozojë ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
- Të zbatojë ligjet dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
- Të hartojë dhe aprovojë Strategjinë Kombëtare Shtetërore për ujëra ;
- Të zhvillojë politikat nga fusha e ujërave;
- Të zgjidhë politikat financiare nga fusha e ujërave.

Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra, me vendndodhje në Zyrën e Kryeministrit, është një trup koordinues dhe vendimmarrës i përbërë nga Ministrat përkatës të Qeverisë e që kryesohet nga Zëvendës Kryeministri, i cili Këshill është përgjegjës për përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujërave përmes shqyrtimit të çështjeve sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimit të nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe përmes propozimit të masave për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës (Neni 15 i Ligjit Nr.04/L-147 "*për Ujërat e Kosovës*").

KNMU-ja paraqet forumin e grumbullimit dhe vlerësimit të përvojave pozitive në sektorin e ujërave, por po ashtu edhe të pengesave në implementim, komunikim dhe bashkëpunim. Për më tepër, ky Këshill ofron një platformë për zhvillimin e politikave për reformimin e sektorit të ujërave duke i marrë parasysh perspektivat e ndryshme, që prej përdoruesve të ujit e deri tek ofruesit e shërbimeve të ujit. KNMU-ja po ashtu zhvillon dhe aprovon politikat e kërkuara për të siguruar qëndrueshmëri të reformave dhe të investimeve në sektorin e ujërave.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës, të financuar nga Sida, me kontributin e një ekipi të përbërë nga një Eksperte Ndërkombëtare Seniore, një Eksperte Vendore Juniore, koordinuar nga Udhëheqësja e Ekipit të Komponenteve 6-8, si dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Sekretariatit të KNMU-së dhe të Udhëheqësit të Ekipit të Programit (UEP).


FCG eptisa

3 METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË FJALORIT ANGLISH-SHQIP DHE SHQIP-ANGLISHT TË SEKTORIT TË UJËRAVE (FTSU)

3.1 OBJEKTIVAT E FJALORIT TERMINOLOGJIK SHQIP-ANGLISHT TË SEKTORIT TË UJËRAVE

Zhvillimi i terminologjisë është përgatitur duke u bazuar në shqyrtimin e hollësishëm të terminologjive ekzistuese të cilat gjenden në dokumentet e legjislacionit të BE-së, duke i marrë parasysh në radhë të parë direktivat e BE-së që janë në fuqi, si dhe duke e marrë parasysh terminologjinë e ofruar në legjislacionin e Shqipërisë dhe të Kosovës. Andaj, në përputhje me këtë qasje është propozuar një terminologji konsistente e cila është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe e cila nuk ka për qëllim të ofrojë një terminologji strikte apo këshilla definitive mbi mënyrën e përdorimit të përkufizimeve të ndryshme lidhur me sektorin e ujërave, por më saktësisht, si objektivë e ka ofrimin e udhëzimeve për mënyrat e mundshme të përdorimit të terminologjisë përkatëse, si dhe ofrimin e një pikënisjeje të mundshme për zhvillimet e mëtejshme drejt përdorimit uniform të terminologjisë së sektorit të ujërave në mbështetjen e vendimeve dhe të vendimmarrjes së autoriteteve mjedisore dhe atyre përgjegjëse për ujëra, si dhe për përdoruesit e tjerë në trevat shqipfolëse. Prandaj, ky dokument final paraqet hapin e parë në këtë drejtim dhe synohet që të zhvillohet edhe më tej dhe të përditësohet vazhdimisht në të ardhmen me shfaqjen e kërkesave të reja dhe me avancimin e njohurive të fushës, mirëpo gjithnjë në konsultim me universitetet, institucionet akademike dhe me palët kyçe të interesit të vendeve të ndryshme ku flitet gjuha shqipe.

3.2 QASJA E PËRGJITHSHME E METODOLOGJISË

Përkufizimi konkret i një termi të caktuar pikë së pari është nxjerrë nga dokumentet relevante të legjislacionit të BE-së të cilat janë ligjërisht të detyrueshme, ndërsa ato terme të cilat nuk përcaktohen me legjislacionin e BE-së janë përkufizuar në bazë të literaturës së specializuar e cila është në dispozicion *online* në internet. Çdo përkufizim është shkruar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Termet janë të renditura në mënyrë alfabetike si dhe janë të grupuara në tema të ndryshme që lidhen me sektorin e ujërave.

Fjalori Terminologjik i Sektorit të Ujërave është rezultat përfundimtar i sugjerimeve të marra nga palët e interesit pas një procesi konsultativ të organizuar mbi draftin e mëparshëm përfundimtar të këtij dokumenti. Grafiku i **Figurës 3.2.1** paraqet metodologjinë e përgjithshme të zhvillimit të Fjalorit Terminologjik Shqip-Anglisht të Sektorit të Ujërave.



Fig.3.2.1: Metodologjia e Përgjithshme e përdorur për të finalizuar Fjalorin Terminologjik Shqip-Anglisht të Sektorit të Ujërave

3.3 SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT, I POLITIKAVE DHE RREGULLOREVE TË BE-SË, SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Në krye të pakos legjislative të BE-së për mbrojtjen e ujërave qëndron Direktiva Kornizë për Ujëra (DKU) e cila i përcakton parimet kryesore të menaxhimit dhe mbrojtjes së ujërave, të cilat më zgjerimisht pastaj shtjellohen në direktivën për mbrojtjen e ujit të pijshëm, direktivën për ujërat nëntokësore, direktivën për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, direktivën për përmbytjet, etj.

Direktivat dhe Rregulloret kyçe të BE-së të cilat merren me çështjet e ujit janë:

- **Direktiva Nr. 2000/60/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 23.10.2000 "***që themelon kornizën për veprim të Komunitetit në fushën e politikave ujore*"** (**Direktiva Kornizë për Ujëra -DKU)**;
- **Direktiva e Këshillit Nr. 91/271/EEC** e datës 21.05.1991 në lidhje me "***trajtimin e ujërave të ndotura urbane***" (**Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane**);
- **Direktiva e Këshillit Nr. 91/676/EEC** e datës 12.12.1991 "***për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet me prejardhje nga burimet bujqësore***" (**Direktiva për Nitratet**);
- **Direktiva e Këshillit Nr. 98/83/EC** e datës 03.11.1998 "***për cilësinë e ujit që synohet të përdoret për konsum njerëzor***" **(Direktiva për Ujin e Pijshëm-DUP);**
- **Direktiva Nr.2007/60/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 23.10.2007 "***për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet*" (Direktiva për Përmbytjet)**;
- **Direktiva Nr.2008/105/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 16.12.2008 "***për standartet e cilësisë së mjedisit në fushën e politikave ujore***", që amendamenton dhe më pas shfuqizon Direktivat e Këshillit Nr. 82/176/EEC, 83/513/EEC, 84/156/EEC, 84/491/EEC, 86/280/EEC dhe amendamenton Direktivën Nr.2000/60/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian;
- **Direktiva Nr.2006/118/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 12.12.2006 "***për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi***";
- **Direktiva Nr.2006/7/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 15.02.2006 "***për menaxhimin e cilësisë së ujit për larje"*** dhe shfuqizimin e Direktivës Nr.76/160/EEC**.**
- **Direktiva Nr. 2006/44/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 06.09.2006 "***për cilësinë e ujërave të ëmbla që kanë nevojë për mbrojtje apo përmirësim, në mënyrë që të mbështesin jetën e peshqve*", (Direktiva për Peshqit);**
- **Direktiva Nr. 2009/54/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 18.06.2009 **"*për shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave natyrale minerale*".**

Për më tepër, për përgatitjen e këtij Fjalori Terminologjik të Sektorit të Ujërave janë marrë parasysh edhe Direktivat e tjera të BE-së për mjedisin natyror, vlerësimin mjedisor si dhe ndotjen mjedisore, të cilat ndërlidhen me sektorin e ujërave,si në vijim:

1. VLERËSIM MJEDISOR TË PROJEKTEVE, PLANEVE DHE PROGRAMEVE DHE AUDITIME MJEDISORE
   - **Direktiva Nr.2001/42/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 27.06.2001 "***për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis***" (**Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor-VSM**");
   - **Direktiva Nr.2011/92/EU** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 13.12. 2011 "***për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis"***;
   - **Direktiva Nr.2014/52/EU** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 16.04.2014 që amendamenton **Direktivën 2011/92/EU *"për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis"***;
   - **Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 25.11.2009 "***mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave në një skemë eko-menaxhimi dhe auditimi të Komunitetit (EMAS)***, *që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr.. 761/2001, dhe Vendimet e Komisionit Nr.2001/681/EC dhe 2006/193/EC*".
2. NDOTJE:
   - **Direktiva e Këshillit Nr.86/278/EEC** e datës 12.06.1986 "***për mbrojtjen e mjedisit e posaçërisht të tokës, kur lymi (llumi) i ujërave të ndotura përdoret në bujqësi***";
   - **Direktiva e Këshillit Nr.1999/31/EC** e datës 26.04.1999 "***për deponinë e mbeturinave (mbi landfillin e mbetjeve)***";

- **Direktiva Nr.2004/35/CE** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 21.04.2004 "***mbi përgjegjësinë mjedisore lidhur me parandalimin dhe sanimin e dëmeve mjedisore***" (**Direktiva për Përgjegjësinë Mjedisore**);
- **Direktiva Nr.2008/98/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 19.11.2008 "***për mbeturina (mbetje)"*** që shfuqizon disa Direktiva të caktuara ("***Direktiva Kornizë për Mbeturina (Mbetje)***");
- **Direktiva 2006/21/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 15.03.2006 "***për menaxhimin e mbeturinave (mbetjeve) nga industritë nxjerrëse"*** që amendamenton Direktivën Nr.2004/35/EC;
- **Direktiva 2010/75/EU** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 24.11.2010 ***"mbi emetimet industriale (parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes)",*** (**Direktiva e Emetimeve Industriale apo DEI**);
- **Direktiva 2012/18/EU** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 4.07.2012 "***për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme***", që amendamenton dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 96/82/EC (**Direktiva SEVESO III**).
- **Rregullorja (EC) Nr.166/2006** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 18.01.2006 "***për krijimin e një Regjistri Evropian të Shkarkimit dhe Tranferimit të Ndotësve***", që amendamenton Direktivat e Këshillit Nr.91/689/EEC dhe 96/61/EC.

3. MJEDIS NATYROR:
   - **Direktiva e Këshillit Nr.92/43/EEC** e datës 21.05.1992 "***për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër***" (**Direktiva e Habitateve**).
4. INFORMACION MJEDISOR DHE INFORMIM PUBLIK:
   - **Direktiva Nr.2003/35/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 26.05.2003 "***që parasheh pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin***" dhe që amendamenton Direktivat e Këshillit Nr.85/337/EEC dhe 96/61/EC lidhur me pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen e tij në drejtësi, (**Direktiva për Pjesëmarrjen Publike**);
   - **Direktiva Nr. 2003/4/EC** e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 28.01.2003 "***për qasjen e publikut në informacion mjedisor***" dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit Nr. 90/313/EEC.
5. POLITIKA, RREGULLORE DHE UDHËZUES TË TJERË TË BE-SË:
   - **Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe për Komitetin e Rajoneve** - Një plan për ruajtjen e resurseve (burimeve) ujore të Evropës (COM(2012) 673 final, 14.11.2012);
   - **Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe për Komitetin e Rajoneve** - Raport mbi Rishikimin e Politikës Evropiane për mungesën e ujit dhe thatësira. (SWD(2012) 380 final, 14.11.2012);
   - **Vendimi 2455/2001/EC** i Këshillit dhe Parlamentit Evropian i datës 20.11.2001 "***që përcakton listën e substancave prioritare në fushën e politikave ujore***" dhe që amendamenton Direktivën 2006/60/EC;
   - **Politika e Përbashkët Bujqësore**;
   - **"59 Terme dhe Përkufizime nga Direktiva Kornizë për Ujëra"**. Nxjerr nga udhëzuesi i Komisionit Evropian: Fjalor i termeve kyçe nga dokumentet udhëzuese (Përjashtuar Nenin 2 Termet);
   - **"Termet dhe Përkufizimet nga Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane 91/271/EEC"**. Bruksel, 16 janar 2007;
   - Dokumentet Udhëzuese të **Strategjisë së Përbashkët të Implementimit të Direktivës Kornizë për Ujëra**;
   - **Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare**, miratuar më 17 mars 1992 në Helsinki, (**Konventa për Ujërat**).

Legjislacioni kyç i Shqipërisë dhe i Kosovës që lidhet me menaxhimin e ujërave:

- Ligji Nr. 04/L-147 "***për Ujërat e Kosovës***" miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19.03.2013 dhe shpallur me Dekretin Presidencial Nr. DL-011-2013, datë 05.04.2013 që shfuqizon Ligjin Nr. 2004/24 "për Ujëra" miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 08.07.2004 dhe shpallur nga PSSP më 14.10.2004;
- Ligji Nr. 02/L-79 *"**për Veprimtaritë Hidrometeorologjike**"* miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 15.06.2006 dhe shpallur nga PSSP më 09.01.2007;
- Ligji Nr. 05/L-042 ***"për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit"*** miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14.12.2015 dhe shpallur me Dekretin Presidencial Nr. DL-001-2016, datë 05.01.2016;
- Ligji Nr. 02/L-85 **"*për Peshkatari dhe Akuakulturë*"** miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 10.10.2006;
- Ligji Nr. 04/L-027 ***"për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera"*** miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 22.09.2011 dhe shpallur me Dekretin Presidencial Nr. DL-037-2011, datë 07.10.2011;

- Ligji Nr. 111/2012 ***"për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"***, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 15.11.2012;
- UA Nr. 2/99 "***për testimin dhe zbatimin e standardeve minimale të cilësisë së ujit të pijshëm***";
- UA Nr. 23/05-MMPH "***për përcaktimin e mënyrës së evidentimit dhe legjitimacionit të inspektorit të ujërave***" datë 11.10.2005;
- UA Nr. 24/05-MMPH "***për përmbajtjen, formën, kushtet dhe mënyrën e dhënies dhe ruajtjes së lejes ujore***", datë 11.10.2005;
- UA Nr. 06/2006-MMPH "***për strukturën e pagesave të ujit***", datë 02.2006;
- UA Nr. 06/07-MMPH "***për përmbajtjen e infrastrukturës ujore***", datë 08.06.2007;
- UA Nr. 13/07-MMPH "***për kriteret e përcaktimit të zonave të mbrojtura ujore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije***", datë 23.11.2007;
- UA Nr. 13/2008 "***për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujor dhe në rrjetin e kanalizimit publik***", datë 18.07.2008;
- UA Nr. 08/26 "***për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujor dhe në rrjetin e kanalizimit publik"*** aprovuar nga Qeveria e Kosovës (QK) me datën 09.07.2008;
- UA Nr. 16/2012 "***për cilësinë e ujit që synohet të përdoret për konsum njerëzor***", datë 24.12.2012;
- UA Nr. 12/2013 "***për Sistemin Informativ Ujor***", datë 17.06.2013;
- UA Nr. 21/2014 "***për menaxhimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierave*** ", datë 05.11.2014;
- UA Nr. 28/2014 "***për zonat e mbrojtura sanitare***", datë 23.12.2014;
- UA Nr. 29/2014 "***për menaxhimi e lymit nga trajtimi i ujërave të ndotura***", datë 30.12.2014 ;
- UA Nr. 30/2014 "***për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor"*** , datë 30.12.2014;
- UA Nr. 12/2015 "***për përcaktimi e kritereve për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike***", datë 20.11.2015;
- UA Nr. 19/2015 "***për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave***", datë 16.12.2015;
- UA Nr. 20/2015 "***për kriteret për zonat për larje***", datë 17.12.2015;
- UA Nr. 02/2016 "***për strukturën e pagesave të ujit***", datë 18.02.2016;
- UA Nr. 05/2016 "***për rregullimin e statusit të pasurisë ujore***", datë 29.09.2016;
- UA Nr. 04/2016 "***për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve***", datë 07.09.2016;
- UA Nr. 09/2016 "***për strukturën organizative dhe detyrat shtesë të autoritetit të rajonit të pellgjeve lumore***", datë 23.12.2016;
- Rregullorja Nr. 02/2016 "***për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike*** ", datë 11.09.2016;
- UA Nr. 11/2016 ***"për përcaktimin, mënyrën dhe procedurat për mbrojtjen e zonave erozive*** ", datë 23.12.2016;
- UA Nr. 16/2017 "***për klasifikimin e trupave ujorë sipërfaqësorë***", datë 08.12.2017;
- UA Nr. 17/2017 "***për klasifikimin e trupave ujorë nëntokësorë***", datë 08.12.2017;
- UA Nr. 09/2017 "***për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave***", datë 04.07.2017.

Legjislacioni tjetër primar dhe sekondar mjedisor, i Shqipërisë dhe Kosovës, i cili ndërthuret me sektorin e ujërave përfshinë ligjet dhe aktet nënligjore në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-025 "***për Mbrojtjen e Mjedisit***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës (KK) me 26.02.2009 dhe shpallur me Dekretit Presidencial më 19.03.2009;
- Ligji Nr. 04/L-175 "***për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit",*** miratuar nga Kuvendi i Kosovës (KK) me 02.10.2013, dhe shpallur me Dekretit Presidencial Nr.DL-053-2013 më 21.10.2013 që e ka shfuqizuar Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2004-MMPH "***për Themelimin e Inspektoratit për Mbrojtje të Mjedisit*** ", të datës 18.02.2004 dhe Rregulloren Nr. 2003/9;
- Ligji Nr. 03/L-160 "***për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës (KK) me 25.02.2010 , dhe shpallur me Dekretit Presidencial Nr DL-012-2010 më 12.03.2010;
- Ligji Nr. 10 431 " ***për Mbrojtjen e Mjedisit*** ", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 09.06.2011;
- Ligji Nr. 81/2017 "***për Zonat e Mbrojtura***", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 28.04.2017 , dhe shpallur me Dekretit Presidencial Nr. 10335 më 18.05.2017;
- Ligji Nr. 9587 "***për Mbrojtjen e Biodiversitetit***", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 20.07.2006;
- Ligji Nr. 68/2014 "***për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587 " për Mbrojtjen e Biodiversitetit" të datës 20.07.2006, të ndryshuar***", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 03.07.2014;
- Ligji Nr. 8906 " ***për Zonat e Mbrojtura*** ", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 06.06.2002;
- UA Nr. 02/2004-MMPH "***për Themelimin e Inspektoratit për Mbrojtje të Mjedisit***", datë 18.02.2004;

- UA Nr.2004/09- MMPH "***për Kadastrin e Emisioneve të Ndotësve në Mjedis. Formularët dhe Udhëzimet për Plotësimin e Formularëve***", datë 03.08.2005;
- UA Nr.17/2013 "***për Kadastrin e Shkarkimeve të Ndotësve në Mjedis***", datë 06.08.2013;
- UA Nr. 22/03-MMPH "***për Organizimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës***", datë 06.10.2003;
- Vendimi Nr.633 *"**për Miratimin e Procedurave dhe të Kërkesave për Dhënien e Skemave të Ekomenaxhimit dhe Auditimit** "*, datë 15.07.2015, të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 03/L-214 "***për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 23.09.2010 dhe shpallur me Dekretin Presidencial Nr. DL-048-2010 të datës 14.10.2010. i cili zëvendëson Ligjin Nr . 03/L-024 miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 26.02.2009;
- Ligji Nr. 10 440 *"**për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**"*, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 07.07.2011;
- UA Nr. 03/2004-MMPH "***për licencimin e personave dhe ndërmarrjeve për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*"**, datë 27.04.2004;
- UA Nr. 09/2004-MMPH "***për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis***", datë 14.07.2004;
- UA Nr. 07/11 "***për licencimin e hartuesve të raporteve për vlerësimin e ndikimit në mjedis***", datë 13.07.2011;
- UA Nr. 9/11 "***për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis***", datë 13.07.2011;
- UA Nr. 10/2011-MMPH "***për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme*"**, datë 13.07.2011;
- UA Nr. 11/2011 "***për përcaktimin e vlerës së tarifës për shërbimet lidhur me procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis***", datë 13.07.2011;
- UA Nr. 16/2015 "***për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis***", datë 01.12.2015*;*
- Ligji Nr. 03/L-230 "***për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 30.08.2010 dhe shpallur me Dekretin Presidencial me datën 18.10.2010, i cili zëvendëson Ligjin Nr. 03/L-015 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 12.02.2009;
- Ligji Nr. 03/L-043 "***për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26.03.2009 dhe shpallur përmes Dekretit Presidencial Nr.DL-010-2009 të datës 23.04.2009;
- Ligji Nr. 05/L-081 *"**për Energji**"*, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 16.06.2016 dhe shpallur përmes Dekretit Presidencial Nr. DL-025-2016, të datës 01.07.2016;
- Ligji Nr. 04/L-060 "***për Mbeturinat",*** miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 24.05.2012 dhe i shpallur me Dekret Presidencial Nr. DL-027-2012 më 08.06.2012. Ky ligj i ri për Mbeturina ka shfuqizuar Ligjin Nr.02/L-30 me përjashtim të Shtojcës 1 "*Katalogu i Mbeturinave*" (GZ nr 7, 29 qershor 2012);
- Ligji Nr. 10 463 *"**për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve**",* miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 22..09.2011;
- Ligji Nr. 04/L-197 *"**për Kimikate**",* miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27.02.2014 dhe i shpallur me Dekret Presidencial Nr. DL-05-2014, të datës 14.03.2014;
- Ligji Nr. 10 433 *"**për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë** ",* miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 16.06.2011;
- Projektligji *"**për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore që shkaktohen nga Substanca të Rrezikshme**", të* Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 2003/3 "***për Pyjet e Kosovës***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13.02.2003 dhe i shpallur nga PSSP më 20.03.2003 (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/6). Ky ligj është ndryshuar me Ligjin Nr. 2004/29 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28.07.2004 dhe me Ligjin Nr. 03/L-153 miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25.02.2010;
- Ligji Nr. 9385 *"**për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor**" të* Republikës së Shqipërisë, miratuar më 04.05.2005 dhe i përditësuar më 05.05.2016;
- Ligji Nr. 03/L-233 "***për Mbrojtjen e Natyrës***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 30.09.2012 dhe shpallur me Dekretin Presidencial Nr. DL-054-2010 të datës 18.10.2010 i cili zëvendëson Ligjin Nr. 02/L-18 "***për Mbrojtjen e Natyrës***" miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 23.03.2005;
- Ligji Nr. 02/L-53 "***për Gjuetinë***", miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 16.12.2005 dhe i shpallur nga PSSP më 11.08.2006 (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/41);
- UA Nr. 04/2006-MMPH "***për formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës",*** të datës 05.10.2006;
- UA Nr. 01/07-MMPH "***për formën dhe mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura të natyrës***", të datës 25.01.2007;
- UA Nr. 11/07-MMPH "***për Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të Natyrës***", të datës 02.11.2007;

- UA Nr. 08/2011 "***për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra të mbrojtura, me qëllim të përpunimit dhe tregtimit*"** datë 13.07.2011;
- UA Nr. 26/05-MMPH "***për dhënien e lejes ekologjike***", të datës 07.11.2005;
- UA Nr. 08/2010-MMPH "***për kushtet e lejes për llojet specifike të operimeve dhe impianteve***", të datës 16.08.2010;
- UA Nr. 01/2011-MMPH "***për procedurat e zhvillimit dhe aprovimit të dokumenteve të referimit për teknikat më të mira të mundshme***", të datës 31.03.2011;
- UA Nr. 03/2011 "***për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacioneve për leje të integruar*"**, të datës 31.03.2011;
- UA Nr. 09/2012 "***për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të lejeve të lëshuara të integruara***", të datës 18.06.2012;
- UA Nr. 17/2010 "***për kushtet e lejes për llojet specifike të operimeve dhe impianteve***", të datës 16.08.2010;
- UA Nr. 06/2007-MMPH "***për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes***", të datës 04.06.2007*;*
- UA *"**për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave** ",* të datës 15.08.2010;
- UA *"**për menaxhimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierat**".*

3.4 GRUPIMI I TERMEVE NË GRUPE TEMASH QË LIDHEN ME SEKTORIN E UJËRAVE

Termet janë paraqitur të grupuara në grupe të temave të paracaktuara. Lista e këtyre temave përfshinë kategoritë e mëposhtme:

- Agriculture and irrigation - Bujqësi dhe ujitje
- Drinking water - Ujë i pijshëm
- Drought - Thatësirë
- Economic analysis - Analizë ekonomike
- Environmental assessment - Vlerësim mjedisor
- Environmental objectives - Objektiva mjedisore
- Environmental problems - Probleme mjedisore
- Floods - Përmbytje
- Hydraulics - Hidraulikë
- Impact assessment - Vlerësim i ndikimit
- Industry - Industri
- Information systems - Sisteme Informative
- Institutional and legal aspects - Aspekte institucionale dhe ligjore
- Measures - Masat
- Monitoring - Monitorim
- Pollution - Ndotje
- Pressure assessment - Vlerësim i presioneve
- Protected areas - Zona të mbrojtura
- Public health - Shëndet publik
- Public information, consultation and participation - Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike
- Risk - Rreziku
- River basin - Pellg lumor (Basen ujor)
- Sewerage and waste water treatment - Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura
- Transboundary issues, international agreements - Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare
- Water bodies status - Status i trupave ujorë
- Water bodies - Trupa ujorë
- Water management - Menaxhim i ujërave
- Water quality - Cilësi e ujërave
- Water supply - Furnizim me ujë

3.5 PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

Drafti i Fjalorit Terminologjik Shqip-Anglisht të Sektorit të Ujërave i është prezantuar palëve kosovare të interesit me qëllim të marrjes së komenteve dhe përshtypjeve të tyre për dokumentin, duke i informuar kështu mbi iniciativën, objektivat, metodologjinë dhe rezultatet e pritura, si dhe prej tyre është kërkuar që brenda një periudhe të caktuar kohore ta rishikojnë draftin e fjalorit në fjalë duke kontribuar me komentet e tyre.

Po ashtu është paraparë edhe një konsultim me palët e interesit në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi me qëllim të kompletimit të rishikimit shqip-anglisht të terminologjisë përkatëse të këtij sektori.

Për finalizimin e këtij Fjalori si dhe të bazës së të dhënave (versionit elektronik të tij) janë pranuar dhe marrë parasysh komentet, sugjerimet dhe vlerësimet e vlefshme të ekspertëve të Autoriteteve të Rajoneve të Pellgjeve Lumore, të Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave të MMPH-së, AMMK-së, të universiteteve, si dhe projektet e tjera ndërkombëtare siç është- Projekti i GEF-it "***Mundësimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe i Menaxhimit të Integruar të Resurseve (Burimeve) Ujore në Pellgun e zgjeruar të Lumit Drin***".

3.6 FORMATET E FJALORIT TË SEKTORIT TË UJËRAVE

Krijimi dhe mirëmbajtja e fjalorëve teknik paraqet një sfidë që tashmë dihet, andaj për dizajnimin e versionit përfundimtar të fjalorit kërkohet një fleksibilitet i madh. Për të përmbushur këtë kërkesë, versioni final i Fjalorit Terminologjik Shqip-Anglisht të Sektorit të Ujërave është prezantuar në dy formate: a) në formë të Bazës së Të Dhënave në MS Access, si dhe b) në format të Word Dokumentit të shtypur.

Baza e të Dhënave në MS Access

Baza e të Dhënave në MS Access do të shërbejë si një mjet dinamik me mundësi përditësimi. Mirëpo me rëndësi është edhe mbështetja dhe mirëmbajtja afatgjate e Bazës së të Dhënave të FJalorit të Sektorit të Ujërave, e cila kërkon vendimin e MMPH-së që një gjë e tillë të sigurohet. Struktura e Bazës së të Dhënave është përshkruar më poshtë.

- *Tabela "Referencat Kyçe"*



Id	Code of reference	Name of reference
1	Directive 2014/52/EU	Directive 2014/52/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 amending Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment (Text with EEA relevance).
2	Directive 86/278/EEC	Council Directive 86/278/EEC of 12 June 1986 on the protection of the environment, and in particular of the soil, when sewage sludge is used in agriculture.
3	Directive 91/676/EEC	Council Directive of 12 December 1991 concerning the protection of waters against pollution caused by nitrates from agricultural sources (91 / 676 / EEC).
4	Directive 91/271/EEC	Council Directive 91/271/EEC of 21 May 1991 concerning urban waste water treatment.
5	Directive 98/83/EC	Council Directive 98/83/EC of 3 November 1998 on the quality of water intended for human consumption.
6	Directive 1999/31/EC	Council Directive 1999/31/EC of 26 April 1999 on the landfill of waste.
7	Directive 2000/60/EC	Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council of 23 October 2000 establishing a framework for Community action in the field of water policy.
8	Directive 2001/42/EC	Directive 2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27 June 2001 on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment.
9	Directive 2004/35/CE	Directive 2004/35/CE of the European Parliament and of the Council of 21 April 2004 on environmental liability with regard to the prevention and remedying of environmental (Environmental Liability Directive).
10	Directive 2006/118/EC	Directive 2006/118/EC of the European Parliament and the Council of 12 December 2006 on the protection of

- *Tabela "Temat"*

Përfshinë opsionin e zgjedhjes së temave nga një listë temash të renditura sipas rendit alfabetik.



Topic - Tema
Agriculture and irrigation; Bujqësi dhe ujitje
Drinking water; Ujë i pijshëm
Drought; Thatësira
Economic analysis; Analizë ekonomike
Environmental assessment; Vlerësim mjedisor
Environmental objectives; Vlerësim mjedisor
Environmental problems; Probleme mjedisore
Floods; Përmbytje
Hydraulics; Hidraulikë
Impact assessment; Vlerësim i ndikimit
Industry; Industri
Information systems; Sistemet Informative
Institutional and legal aspects; Aspektet institucionale dhe ligjore
Measures; Masat
Monitoring; Monitorim
Pollution; Ndotja
Pressure assessment; Vlerësim i presioneve
Protected areas; Zona të mbrojtura
Public health; Shëndeti publik
Public information, consultation and participation; Informim konsultim, dhe pjesëmarrje publike
Risk; Rreziku
River basin; Pellg Lumor (Basen Ujor)
Sewerage and waste water treatment; Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura
Transboundary issues, international agreements;
Water bodies status; Statusi i trupave ujor

➢ *Tabelat e terminologjisë*

Për secilën shkronjë të alfabetit: A, B, C, D, etj., ekziston një tabelë me terme që fillojnë me atë shkronjë. Tabela "Temat" është e lidhur me shtyllën e titulluar "Topic-Tema" brenda këtyre tabelave të cilat i përmbajnë termet sipas shkronjave të alfabetit (shihni shembullin më poshtë), kështu që sigurohet një konsistencë sa i përket grupimit të termeve sipas temave, siç u përshkrua në Seksionin 3.4. më sipër.



Term -Term	Definition in Albanian - Përkufizimi në gju	Definition in English - Përkufizimi në gjuhën angleze	Topic - Tema	Main references -Referenca krye
Absorbent	Absorbent (lëndë përthithëse) - Substancë e cila i thithë molekulat brenda strukturës së saj	Substance that takes up molecules into its structure	Sewerage and waste water treatment; Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Absorption	Absorbim (përthithje) - procesi në të cilin një substancë depërton në trupin e një substance tjetër, që ndryshe quhet absorbent (lëndë përthithëse). Një	The process in which one substance penetrates into the body of another substance, termed the absorbent. An example is the absorption of water into soil	Sewerage and waste water treatment; Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Abstraction	Nxjerrja - procesi i marrjes së ujit nga ujërat sipërfaqësore apo ujërat nëntokësore, qoftë përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, me qëllim të shfrytëzimit të tij	The process of taking water from surface waters or groundwaters, either temporarily or permanently in order to be used	Water supply; Furnizim me ujë	Directive 2000/60/EC
Accumulation tank	Rezervuar akumulues (grumbullues) - enë apo rezervuar në të cilin uji magazinohet (ruhet) për përdorim sipas kërkesës	Container or reservoir in which water is stored for use upon request	Water supply; Furnizim me ujë	
Accuracy	Saktësia - afria e përputhshmërisë ndërmjet një rezultati testi dhe vlerës së pranuar referente	Closeness of an agreement between a test result and the accepted reference value	Water quality; Trupat ujor	Directive 2000/60/EC
Acid rain	Shi acidic - Shiu i cili ka nivel jashtëzakonisht të ultë të pH-së, si pasojë e kontaktit me ndotësit atmosferik siç janë oksidet e squfurit	Rain that has a flamboyantly low pH, due to contact with atmospheric pollutants such as sulphuric oxides	Environmental problems; Probleme mjedisore	
Acidity of	Aciditet i ujërave - kapaciteti sasior i ujit për	The quantitative capacity of water to neutralize a	Water quality; Trupat	

➢ *Format*

Ekziston një formë për çdo tabelë që përmban termet sipas një shkronje të caktuar të alfabetit.



<u>Formati i shtypur i Word Dokumentit</u>

Fjalori Anglisht-Shqip dhe Shqip-Anglisht i Sektorit të Ujërave i cili i përfshinë komentet dhe sugjerimet e palëve të interesit të konsultuara për këtë qëllim, është prezantuar në këtë Dokument në Kapitullin e 4-të.

4 SHQIP-ANGLISHT FJALORI I SEKTORIT TË UJËRAVE

4.1 Aa

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Absorbent (lëndë thithëse)	Substancë e cila i thithë molekulat brenda strukturës së saj	**Absorbent**	Substance that takes up molecules into its structure	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Absorbim (thithje)	Procesi në të cilin një substancë depërton në trupin e një substance tjetër, që ndryshe quhet absorbent (lëndë thithëse). Një shembull i këtillë është absorbimi i ujit në tokë	**Absorption**	The process in which one substance penetrates into the body of another substance, termed the absorbent. An example is the absorption of water into soil	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Aciditet i ujërave	Kapaciteti sasior i ujit për të neutralizuar një bazë, që shprehet në ppm apo mg/L ekuivalent karbonati të kalciumit. Në ujin e ndotur, aciditeti rezulton nga dioksidi i karbonit të tretur në të apo nga acidet organike që rezultojnë nga ujitja e tokës. Ndotja atmosferike gjithashtu mund të shkaktojë aciditet në ujëra përmes reshjeve	**Acidity of waters**	The quantitative capacity of water to neutralize a base, expressed in ppm or mg/L calcium carbonate equivalent. In polluted water, acidity is due to dissolved carbon dioxide or organic acids that come from the watering of the soil. Atmospheric pollution can also cause acidity in the water by precipitation	Cilësi e ujërave	
Acinetobakter	Bakter që rëndom gjendet në tokë dhe ujë, i aftë për të akumuluar polifosfate deri në 20% të masës së tij qelizore. Luan rol shumë të rëndësishëm në largimin e fosforit. Në disa raste mund të konsiderohet si bakter patogjen	**Acinetobacter**	Bacter capable of accumulating polyphosphates up to 20% of its cell mass. It plays a very important role in removing phosphorus. In some cases they can be considered as pathogenic bacteria	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Adaptim (përshtatje)	Masat e marra paraprakisht për të zvogëluar cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike	**Adaptation**	Measures taken ahead of time to reduce vulnerability to climate change	Masat	Politikat e BE-së për Pamjaftueshmëri të Ujit dhe Thatësira
Adsorbim (ndajthithje)	Procesi fizik i aderimit (ngjitjes) të lëngjeve, gazeve, apo materieve të suspenduara për sipërfaqet apo poret e një mjedisi adsorbues (ndajthithës) siç është karboni i aktivizuar Adsorbimi (ndajthithja) është një proces fizik i cili zhvillohet pa ndonjë reaksion kimik	**Adsorption**	The physical process occurring when liquids, gases, or suspended matters adhere to the surfaces of, or in the pores of, an adsorbent media such as activated carbon. Adsorption is a physical process which occurs without chemical reaction	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Adsorbim (ndajthithje) kimike	Thithja kimike është një lloj adsorbimi i cili paraqet reaksionin kimik ndërmjet një sipërfaqeje dhe lëndës së ndajthithur (adsorbatit)	**Chemical adsorption**	Chemisorption is a kind of adsorption which involves a chemical reaction between the surface and the adsorbate		
Adsorbim (ndajthithje) mbi shtrat të fiksuar (i quajtur ndryshe -filtrim)	Përdorimi i një shtrati të fiksuar që përmban lëndë si karboni i aktivizuar për të bërë adsorbimin e disa ndotësve nga ujërat e ndotura	**Fixed bed adsorption (percolation)**	Use of a bed with material such as active carbon to carry the adsorption of some pollutants from waste water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Aerob	Një proces që zhvillohet në prani të oksigjenit, siç është p.sh. tretja e materieve organike nga bakteret në një pellg oksidimi	**Aerobic**	A process that takes place in the presence of oxygen, such as the digestion of organic matter by bacteria in an oxidation pond	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Aerobe obligative	Organizma të cilët rriten detyrimisht në prani të oksigjenit, meqë për përfitimin e energjisë e shfrytëzojnë oksigjenin për t'i metabolizuar substancat si sheqernat apo yndyrat	**Obligate aerobe**	Organisms which need oxygen to grow as they use oxygen to metabolise substances, like sugars or fats, to obtain energy	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Aerosol	Grimca të cilat kanë dimensione aq të vogla sa qëndrojnë pezull në ajër	**Aerosol**	Particles that have so small dimensions that are suspended in the air	Ndotje	

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Aftësi ripërtëritëse	Aftësia e një ekosistemi për të mbajtur apo përtëritur biodiversitetin, integritetin biotik, si dhe strukturën e proceset ekologjike, pasi që të ketë ndodhur një dëmtim i tyre	**Resilience**	The ability of an ecosystem to maintain or restore biodiversity, biotic integrity, and ecological structure and processes following disturbance	Probleme mjedisore	
Aglomerat	Një zonë ku popullsia dhe/apo veprimtaritë ekonomike janë me përqendrim të mjaftueshëm ashtu që të bëhet grumbullimi i ujërave të ndotura urbane dhe përçimi i tyre deri në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura urbane apo deri në një pikë fundore të shkarkimit	**Agglomeration**	An area where the population and/or economic activities are sufficiently concentrated for urban waste water to be collected and conducted to an urban waste water treatment plant or to a final discharge point	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Directiva 91/271/EEC
Agjent kondicionues	Një substancë apo proces i cili e përmirëson cilësinë e një lënde tjetër	**Conditioning agent**	Substance or process that improves the quality of another material	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Agjent korroziv	Substancat dhe preparatet të cilat në kontakt me indet e gjalla mund t'i shkatërrojnë ato	**Corrosive**	Substances and preparations which may destroy living tissue on contact	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Agjent tensioaktiv (Surfaktant)	Surfaktantët janë materie të cilat e zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor (apo tensionin ndërfazor) ndërmjet dy lëngjeve apo ndërmjet një lëngu dhe një trupi të ngurtë. Ekzistojnë 4 lloje të surfaktantëve: jojonik, anionik, kationik dhe amfoterik	**Agent, surface active (surfactant)**	Surfactants are materials that lower the surface tension (or interfacial tension) between two liquids or between a liquid and a solid. There are 4 types of surfactants: nonionic, anionic, cationic, amphoteric	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ajërmbledhës/ Ujëmarrës	Vendi apo hapja (gërmimi) prej nga një fluid (lëngë apo gaz) merret përmes një kanali, tubi (gypi), etj.	**Intake**	The place or opening at which a fluid is taken into a channel, pipe, etc.	Furnizim me ujë	
Ajrim	Teknikë e cila përdoret në trajtimin e ujit për të cilën nevojitet furnizimi me oksigjen, që rëndomë njihet si teknikë e pastrimit aerob biologjik të ujit. Qoftë uji sillet në kontakt me pikëzat e ujit përmes spërkatjes (sprucimit) qoftë ajri sillet në kontakt me ujin përmes aeratorëve. Ajri presohet në një trup ujor përmes flluskimit dhe uji pasurohet me oksigjen	**Aeration**	Technique that is used with water treatment that demands oxygen supply, commonly known as aerobic biological water purification. Either water is brought into contact with water droplets by spraying or air is brought into contact with water by means of aeration facilities. Air is pressed through a body of water by bubbling and the water is supplied with oxygen	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ajrimi me ajër të kompresuar	Ajrimi (shihni përkufizimin për "aeration-ajrim") ku ajri kalon nëpër lëng me anë të ajrit të kompresuar, i cili është ajër që mbahet nën presion më të lartë sesa presioni atmosferik	**Compressed air aeration**	Aeration (see aeration) in which the air passes through the liquid by means of compressed air which is air kept under a pressure that is greater than atmospheric pressure	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ajrimi paraprak i ujërave të ndotura	Trajtimi i ujërave të ndotura duke fryrë ajër mbi të përpara se ato të futen në dekantues. Kjo metodë mund të ndikojë në përmirësimin e sedimentimit, duke e mbajtur atë të freskët dhe duke ndihmuar në largimin e dhjamërave dhe yndyrave përmes flotacionit. Mund të përdoret për largimin e rërës (gurëve ranor) në dhomëzat e ajruara të gurëve ranor (në të cilat rryma e ajrit gjenerohet nga një ajërfryrës, i cili ajër futet në këto dhomëza përmes një tubi që gjendet në fundit e tyre)	**Pre-aeration**	A treatment of waste water before sedimentation tanks by blowing air through it. It may improve sedimentation, helping to keep it fresh and remove greases and fats by flotation. It may form part of grit removal in the aerated grit chamber	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ajrues	Pajisje që shërben për shpërndarjen e oksigjenit në ujë apo në ujë të ndotur. Gjithashtu mund të shërbejë edhe për largimin e gazeve të padëshiruara	**Aerator**	Device that serves to disperse oxygen into water or waste water. It can also serve for the purging of unwanted gases	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ajrues me injektim	Një pajisje e cila punon përmes teknologjisë së aspirimit (thithjes) duke futur njëkohësisht vëllime të mëdha të lëngut me energji të lartë kinetike si dhe të ajrit, përmes një apo më shumë hundëzave (grykëzave) injektuese. Ajruesit me injektim gjejnë aplikim në një varg trajtimesh të ujërave, ujërave të ndotura dhe të biosolideve	**Jet aerator**	A device that works through aspirating technology by simultaneously introducing large volumes of high kinetic energy liquid and air through one or more jet nozzles. Jet aerators are applied across a wide range of water, waste water and biosolids treatment applications	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Akt nënligjor	Aktet e lëshuara nga Ministria apo Qeveria, që përfshijnë udhëzimet admnistrative, rregulloret, vendimet, etj.	**Sub-legal act**	Acts issued by the Ministry or the Government, including administrative instructions, regulations, decisions, etc.	Aspekte institucionale dhe ligjore	
Aksident madhor	Është një ndodhi si p.sh. një emision (në Shqipëri - shkarkim), zjarr, apo shpërthim madhor që rezulton nga zhvillime të pakontrolluara në rrjedhën e operimit të cilitdo impianti (në Shqipëri -ndërmarrjeje), dhe që çon në rrezik serioz për shëndetin e njeriut apo mjedisin, qoftë të menjëhershëm apo të vonuar, brenda apo jashtë impiantit (ndërmarrjes), dhe që shkaktohet nga një ose më shumë substanca të rrezikshme	**Major accident**	An occurrence such as a major emission, fire, or explosion resulting from uncontrolled developments in the course of the operation of any establishment, and leading to serious danger to human health or the environment, immediate or delayed, inside or outside the establishment, and involving one or more dangerous substances	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU, Direktiva 2006/21/EC
Akuakulturë	Kultivimi i organizmave shtazorë dhe bimorë ujorë, posaçërisht i peshkut, molusqeve të ngrënshme (si gocat e detit), dhe i algave e bimësisë ujore, në mjediset natyrore apo të kontrolluara të ujërave të njelmëta apo të ëmbla	**Aquaculture**	The cultivation of aquatic animals and plants, especially fish, shellfish, and seaweed, in natural or controlled marine or freshwater environments	Probleme mjedisore	
Akuifer	Një apo disa shtresa nën-sipërfaqësore të shkëmbinjve apo formacioneve të tjera gjeologjike të tokës, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme që mundësojnë qoftë një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore apo nxjerrjen e sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore	**Aquifer**	A subsurface layer or layers of rock or other geological strata of sufficient porosity and permeability to allow either a significant flow of groundwater or the abstraction of significant quantities of groundwater	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Akuifer i kufizuar (i konturuar)	Një pjesë e shkëmbit apo e rërës mbi të cilën është e mbivendosur një shtresë kufizuese (p.sh. akuitardi argjilor) e cila e kufizon lëvizjen e ujit drejt një akuiferi tjetër	**Confined aquifer**	A section of rock or sand that is overlain by a confining layer (e.g. clay aquitard on top) that restricts movement of water into another aquifer	Trupa ujorë	
Akuifer i pakufizuar (i pakonturuar)	Një pjesë e një shkëmbi apo një zonë rëre e cila nuk përmban një shtresë kufizuse (si p.sh akuitard argjilor) mbi të. Një akuifer i pakonturuar zakonisht është i cektë	**Unconfined aquifer**	A section of rock or sand that does not have a confining layer (e.g. clay aquitard) on top of it. An unconfined aquifer is often shallow	Trupa ujorë	
Akuifiugj	Një shtresë krejtësisht e papërshkueshme e cila as nuk e mban e as nuk e tejçon ujin	**Aquifuge**	An absolutely impermeable layer that will neither store nor transmit water	Trupa ujorë	
Akuiklud	Një shtresë me përshkueshmëri të ultë e cila formon qoftë kufirin e sipërm apo të poshtëm të një sistemi të rrjedhës së ujërave nëntokësore	**Aquiclude**	A low-permeability layer that forms either the upper or lower boundary of a groundwater flow system	Trupa ujorë	
Akuitard	Njësi me përshkueshmëri të ultë e cila edhe mund t'i ruajë (magazinojë) ujërat nëntokësore edhe t'i tejçoj ato ngadalë nga një akuifer në akuiferin tjetër	**Aquitard**	Low permeability unit that can store groundwater and also transmit it slowly from one aquifer to another	Trupa ujorë	
Alga	Organizma një apo shumëqelizor që rëndom gjenden në ujërat sipërfaqësore, si p.sh. alga 'duckweed' që gjendet në sasi të mëdha në ujërat amull. Algat e prodhojnë ushqimin e vetë përmes fotosintezës. Popullata e algave ndahet në alga të gjelbra dhe alga blu, prej të cilave algat blu janë shumë të dëmshme për shëndetin e njeriut. Rritja e tepërt e algave mund të shkaktojë erë apo shije të pakëndshme të ujit. Kalbja e algave i zvogëlon rezervat e oksigjenit në ujë	**Algae**	Single or multi-celled organisms that are commonly found in surface water, such as duckweed. They produce their own food through photosynthesis. The algae population is divided up into green algae and blue algae, of which the blue algae are very damageable to human health. Excessive algae growth may cause the water to have undesirable odors or tastes. Decay of algae diminishes oxygen supplies in the water	Ndotje	
Algat blu të gjelbra	Algat blu të gjelbra që ndryshe quhen edhe cianobaktere janë një tip bakteresh të cilat ndodhen në shumë liqene, pellgje dhe rezervuare	**Blue-green algae**	Blue-green algae (also called cyanobacteria) are a type of bacteria found in many lakes, ponds, and reservoirs		

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Alkaliniteti	Paraqet kapacitetin e ujit për të neutralizuar (buferizuar) vetveten. Pengon që nivelet e pH së ujit të bëhen shumë bazike apo shumë acidike. Po ashtu ia shton karbonin ujit. Alkaliniteti e stabilizon ujin në një nivel të pH-së prej rreth 7.0. Mirëpo, kur aciditeti në ujë është i lartë, alkaliniteti zvogëlohet, gjë që mund të shkaktojë kushte të dëmshme për jetën ujore. Në kiminë e ujërave alkaliniteti shprehet në ppm (pjesë për milion) apo mg/L të ekuivalentit të karbonatit të kalciumit. Alkalinitetit total i ujërave paraqet shumën e tri llojeve të alkalinitetit: alkalinitetit si rezultat i komponimeve alkaline karbonate, bikarbonate, dhe hidrokside	**Alkalinity**	It represents the capacity of the water to neutralize itself. It prevents the water pH levels from becoming too basic or acid. It also adds carbon to water. Alkalinity stabilizes water at pH levels around 7. However, when the acidity is high in water the alkalinity decreases, which can cause harmful conditions for aquatic life. In water chemistry alkalinity is expressed in ppm or mg/L of equivalent calcium carbonate. Total alkalinity of water is the sum of all three sorts of alkalinity: carbonate, bicarbonate and hydroxide alkalinity	Cilësi e ujërave	
Alkalinizimi	Procesi kur diçka bëhet apo shndërrohet në alkaline	**Alkalinization (Alkalinisation)**	The process of becoming alkaline, or making alkaline	Cilësi e ujërave	
Alterimet fizike	Modifikimet e hidromorfologjisë së një trupi ujor të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore	**Physical alterations**	Modifications of the hydromorphology of a water body by human activity	Vlerësim i ndikimit	Direktiva 2000/60/EC
Aluvium (lyshtër, lymërishtë)	Depozitimet e argjilës, lymit (fundërresës), rërës, zhavorrit, apo të materieve të tjera grimcore që janë depozituar nga një ujërrjedhë apo ndonjë trup tjetër ujor rrjedhës në një shtrat të një ujërrjedhe, në një lumare (fushë lymore), në një deltë, apo në bazën e një mali	**Alluvium**	Deposits of clay, silt, sand, gravel, or other particulate material that has been deposited by a stream or other body of running water in a streambed, on a flood plain, on a delta, or at the base of a mountain	Përmbytje	
Anaerob	Një proces që zhvillohet në mungesë të oksigjenit	**Anaerobic**	A process that takes place in the absence of oxygen	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Anaerobe fakultative	Organizma të cilët për prodhimin e energjisë së vet e shfrytëzojnë oksigjenin, po qe i pranishëm, mirëpo mund të shfrytëzojnë edhe metoda anaerobe, d.m.th. mund të rriten me ose pa prezencën e oksigjenit, meqë mund ta përfitojnë energjinë në mënyrë aerobe apo anaerobe	**Facultative anaerobic**	Organisms which use oxygen if it is available, but also have anaerobic methods of energy production, thus grow with or without oxygen because they can metabolise energy aerobically or anaerobically	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Anaerobe obligative	Organizma anaerob të cilët rriten pa praninë e oksigjenit, dhe të cilët reagojnë negativisht apo edhe mund të vdesin në prani të oksigjenit. Anaerobet obligative rriten vetëm në mungesë të oksigjenit	**Obligate anaerobe**	Anaerobe organism does not require oxygen for growth. It may react negatively or even die if oxygen is present. Obligate anaerobe grow only in the absence of oxygen	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Analiza e efektivitetit të kostos	Një instrument ekonomik për të analizuar kostot e alternativave të programeve të masave të hartuara për të përmbushur objektivat menaxhuese të caktuara. Programi i cili kushton më pak paraqet programin me koston më efektive	**Cost-effectiveness analysis**	An economic tool to analyze the costs of alternative programmes of measures designed to meet given management objectives. The programme which costs least will be the most cost effective	Analizë ekonomike	Direktiva 2000/60/EC
Analiza kosto-benefit	Proces i vlerësimit të kostove dhe benefiteve të një vendimi, programi apo projekti (për një periudhë të caktuar kohore), si dhe vlerësimi i alternativave të tyre (brenda të njëjtës periudhë), ashtu që të fitohet një shkalle e vetme krahasimi për një vlerësim sa më të paanshëm	**Cost-benefit analysis**	The evaluation of an investment project with a long-perspective from the viewpoint of the economy as a whole by comparing the effects of undertaking the project with not doing so	Analizë ekonomike	Direktiva 2000/60/EC
Analizë Krahasuese	Metodologjia për monitorimin dhe krahasimin e performacëns së indikatorëve me një standard, në një sektor të caktuar, bazuar në performancën e tyre përgjatë një periudhe të caktuar kohore	**Benchmarking**	Methodology for monitoring and comparing performance indicators with a standard in a given sector based on performance over a given period of time	Monitorim	

Fjalor Terminologjik Shqip-Anglisht i Sektorit të Ujërave (FTSASU)

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Anion	Një jon i ngarkuar negativisht në gjendje të tretur, siç është bikarbonati, kloruri apo sulfati. Një anion [si kloruri (Cl-)] mund të rezultojë nga disocijimi i një kripe, acidi apo alkali	**Anion**	A negatively charged ion in solution, such as bicarbonate, chloride, or sulfate. An anion [such as chloride (Cl-)] may result from the dissociation of a salt, acid, or alkali	Cilësi e ujërave	
Ankesë	Një deklaratë (parashtresë) në të cilën një person mund të shpreh pakënaqësinë e tij me një situatë të caktuar, si p.sh. me standardin e shërbimeve të ujit	**Complaint**	A statement in which a person can express the dissatisfaction with a particular situation, such as the standard of water services	Aspekte institucionale dhe ligjore	
Anoksi	Një gjendje e karakterizuar me mungesë të oksigjenit	**Anoxia**	A condition characterized by an absence of oxygen	Cilësi e ujërave	
Aplikimi (futja) në tokë	Shtimi i materieve në tokë qoftë përmes shpërndarjes së tyre në sipërfaqen e tokës, injektimit në tokë, vendosjes nën sipërfaqen e tokës apo përzierjes me shtresat sipërfaqësore të tokës	**Land application**	It is spreading on the surface of the land, injection into the land, placing below the surface of the land or mixing with the surface layers of the land	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 91/676/EEC
Aplikuesi	Çdo person fizik apo juridik, i cili kërkon informacione mjedisore apo një leje/licencë	**Applicant**	Any natural or legal person requesting environmental information or a permit/license	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2003/4/EC Direktiva 1999/31/EC
Argjilë	Tokë e ngjeshur, vjeshtullore kokërrizë-imtë, zakonisht me ngjyrë të verdhë, kuqe apo kaltër në të hirtë, e që shpeshherë formon një shresë të padepërtueshme në tokë	**Clay**	A stiff, sticky fine-grained earth, typically yellow, red, or bluish-gray in color and often forming an impermeable layer in the soil	Hidraulikë	
Argjinaturë	Një mur apo ledh prej dheu apo gurësh e ngritur për të ndaluar përmbytjen e një sipërfaqeje nga një lumë	**Embankment**	A wall or bank of earth or stone built to prevent a river flooding an area	Përmbytje	
Aspekti mjedisor	Një element i aktiviteteve, produkteve apo shërbimeve të një organizate, i cili ka apo mund të ketë ndikim në mjedis	**Environmental aspect**	An element of an organisation's activities, products or services that has or can have an impact on the environment	Vlerësim mjedisor	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Auditim Mjedisor	Një shqyrtim sistematik, i dokumentuar, periodik dhe objektiv nga një subjekt i rregulluar për operimet dhe praktikat e impianteve (ndërmarrjeve, objekteve) lidhur me përmbushjen e tyre të kërkesave mjedisore	**Environmental audit**	Environmental audit is a systematic, documented, periodic and objective review by a regulated entity of facility operations and practices related to meeting environmental requirements		
Auditor (Revizor)	Një individ apo grup individësh që i takojnë një organizate, apo një person fizik apo juridik jashtë asaj organizate, që e përfaqëson atë, e që kryen në veçanti vlerësimin e sistemit ekzistues të menaxhimit mjedisor dhe që përcakton pajtueshmërinë me politikën dhe programin mjedisor të organizatës, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore lidhur me mjedisin	**Auditor**	An individual or group of individuals, belonging to an organisation itself or a natural or legal person external to that organisation, acting on behalf of that organisation, carrying out an assessment of, in particular, the environmental management system in place and determining conformity with the organisation's environmental policy and programme, including compliance with the applicable legal requirements relating to the environment	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Autoklavë	Një rezervuar (depozitë) në të cilin kryhen reaksione kimike apo biologjike. Autoklava anaerobe është njëra prej metodave më të zakonta të trajtimit të lymit (llumit) organik që përgjithësisht rezultojnë nga trajtimi biologjik i ujërave të ndotura përmes proceseve të përfitimit të lymit (llumit) aktiv	**Digester**	A container in which chemical or biological reactions are carried out. Anaerobic Digester is one of the most commonly used method for treating organic sludges generally resulting from the biological treatment of waste waters through activated sludge processes	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Autoriteti kompetent	Është autoriteti ose autoritetet apo organet përgjegjëse sipas dispozitave ligjore të Shteteve për zbatimin brenda territorit të tyre të obligimeve që dalin nga Direktivat e BE-së	**Competent Authority**	Authority or authorities or bodies responsible under the national legal provisions of the States for carrying out the obligations arising from the EU Directives within its territory	Aspekte institucionale dhe ligjore	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Autoriteti publik	Paraqet cilindo prej të mëposhtëmve: (a) qeveria apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organet këshilluese publike, në nivel qendror, rajonal apo lokal; (b) çdo person fizik apo juridik që ushtron funksione administrative publike sipas ligjeve vendore, përshirë detyrat, aktivitetet apo shërbimet specifike lidhur me mjedisin; dhe (c) çdo person fizik apo juridik që ka përgjegjësi apo funksione publike, apo që ofron shërbime publike, që ndërlidhen me mjedisin dhe janë nën kontrollin e një organi apo personi të përmendur nën (a) apo (b)	**Public authority**	Any of the following: government or other public administration, including public advisory bodies, at national, regional or local level; any natural or legal person performing public administrative functions under national law, including specific duties, activities or services in relation to the environment; and any natural or legal person having public responsibilities or functions, or providing public services, relating to the environment under the control of a body or person falling within the two previous cases	Aspekte institucionale dhe ligjore	Direktiva 2003/35/EC
Autoriteti zbatues	Autoritetet kompetente përkatëse siç identifikohen nga Shtetet për të identifikuar, parandaluar dhe hulumtuar shkeljet e kërkesave ligjore në fuqi që lidhen me mjedisin dhe, kurdo që është e nevojshme, të ndërmarrin veprime për zbatimin e tyre	**Enforcement authority**	The relevant competent authorities as identified by the States to detect, prevent and investigate breaches of applicable legal requirements relating to the environment and, where required, take enforcement action	Aspekte institucionale dhe ligjore	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Avull	Gjendja agregate e gaztë e substancave siç është uji	**Vapour**	The gaseous phase of substances such as water	Menaxhim i ujërave	
Avullim	Procesi i shëndërrimit të ujit prej gjendjes së lëngët në gjendje të gaztë (avull), përfshirë avullimin nga sipërfaqet ujore, tokësore dhe nga fushat me borë, por duke përjashtuar avullimin (transpirimin) nga sipërfaqet e gjetheve të bimëve	**Evaporation**	The process of liquid water becoming water vapor, including vaporization from water surfaces, land surfaces, and snow fields, but not from leaf surfaces	Menaxhim i ujërave	
Azoti amoniakal	Një masë matëse për sasinë e amoniakut, një ndotësi toksik (helmues) që shpeshherë gjendet në lëngun kullues nga deponitë (në Shqipëri -lendfillet) dhe në produktet e kthyera në mbeturina (në Shqipëri - mbetje), si në ujërat e ndotura shtëpiake, në plehun e lëngët dhe në produkte tjera organike të lëngëta të kthyera në mbeturina (mbetje)	**Ammoniacal nitrogen**	A measure for the amount of ammonia, a toxic pollutant often found in landfill leachate and in waste products, such as sewage, liquid manure and other liquid organic waste products	Ndotje	
Azot organik	Azoti i pranishëm në ujërat e ndotura shtëpiake i cili ekziston në forma të kombinuara. Komponimet organike më të shpeshta janë aminoacidet, proteinat ose urea, të cilat përcaktohen me anë të metodës së Kjeldahl-it (shihni përkufizimin për 'Nitrogen, total' - 'Azotin total'). Amoniaku dhe komponimet e tija, si dhe nitratet nuk janë forma të azotit organik	**Organic nitrogen**	Nitrogen present in domestic waste water that exists in combined forms. The most common organic compounds are amino acids, proteins or ureas which are determined by the Kjeldahl method (see the defintion for 'Nitrogen, total'). Ammonia and its compounds and nitrates are not organic nitrogen forms	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Azoti total	Ekzistojnë tri forma të azotit të cilat rëndomë maten në trupat ujor: amoniaku, nitratet dhe nitritet. Azoti total paraqet shumën e azotit total Kjeldahl[1](amoniakut, azotit organik dhe të reduktuar) dhe të nitrateve-nitriteve	**Nitrogen, total**	There are three forms of nitrogen that are commonly measured in water bodies: ammonia, nitrates and nitrites. Total nitrogen is the sum of total kjeldahl nitrogen[2] (ammonia, organic and reduced nitrogen) and nitrate-nitrite.	Ndotje	

[1] **Metoda Kjeldahl** apo **zbërthimi Kjeldah** - në kiminë analitike paraqet metodën për përcaktimin sasior të **azotit** në përbërje të substancave organike, si dhe të **azotit** në amoniakun inorganik dhe në jonet e amonit

[2] The **Kjeldahl** method or **Kjeldahl** digestion in analytical chemistry is a method for the quantitative determination of **nitrogen** contained in organic substances plus the **nitrogen** in inorganic ammonia and ammonium (NH_3/NH_4^+).

4.2 Bb

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Bagëti	Kafshët shtëpiake që rriten në një mjedis bujqësor dhe që mbahen për përdorim apo përfitim	**Livestock**	Domesticated animals raised in an agricultural setting to produce commodities such as food, fiber, and labor	Ndotje	Direktiva 91/676/EEC
Bajpas (shunt, kanal devijues)	Një kanal, tub (gyp) apo lidhje sekondare që mundëson rrjedhjen nëpër të, kur kanali, gypi (tubi) apo lidhjet kryesore nuk mund të përdoren për shkak të mbylljes, bllokimit, tejngarkimit të tyre, etj.	**Bypass**	A secondary channel, pipe, or connection to allow a flow when the main one cannot be used (closed, blocked, overloaded, etc.)	Hidraulikë	
Baktere	organizma njëqelizorë mikroskopikisht të vegjël, të cilët riprodhohen me ndarjen e sporeve	**Bacteria**	Microscopically small single-cell organisms, that reproduce by fission of spores	Ndotje	
Baktere koliforme	Baktere që, po qe se gjenden në ujë, shërbejnë si tregues të ndotjes dhe të patogjenëve të tjerë të pranishëm në ujë. Këto baktere zakonisht gjenden në traktin gastroinstestinal (përkatësisht në zorrë) të njerëzve dhe kafshëve me gjak të ngrohtë	**Coliform (bacteria)**	Bacteria that serve as indicators of pollution and pathogens when found in water. These are usually found in the intestinal tract of humans and warm-blooded animals	Ndotje	
Baktere nitrifikuese	Një grup i ngushtë taksonomik që ndodhet në mjedis, i cili në numër të madh gjendet aty ku janë të pranishme sasi të konsiderueshme të amoniakut (zonat me dekompozim të madh proteinik, si dhe në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura shtëpiake)	**Nitrifying bacteria**	A narrow taxonomic group in the environment, found in highest numbers where considerable amounts of ammonia are present (areas with extensive protein decomposition, and sewage treatment plants).	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Baticë e kuqe	Lulëzimi i algave që përfshinë fitoplanktonin e llojit dinoflagellate, siç është *Gonyaulax monilata* dhe *Ptychodiscus brevis*, të cilat në mënyrë natyrore prodhojnë biotoksina të cilat shkaktojnë ngordhjen e peshqve si dhe një mori helmimesh të molusqeve	**Red tide**	Algal bloom involving dinoflagellate phytoplankton species, such as *Gonyaulax monilata* and *Ptychodiscus brevis*, which naturally manufacture biotoxins, can cause fish kills and several types of shellfish poisoning	Probleme mjedisore	
Bërryl i lumit (i ujërrjedhës)	Gjatësia e një ujërrjedhe me karakteristika relativisht homogjene	**Reach**	A length of stream with relatively homogenous characteristics	Trupa ujorë	
Bikarbonate	Kripërat që e përmbajnë anionin HCO3-. Kur i shtohet acidi, ky jon shpërbëhet në H2O dhe CO2 dhe vepron si pufer	**Bicarbonates**	Salts containing the anion HCO3-. When acid is added, this ion breaks into H2O and CO2, and acts as a buffer	Cilësi e ujërave	
Bilanci i ujërave	Përcaktohet si llogaritje numerike e cila përfshinë hyrjet në, daljet nga, si dhe ndryshimet në vëllimin e ujit në një varg komponentesh të ciklit hidrologjik si p.sh. në rezervuar, lumë, apo akuifer, brenda një njësie të caktuar hidrologjike (p.sh. një ujëmbledhësi lumi apo pellgu lumor) si dhe për një njësi të caktuar kohore (p.sh. gjatë një muaji apo një viti), që ndodhin në mënyrë të natyrshme ose si pasojë e nxjerrjeve dhe shkarkimeve (kthimeve) të ujit të shkaktuara nga njeriu	**Water balance**	Is defined as the numerical calculation accounting for the inputs to, outputs from, and changes in the volume of water in the various components (e.g. reservoir, river, aquifer) of the hydrological cycle, within a specified hydrological unit (e.g. a river catchment or river basin) and during a specified time unit (e.g. during a month or a year), occurring both naturally and as a result of the human induced water abstractions and returns	Menaxhim i ujërave	Direktiva Kornizë e Ujërave
Bioakumulimi	Rritja e përqendrimit të një substance në organizmat e gjallë, me marrjen e ajrit, ujit apo ushqimit të kontaminuar, për shkak të metabolizimit të ngadalshëm dhe ekskretimit të tyre të ngadalshëm	**Bioaccumulation**	The increase in concentration of a substance in living organisms, as they take in contaminated air, water, or food, due to slow metabolization and excretion	Ndotje	
Biodegradim	Procesi me anë të të cilit substancat organike dekompozohen nga mikroorganizmat në substanca më të thjeshta si në dioksid karboni, ujë dhe amoniak	**Biodegradation**	The process by which organic substances are decomposed by micro-organisms into simpler substances such as carbon dioxide, water and ammonia	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biodegra-dueshme	Substancë e aftë për t'u dekompozuar në kushte natyrore	**Biodegradable**	Substance capable of decomposing under natural conditions	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Biofilm	Popullatë mikrooganizmash të ndryshëm, të mbetura në një shtresë lymi (llumi) dhe produktesh ekskretimi, e cila popullatë është e ngjitur për një sipërfaqe	**Biofilm**	Population of various microrganisms, trapped in a layer of slime and excretion products, attached to a surface	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biofiltër	Një teknikë e kontrollit të ndotjes ku përdoret një bioreaktorë që përmban materie të gjalla për kapjen dhe degradimin biologjik të ndotësve. Në trajtimin e ujërave të ndotura ky është njëri pej proceseve më të rëndishme të separimit (ndarjes), i cili mund të përdoret për të larguar ndotësit organikë	**Biofilter**	A pollution control technique using a bioreactor containing living material to capture and biologically degrade pollutants. In waste water treatment is one of the most important separation processes that can be employed to remove organic pollutants	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biofiltër	Një lloj i sistemit të trajtimit të ujërave të ndotura që konsiston në një shtrat të fiksuar mediumesh filtruese siç janë gurët, lava, koksi, zgjyra, zhavorri, shkuma poliuretane, myshku i bardhë torfik, qeramika apo plastika, sipër të cilave rrjedhin ujërat e ndotura shtëpiake apo ujërat e tjera të ndotura, duke bërë që në këto mediume filtruese të rritet një shtresë e mikrobeve (që paraqet biofilmin) e cila e mbulon shtratin e mediumit filtrues. Kushtet aerobe ruhen përmes spërkatjes e difuzionit të ajrit, si dhe qoftë edhe përmes futjes së ajrit i cili qarkullon nëpër shtrat apo përmes konveksionit natyral të ajrit në rast se mjeti filtrues është poroz (me vrima)	**Trickling filter**	A type of waste water treatment system consisting of a fixed bed of rocks, lava, coke, gravel, slag, polyurethane foam, sphagnum peat moss, ceramic, or plastic media over which sewage or other waste water flows downward and causes a layer of microbial slime (biofilm) to grow, covering the bed of media. Aerobic conditions are maintained by splashing, diffusion, and either by forced-air flowing through the bed or natural convection of air if the filter medium is porous	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biogaz	Një përzjerje e metanit (CH_4) dhe e dioksidit të karbonit (CO_2) e cila lirohet nga zbërthimi anaerob i lymit (llumit) organik. Mund të përdoret për gjenerim të energjisë elektrike dhe të nxehtësisë, apo mund të përpunohet në gaz natyror të ripërtritshëm dhe në lëndë djegëse për mjetet e transportit	**Biogas**	A mixture of methane (CH4) and carbon dioxide (CO2) which is released from anaerobic digestion of organic sludge. Can be combusted to generate electricity and heat, or can be processed into renewable natural gas and transportation fuels	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biomasë	Nënkupton cilëndo prej të mëposhtmeve: (a) produktet që përbajnë çfarëdo materie bimore nga bujqësia apo pylltaria që mund të përdoren si lëndë djegëse me qëllim të rikuperimit të energjisë që e përmbajnë; (b) mbeturinat (në Shqipëri- mbetjet) në vijim:(i) mbeturinat (mbetjet) bimore nga bujqësia dhe pylltaria; (ii) mbeturinat (mbetjet) bimore nga industria e përpunimit të ushqimit, nëse nxehtësia e gjeneruar rikuperohet; (iii) mbeturinat (mbetjet) bimore fijore nga prodhimi i masës drusore të virgjirë dhe nga prodhimi i letrës prej masës drusore, nëse bashkë-incinerohen në vendin e prodhimit dhe nëse nxehtësia e gjeneruar rikuperohet; (iv) mbeturinat (mbetjet) nga tapa; (v) mbeturinat (mbetjet) drusore me përjashtim të mbeturinave (mbetjeve) drusore të cilat mund të përmbajnë komponime (bashkëdyzime) organike të halogjenizuara apo metale të rënda si rezultat i trajtimit me konservues druri apo me shtresë mbuluese e që përfshinë, në veçanti, mbeturinat (mbetjet) drusore që rezultojnë prej mbeturinave (mbetjeve) nga ndërtimi dhe demolimi	**Biomass**	Any of the products consisting of any vegetable matter from agriculture or forestry which can be used as a fuel for the purpose of recovering its energy content, or specific types of waste: vegetable waste from agriculture and forestry; from the food processing industry, if the heat generated is recovered; fibrous vegetable waste from virgin pulp production and from production of paper from pulp, if it is co-incinerated at the place of production and the heat generated is recovered; cork waste; and wood waste with the exception of wood waste which may contain halogenated organic compounds or heavy metals as a result of treatment with wood preservatives or coating and which includes, in particular, such wood waste originating from construction and demolition waste	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Biopërtëritje (biosanim)	Trajtimi biologjik i ujërave të ndotura dhe lymit (llumit), duke e nxitur zbërthimin e komponimeve (bashkëdyzimeve) organike dhe hidrokarbureve në dioksid karboni dhe ujë	**Bioremediation**	The biological treatment of waste water and sludge, by inducing the breakdown of organics and hydrocarbons to carbon dioxide and water	Masat	
Biosferë	Paraqet pjesën e korës së Tokës, ujërave dhe atmosferës së saj që mundësojnë jetën në të	**Biosphere**	The part of the earth's crust, waters, and atmosphere that supports life	Menaxhim i ujërave	

SHQIP		ANGLISHT		Temat	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Biosolide	Materiet organike të ricikluara nga ujërat e ndotura shtëpiake, posaçërisht për përdorim në bujqësi si kondicionues të tokës	**Biosolids**	Organic matter recycled from sewage, especially for use in agriculture as soil conditioner	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Biotë, Biocenozë (Bashkësi jetësore)	Të gjithë organizmat e gjallë në një rajon apo ekosistem	**Biota; biocoenosis**	All living organisms in a region or ecosystem	Vlerësim mjedisor	
Bioteknologji	Çdo aplikim i teknologjisë i cili shfrytëzon sistemet biologjike, organizmat e gjallë, apo derivatet e tyre, për të bërë apo modifikuar produktet apo proceset për përdorim të tyrin specifik	**Biotechnology**	Any technological application that uses biological systems, living organisms, or derivatives thereof, to make or modify products or processes for specific use	Masat	
Bllokim	Një obstruksion që e vështirëson apo e bënë të pamundur lëvizjen apo rrjedhjen	**Blockage**	An obstruction that makes movement or flow difficult or impossible	Hidraulikë	
Borë	Reshje në formë kristalesh gjashtëkëndore të degëzuara, shpesh të përziera me kristale të thjeshta akulli, të cilat bien pak a shumë në mënyrë të vazhdueshme nga një shtresë resh solide. Këto kristale mund të bien veç e veç apo në formë tufash të bashkuara që formojnë fjollat e borës	**Snow**	Precipitation in the form of branched hexagonal crystals, often mixed with simple ice crystals, which fall more or less continuously from a solid cloud sheet. These crystals may fall either separately or in cohesive clusters forming snowflakes	Menaxhim i ujërave	
Breg	Është toka që puqet me liqenet, lumenjtë, rezervuarët dhe ujërrjedhat, e cila ndikon apo ndikohet nga këta trupa ujorë	**Shore**	The land that is in contiguity with lakes, rivers, reservoirs and waterflows which affects or is affected by these water bodies	Trupa ujorë	
Bufer	Substancë e cila reagon me hidrogjenin apo me jonet e hidrogjenit në një tretësirë, për të mbajtur pH-në e tretësirës relativisht stabile	**Buffer**	A substance that reacts with hydrogen or hydroxyl ions in a solution, in order to maintain the pH of the solution relatively stable	Cilësi e ujërave	
Bufer mjedisor	Një bufer mjedisor mund të përbëhet nga një sipërfaqe lumi, një rezervuar (akumulim) ujëfurnizues apo nga një sistem ujëmbajtës nëntokësor, i cili shërben për të derdhur në të ujin e ricikluar. Nevoja për një bufer mjedisor është një komponentë me rëndësi për menaxhimin e rrezikut	**Environmental buffer**	An environmental buffer may consist of a stretch of river, a water supply reservoir or a soil aquifer system to which recycled water is added. The need for an environmental buffer is an important component of risk management	Masat	
Bujqësi	Rritja e të gjitha llojeve të drithërave ushqimore komerciale, përshirë ato që përdoren për rritjen e bagëtisë	**Agriculture**	The growing of all types of commercial food crops, including for stock-rearing purposes	Bujqësi dhe ujitje	Directiva 86/278/EEC
Burim pikor i ndotjes	Një pikë e identifikueshme dhe e lokalizuar e emisioneve (në Shqipëri - shkarkimeve) në ajër dhe e shkarkimeve në ujëra siç është p.sh. tubi shkarkues i ujërave të ndotura shtëpiake	**Point source of pollution**	Identifiable and localized point of emissions to air and discharges to water, e.g. a sewage-outflow pipe	Vlerësim i presioneve	Direktiva 2000/60/EC
Burimet difuze të ndotjes[3] (në Shqipëri - burimet e shpërndara)	Burimet e ndotjes të cilat nuk janë të veçuara por burojnë nga një përdorim i gjerë hapësinor i tokës (p.sh. nga bujqësia, vendbanimet, transporti, industria) si dhe shtrihen mbi një sipërfaqe të gjerë gjeografike. Shembuj të burimeve difuze (të shpërndara) të ndotjes janë depozitimi atmosferik, rrjedhjet sipërfaqësore nga bujqësia, erozioni, drenazhimi (kullimi) dhe rrjedhja e ujërave nëntokësore	**Diffuse sources of pollution**	Sources of pollution that are not discrete but originate from a spatially extensive land use (e.g. agriculture, settlements, transport, industry) and extend over a wide geographical area. Examples for diffuse source pollution are atmospheric deposition, run-off from agriculture, erosion, drainage and groundwater flow	Vlerësim i presioneve	Direktiva 2000/60/EC, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006

[3] Burimet difuze të ndotjes - do të thotë burim i shpërndarjes gjithpërfshirëse të ndotjes, jo i lokalizuar, i pa orientuar me prejardhje antropogjene ose natyrore, (**UA** ***"për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave"***, **Neni 3)**

4.3 Cc

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Centrifugim	Një proces separimi, ku përdoret veprimi i forcës centrifugale për të nxitur një fundërrim të përshpejtuar të grimcave në një përzierje të ngurtë-të lëngët	**Centrifugation**	A separation process, which uses the action of centrifugal force to promote accelerated settling of particles in a solid-liquid mixture	Hidraulikë	
Cianobaktere	Një lloj bakteresh të cilët e përftojnë energjinë përmes fotosintezës, dhe janë të vetmit prokariot fotosintetik të aftë për të prodhuar oksigjen. Kur profili i ujërave për larje[4] tregon se ekziston një potencial për proliferim të cianobaktereve [5] (formimi i kolonive të cianobaktereve në formë të lules, në formë të masës së gërshetuara apo në formë të shkumës në apo afër sipërfaqes së ujërave), atëherë duhet të bëhet një monitorim adekuat për të mundësuar identifikimin me kohë të rreziqeve shëndetësore	**Cyanobacteria**	A phylum of bacteria that obtain their energy through photosynthesis, and are the only photosynthetic prokaryotes able to produce oxygen. When the bathing water profile indicates a potential for cyanobacterial proliferation (an accumulation at or near a water surface of cyanobacteria in the form of a bloom, mat or surface scum), appropriate monitoring shall be carried out to enable timely identification of health risks	Ndotje	Direktiva 2006/7/EC
Cikël hidrologjik	Transferi ciklik i avullit të ujit nga sipërfaqja e Tokës përmes evapotranspirimit në atmosferë, prej atmosferës përmes reshjeve në tokë, dhe më pas përmes rrjedhjeve sipërfaqësore në përrenj, lumenj e liqene, dhe përfundimisht në oqeane	**Hydrologic cycle**	The cyclic transfer of water vapor from the Earth's surface via evapotranspiration into the atmosphere, from the atmosphere via precipitation back to earth, and through runoff into streams, rivers, and lakes, and ultimately into the oceans	Menaxhim i ujërave	
Cilësi e ujërave	Karakteristikat kimike, fizike dhe biologjike të ujërave lidhur me sasinë e papastërtive që ato e përmbajnë, gjë që ndërlidhet me atë se sa janë ato të përshtatshme të përdoren për një qëllim të caktuar	**Water quality**	The chemical, physical, and biological characteristics of water with respect to the amount of impurities in it, usually in respect to its suitability for a particular purpose	Cilësi e ujërave	
Curril	Një rrjedhë e fluidit që hedhet (fluron[6]) në mjedisin përreth, zakonisht nga ndonjë grykë, aperturë apo hapje (çarje)	**Jet**	A stream of fluid that is projected into a surrounding medium, usually from some kind of a nozzle, aperture or orifice	Hidraulikë	

[4] **Profili i ujërave për larje** - Shtete Anëtare të BE-së janë të obliguara të informojnë publikun për cilësinë e ujërave për larje dhe për menaxhimin e plazheve nëpërmjet të ashtuquajturave profile të ujërave për larje. Këto profile përmbajnë informata për llojin e ndotjes dhe burimet të cilat ndikojnë në cilësinë e ujërave për larje e që paraqesin rrezik për shëndetin e larësve (si p.sh. shkarkimet e ujërave të ndotura)

[5] **Proliferim i cianobaktereve** - nënkupton grumbullimi e cianobaktereve në formën e lulëzimit, mveshjes ose shkumës (**UA Nr. 20/2015 *"për kriteret për Zonat për Larje "*, Neni 3, paragrafi 1.14 (Legjislacioni i Kosovës**)

[6] Fluron - shkëputet nga trupi që e përmban dhe përhapet në ajër (për një lënde të gaztë)

4.4 Dd

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Degazifikim; degazim	Largimi i gazeve të tretur në ujë siç është dioksidi i karbonit, metani, gazi sulfhidrik dhe oksigjeni. Kjo arrihet duke e vendosur ujin në presion më të ultë sesa presioni atmosferik, apo duke e kaluar ajrin nëpër ujë nën presion atmosferik	**Degasification; degassing**	The removal of dissolved gasses from water such as carbon dioxide, methane, hydrogen sulphide, and oxygen. This can by done by subjecting the water to below atmospheric pressure, or by passing air through the water at atmospheric pressure	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Degë e ujërrjedhës	Një ujërrjedhë apo lumë i cili rrjedh në një lumë tjetër apo trup ujor tjetër, i cili mund të mos derdhet drejtpërdrejt në det	**Tributary**	A stream or river which flows into another river (a parent river) or body of water but which may not flow directly into the sea	Trupa ujorë	
Dehidratim; çhidratim (tharje)	Proces i humbjes apo largimit të ujit apo lagështisë. Gjatë procesit të trajtimit të ujërave të ndotura, posaçërisht, gjatë trajtimit të lymit (llumit), çhidratimi (tharja) e lymit shërben për reduktimin e mëtejshëm të vëllimit dhe masës së tij përmes largimit të ujit të lymit prej zbrazëtive (hapësirave) ndërmjet grimcave përbërëse të tij	**Dehydration; dewatering**	The process of losing or removing water or moisture. In a waste water treatment process, in particular, in the treatment of the sludge, sludge dewatering serves for further reduction of sludge volume and mass by removal of sludge water from interstices between sludge particles	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Dehidratimi (tharja) e lymit (llumit)	Reduktimi i përbërjes së ujit në lym (llum), i cili gjendet qoftë në formë të ujit të lidhur për flok (grumbull papastërtish dhe bakteresh të formuara në fund të procesit të flokulimit) qoftë në formë të ujit kapilar	**Sludge dewatering**	The reduction of floc-bound and capillary water content of sludges	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Dekalcifikim	Largimi i kalciumit, magnezit dhe kationeve të metaleve të tjera të caktuara nga uji i fortë. Uji i butë rezultues është më kompatibil me sapunin dhe e zgjatë jetëgjatësinë e sistemit hidraulik	**Decalcification**	The removal of calcium, magnesium, and certain other metal cations in (hard) water. The resulting soft water is more compatible with soap and extends the lifetime of plumbing	Furnizim me ujë	
Dekantues me prurje radiale	Një dekantues me formë rrethore në të cilin uji i ndotur hyn nga qendra nëpërmjet një tubi nëpër të cilin uji i ndotur ngjitet prej poshtë lart dhe më pas kalon në një tambur të ngjitur për muri. Më pas tamburi i shpërndan ujërat e ndotura nëpër fundin dhe pjesët anësore të tij, dhe efluenti derdhet jashtë një kapërderdhësi rrethues	**Radial flow sedimentation tank**	A circular decanter in which the waste water enters at the centre through an upward flow pipe into a vertical walled drum. The drum distributes the waste water through its bottom and sides, and the effluent flows out over a perimeter weir	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Dekantuesi Dortmund	Një rezervuar i thellë, me pjesën e poshtme në formë koni ku ujërat e ndotura shtëpiake të lëngshme derdhen nga një tub që arrinë gjerë në afërsi të fundit të rezervuarit. Rrjedhja rezultuese që ngrihet lart e ndihmon sedimentimin e lymit (llumit)	**Dortmund tank**	A deep tank, with conical bottom to which liquid sewage is supplied by a pipe reaching down nearly to the bottom. The resulting upward flow assists sedimentation of the sludge	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Dekantuesi Imhoff	Një dhomëz (depozitë) e përshtatshme për pranimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura shtëpiake. Mund të përdoret për filtrimin e këtyre ujërave të ndotura përmes filtrimit të thjeshtë dhe sedimentimit, krahas zbërthimit anaerob të lymit (llumit) të ekstraktuar. Përbëhet nga një dhomëz e sipërme ku kryhet sedimentimi, prej ku lëndët e ngurta të grumbulluara rrëshqasin poshtë me anë të kanaleve të pjerrëta në pjesën e fundme drejt një hyrjeje në një dhomëz të poshtme ku grumbullohet dhe zbërthehet lymi (llumi)	**Imhoff tank**	Chamber suitable for the reception and processing of sewage. It may be used for the clarification of sewage by simple settling and sedimentation, along with anaerobic digestion of the extracted sludge. It consists of an upper chamber in which sedimentation takes place, from which collected solids slide down inclined bottom slopes to an entrance into a lower chamber in which the sludge is collected and digested	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Dekantuesit primar	Rezervuarët e fundërrimit apo sedimentimit primar janë të dizajnuar ashtu që të reduktojnë shpejtësinë e rrjedhjes së ujërave të ndotura, duke mundësuar fundërrimin e lëndëve të ngurta organike me peshë më të madhe (të cilat ndryshe quhen lym (Ilum) i papërpunuar kanalizimesh)	**Primary sedimentation tanks**	The Primary Settlement or sedimentation tanks are designed to reduce the velocity of the wastewater flow, allowing heavier organic solids (called raw sludge) to settle	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Deklaratë mjedisore	Informacioni gjithëpërfshirës i vënë në dispozicion të publikut dhe palëve të tjera të interesuara lidhur me të dhënat në vijim të një organizate: a) strukturën dhe aktivitetet; b) politikën mjedisore dhe sistemin e menaxhimit mjedisor; c) aspektet dhe ndikimet mjedisore; d) programin, objektivat dhe caqet (synimet) mjedisore; dhe e) performancën mjedisore dhe përputhshmërinë me detyrimet ligjore në fuqi që lidhen me mjedisin	**Environmental statement**	The comprehensive information to the public and other interested parties regarding an organisations: a) structure and activities; b) environmental policy and environmental management system; c) environmental aspects and impacts; d) environmental programme, objectives and targets, and e) environmental performance and compliance with applicable legal obligations relating to the environment	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Deklorizim	Largimi i klorit të tepërt apo të lirë nga një ujëfurnizues përmes adsorbimit (ndajthithjes) me karbonin e aktivizuar apo me lëndët filtruese të tipit katalitik	**Dechlorination**	The removal of excess or free chlorine from a water supply by adsorption with activated carbon or by catalytic type filter media	Ujë i pijshëm	
Dekompozim (zbërthim)	Zbërthimi i materieve organike nga bakteret dhe kërpudhat, duke e ndryshuar kështu strukturën e tyre kimike dhe formën e tyre fizike	**Decomposition**	The break down of organic matter by bacteria and fungi, to change the chemical structure and physical appearance of matter	Cilësi e ujërave	
Dekontaminim	Procesi i pastrimit të një objekti, substance apo sipërfaqe duke i larguar, neutralizuar apo shkatërruar kontaminantët (lëndët ndotëse) si mikroorganizmat apo lëndët e rrezikshme, përfshirë kimikatet dhe substancat radioaktive	**Decontamina-tion**	The process of cleansing an object, substance or area by removing, neutralizing, or destroying contaminants such as micro-organisms or hazardous materials, including chemicals and radioactive substances	Probleme mjedisore	
Dendësim (trashje) e lymit (Ilumit)	Është procesi i reduktimit të përbërjes së ujit të lirë në lym. Për dallim prej këtij procesi, dehidratimi apo tharja e lymit i referohet reduktimit të përbërjes së ujit në lym i cili gjendet qoftë në formë të ujit të lidhur për flok (grumbull papastërtish dhe bakteresh të formuara në fund të procesit të flokulimit) apo në formë të ujit kapilar	**Thickening of sludge**	The process of reducing the free water content of sludges; whereas, dewatering refers to the reduction of floc-bound and capillary water content of sludges	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Denitrifikim	Një proces i ndërmjetësuar nga mikrobet ku nitrati reduktohet duke prodhuar në fund azotin molekular (N2) nëpërmjet një vargu ndërmjet-produktesh të gazta të oksideve të azotit	**Denitrification**	A microbially facilitated process where nitrate is reduced and ultimately produces molecular nitrogen (N2) through a series of intermediate gaseous nitrogen oxide products	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Densitet	Densiteti i ujit paraqet masën e ujit për njësinë e vëllimit të tij, që varet nga temperatura e ujit	**Density**	The density of water is the weight of the water per its unit volume, which depends on the temperature of the water	Hidraulikë	
Deoksigjenim, çajrosje	Një reaksion kimik i cili përfshinë largimin e atomeve të oksigjenit nga një molekulë. Një fenomen i padëshiruar i trajtimit biologjik aerob të ujërave të ndotura që shkaktohet nga aktiviteti i aersoleve të cilat shfrytëzojnë oksigjenin për të oksiduar materiet organike	**De-aeration, deoxygenation**	A chemical reaction involving the removal of oxygen atoms from a molecule. An undesirable phenomenon of aerobic biological waste water treatment which is caused by the activity of aerosols that use oxygen to oxidize organic matter	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Deponi (në Shqipëri - Lendfill) [7]	Vendi për deponimin (në Shqipëri - asgjësimin) e mbeturinave (në Shqipëri- mbetjeve) mbi apo nën tokë	**Landfill**	A waste disposal site for the deposit of the waste onto or into land	Ndotje	Direktiva 1999/31/EC
Depozitim i lymit (llumit) organik	Gjatë trajtimit të ujërave të ndotura po ashtu prodhohet edhe lym (llum) nga ngjizja kimike (koagulimi kimik) si dhe separimi (ndarja, veçimi) i papastërtive. Trajtimi dhe deponimi i këtyre lymrave (llumrave) duhen konsideruar si pjesë përbërëse e procesit të trajtimit	**Organic sludge deposit**	Water treatment also produces a sludge from the chemical coagulation and separation of impurities. The treatment and disposal of these sludges should be considered as an integral part of the treatment process		
Depozitim total apo depozitim voluminoz	Masa totale e ndotësve e cila transferohet nga atmosfera në sipërfaqen e tokës, në vegjetacion, në sipërfaqen e ujit, të ndërtesave, etj. në një zonë të caktuar brenda një kohe të caktuar	**Total or bulk deposition**	The total mass of pollutants which is transferred from the atmosphere to surfaces (e.g. soil, vegetation, water, buildings, etc.) in a given area within a given time	Ndotje	Direktiva 2004/107/EC
Detergjent (larës)	Çdo lëndë me aftësi pastruese siç është sapuni, lëndët alkaline, detergjentet sintetikë, tretësit, dhe lëndët abrazive. Detergjentet sintetikë njihen si surfaktant të cilët shkumëzojnë dhe veprojnë si sapunë por nuk përbajnë acide yndyrore dhe hidrokside të metaleve siç është soda kaustike (NaOH) apo hidroksidi i kaliumit (KOH)	**Detergent**	Any material with cleansing powers such as soap, alkaline materials, synthetic detergents, solvents, and abrasives. Synthetic detergents are known as surfactants which foam and act like soap but are not made from fatty acids and lye[8]	Ndotje	
Dezinfektim ultraviolet	Një proces i cili përfshinë ekspozimin e ujërave të kontaminuara ndaj rrezeve ultraviolete të prodhuara nga drita ultraviolete. Drita ultraviolete e bënë inaktivizimin e shpejtë dhe efektivë të mikroorganizmave meqë e depërton murin qelizor të tyre dhe e shkatërron materialin gjenetik të tyre, duke ua pamundësuar kështu riprodhimin	**Ultraviolet disinfection**	A process that involves exposing contaminated water to radiation from UV light. Ultraviolet light provides rapid, effective inactivation of microorganisms as it penetrates an organism's cell walls and disrupts the cell's genetic material, making reproduction impossible	Ujë i pijshëm	
Dezinkim (heqje e zinkut, dealiazhim)	Një formë e korrozionit dhe e dobësimit të objekteve nga tunxhi, ku zinku largohet nga aliazhi i tunxhit. Heqja e zinkut nga aliazhet e bakrit/zinkut, e veçanërisht nga tunxhi i dyfishtë i farkëtuar paraqet problem për industrinë e ujit	**Dezincification**	A form of corrosion and weakening of brass objects in which zinc is dissolved out of the brass alloy. Dezincificationof copper/zinc alloys, particularly forged duplex brass is a problem for the Water Industry	Ujë i pijshëm	
Dezinfektim i ujërave	Proces në të cilin bëhet asgjësimi apo kontrollimi i një përqindjeje të konsiderueshme të organizmave patogjenë të pranishëm në ujërat e ndotura apo në ujin e pijes	**Water disinfection**	A process where a significant percentage of pathogenic organisms in waste water or potable water are killed or controlled	Cilësi e ujërave	
Dëmtim	Një ndryshim i matshëm negativ i cili ndodh në një resurs natyror (në Shqipëri - burim natyror), apo një dëmtim i matshëm i një shërbimi të resursit natyror që mund të ndodh drejtpërsëdrejti apo tërthorazi	**Damage**	A measurable adverse change in a natural resource or measurable impairment of a natural resource service which may occur directly or indirectly	Përmbytje	Direktiva 2004/35/CE

[7] **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës (**Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Neni 4, paragrafi 1.20, Legjislacioni i Kosovës**)
Lendfill - është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë (**Ligji Nr. 10 463 për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Neni 3, paragrafi 16, Legjilsacioni i Shqipërisë**)

[8] **Lye** -a strongly alkaline solution, especially of potassium hydroxide, used for washing or cleansing. Lye is commonly an alternative name of sodium hydroxide or potassium hydroxide , though the term "lye" refers to any member of a broad range of metal hydroxides.
Hidroksidet e metaleve - tretësira të fuqishme alkaline, posaçërisht hidroksidi i kaliumit, që përdoret për larje apo pastrim. Kur thuhet hidrokside të metaleve fjala është për hidroksidin e natriumit (soda kaustike) apo hidroksidin e kaliumit (KOH), edhe pse termi "hidrokside të metaleve"i referohet çdo hidroksidi metali të mundshëm.

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Dëmtim i mjedisit	Çdo dëmtim që ka efekte domethënëse negative në arritjen apo ruajtjen e statusit të favorshëm të ruajtjes së vendbanimeve natyrore (habitateve), llojeve të mbrojtura, apo të trupave ujorë, dhe çdo kontaminim i tokës që shkakton rrezik domethënës për të ndikuar negativisht në shëndetin e njeriut, si pasojë e futjes së drejtpërdrejt apo të tërthortë të substancave, preparateve, organizmave apo mikroorganizmave në tokë, mbi të apo nën të	**Environmental damage**	Any damage that has significant adverse effects on reaching or maintaining the favourable conservation status of natural habitats, protected species or water bodies and any land contamination that creates a significant risk of human health being adversely affected as a result of the direct or indirect introduction, in, on or under land, of substances, preparations, organisms or micro-organisms	Probleme mjedisore	Direktiva 2004/35/CE
Diametër i brendshëm i tubit (gypit)	Madhësia e tubit (gypit) specifikohet me dy numra të papërmasë (jo-dimensional): (a) madhësinë nominale të një tubi dhe me (b) trashësinë nominale të murit të tubit (gypit), ku marrëdhënia në mes këtyre dy numrave e përcakton diametrin e brendshëm të një tubi. Sa i përket madhësisë nominale të gypit, emërtimi "Nominal" i referohet tubit në kushte jo specifike, dhe përcakton diametrin e vrimës me një numër të papërmasë	**Inside pipe diameter**	It is the Nominal Diameter . "Nominal" refers to pipe in non-specific terms and identifies the diameter of the hole with a non-dimensional number.	Furnizim me ujë	
Digë	Një barrierë e ndërtuar për të mbajtur (ndaluar) apo kufizuar ujin dhe për të rritur nivelin e tij, ku rezervuari rezultues më pas përdoret për gjenerim të rrymës elektrike apo për furnizim me ujë	**Dam**	A barrier constructed to retain or confine water and raise its level, the resulting reservoir being used in the generation of electricity or as a water supply	Hidraulikë	Direktiva 2007/60/EC
Disku Secchi	Është mjet apo instrument për matjen e kthjelltësisë së ujërave, që paraqet një matje praktike, tradicionale e kthjelltësisë së ujit, dhe është e ndërlidhur me turbiditetin dhe me thellësinë e zonës biologjike fotike (me dritë). Kjo metodë matjeje konsiston në zhytjen në ujë të një disku jo të tejdukshëm bardhë e zi deri në atë nivel sa nuk shihet më vija e tij ndarëse ndërmjet pjesës së zezë dhe të bardhë	**Secchi Disc**	A practical, traditional measurement of water clarity, and is correlated with turbidity and the depth of the biological photic zone. It consists in an opaque, black and white disk lowered into water until the demarcation between the black and white portions is no longer visible	Monitorim	
Djegie	Djegia është një proces kimik në të cilin një substancë reagon shpejtë në kontakt me oksigjenin me ç'rast vjen deri te lirimi i nxehtësisë	**Combustion**	Combustion is a chemical process in which a substance reacts rapidly with oxygen and gives off heat	Industri	
Drenazhim (kullim) i tokës	Proces nëpërmjet të cilit uji kullohet (drenazhohet) prej tokës së lagësht apo moçalore, apo proces përmes të cilit zvogëlohet shtypja hidrostatike	**Land drainage**	Process to allow water in wet or swampy ground to rapidly drain away or to relieve hydrostatic pressure	Bujqësi dhe ujitje	

4.5 DHdh

ENGLISH		ALBANIAN		Topic	Main references
Term	Definition	Term	Definition		
Dheu (toka)	Është shtresa më e sipërme e korës së Tokës që gjendet ndërmjet shtresës shkëmbore dhe sipërfaqes. Toka përbëhet nga grimcat minerare, materiet organike, uji, ajri dhe organizmat e gjallë	**Soil**	The top layer of the Earth's crust situated between the bedrock and the surface. The soil is composed of mineral particles, organic matter, water, air and living organisms	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 2010/75/EU
Dhjamërat dhe yndyrat	Totali i vajrave dhe yndyrave të nxjerra nga tretësit e lëngshëm apo suspensionet, sipas procedurave laboratorike të përcaktuara dhe që përfshin, por nuk kufizohet vetëm me, hidrokarburet, vajrat, dhjamërat, dyllin, si dhe acidet yndyrore me densitet të lartë molekular.	**Greases and fats**	Total of oils and fats extracted from liquid solvents or suspensions according to determined laboratory procedures and which includes, but is not limited to, hydrocarbons, oils, greases, waxes and fatty acids with high molecular densities	Ndotje	
Dhomë pranuese e ujërave të ndotura	Paraqet njësinë e parë të trajtimit primar të ujërave të ndotura. Dhoma e këtillë kryesisht përdoret për të kontrolluar shpejtësinë e influentit të papërpunuar si dhe për të siguruar rrjedhjen e tij të njëtrajtshme drejt kanalit me 'sitë me vrima të imta'	**Inlet chamber**	It is the first unit of primary waste water treatment. The inlet chamber is mainly used to control the velocity of raw influent and also for its smooth distribution of flow to the fine screen channel	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.6 Ee

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Efekti i absorbimit të përmbytjes nga një rezervuar	Një reduktim në shkarkimin e një përmbytjeje, me magazinimin e ujit në një rezervuar	**Flood absorption effect (of a reservoir)**	A reduction in a flood discharge by the storage of water in a reservoir	Përmbytje	
Efiçienca e grumbullimit	Fraksioni i pikëzave që i afrohen një sipërfaqeje e që faktikisht depozitohen në atë sipërfaqe	**Collection efficiency**	The fraction of droplets approaching a surface that actually deposit on that surface	Hidraulikë	Fjalor i Ndryshimeve Klimatike (2014)
Efiçiencë	Efiçienca paraqet një nivel performance ku me një kontribut (angazhim) minimal prodhohen rezultate maksimale	**Efficiency**	Efficiency is a level of performance that uses the lowest amount of inputs to create the greatest amount of outputs	Menaxhim i ujërave	
Efluent[9] (ujërat e shkarkimeve, ndotësitë e lëngët)	Lëngë (p.sh. ujërat e ndotura të trajtuara apo të patrajtuara) i cili derdhet (shkarkohet) nga një hapësirë e mbyllur apo pas një procesi	**Effluent**	Liquid (e.g. treated or untreated waste water) that flows out of a process or confined space	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ekoregjion	Një tërësi e madhe toke apo uji që përmban një grupim gjeografikisht të veçantë të llojeve, komuniteteve natyrore, dhe të kushteve mjedisore. Ekoregjioni mbulon një zonë brenda së cilës bashkëveprojnë fuqishëm procese të rëndësishme ekologjike dhe evolutive	**Ecoregion**	A large unit of land or water containing a geographically distinct assemblage of species, natural communities, and environmental conditions, encompassing an area within which important ecological and evolutionary processes most strongly interacts	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Ekosistem[10]	Një grup kompleks marrëdhëniesh në mes të organizmave të gjallë, vendbanimeve natyrore (habitateve) dhe banorëve të një zone. Ekosistemi përfshinë drunjtë, bimët, kafshët, peshqit, shpendët, mikroorganizmat, ujin, tokën dhe njerëzit. Komunitetit i organizmave dhe mjedisi i tyre fizik bashkëveprojnë ndërmjet vete si një njësi ekologjike	**Ecosystem**	A complex set of relationships among the living resources, habitats, and residents of an area. It includes trees, plants, animals, fish, birds, microorganisms, water, soil and people. The community of organisms and their physical environment interact as an ecological unit	Zona të mbrojtura	
Ekosistemi i varur nga ujërat nëntokësore	Një ekosistem që deri diku për mbijetesën e vet mbështetet në ujërat nëntokësore	**Groundwater dependent ecosystem**	An ecosystem that relies on groundwater, to some degree, for its survival	Probleme mjedisore	
Ekotoksike	Mbeturinat (në Shqipëri -mbetjet) të cilat paraqesin apo mund të paraqesin rreziqe të menjëhershme apo të vonuara për një apo më tepër sektorë të mjedisit	**Ecotoxic**	Waste which presents or may present immediate or delayed risks for one or more sectors of the environment	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Eksploziv (lëndë plasëse)	Substancat dhe preparatet të cilat mund të eksplodojnë nën efektin e flakës apo të cilat janë më të ndjeshme ndaj goditjeve apo fërkimit sesa dinitrobenzeni	**Explosive**	Substances and preparations which may explode under the effect of flame or which are more sensitive to shocks or friction than dinitrobenzene	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Ekuacioni i Bernulit	Ekuacioni i Bernulit paraqet parimin e ruajtjes së energjisë që i përgjigjet rrjedhjes së fluideve (lëngjeve dhe gazeve). Në dinamikën e fluideve, parimi i Bernulit thotë se një rritje në shpejtësinë e një fluidi ndodh njëkohësisht me zvogëlimin e presionit të tij apo me zvogëlimin e energjisë potenciale të fluidit	**Bernoulli equation**	The Bernoulli Equation can be considered to be a statement of the conservation of energy principle appropriate for flowing fluids. In fluid dynamics, Bernoulli's principle states that an increase in the speed of a fluid occurs simultaneously with a decrease in pressure or a decrease in the fluid's potential energy.	Hidraulikë	Fjalor i Koncepteve të Hiperfizikës

[9] **Efluent** - do të thotë çdo shkarkim apo depozitim, drejtpërdrejt apo tërthorazi i ujërave të tepërta të përdorura, të ndotura, mbeturinave, produkteve e nënprodukteve kimike, industriale apo substancave tjera, pavarësisht nga natyra e tyre në rezervat ujore në tokë, nëntokë, apo vende te gërmuara (UA **Nr.13/2008 për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujor dhe në rrjetin e kanalizimitpublik, Neni 3, Legjislacioi e Kosovës**)

[10] **Ekosistem** – kompleks dinamik pak a shumë i kufizuar hapësinor i biocenozave dhe mjedisit abiotik i cili bashkëvepron si tërësi funksionale (**Ligji për Mbrojtne e Natyrës Nr.03/L-233, Neni 7, paragrafi 1.4, Legjislacioni i Kosovës**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ekuivalent për milion, e.p.m	Njësi e peshës së një substance të tretur për milion njësi të peshës së tretësirës. E.p.m. e një substance të tretur në një tretësirë është e barabartë me p.p.m. (pjesë për milion) pjesëtuar për peshën e saj ekuivalente	**Equivalent per million**	The unit chemical weight of solute per million unit weights of solution. The epm of a solute in solution is equal to the ppm (parts per million) divided by the equivalent weight	Cilësi e ujërave	
Ekuivalent popullsie (p.e.)	Një masë matëse e ndotjes që parqet ngarkesën mesatare organike të biodegradueshme për person për një ditë. Po ashtu përkufizohet edhe si ngarkesa organike e biodegradueshme, që ka kërkesë pesëditore për shpenzimin biokimik të oksigjenit $SHBO_5$ (BOD_5) prej 60g oksigjen në ditë	**Population equivalent**	A measure of pollution representing the average organic biodegradable load per person per day. It is also defined as the organic biodegradable load having a five-day biochemical oxygen demand (BOD_5) of 60 g of oxygen per day	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Elektrodializë	Një proces i cili përdorë rrymën elektrike e cila aplikohet në membranat permeabile (të përshkueshme) për të larguar mineralet nga uji	**Electrodialysis**	A process that uses electrical currents, applied to permeable membranes, to remove minerals from water	Ndotje	
Elementet e cilësisë	Elemente të cilat duhet të përdoren për vlerësimin e statusit ekologjik (p.sh. për përbërjen dhe begatinë e faunës së invertebrorëve bentik). Elementet e cilësisë përfshijnë elementet e cilësisë biologjike dhe elementet e cilësisë hidromorfologjike, kimike dhe fiziko-kimike, të cilat i mbështesin elementet e cilësisë biologjike	**Quality element**	Elements that must be used for the assessment of ecological status (eg. composition and abundance of benthic invertebrate fauna). Quality elements include biological elements and elements supporting the biological elements, which are 'hydromorphological' and 'chemical and physicochemical'	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Eliminimi i fosfateve	Paraqet largimin e fosforit nga ujërat e ndotura shtëpiake. Rreth 20% e fosforit (në formë fosfatesh) largohet me anë të sedimentimit dhe 20% tjetër largohet përmes aktivitetit bakterial gjatë trajtimit sekondar të këtyre ujërave të ndotura. Largimi më në tërësi i fosforit mund të arrihet me anë të shtimit të kripërave të kalciumit, aluminit apo të hekurit. Nëse këto komponime shtohen para futjes së ujërave të ndotura në dekantuesin primar, mungesa e fosforit mund të çojë në zvogëlim të efikasitetit gjatë trajtimeve biologjike, ndërsa nëse këto kimikate shtohen gjatë trajtimit biologjik, do të ndodhë precipitimi i tyre në dekantuesin sekondar	**Phosphate elimination**	It is the removal of phosphorus from domestic waste water. About 20% of phosphorus (in the form of phosphates) is removed by sedimentation and another 20% by bacterial activity in secondary treatment. A more complete removal of phosphorus can be achieved by adding calcium, aluminum or iron salts. If these compounds are added before the primary decanter, the lack of phosphorus can lead to decreased efficacy during biological treatments, and if these chemicals are added during biological treatment, their precipitation in the secondary decanter will occur	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Emision[11] (në Shqipëri - shkarkim)	I drejtpërdrejtë ose i tërthortë i substancave ndotëse si dridhjeve, nxehtësisë, organizmave ose mikroorganizmave apo zhurmës nga burimet individuale ose të shpërndara nga instalimet në ajër, ujë ose tokë duke përfshirë edhe "shkarkimet" (shih përkufizimin "Discharge - Shkarkim")	**Emission**	The direct or indirect release of polluting substances, vibrations, heat, organisms or micro-organisms or noise from individual or diffuse sources in the installations into air, water or land including "discharges" (see the definition "discharge")	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2004/35/CE , Direktiva 2010/75/EU

[11] **Emision** - nënkupton shkarkimin direkt ose indirekt të substancave, vibracioneve, nxehtësisë ose zhurmës nga burimet individuale ose ato shpërndarëse të një impianti në ajër, ujë ose tokë **(Ligji Nr. 03/L-043 mbi Parandalimin dhe Kontollin e Integruar të Ndotjes, Neni 2, Legjilsacioni i Kosovës)**
Shkarkim - është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.(**Ligji Nr. 10 431 për Mbrojtjne e Mjedisit, Neni 5, paragrafi 18, Legjislacioni i Shqipërisë**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Erë e keqe	Ndjesi që vjen si rezultat i pranisë së substancave që kanë një shtypje avulli të ndjeshme dhe të cilat stimulojnë organet shqisore të njeriut në zgavrën e hundës dhe në hapësirat sinusale. Uji i pijes duhet të jetë i pastër dhe pa erë që të jetë i denjë për konsumim	**Odour**	Sensation that is due to the presence of substances that have an appreciable vapour pressure and that stimulate the human sensory organs in the nasal and sinus cavities. Drinking water should be purely and fit for consumption and therefore odourless	Ndotje	
Erozion[12]	Proces i erodimit apo i gërryerjes nga era, uji, apo agjentët e tjerë natyror. Në kuptim të mjedisit ujor, erozioni paraqet shkatërrimin e shkëmbinjve dhe të tokës nga veprimtaria e ujërave, që sjell thellimin (erozionin vertikal) apo zgjerimin e shtratit të rrjedhës	**Erosion**	The process of eroding or being eroded by wind, water, or other natural agents. In the water environment context, it is the destruction of rocks and soil by the activity of water, that brings deepening (vertical erosion) or enlargement of the flowing basin	Probleme mjedisore	
Escherichia coli (E. Coli)	Bakter në formë shkopi (baktere koliforme) me gjatësi prej 2-4 µm dhe me diametër prej rreth 1 µm. E. coli është florë normale në zorrën e njeriut dhe përbënë 90% të grupit të baktereve koliforme që ndodhen në feces (feçe). Ujërat e pijshëm nuk duhet të përmbajnë E.coli pasi ky patogjen i rrezikshëm mund të shkaktojë sëmundje që çojnë në dëmtim të mëlçisë dhe veshkave	**Escherichia coli**	A rod-shaped bacterium with a length of 2 to 4 µm and a diameter of ca. 1 µm. E. coli constitutes the normal flora of the human gut, and represent 90% of the coliform bacteria that are found in feces. Drinking water shall not contain E.coli, as it is a dangerous pathogen that poses threat to human health by causing liver and kidney damage	Ndotje	
Estuarë	Është zona kalimtare në grykëderdhjen e një lumi ndërmjet ujërave të ëmbla dhe ujërave bregdetare	**Estuary**	The transitional area at the mouth of a river between fresh-water and coastal waters	Trupa ujorë	Direktiva 91/271/EEC
Euglenophyta, phytoflagellate protozoare	Një grup algash njëqelizore me fshikuj, të cilat janë fotosintetike dhe heterotrofike që kryesisht i popullojnë ujërat e ëmbla (p.sh. Euglena, e cila mund të jetë e bollshme në ujërat e ndenjura të pasura me lëndë ushqyese si p.sh. në pellgoret e stabilizimit të mbeturinave)	**Euglenophyta, phytoflagellate protozoa**	A group of unicellular algae with flagella, which are both photosynthetic and heterotrophic mostly inhabiting fresh water (e.g. Euglena, which can be abundant in stagnant, nutrient rich waters such as waste stabilisation ponds)	Status i trupave ujorë	
Eutrofikim	Është pasurimi, ngarkimi ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime të azotit dhe/ose të fosforit, duke shkaktuar kështu një rritje të shtuar të algave dhe formave më të larta bimore që shkaktojnë një çrregullim të padëshirueshëm në ekuilibrin e organizmave të pranishëm në ujë, si dhe të cilësisë së këtij uji	**Eutrophication**	The enrichment of water by nutrients, especially compounds of nitrogen and/or phosphorus, causing an accelerated growth of algae and higher forms of plant life to produce an undesirable disturbance to the balance of organisms present in the water and to the quality of the water concerned	Probleme mjedisore	Direktiva 91/676/EEC, Direktiva 91/271/EEC
Evapotranspirim	Shuma e avullimit dhe transpirimit	**Evapo-transpiration**	The sum of evaporation and transpiration	Menaxhim i ujërave	

[12] **Erozion** - shkatërrim i shkëmbinjve nga veprimtaria e ujërave, që sjell thellimin apo zgjërimin e shtratit të rrjedhës (**Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat, Neni 4, paragrafi 1.7, Legjislacini i Kosovës**)

4.7 Ff

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Faktori i sigurisë	Shpreh kapacitetin e bartjes së një ngarkese nga një sistem përtej ngarkesave të pritshme apo atyre ekzistuese, duke matur në këtë mënyrë se sa më i fortë është një sistem sesa që realisht nevojitet të jetë për një ngarkesë të synuar (planifikuar)	**Factor of safety**	It describes the load carrying capacity of a system beyond the expected or actual loads, thus it measures how much stronger the system is than it usually needs to be for an intended load	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Fauna invertebrore bentonike	Organizmat shtazorë invertebrorë që jetojnë për të paktën një pjesë të ciklit të tyre jetësor në substratet bentonike të lumenjëve, liqeneve, ujërave kalimtare (në Shqipëri - ujërat e përkohshme) apo të ujërave bregdetare	**Benthic Invertebrate Fauna**	Invertebrate animals living at least for part of their lifecycles or in the benthic substrates of rivers, lakes, transitional waters or coastal waters	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Fermentim	Një proces metabolik i cili konsumon sheqer në mungesë të oksigjenit ndërsa produktet e tij janë acidet organike, gazet apo alkoolet	**Fermentation; fermenting**	A metabolic process that consumes sugar in the absence of oxygen. The products are organic acids, gases, or alcohol	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Fiksimi i azotit	Proces i realizuar nga bakteret që e fiksojnë azotin, ku azoti atmosferik shndërrohet në azot të fiksuar (komponime inorganike që përdoren nga bimët)	**Fixation of nitrogen**	Process carried out by Nitrogen-fixing bacteria of transforming atmospheric nitrogen into fixed nitrogen (inorganic compounds usable by plants)	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Filtër ajri	Një filtër i përbërë nga lëndë fibroze i cili i largon nga ajri grimcat e ngurta si pluhurin, polenin, mykun dhe bakteret	**Air filter**	A filter composed of fibrous materials which removes solid particulates such as dust, pollen, mould, and bacteria from the air	Ndotje	
Filtër (sitë) cilindrike, sitë tamburi	Një enë cilindrike në formë daulleje(tamburi) e përbërë nga çeliku që nuk zë ndryshk, e cila rrotullohet duke larguar lëndët e ngurta. Kjo teknikë është e qëlluar për përzierjet gjysmë të lëngshme (përzierjet e lëndëve të ngurta në formë pluhuri me një lëngë, kryesisht ujë) dhe për lëngjet me përbërje të lartë të lëndëve të ngurta, të cilat mund të bllokojnë format e tjera të filtrave, andaj ky lloj filtri (site) është i dobishëm për largimin e lëndëve të ngurta nga ujërat e ndotura në hyrje të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura	**Drum screen**	A cylindrical drum shaped container made of non-rusting steel which rotates by removing solids. The technique is well suited to slurries, and liquids with a high solid content, which could clog other forms of filter so it is useful to remove solids from waste water at the entrance of the waste water treatment plant	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Filtër i karbonit të aktivizuar	Filtra që zakonisht përdoren në procesin e largimit të komponimeve (bashkëdyzimeve) organike dhe/ose heqjen e klorit të lirë nga uji	**Activated carbon filter**	Filters usually employed in the process of removing organic compounds and/or extracting free chlorine from water.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Filtër rëre	Një pajisje e cila i largon lëndët e ngurta të suspenduara (pezullitë) nga efluenti i një impianti të trajtimit të ujërave të ndotura	**Sand filter**	Device that removes suspended solids from a waste water treatment plant effluent	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Filtër shirit	Pajisje që bënë kompresimin e lymit (llumit) ndërmjet dy brezave lëvizës, që çon në tharjen e lymit (llumit)	**Belt press**	Equipment that carries out sludge compression between two moving streaks, leading to sludge drying	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Filtrim	Cilado prej proceseve të ndryshme mekanike, fizike apo biologjike e cila i ndanë materiet e ngurta nga fluidet (lëngjet apo gazet) përmes shtimit të një mediumi nëpër të cilin vetëm fluidi mund të depërtojë	**Filtration**	Any of various mechanical, physical or biological operations that separate solids from fluids (liquids or gases) by adding a medium through which only the fluid can pass	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Filtrim	Lëvizja e ujit nëpër të çarat e shkëmbinjve apo tokës. Filtrimi paraqet edhe depërtimin e një pjesë të rrjedhës së ujit nëpër lëndët përbërëse të shtratit të ujërrjedhës duke kontribuar kështu në shtimin e sasisë së ujërave nëntokësore	**Percolation**	The movement of water through the openings in rock or soil. It is also the entrance of a portion of the streamflow into' the channel materials to contribute to groundwater replenishment	Hidraulikë	
Filtrim intermitent i rërës	Një lloj i trajtimit në tokë të ujërave të ndotura ku përdoren shtretër të cektë rëre (me thellësi prej 600 deri në 750 mm). Ky proces mund të përdoret për të trajtuar ujërat e ndotura të sedimentuara apo për trajtimin e mëtutjeshëm të efluentti të ujërave të ndotura, apo të efluentit të gropave septike	**Intermittent sand filtration**	A type of land treatment of waste water that consists of shallow beds of sand (600 to 750 mm deep). The process can be used to treat settled waste water or further treat waste water effluent or a septic tank effluent	Masat	
Filtrim membranor	Proces në të cilin uji nën presion të lartë kalon nëpër një membranë të përshkueshme (permeabile), të përbërë nga një material i hollë me pore shumë të vogla, e cila i ndalon grimcat e vogla (përfshirë bakteret) duke bërë kësisoj dezinfektimin e ujërave të ndotura	**Membrane filtration**	Process in which water under high pressure is forced through a permeable membrane, a thin material with very small pores, stopping small particles (including bacteria, so that waste-water can be disinfected in this way)	Ujë i pijshëm	
Filtrim përmes sitave (sitje) e ujërave të ndotura	Operacioni i parë që përdoret në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, me qëllim të largimit të copëzave me përmasa të mëdha siç janë fragmentet, letra, plastika dhe metalet, ashtu që të pengohet dëmtimi dhe bllokimi i pajisjeve, tubacioneve dhe i pajisjeve shtesë në pjesën e poshtme të rrjedhës	**Screening (waste water)**	The first unit operation used at waste water treatment plants (WWTPs), to remove large size objects such as rags, paper, plastics, and metals to prevent damage and clogging of downstream equipment, piping, and appurtenances	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Fitobentos	Nënkupton bimët vaskulare, organizmat heterotrofik dhe algat fotosintetike (përfshirë cianobakteret) të cilat jetojnë në apo janë të fiksuara për një substrat apo organizma të tjerë në ujërat sipërfaqësore. Paraqet një element të cilësisë biologjike që përdoret në klasifikimin e statusit ekologjik të trupave ujorë sipërfaqësorë	**Phytobenthos**	Vascular plants, heterotrophic organisms and photosynthetic algae (including cyanobacteria) living on or attached to substrate or other organisms in surface waters. It is a biological quality element for classification of ecological status of surface water bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Fitoplankton	Algat njëqelizore dhe cianobakteret, si të vetme apo në formë kolonish, të cilat jetojnë të paktën për një pjesë të ciklit të tyre jetësor, në shtyllën ujore të trupave ujorë sipërfaqësorë. Paraqet një element të cilësisë biologjike që përdoret në klasifikimin e statusit ekologjik të trupave ujorë sipërfaqësorë	**Phytoplankton**	Unicellular algae and cyanobacteria, both solitary and colonial, that live, at least for part of their lifecycle, in the water column of surface water bodies. It is a biological quality element for classification of ecological status of surface water bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Flanxhë	Një metodë e lidhjes së tubave (gypave), valvuleve, pompave dhe pajisjeve të tjera për të formuar një sistem tubash, duke mundësuar kështu një çasje më të lehtë për pastrimin, inspektimin apo modifikimin e tyre	**Flange**	A method of connecting pipes, valves, pumps and other equipment to form a piping system. It also provides easy access for cleaning, inspection or modification	Furnizim me ujë	
Flokulim	Një proces ku koloidet dalin prej një suspensioni në formë flokësh apo fjollash, qoftë spontanisht apo për shkak të shtimit të një agjenti pastrues (filtrues)	**Flocculation**	A process wherein colloids come out of suspension in the form of floc or flake, either spontaneously or due to the addition of a clarifying agent	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Flokulues, flokëformues	Reagensë fiziko-kimik siç janë polielektrolitët të cilët nxisin bashkimin (grumbullimin) e grimcave, veçanërisht reagensët që përdoren në trajtimin e ujërave të ndotua me qëllim të sedimentimit apo filtrimit të grimcave nga uji. Një flokulues mund të veprojë edhe si koagulant	**Flocculant**	Physico-chemical reagents such as polyelectrolytes that promotes the clumping of particles, especially one used in treating waste water in order to settle or filter particles from the water. A flocculant can also act as a coagulant	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Flotacion me tretje të ajrit	Një proces i trajtimit të ujërave i cili i filtron ujërat e ndotura përmes heqjes së lëndëve të suspenduara në to, siç janë vajrat apo lëndët e ngurta. Heqja e tyre arrihet përmes tretjes së ajrit nën presion në ujërat apo ujërat e ndotura dhe më pas me lëshimin e ajrit nën presion atmosferik në një rezervuar apo pellgore flotacioni	**Dissolved air flotation**	A water treatment process that clarifies waste waters (or other waters) by the removal of suspended matter such as oil or solids. The removal is achieved by dissolving air in the water or waste water under pressure and then releasing the air at atmospheric pressure in a flotation tank or basin	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Fluks	Tek filtrimi me rrjedhje kryqëzore (ndryshe të quajtur filtrim me rrjedhje tangjenciale), fluksi paraqet prurjen rezultuese përmes osmozës reverse, elektrodializës apo membranës ultrafiltruese. Zakonisht shprehet me njësinë e vëllimit për njësinë e kohës dhe të sipërfaqes së membranës	**Flux**	In crossflow filtration (also referred to as tangential flow filtration), it is the product flow rate through a reverse osmosis, electrodialysis or ultrafiltration membrane. It is usually given in terms of volume unit per time per membrane area	Ujë i pijshëm	
Formim boshllëku	Formimi dhe shkatërrimi i shpejtë i flluskave (bulëzave) të gazit apo avujve në lëngjet rrjedhëse në zonat me presion shumë të ulët në një tubacion, që është një prej shkaktarëve të shpeshtë të dëmtimeve strukturore të helikave, pompave, etj. Kjo mund të ndodhë gjatë kohës që presioni reduktohet nga shpejtësia e madhe e prurjes dhe zakonisht është bashkëpjesëmarrës në fenomenin e korrozionit	**Cavitation**	The rapid formation and collapse of vapor pockets in a flowing liquid in regions of very low pressure, a frequent cause of structural damage to propellers, pumps, etc. It can happen while the pressure is reduced by the high speed of flow. Usually conjoined in the corrosion phenomenon	Hidraulikë	
Fortësi e ujit	Përqendrimi total i joneve të kalciumit dhe magnezit të pranishme në ujë. Komponimet e hekurit, magnezit dhe stronciumit po ashtu kontribuojnë në fortësinë e ujit, e cila zakonisht matet me ppm $CaCO_3$. Uji me fortësi mbi 80 ppm $CaCO_3$ zakonisht trajtohet me një zbutës uji (antibigorr) ashtu që të mos krijojë gëlqere në tubat nëpër të cilët kalon, dhe të mos ndikojë në efikasitetin e detergjenteve larëse	**Hardness (of water)**	Total concentration of calcium and magnesium ions present in water. Iron, magnesium and strontium compounds also contribute to water hardness, which is usually measured with ppm $CaCO_3$. Water with a hardness of over 80 ppm $CaCO_3$ is usually treated with a water softener so as not to create mortar when passing water to the pipes and not affect the effectiveness of washing detergents	Cilësi e ujërave	
Fosfor	Është njëra prej lëndëve ushqyese kryesore të baktereve dhe organizmave shtazorë, i cili gjendet natyrshëm në ujë, zakonisht në formë të ortofosfatit. Veprimtaria e njeriut është shkaktar i pranisë së ortofosfateve dhe formave të tjera të fosforit në ujërat e ndotura	**Phosphorus**	It is a major nutrient for bacteria and animals, and occurs naturally in water, usually as orthophosphates. Human activity adds these and other forms of phosphorus to waste waters	Ndotje	
Fragmentim i vendbanimeve natyrore (habitateve)	Është një term i përbashkët për gjithë procesin përmes të cilit humbja e vendbanimeve natyrore (habitateve) rezulton në ndarjen e vendbanimeve natyrore të mëdha e të pandërprera në një numër të madh parcelash të vogla me sipërfaqe të përgjithshme më të vogël, që janë të izoluara prej njëra tjetrës me një matricë vendbanimesh natyrore të pangjashme, dhe nuk paraqet vetëm një strukturë të radhitjes hapësinore të vendbanimit natyror që mbetet	**Fragmentation (of habitat)**	The complete process by which habitat loss results in the division of large, continuous habitats into a greater number of smaller patches of lower total area, isolated from each other by a matrix of dissimilar habitats, and is not just the pattern of spatial arrangement of remaining habitat	Probleme mjedisore	
Fundërrim (heqja e fundërrive)	Trajtimi paraprak i ujërave të ndotura të pa trajtuara, përmes një metode sedimentimi për 0.5 deri në 1 orë, e cila përdoret për ujërat me turbiditet të lartë përpara se efluenti të drejtohet për në klarifikator (pastrues,pajisje për filtrimin e ujërave të ndotura)	**Desilting**	Pre-treatment of untreated waste water by a sedimentation method for 0.5-1 hours, which is used for high-turbidity waters before the effluent is directed to the clarificator	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Furnizim me ujë	Ofrimi i ujit nga shoqëritë tregtare të kompanive publike, nga iniciativat e komunitetit apo individët, të cilat furnizohen përmes një "sistemi të furnizimit me ujë"	**Water supply**	The provision of water by public utilities commercial organisations, community endeavors or by individuals, usually via a "water supply system"	Furnizim me ujë	

4.8 Gg

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Gaz deponie (lendfilli)	Të gjitha gazet të cilat gjenerohen nga mbeturinat (mbetjet) e deponisë (në Shqipëri - lendfillit)	**Landfill gas**	All the gases generated from the landfilled waste	Ndotje	Direktiva 1999/31/EC
Gazveçues	Një pajisje e cila përmes një lakese në formë sifoni e kap ujin duke penguar në këtë mënyrë që gazet që gjenden në tubat e kanalizimit të futen në ndërtesa, përderisa e lejon kalimin nëpër të të ujërave të ndotura	**Trap**	A device which uses a bending path to capture water to prevent sewer gases from entering buildings, while allowing waste to pass through	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Gërryerje nga uji	Veprimi eroziv i ujërave që rrjedhin në ujërrjedha, i cili veprim gërryen dhe rrëmben përpara materialet nga shtrati dhe brigjet e këtyre ujërrjedhave	**Scour**	The erosive action of running water in streams, which excavates and carries away material from the bed and banks	Probleme mjedisore	
Gradient hidraulik	Vija e cila i bashkon pikat e elevacionit (ngritjes) më të lartë të ujit në një varg tubash (gypash) vertikal të hapur, të cilët ngriten nga një tubacion nëpër të cilin uji rrjedh nën presion	**Hydraulic gradient**	A line joining the points of highest elevation of water in a series of vertical open pipes rising from a pipeline in which water flows under pressure.	Hidraulikë	
Gradient hidraulik i ujërave nëntokësore	Një gradient vektorial ndërmjet dy apo më shumë matjeve të presionit hidraulik përgjatë gjatësisë së trajektores së rrjedhës. Ndryshe quhet edhe 'pjerrësia Darcy-Darcy-slope', meqë e përcakton sasinë e fluksit Darcy apo të shkarkimit	**Hydraulic gradient (groundwater)**	A vector gradient between two or more hydraulic head measurements over the length of the flow path. It is also called the 'Darcy slope', since it determines the quantity of a Darcy flux or discharge	Monitorim	
Gradient i presionit (shtypjes)	Një madhësi fizike e cila tregon se në cilin drejtim dhe me çfarë shpejtësie ndryshon shtypja më së shpejti në një lokacioni të caktuar. Shprehet me njësinë e shtypjes për njësinë e gjatësisë (Pa/m)	**Pressure gradient**	A physical quantity that describes which direction and at what rate the pressure changes the most rapidly around a particular location. The pressure gradient is a dimensional quantity expressed in units of pressure per unit length, or Pa/m	Hidraulikë	
Gropë septike	Rezervuar (depozitë, kontejner) nëntokësor i ujërave të ndotura shtëpiake. Bakteret në ujërat e ndotura i dekompozojnë (zbërthejnë) mbeturinat organike (në Shqipëri - mbetjet organike), dhe lymi (llumi) fundërron në fund të rezervuarit, i cili në mënyrë periodike largohet prej aty. Efluenti rrjedh jashtë këtij rezervuari duke u shpërndarë në tokë nëpërmjet tubave të drenazhimit	**Septic tank**	Underground receptacle for domestic waste water. The bacteria in the sewage decompose the organic wastes, and the sludge settles to the bottom of the tank and has to be removed periodically. The effluent flows out of the tank into the ground through drain lines	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Grupe interesi	Një person, grup apo organizatë të cilët kanë interes, apo shqetësohen, apo luajnë rol ose ndikohen nga shërbimi apo arritja e objektivave të një organizate. Këtu përfshihen punonjësit, konsumatorët, furnizuesit, komunitetet, individët e veçantë madje edhe konkurrentët	**Stakeholder**	A person, group or organization that has interest or concern or plays a role or is affected by the service or achievement of an organization's objectives. This includes employees, consumers, suppliers, communities, individuals, and even competitors	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	
Gur sedimentar	Gur i formuar nga sedimentet, posaçërisht: (a) gurët ranor dhe argjila shistore (shisti), që formohen nga fragmentet e gurëve të tjerë të cilët janë transportuar nga burimi i tyre dhe janë depozituar në ujë, si dhe (b) gurët e formuar nga sekrecionet e organizmave, siç janë shumica e gurëve gëlqerorë	**Sedimentary rock**	Rock formed of sediment, and specifically sandstone and shale, formed of fragments of other rock transported from their sources and deposited in water, and rocks formed by or from secretions of organisms, such as most limestone	Bujqësi dhe ujitje	
Gurë ranor	Paraqesin rërën në ujërat e ndotura. Termi "rërë" përfshin vet rërën, zhavorrin, hirin, grimcat metalike, xhamin, dheun nga shpëlarja e tokës, etj.	**Grit**	Sand in the waste waters. The term "sand" includes the sand itself, gravel, ashes, metal particles, glass, seeds, etc.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.9 GJgj

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Gjendja themelore (dëmtimi i mjedisit)	Gjendja e cila do të mbizotëronte në kohën e dëmtimit të resurseve (në Shqipëri-burimeve) dhe shërbimeve natyrore në rast se nuk do të ndodhte dëmtimi i mjedisit, vlerësuar në bazë të informacionit më të mirë në dispozicion	**Baseline condition (environmental damage)**	The condition at the time of the damage of the natural resources and services that would have existed had the environmental damage not occurred, estimated on the basis of the best information available	Vlerësim i ndikimit	Direktiva 2004/35/CE
Gji i ngushtë	Një thellim në vijën bregdetare, zakonisht i gjatë dhe i ngushtë, si një gji i vogël apo një zgjatje e ngushtë e detit, e cila shpeshherë krijon një trup të mbyllur të ujit të njelmët, siç është p.sh. ngushtica, gjiri, laguna apo këneta	**Inlet**	An indentation of a shoreline, usually long and narrow, such as a small bay or arm, that often leads to an enclosed body of salt water, such as sound, bay, lagoon, or marsh	Menaxhim i ujërave	

4.10 Hh

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Halofite	Bimë të cilat rriten në ujërat me kripshmëri të lartë, të cilat vijnë në kontakt me ujëra të njelmëta përmes rrënjëve të tyre apo nga spërkatja me kripë, siç ndodh në gjysmë shkretëtirat e njelmëta, moçalet e rizoforeve, kënetat dhe baltinat (moçalishtet) si dhe brigjet e detit	**Halophytes**	Plants that grow in waters of high salinity, coming into contact with saline water through its roots or by salt spray, such as in saline semi-deserts, mangrove swamps, marshes and sloughs and seashores	Zona të mbrojtura	
Hartat e Rrezikshmërisë nga Përmbytjet	Harta që përfshijnë zonat gjeografike të cilat mund të përmbyten sipas skenarëve në vijim: përmbytjet me probabilitet të ultë, apo skenarët e ndodhive ekstreme; përmbytjet me probabilitet mesatar (me periudhë të mundshme të përsëritjes ≥ 100 vite); përmbytjet me probabilitet të lartë, kurdo që konsiderohet e përshtatshme	**Flood hazard maps**	Maps that cover the geographical areas which could be flooded according to the following scenarios: floods with a low probability, or extreme event scenarios; floods with a medium probability (likely return period ≥ 100 years); and floods with a high probability, where appropriate	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Hartat e Rrezikut nga Përmbytjet	Hartat e përpiluara për Rajonin e Pellgut Lumor (në Shqipëri- basenit ujor) të cilat i tregojnë pasojat potenciale negative të lidhura me skenarët e përmbytjeve të përmendura në përkufizimin për "Hartat e Rrezikshmërisë nga Përmbytjet" dhe të shprehura në kuptimet si më poshtë: a) numri indikativ i banorëve potencialisht të prekur; b) tipi i veprimtarisë ekonomike i zonës potencialisht të prekur; c) impiantet (në Shqipëri -instalimet) siç përcaktohen në legjislacionin përkatës, të cilat mund të shkaktojnë ndotje aksidentale në rast përmbytjeje, dhe zonat e mbrojtura potencialisht të prekura të identifikuara në legjislacionin përkatës; d) informacioni tjetër i dobishëm, sië është p.sh. tregimi i zonave ku mund të ndodhin përmbytje me përbërje të lartë të sedimenteve të bartura dhe përmbytje nga lumenjtë malor që përmbajnë copëza shkëmbinjsh, si dhe informacioni mbi burimet e tjera të konsiderueshme të ndotjes	**Flood risk maps**	Maps, developed for a River Basin District, that show the potential adverse consequences associated with flood scenarios referred to in "Flood Hazard Maps" and expressed in terms of the following: the indicative number of inhabitants potentially affected; type of economic activity of the area potentially affected; installations as referred in specific legislation in this regard which might cause accidental pollution in case of flooding and potentially affected protected areas identified in the corresponding legislation; and other useful information such as the indication of areas where floods with a high content of transported sediments and debris floods can occur and information on other significant sources of pollution	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Hendek	Një kanal i ngushtë i gërmuar në tokë, që normalisht përdoret për drenazhim (kullim) e që shtrihet përgjatë një rruge apo skaji të një fushe, are	**Ditch**	A narrow channel dug in the ground, typically used for drainage alongside a road or the edge of a field	Hidraulikë	
Hermetizim i tegelit (ngjitjes)	I bënë tubat (gypat) dhe tegelat (ngjitjet) e pusetave të papërshkueshme nga uji, në rastin kur ndodh infiltrimi i tyre si pasojë e ekspozimit të tyre ndaj presionit të lartë të ujërave nëntokësore	**Joint seal**	It reestablishes watertight conditions in pipes and manhole joints when infiltration occurs due to their exposition to high ground water pressures	Furnizim me ujë	
Heterotrof	Një organizëm i cili e gëlltitë apo e absorbon karbonin organik (më parë sesa ta fiksojë atë nga burimet inorganike siç është dioksidi i karbonit) për të qenë në gjendje që të prodhojë energji dhe t'i sintetizojë komponimet e nevojshme për të plotësuar nevojat e veta jetike	**Heterotroph**	An organism that ingests or absorbs organic carbon (rather than fix carbon from inorganic sources such as carbon dioxide) in order to be able to produce energy and synthesize compounds to maintain its life	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Hidrant zjarrfikës	Një tub dege, zakonisht në një rrugë, i lidhur me sistemin e furnizimit me ujë, i cili mundëson që një tub gome për shuarjen e zjarrit të lidhet me tubin qendror	**Fire hydrant**	A branch pipe, usually in a street, connected to the water supply system, which enables a fire hose to be connected to the main	Furnizim me ujë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Hidrocentral	Lloji më i shpeshtë i centraleve hidroelektrike është ai në formë të objekteve akumuluese. Një objekt akulumues siç është një sistem i madh hidroenergjik, shftrytëzon digat për të bërë akumulimin e ujit të lumenjëve në një rezervuar	**Hydropower plant**	The most common type of hydroelectric power plant is an impoundment facility. An impoundment facility, typically a large hydropower system, uses a dam to store river water in a reservoir	Hidraulikë	
Hidroelektricitet	Energjia elektrike e gjeneruar përmes drejtimit të ujërave në turbinat e centraleve të energjisë të lokalizuara poshtë digave	**Hydroelectricity**	Electricity created by channeling water through turbines in power stations located below dams	Industri	
Hidrofilik	Substanca me afinitet ndaj ujit, të cilat kanë tendencë të përzihen apo të treten në ujë, si dhe të njomen me të	**Hydrophilic**	Substances that have a tendency to mix with, dissolve in, or be wetted by water	Cilësi e ujërave	
Hidrofobik	Substanca të cilat nuk shprehin afinitet ndaj ujit, që kanë tendencë ta refuzojnë (zmbrapsin) ujin apo të mos përzihen me të	**Hydrophobic**	Substances that tend to repel or fail to mix with water	Cilësi e ujërave	
Hidrograf	Një grafik që tregon prurjen (shkarkimin) kundrejt kohës në një pikë specifike në një lumë, apo në ndonjë kanal apo tub tjetër nëpër të cilat kalon rrjedha. Prurja zakonisht shprehet në metra kub apo këmbë kub për sekondë (cms apo cfs)	**Hydrograph**	A graph showing the rate of flow (discharge) versus time past a specific point in a river, or other channel or conduit carrying flow. The rate of flow is typically expressed in cubic meters or cubic feet per second (cms or cfs)	Hidraulikë	
Hidrogjeologjia	Është një degë e shkencave të tokës që merren me lëvizjen dhe ruajtjen e ujit në koren e Tokës dhe trupave të tjerë shkëmborë ne tokë	**Hydrogeology**	Hydrogeology is a branch of the earth sciences dealing of the movement and storage of water in the crust of Earth and other rocky planetary bodies	Menaxhim i ujërave	
Hidrolizë	Dekompozimi i komponimeve organike me anë të bashkëveprimit me ujin	**Hydrolisis**	The decomposition of organic compounds by interaction with water	Cilësi e ujërave	
Hidrologjia	Shkenca që merret me ujin qe ndodhet në atmosferë, në sipërfaqen e tokës dhe nëntokë	**Hydrology**	The science that deals with water as it occurs in the atmosphere, on the surface of the ground, and underground	Menaxhim i ujërave	
Hidromorfologji	Karakteristikat fizike të formës, kufijve dhe përbërjes së një trupi ujor. Elementet e cilësisë hidromorfologjike përdoren në klasifikimin e statusit ekologjik të trupave ujor sipërfaqësorë	**Hydromorpho-logy**	The physical characteristics of the shape, the boundaries and the content of a water body. Hydromorphological quality elements are used in the classification of ecological status of surface water bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Hietograf i reshjeve	Një paraqitje grafike e shpërndarjes së reshjeve gjatë një periudhe kohore	**Rainfall hyetograph**	A graphical representation of the distribution of rainfall over time	Hidraulikë	
Horizont (shtresë) gjeologjike	Shtresë që shtrihet paralelisht me sipërfaqen e tokës, karakteristikat fizike të së cilës dallojnë prej shtresave mbi dhe nën të. Horizontet në shumicën e rasteve përcaktohen në bazë të tipareve fizike të tokës siç është ngjyra, tekstura, përbërja e fragmenteve të shkëmbinjve, struktura dhe konsistenca e secilt horizont gjeologjik apo shkëmbi mëmë[13]	**Horizon, soil**	A layer within a soil profile from the soil above or below it in one or more soil morphological characteristics including color, texture, rock fragment content, structure and consistence of each soil horizon or parent material[14]	Bujqësi dhe ujitje	
Humbje në fërkim e presionit të fluidit	Në kontekst të rrjedhjes së fluideve (lëngjeve apo gazeve), humbja në fërkim (apo fërkimi në sipërfaqe) paraqet humbjen e presionit të fluidit e cila ndodh gjatë rrjedhjes së tij nëpër gypa apo tuba për shkak të viskozitetit të fluidit afër sipërfaqes së gypit apo tubit	**Friction head**	In fluid flow, friction loss (or skin friction) is the loss of pressure or "head" that occurs in pipe or duct flow due to the effect of the fluid's viscosity near the surface of the pipe or duct	Hidraulikë	

[13] **Shkëmb mëmë** - materiali gjeologjik mbi të cilin ndërtohen horizontet (shtresat) gjeologjike (në përgjithësi shtrati i shtresës (shkëmbi shtrues bazë) apo depozitimet sipërfaqësore apo depozitimet me prejardhje akullnajore (mbushja akullnajore)

[14] **Parent material** is the underlying geological material (generally bedrock or a superficial or drift deposit) in which soil horizons form

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Humbje e presionit	Shpërhapja e energjisë për shkak të fërkimit në një lëngë që realisht lëvizë, e që kjo humbje ndahet në dy kategori kryesore, "humbjet e mëdha" që lidhen me humbjet e energjisë përgjatë gjatësisë së tubit, dhe "humbjet e vogla" të lidhura me bërrylat e tubave, rakordet, valvulet, etj.	**Head loss**	Dissipation of energy due to friction in a real moving fluid, that is divided into two main categories, "major losses" associated with energy loss per length of pipe, and "minor losses" associated with bends, fittings, valves, etc.	Hidraulikë	
Humbje e shtypjes (trysnisë)	Humbja e shtypjes (pL) paraqet ndryshimin e shtypjes që shkaktohet nga fërkimi në muret e tubave (gypave) dhe nga rezistenca në valvule, rakorde (gypa nipels). Humbja e shtypjes llogaritet si në formulën e mëposhtme, ku merret parasysh humbja e presionit (HL) që është e pavarur nga dendësia e fluidit (ρ): pL = ρ * g * HL, ku g=9.81 m/s2 (nxitimi, graviteti i tokës)	**Pressure loss**	Pressure loss (pL) is a pressure difference caused by wall friction (in pipes) and resistances (in valves, fittings etc.). It is calculated on the basis of the head loss (HL) which is independent of the fluid density (ρ): pL = ρ * G * HL, where g = 9,81 m/s2	Hidraulikë	
Humbje gjatë transportimit (bartjes)	Humbja e ujit në gypa (tuba), kanale apo hendeqe përmes rrjedhjes apo avullimit, çka bënë që ai më të mos jetë në dispozicion për përdorim të mëtejshëm	**Conveyance loss**	Water loss in pipes, canals, or ditches by leakage or evaporation. Generally, the water is not available for further use	Furnizim me ujë	
Humbjet e dukshme apo humbjet administrative (Humbjet komerciale)	Humbjet e dukshme (humbjet administrative) ndonjëherë të quajtura humbje komerciale apo jofizike, i referohen vëllimit të konsumit të autorizuar i cili arrin tek konsumatorët por që nuk faturohet. Humbjet e dukshme u ndodhin ndërmarrjeve (kompanive) si rezultat i pasaktësisë së njehsorëve (p.sh. ujëmatësve) të konsumatorëve, si rezultat i gabimeve në menaxhimin sistematik të të dhënave në sistemet e faturimit, si dhe si rezultat i konsumit të pa-autorizuar	**Apparent losses (Commercial losses)**	Apparent losses, sometimes called commercial or non-physical losses, refers to volumes of authorised consumption that reach consumers, but are not billed. Apparent losses occur in utility operations due to customer meter inaccuracies, systematic data handling errors in customer billing systems, and unauthorized consumption	Furnizim me ujë	Udhëzyesit e Asociacionit Ndërkombëtar për Ujëra mbi humbjet e dukshme (komerciale) dhe planifikimin e zvogëlimit të humbjeve të ujit
Humbjet komerciale	Shihni përkufizimin për "Humbjet e dukshme apo humbjet administrative"	**Commercial losses**	See the defitnion for "Apparent Losses"	Furnizim me ujë	Udhëzyesit e Asociacionit Ndërkombëtar për Ujëra mbi humbjet e dukshme (komerciale) dhe planifikimin e zvogëlimit të humbjeve të ujit
Humbjet e ujit	Kontrolli i humbjeve të ujit konsiston në përpjekjet e ndërmarrjeve (kompanive) për të menaxhuar rrjedhjet në nivele ekonomikisht të ulta, dhe zvogëlimin e gabimeve në matje dhe faturim, ashtu që të arrihen masat e besueshme të konsumit të konsumatorëve dhe të fitohen të ardhura të mjaftueshme nga ndërmarrjet e ujit	**Water loss**	Water loss control includes utility efforts to manage leakage to economically low levels, and reducing metering and billing errors such that reliable measures of customer consumption are attained and sufficient revenue is gained by the water utility	Furnizim me ujë	
Humbjet e vërteta (shihni Humbjet teknike)	Humbjet e vërteta janë humbjet fizike të ujit nga sistemi i shpërndarjes, përfshirë rrjedhjet dhe përmbytjet (derdhjet) e rezervuarëve akumulues të ujit në sistemin e furnizimit me ujë	**Real losses (see Technical losses)**	Real losses are the physical losses of water from the distribution system, including leakage and storage overflows	Furnizim me ujë	
Humbjet në kanal	Uji i cili mund të humb nga kanalet që e transportojnë ujin në një sistem të ujitjes, si pasojë e dëmtimit të mbështjellësit të brendshëm të kanaleve, duke e reduktuar kështu efiçiencën e sistemit	**Canal losses**	Water that can escape from the canals that transport water in an irrigation systems, due to the deterioration of the canals lining, thus reducing efficiency of the system.	Bujqësi dhe ujitje	
Humbjet teknike	Shihni përkufizimin për "Humbjet e Vërteta"	**Technical losses**	See the defintion for Real Lossess	Furnizim me ujë	

4.11 Ii

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Impiant (në Shqipëri - Ndërmarrje)	Është i tërë lokacioni nën kontrollin e një operatori ku substancat e rrezikshme janë të pranishme në një apo më shumë njësi, përfshirë infrastrukturën apo aktivitetet e përbashkëta apo ato të ndërlidhura	**Establishment**	The whole area under the control of an operator where dangerous substances are present in one or more installations, including common or related infrastructures or activities	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU
Impiant i incinerimit të mbeturinave (në Shqipëri - mbetjeve)	Është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbeturinave (mbetjeve), me ose pa rikuperim të nxehtësisë së krijuar nga djegia, përmes incinerimit me oksidim të mbeturinave (mbetjeve), si edhe proceset e tjera të trajtimit termik, si piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, nëse substancat që përfitohen nga ky trajtim incinerohen më pas	**Waste incineration plant**	Any stationary or mobile technical unit and equipment dedicated to the thermal treatment of waste, with or without recovery of the combustion heat generated, through the incineration by oxidation of waste as well as other thermal treatment processes, such as pyrolysis, gasification or plasma process, if the substances resulting from the treatment are subsequently incinerated	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Impiant i trajtimit të ujërave të ndotura	Infrastruktura për trajtimin e ujërave të ndotura me largimin e ndotësve dhe lëndëve kontaminuese prej ujërave të ndotura, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit. Nje impiant tipik i trajtimit të ujërave të ndotura urbane në një vend të industrializuar nënkupton tërësinë e operacioneve të trajtimit të cilat përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm me, largimin e gurëve ranor (rërës), filtrimin (sitjen) me sitë me grila (vrima) të të mëdha apo të vogla, koagulimin (ngjizjen)-flokulimin (flokëformimin), sedimentimin, biooksidimin, biofiltrimin, adsorbimin (ndajthithjen) me karbonin e aktivizuar, dhe dezinfektimin, me anë të të cilave ndotësit transformohen dhe largohen nga ujërat e ndotura. Nivelet e trajtimit të ujërave të ndotura varësisht nga shkalla e përpunimit të tyre mund të kategorizohen në: trajtimin preliminar apo paratrajtimin, trajtimin sekondar dhe trajtimin terciar	**Waste water treatment plant**	Infrastructure for waste water treatment by the removal of pollutants or contaminants for the protection of public health and the environment. A typical municipal waste water treatment plant in an industrialized country includes several treatment unit processes including, but not limited to, one or more of: grit removal, screening, coagulation-flocculation, sedimentation, biooxidation, biofiltration, carbon adsorption and disinfection by which pollutants are transformed and removed from wastewater streams. Treatment levels may be categorized as preliminary or pretreatment, secondary and tertiary treatment, depending on degree of processing	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Incinerim (djegie) i lymit (llumit)	Proces i trajtimit të lymit (llumit) përmes incinerimit (djegies)	**Sludge incineration**	It is a sewage sludge treatment process using incineration	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Indeksi i njomjes (lagështisë)	Një indeks numerik, shpeshherë i shprehur si përqindje, që i përgjigjet raportit në mes të rrjedhjes nga një pellg (në Shqipëri - basen) në një vit të caktuar dhe mesatares vjetore	**Index of wetness**	A numerical index, often expressed as a percentage, corresponding to the ratio of the runoff from a basin in a given year to the annual average	Bujqësi dhe ujitje	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Indeksi i Reshjeve, Indeksi i Reshjeve të Standardizuara (IRS)	Një mjet për përcaktimin dhe monitorimin e thatësirës meteorologjike për një varg shkallësh kohore në çdo stacion të reshjeve që posedon të dhëna shumëvjeçare (d.m.th. të dhëna për ndodhitë dhe rrethanat që kanë ndodhur në të kaluarën). Matematikisht, IRS-ja bazohet në probabilitetin kumulativ të ndodhshmërisë së një eventi thatësire apo një eventi lagështie në një stacion reshjesh. Të dhënat shumëvjeçare të reshjeve të cilat i ka regjistruar stacioni, paraqiten në një kurbë shpërndarjeje statistikore gama. Për shkallët kohore të shkurtra, IRS-ja është e ndërlidhur ngushtë më lagështinë e dheut, ndërsa për shkallët kohore të gjata IRS-ja mund të lidhet me ujërat nëntokësore dhe me vëllimin e akumulimeve (në Shqipëri - rezervuarëve)	**Rainfall Index, Standardized Precipitation Index**	A tool for defining and monitoring meteorological drought on a range of timescales for any rainfall station with historic data. Mathematically, the SPI is based on the cumulative probability of a given rainfall event occurring at a station. The historic rainfall data of the station is fitted to a gamma distribution. On short timescales, the SPI is closely related to soil moisture, while at longer timescales, the SPI can be related to groundwater and reservoir storage	Thatësirë	
Industri ekstraktive	Të gjitha impiantet (në Shqipëri -ndërmarrjet) dhe sipërmarrjet e përfshira në nxjerrjen sipërfaqësore apo nëntokësore të burimeve minerare për qëllime komerciale, përfshirë nxjerrjen e tyre përmes shpimit të vrimave në thellësi, apo trajtimin e këtyre materieve të nxjerra	**Extractive industries**	All establishments and undertakings engaged in surface or underground extraction of mineral resources for commercial purposes, including extraction by drilling boreholes, or treatment of the extracted material	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC
Infektive	Substanca të cilat përmbajnë mikroorganizma të gjallë apo toksinat e tyre, të cilat njihen apo besohet se shkaktojnë sëmundje tek njeriu apo organizmat e tjerë të gjallë	**Infectious**	Substances and preparations containing viable micro-organisms or their toxins which are known or reliably believed to cause disease in man or other living organisms	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Infiltrim	Depërtimi i ujit në një mjedis siç është p.sh. toka	**Infiltration**	Penetration of water into a medium, for instance the soil	Bujqësi dhe ujitje	
Influent	Ujë i cili futet në një sistem trajtimi	**Influent**	The water entering a water treatment system	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Informacion gjeografik (gjeohapësinor)	I referohet çdo të dhëne të regjistruar që ka një referencë në sipërfaqen e tokës, qoftë përmes koordinatave gjeografike apo përmes identifikuesve të tillë siç janë adresat	**Geographic information**	Information that is referenced to the earth's surface, whether by co-ordinates or by identifiers such as addresses	Sisteme Informative	
Informacion i mbajtur nga një autoritet publik	Është informacioni mjedisor që autoriteti publik e ka në posedim i cili është përpiluar apo të cilin e ka pranuar ai autoritet	**Information (held by a public authority)**	Environmental information in its possession which has been produced or received by that authority	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2003/4/EC
Informacion mjedisor[15]	Është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose çdo formë tjetër e të dhënave mbi gjendjen e përbërësve të mjedisit, si dhe bashkëveprimin ndërmjet këtyre elementeve të mjedisit, faktorët, masat siç janë politikat, legjislacioni, planet, programet, marrëveshjet mjedisore, dhe aktivitetet që ndikojnë apo kanë gjasë të ndikojnë në mjedis ,si dhe raportet mbi implementimin e legjislacionit mjedisor	**Environmental information**	Any information in written, visual, aural, electronic or any other material form on the state of the elements of the environment, and the interaction among these elements; factors, measures, such as policies, legislation, plans, programmes, environmental agreements, and activities affecting or likely to affect the environment; and reports on the implementation of environmental legislation	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2003/4/EC

[15] **Informacion mjedisor** - është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër ne lidhje me gjendjen e përbërësve te mjedisit, masat, raportet, kostbenenfit analizat si dhe gjendja e shëndetit te njeriut (**Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 4**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Inspektim	Të gjitha veprimet, përfshirë vizitat në terren, kontrollin e masave, sistemeve dhe raporteve të brendshme dhe të dokumenteve që e përcjellin progresin e tyre, si dhe çfarëdo ndjekje të nevojshme të zbatimit të tyre, të cilat ndërmerren nga autoriteti kompetent apo në emër të tij, për të verifikuar dhe nxitur respektimin e kërkesave të legjislacionit përkatës dhe të lejeve nga ana e impianteve (në Shqipëri - ndërmarrjeve)	**Inspection**	All actions, including site visits, checks of internal measures, systems and reports and follow-up documents, and any necessary follow-up, undertaken by or on behalf of the competent authority to check and promote compliance of establishments with the requirements of legislation and permits	Masat	Direktiva 2012/18/EU
Inspektim mjedisor[16]	Të gjitha veprimet, përfshirë vizitat në terren, monitorimin e emisioneve (në Shqipëri - shkarkimeve) dhe kontrollet e raporteve të brendshme dhe të dokumenteve të përcjelljes së zbatimit të tyre, verifikimin e vetë-monitorimit, kontrollin e teknikave të përdorura dhe të përshtatshmërisë së menaxhimit mjedisor të impiantit, të ndërmarra nga apo në emër të autoritetit kompetent për të kontrolluar dhe nxitur përputhshmërinë e impianteve me kushtet e tyre të lejes dhe, kurdo që është e nevojshme, për të monitoruar ndikimin e tyre në mjedis	**Environmental inspection**	All actions, including site visits, monitoring of emissions and checks of internal reports and follow-up documents, verification of self-monitoring, checking of the techniques used and adequacy of the environment management of the installation, undertaken by or on behalf of the competent authority to check and promote compliance of installations with their permit conditions and, where necessary, to monitor their environmental impact	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2010/75/EU
Instalime	Është një njësi statike teknike brenda së cilës kryhen një apo më shumë aktivitete (të renditura në legjislacionin përkatës), si dhe çfarëdo aktivitetesh tjera drejtpërsëdrejti të lidhura me to që zhvillohen në po atë vendndodhje, të cilat kanë një lidhshmëri teknike me aktivitetet e renditura në legjislacionin përkatës, dhe të cilat mund të kenë ndikim në emisionet (në Shqipëri - shkarkimet) dhe në ndotje	**Installation**	A stationary technical unit within which one or more specific activities (listed in legislation) are carried out, and any other directly associated activities on the same site which have a technical connection with those activities listed in those and which could have an effect on emissions and pollution	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU, Direktiva 2010/75/EU, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Interceptor (kolektor derdhjeje)	Mbledh ujërat e ndotura nga kolektorët e përgjithshëm të kanalizimit dhe i dërgon ato drejt impinateve të trajtimit të ujërave të ndotura	**Interceptor sewer**	It receives the waste water from trunk sewers and convey it to a waste water treatment plant	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Interkalibrim	Një ushtrim i dizajnuar për të siguruar që kufijtë e klasës ***i lartë/i mirë*** dhe kufijtë e klasës ***i mirë/mesatar***, që përdoren për vlerësimin e statusit të një trupi ujor, janë në përputhje me përkufizimet normative në legjislacionin e BE-së	**Intercalibration**	An exercise designed to ensure that the high/good and good/moderate class boundaries for assessing the status of water bodies are consistent with the normative definitions in the EU legislation	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Intruzion (futje) i ujërave detarë	Një proces natyror i cili ndodh në pothuajse të gjithë akuiferët bregdetarë. Paraqet rrjedhjen e ujit të detit duke u futur në brendësi të territorit në akuiferët me ujëra të ëmbla. Ky veprim shkaktohet duke e marrë parasysh faktin se ujërat detarë kanë densitet më të lartë (duke qenë se përmbajnë më shumë lëndë të tretura në to) sesa ujërat e ëmbla	**Intrusion of saltwater**	A natural process that occurs in virtually all coastal aquifers. It consists in salt water (from the sea) flowing inland in freshwater aquifers. This behavior is caused by the fact that sea water has a higher density (which is because it carries more solutes) than freshwater	Probleme mjedisore	
Irrituese (H4)	Substancat dhe preparatet jokorrozive të cilat, në kontakt të menjëhershëm, të zgjatur apo të përsëritur me lëkurën apo membranat mukozale, mund të shkaktojnë inflamacion (pezmatim)	**Irritant**	Non-corrosive substances and preparations which, through immediate, prolonged or repeated contact with the skin or mucous membrane, can cause inflammation	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

[16] **Inspektim i mjedisit** - kontrollë dhe mbikëqyrje inspektive, me qëllim të respektimit të normave, standardeve dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit (**Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Neni 3, Paragrafi 1.11, Legjislacioni i Kosovës**)

4.12 Jj

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		

4.13 Kk

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Kalibrim	Proceset e përdorura për të ruajtur saktësinë e instrumenteve duke i përcaktuar, kontrolluar dhe korrigjuar treguesit e instrumenteve që tregojnë matjet sasiore	**Calibration**	Processes used to maintain instrument´s accuracy by determining, checking, or rectifying the marking of the instruments giving quantitative measurements	Monitorim	
Kanal	Rruga natyrale ose artificiale që ndjek uji përgjatë një shtrati të caktuar	**Channel**	The natural or artificial path that the water follows along a certain bed	Bujqësi dhe ujitje	
Kanal drenazhimi me filtër (Kanal francez drenazhimi)	Një kanal (hendek) i mbushur me zhavorr apo gurë, ose që përmban një tub të perforuar (shpuar) i cili i ridrejton ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore tutje prej një sipërfaqeje (bënë drenazhimin e tokës). Ky kanal mund të përmbajë tuba të perforuar e të thelluar që shtrihen përgjatë fundit të tij, për të larguar shpejt ujin i cili kullohet poshtë zhavorrit apo gurëve	**Filter drain (French drain)**	A trench filled with gravel or rock or containing a perforated pipe that redirects surface water and groundwater away from an area (drain the land). It can have perforated hollow pipes along the bottom to quickly vent water that seeps down through the upper gravel or rock	Bujqësi dhe ujitje	
Kanal i lundrueshëm	Çdo trup ujor i lundrueshëm, i cili shërben si rrugë apo linjë udhëtimi apo transporti	**Waterway**	Any navigable body of water, thus it serves as a route or way of travel or transport	Menaxhim i ujërave	
Kanal (transhe) i ujërave nëntokësore	Një hendek ujëmbledhës i një ujërrjedhe apo një lug (vijë) ujëmbledhëse, ose një kanal drenazhimi i hapur nën nivelin e përgjithshëm të ujërave nëntokësore, i cili e krijon një kanal në tablon ujore që kulmon nën shtratin apo kanalin e drenazhimit	**Groundwater trench**	A stream gully or valley or a drainage ditch cut below the general level of groundwater produces a trench in water table which apexes under bed or drainage ditch	Furnizim me ujë	
Kanal shkarkimi	Kanali apo korridori përreth një dige apo sipër saj, nëpër të cilin devijohet uji i tepërt, d.m.th i ndryshohet drejtimi	**Spillway**	The channel or passageway around or over a dam through which excess water is diverted	Përmbytje	
Kanal ujëheqës (grykë e shkarkimit)	Vendi prej ku një tub shkarkimi (kolektor) i ujërave të ndotura, një kanal drenazhimi, apo një ujërrjedh shkarkohet; një vrimë lëshimi (shkarkimi) apo strukturë nëpërmjet së cilës uji i ricikluar apo efluenti i trajtuar shkarkohet përfundimisht në një trup ujor pritës	**Outfall**	The place where a sewer, drain, or stream discharges; the outlet or structure through which reclaimed water or treated effluent is finally discharged to a receiving water body	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Kapaciteti asimilues	Kapaciteti i ujërave natyrorë për të pranuar ujërat e ndotura apo materiet toksike pa pas efekte negative dhe pa shkaktuar dëme tek organizmat ujor apo njerëzit të cilët i konsumojnë këta ujëra	**Assimilative capacity**	The capacity of natural water to receive waste waters or toxic materials without negative effects and without causing damage to aquatic life or humans who consume the water	Cilësi e ujërave	
Kapaciteti buferizues	Shkalla e efiçiencës së një buferi për t'i rezistuar ndryshimeve të pH-së	**Buffering capacity**	Measure of the efficiency of a buffer in resisting changes in pH	Cilësi e ujërave	
Kapërderdhës (pritë kapërdherdhëse)	Paraqet një digë të ultë të ndërtuar tejpërtej një lumi për të ngritur nivelin e ujit në rrjedhën e sipërme të tij apo për të rregulluar prurjen e tij	**Weir**	It is a low dam built across a river to raise the level of water upstream or regulate its flow	Hidraulikë	
Kapërderdhje	Rrjedhja jashtë skajit të sipërm (buzëve) të një depozite (rezervuari) apo derdhja e lëngut të tepërt prej saj. Kapërderdhja po ashtu i referohet edhe prurjes së tepërt të shkarkuar në një pus, zakonisht si rezultat I keqfunksionimit të pajisjeve rregulluese të prurjes	**Overflow**	Flow over the brim of a receptacle or to flow or run over, as rivers. Also it refers to the excessive discharge into a well, usually as a result of malfunction of the flow control devices	Hidraulikë	
Karakterizim i trupave ujor	Një vlerësim i i trupave ujor i përbërë prej dy stadesh. Stadi i 1rë i identifikon trupat ujor dhe i përshkruan karakteristikat e tyre natyrore. Stadi i 2të vlerëson presionet dhe ndikimet nga veprimtaria njerëzore në mjedisin ujor. Vlerësimi i identifikon ata trupa ujorë të cilët rrezikojnë të mos i përmbushin objektivat mjedisore	**Characterisation (of water bodies)**	A two-stage assessment of water bodies. Stage 1 identifies water bodies and describes their natural characteristics. Stage 2 assesses the pressures and impacts from human activities on the water environment. The assessment identifies those water bodies that are at risk of not achieving the environmental objectives.	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Karbon organik i tretur	Paraqet një materie organike që është e aftë të kalojë nëpër një filtër (filtrat zakonisht sillen në madhësi ndërmjet 0.7 dhe 0.22 um). Përdoret për klasifikimin e gjerë të molekulave organike me origjinë dhe përbërje të larmishme brenda sistemeve ujore	**Dissolved organic carbon**	The organic matter that is able to pass through a filter (filters generally range in size between 0.7 and 0.22 um). It is used as a broad classification for organic molecules of varied origin and composition within aquatic systems	Ndotje	
Karboni aktiv	Mjedis adsorbues (ndajthithës) që rëndom përdoret e që gjendet në formë masivi, në formë të granuluar apo në formë pluhuri, që prodhohet me nxehjen në mungesë të ajrit të substancave me përmbajtje karboni apo bazave celuloze, siç është thëngjilli (qymyri), druri apo lëvozhga e arrës së kokosit. Karboni i aktivizuar ka strukturë shumë poroze dhe rëndomë përdoret për largimin nga uji të materieve organike dhe gazeve të tretur në të	**Activated carbon**	The most commonly used adsorption medium, found in block, granulated, or powdered form, produced by heating carbonaceous substances or cellulose bases, such as coal, wood, or coconut shells, in the absence of air. It has a very porous structure and is commonly used to remove organic matter and dissolved gases from water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Karboni total organik	Sasia e karbonit të ndodhur në një komponim organik dhe që shpeshherë përdoret si tregues jospecifik i cilësisë së ujërave	**Total organic carbon**	The amount of carbon found in an organic compound and it is often used as a non-specific indicator of water quality	Cilësi e ujërave	
Katalizator	Kimikat i cili e rritë shpejtësinë e një reaksioni por nuk merr pjesë drejtpërsëdrejti në atë reaksion, ashtu që mbetet i pandryshuar edhe pas përfundimit të reaksionit kimik	**Catalyst**	Chemical that increases the rate of a reaction but does not take a direct part in the reaction, so that it is still intact after the reaction has taken place	Cilësi e ujërave	
Kation	Një grimcë apo jon i ngarkuar pozitivisht	**Cation**	A positively charged particle or ion	Cilësi e ujërave	
Kek (mbetje e shtrydhur)	Mbetjet e ngurta të thara (të cilave iu është hequr uji), që adsorbohen (ndajthithen) nga lëndët filtruese pas filtrimit	**Cake**	Solid dewatered residue on a filter media after filtration	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Kërcim hidraulik	Një dukuri e cila vërehet shpesh në rrjedhjet nëpër kanalet e hapura siç janë lumenjtë dhe kanalet e shkarkimit. Kur një lëng me shpejtësi të madhe shkarkohet në një zonë me shpejtësi më të ultë, ndodh një ngritje e papritur në sipërfaqen e lëngut	**Hydraulic jump**	A phenomenon which is frequently observed in open channel flow such as rivers and spillways. When liquid at high velocity discharges into a zone of lower velocity, a rather abrupt rise occurs in the liquid surface	Hidraulikë	
Kërkesa Biokimike për Oksigjen (Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit - SHBO)	Ndryshe quhet edhe nevoja biologjike për oksigjen, që paraqet sasinë e oksigjenit të tretur që nevojitet (d.m.th. kërkohet) nga organizmat aerob biologjik për zbëthimin e materieve organike të pranishme në një mostër të caktuar uji, në temerpaturë të caktuar, për një periudhë të caktuar kohore. Ngarkesa organike e biodegradueshme, që ka nevojë biokimike 5 ditore për 60 g oksigjen në ditë, është ekuivalente me 1 p.e. (ekuivalent popullate)	**Biochemical Oxygen Demand (BOD)**	It is also called biological oxygen demand, which is the amount of dissolved oxygen needed (i.e., demanded) by aerobic biological organisms to break down organic material present in a given water sample at certain temperature over a specific time period. The organic biodegradable load having a five-day biochemical oxygen demand (BOD5) of 60 g of oxygen per day is equivalent to 1 p.e. (population equivalent).	Ndotje	Direktiva 91/271/EEC
Kërkesa Biologjike për Oksigjen	Shihni përkufizimin "Kërkesa Biokimike për Oksigjen"	**Biological oxygen demand**	See Biochemical Oxygen Demand		
Kërkesa për klor	Masë matëse për sasinë e klorit që do të shpenzohet nga materiet organike të pranishme në ujë, përpara se në të të gjendet ndonjë mbetje klori	**Chlorine demand**	A measure of the amount of chlorine which will be consumed by organic matter in a water before a chlorine residual will be found	Ujë i pijshëm	
Kërkesa për oksigjen	Nevoja që oksigjeni molekular t'i përmbushë nevojat e proceseve biologjike dhe kimike në ujë. Edhe pse një sasi shumë e vogël e oksigjenit realisht tretet në ujë, është jashtëzakonisht me rëndësi për proceset biologjike dhe kimike që zhvillohen në të	**Oxygen demand**	The need for molecular oxygen to meet the needs of biological and chemical processes in water. Even though very little oxygen will dissolve in water, it is extremely important in biological and chemical processes	Cilësi e ujërave	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Kërkesa për ujë	Sasia e përgjtihshme e ujit që konsumohet nga përdoruesit brenda sistemit të furnizimit me ujë	**Demand (of water)**	Total amount of water used by the users within the water supply system	Furnizim me ujë	
Klimë	Moti i ditëpërditshëm për një periudhe më të gjatë kohore	**Climate**	Day-to-day weather over a longer period of time	Rreziku	
Kloramin	Një përbërje kimike që përbëhet nga klori dhe amoniaku. Shërben si dezinfektues i ujit në rrjetet publike të furnizimit me ujë në vend të klorit, meqë klori mund të lidhet me materiet organike dhe të formojë produkte të rrezikshme reaktive	**Chloramine**	A chemical complex that consists of chlorine and ammonia. It serves as a water disinfectant in public water supplies in place of chlorine because chlorine can combine with organics to form dangerous reaction products	Furnizim me ujë	
Kloraminim	Përdorimi i kloraminave, veçanërisht i monokloraminit (NH2Cl), për dezinfektimin e ujit	**Chloramination**	Use of chloramines, especially monocloramine (NH2Cl), for disinfection of water	Ujë i pijshëm	
Klori (Cl_2) (forma e gaztë)	Gaz që përdoret gjërësisht si dezinfektues i ujit dhe si agjent oksidues për materiet organike. Klori bashkëvepron me substancat organike të pranishme në ujë duke formuar kështu trihalometanet (THM) dhe acidet haloacetike, të njohura si substanca me potencial kancerogjen dhe me efekte të tjera në shëndetin e njeriut	**Chlorine (Cl_2)**	Gas widely used as a water disinfectant and as an oxidizing agent for organic matter. Chlorine interacts with organic substances present in the water forming trihalomethanes (THMs) and haloacetic acids (HAAs) known as substances with carcinogenic potentia and other health realted effects	Ujë i pijshëm	
Klorizim	Proces i pastrimit të ujit ku klori i shtohet ujit për dezinfektim, për kontrollin e mikroorganizmave të pranishëm. Po ashtu përdoret edhe në oksidimin e papastërtive komplekse në ujë	**Chlorination**	A water purification process in which chlorine is added to water for disinfection, for the control of present microrganisms. It is also used in the oxidation of compound impurities in water	Ujë i pijshëm	
Koagulim (ngjizje)	Destabilizimi i grimcave koloidale me shtimin e një kimikati reaktiv të quajtur koagulues (ngjizës) i cili i neutralizon ngarkesat e grimcave	**Coagulation**	Destabilisation of colloid particles by addition of a reactive chemical, called a coagulant that neutralizes the charges of the particles	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Kod	Rregulloret të cilat një departament që posedon jurisdiksion mundet ligjërisht t'i miratojë	**Code**	Those regulations which the department having jurisdiction may lawfully adopt	Aspekte institucionale dhe ligjore	
Kodi/Kodet e praktikës së mirë bujqësore	Një udhëzues praktik për t'i ndihmuar fermerët, kultivuesit dhe menaxhuesit e tokës që të minimizojnë rrezikun për të shkaktuar ndotje dhe të mbrojnë mjedisin në të cilin veprojnë, duke mundësuar njëkohësisht që të zhvillohet një bujqësi fitimprurëse dhe produktive	**Code(s) of good agricultural practice**	A practical guide to help farmers, growers and land use managers to minimise the risks of causing pollution and protect the environment in which they operate, meanwhile allowing a profitable and productive farming to develop	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 91/676/EEC
Koeficient ashpërsie (koeficienti i Manningut)	Koeficienti ("n") përdoret në formulën e Manningut për të vlerësuar shpejtësinë mesatare të rrymimit të një lëngu nëpër një tub i cili është i hapur (d.m.th nuk e mbyll tërësisht lëngun që paraqet rrjedhjen nëpër kanal të hapur). Ky koeficient nuk është i papërmasë, por shprehet përmes njësive në vijim: (T/[L1/3]; s/[ft1/3]; s/[m1/3]	**Roughness coefficient (Manning's)**	Coefficient ("n") is used in the Manning's formula to estimate the average velocity of a liquid flowing in a conduit that does not completely enclose the liquid, i.e., open channel flow. Units for values of "n" are often left off, however it is not dimensionless, having units of: (T/[L1/3]; s/[ft1/3]; s/[m1/3]	Hidraulikë	
Koeficient i shkarkimit	Raporti në mes të shkarkimit ekzistues dhe shkarkimit teorik	**Discharge coefficient**	The ratio of the actual discharge to the theoretical discharge	Hidraulikë	
Koeficient i ultë	Një numër i papërmasë (koeficient karakteristik) për të llogaritur humbjet e presionit	**Loss coefficient**	Dimensionless number (characteristic coefficient) to calculate the head loss (HL)	Hidraulikë	
Koeficienti akumulues i akuiferit	Paraqet vëllimin e ujit që lëshohet (shkarkohet) nga një depozitë brenda akuiferit, për njësinë e rënies së shtypjes hidraulike në akuifer si dhe për njësinë e sipërfaqes së akuiferit	**Storage coefficient (aquifer)**	The volume of water released from storage with respect to the change in head (water level) and surface area of the aquifer	Menaxhim i ujërave	
Koeficienti maksimal i prodhimit	Përkufizohet si raporti ndërmjet 'masës maksimale të qelizave të formuara' dhe 'masës së substratit të përdorur'	**Maximum yield coefficient**	It is defined as the ratio of maximum mass of cells formed to the mass of substrate utilized	Bujqësi dhe ujitje	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Koha e kontaktit	Kohëzgjatja gjatë së cilës një substancë është në kontakt me një lëng, përpara se të largohet me filtrim apo përpara se të ndodh ndonjë ndryshim kimik. Në kuptim të trajtimit të ujërave të ndotura, koha e kontaktit i referohet kohës gjatë së cilës ujërat e ndotura mbesin në kontakt me një oksidues, regjenerues apo një mjet kondicionues të ujit brenda një sistemi të trajtimit të ujërave të ndotura. Kohëzgjatja e kohës së kontaktit e përcakton efikasitetin e sistemit	**Contact time**	The length of time of a substance which is in contact with a liquid, before it is removed by filtration or the occurrence of a chemical change. In the context of waste water treatment, the terms refers to the actual time which waste water remains in contact with an oxidizer, regenerator, or water conditioning media within a waste water treatment system. The amount of contact time determines the effectiveness of the system	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Koha e retencionit (mbajtjes) të ujërave të ndotura	Koha e vërtetë gjatë së cilës ujërat e ndotura qëndrojnë në një mjedis, i cili mund të jetë një dekantues apo pellg (rezervuar) flokulimi, në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, apo një liqe ose një akumulim (në Shqipëri -rezervuarë)	**Retention time**	The actual time that an amount of water is in medium, which can be a settling basin or flocculating basin in a waste water treatment plant, or a lake or a reservoir	Menaxhim i ujërave	
Kolektor i përgjithshëm i kanalizimit	Shërben si një prej arterieve kryesore të sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura. Këta kolektorë i grumbullojnë ujërat e ndotura prej në numri tubash kolektorë kryesor dhe i çojnë në një qendër të trajtimit cilësor të ujërave apo në një kolektor derdhjeje	**Trunk sewer**	It serves as the main arteries of the waste water collection system. They collect and convey the waste water from numerous main sewer lines either to a water quality treatment center or to a interceptor sewer	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Kombinimi i masave me kosto efektive	Një kombinim masash të përzgjedhura në bazë të analizës së efektivitetit të kostos (shihni përkufizimin për "cost-effectiveness analysis" - "analiza e efektivitetit të kostos"	**Cost-effective combination of measures**	A combination of measures chosen subject to a cost-effectiveness analysis (see 'cost-effectiveness analysis')	Analizë ekonomike	Direktiva 2000/60/EC
Kompaktësim (ngjeshje)	Procesi me anë të të cilit poroziteti i një forme të caktuar të sedimentit zvogëlohet si rezultat i grimcave të tija minerale të cilat shtypen (ngjishen) nga pesha e sedimentit që shtrihet mbi to apo nga mjetet mekanike	**Compaction**	The process by which the porosity of a given form of sediment is decreased as a result of its mineral grains being squeezed together by the weight of overlying sediment or by mechanical means	Bujqësi dhe ujitje	
Komponim i azotit	Çdo substancë që përmban azot me përjashtim të azotit molekular të gaztë	**Nitrogen compound**	Any nitrogen-containing substance except for gaseous molecular nitrogen	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/676/EEC
Komponim organik	Është çdo substancë e cila të paktën përmban elementin e karbonit dhe një apo më shumë elemente hidrogjeni, halogjene, oksigjeni, squfuri, fosfori, silici apo azoti, me përjashtim të oksideve të karbonit dhe karbonateve e bikarbonateve inorganike	**Organic compound**	Any compound containing at least the element carbon and one or more of hydrogen, halogens, oxygen, sulphur, phosphorus, silicon or nitrogen, with the exception of carbon oxides and inorganic carbonates and bicarbonates	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Komponime organike shpejtë të avullueshme (në Shqipëri - Komponime volatile organike)	Kimikate organike të cilat në temperaturë dhome karaketerizohen me një shtypje të lartë të avullit. Shtypja e tyre e lartë e avullit vjen si rezultat i pikës së tyre të ultë të vlimit, e cila bënë që një numër i madh i molekulave të avullojnë apo të sublimojnë prej komponimit në formë të lëngët apo të ngurtë, dhe të depërtojnë në ajër, një tipar i njohur si avullueshmëri (paqëndrueshmëri). Shumica e aromave apo erërave të këqija paraqesin Komponime organike shpejtë të avullueshme (komponime volatile organike)	**Volatile organic compounds**	Organic chemicals that have a high vapor pressure at ordinary room temperature. Their high vapor pressure results from a low boiling point, which causes large numbers of molecules to evaporate or sublimate from the liquid or solid form of the compound and enter the surrounding air, a trait known as volatility. Most scents or odors are of Volatile Organic Compounds (VOCs)	Ndotje	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Komponime organike të avullueshme (në Shqipëri - Komponime volatile organike)[17]	Çdo komponim organik si dhe fraksion i krezotit i cili në 293.15K ka një presion avulli prej 0.01kPa apo më tepër, apo që ka një avullueshmëri pëkatëse nën kushtet e caktuara të përdorimit	**Organic compound (volatile)**	Any organic compound as well as the fraction of creosote, having at 293.15 K a vapour pressure of 0.01 kPa or more, or having a corresponding volatility under the particular conditions of use	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Kompostim	Një përzierje e materieve organike të kalbura apo në kalbje e sipër, të cilat përdoren për të plehëruar tokën	**Composting**	A mixture of decayed or decaying organic matter used to fertilize soil	Bujqësi dhe ujitje	
Kon i depresionit	Shfaqet në një akuifer kur ujërat nëntokësore pompohen nga pusi. Në një akuifer të pakufizuar (pakonturuar) ky paraqet rënien aktuale të niveleve të ujit, ndërsa në akuiferët e kufizuar (konturuar), koni i depresionit paraqet një reduktim në lartësinë e presionit hidrostatik që e rrethon pusin pompues	**Cone of depression**	It occurs in an aquifer when groundwater is pumped from a well. In an unconfined aquifer (water table), this is an actual depression of the water levels. In confined aquifers (artesian), the cone of depression is a reduction in the pressure head surrounding the pumped well	Hidraulikë	
Kondicionim termal i lymit (llumit)	Paraqet procesin e dehidratimit (tharjes) së lymit, ku dallohen dy procese themelore të kondicionimit të këtillë: (1) oksidimi me ajër të njomë, i cili konsiston në oksidimin pa flakë të llumrave në temperaturë prej 450°F deri në 550°F dhe në presion prej rreth 1200 psig; si dhe (2) trajtimi me nxehtësi, i cili është krejtësisht i ngjashëm me të mëparshmin vetëm se ky kryhet në temperaturë prej 350°F deri në 400°F dhe në presion prej 150 deri në 300 psig	**Thermal conditioning of sludge**	Process for dewatering sludge. There are two basic processes: one, wet air oxidation, is the flameless oxidation of sludges at temperatures of 450 to 550°F and pressures of about 1200 psig; the other type, heat treatment, is similar but carried out at temperatures of 350 to 400°F and pressures of 150 to 300 psig	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Koni Imhoff	Enë e tejdukshme me formë konike e shkallëzuar, që përdoret për të matur vëllimin e lëndëve të ngurta me aftësi për t'u sedimentuar në një vëllim specifik (zakonisht prej 1 litri) të ujërave ajo ujërave të ndotura	**Imhoff cone**	A clear, cone-shaped container used to measure the volume of settleable solids in a specific volume of water.(usually one liter) of water or waste water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Koncesion	Formë e kontratës së shkruar, me anë të së cilës autoritetet kompetente ia lejojnë bartësit të koncesionit të përfitojë cilëndo të drejtë ekskluzive për të nxjerrë, përdorë apo shkarkuar ujëra, në përputhje me kushtet e koncesionit	**Concession**	The form of written contract, by which the competent authorities allow the holder of the concession to benefit of any exclusive right to extract, use and discharge of water, under the terms of the concession	Aspekte institucionale dhe ligjore	
Kondensim	Ndryshimi i gjendjes agregate nga e gazta në të lëngët. Mund të realizohet përmes një kondensatori, i cili paraqet një pajisje apo njësi që përdoret për të kondensuar një substancë duke e ftohur atë. Kondensimi është proces i kundërt me avullimin	**Condensation**	The change of state from a gas to a liquid. It can be made using a condenser, which is a device or unit used to condense a substance by cooling it. It is the opposite process of evaporation	Hidraulikë	

[17] **Bashkëdyzimet organike të avullueshme** (**BOA)** - bashkëdyzime organike që në 293.15K, dhe në shtypje të avullit prej 0.01kPA ose më shumë, kanë avullim në kushte të caktuara (**Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Neni 2, paragrafi 1.29, Legjislacioni i Kosovës**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Kondicionimi i lymit (Ilumit)	Një proces ku lëndët e ngurta të lymit trajtohen me kimikate apo me një varg mjetesh të tjera, për të përgatitur lymin për procesin e tharjes (dehidratimit), thënë ndryshe, për të përmirësuar karakteristikat dehidratuese të tij. Ekzistojnë dy metoda të kondicionimit të lymit të cilat mund të përdoren, kondicionimi i lymit me metoda fizike, siç është trajtimi me nxehtësi apo përmes shtimit të pluhurit të hirit, apo kondicionimi me metoda kimike, ku përfshihet shtimi i koaguluesve dhe/apo i polimereve	**Sludge conditioning**	A process whereby sludge solids are treated with chemicals or various other means to prepare the sludge for dewatering processes, in other words, to improve dewatering characteristics of the sludge. There are two sludge conditioning approaches that can be used. Sludge can be conditioned by physical methods, such as heat treatment or addition of fly ash or by chemical methods, involving the addition of either coagulants and/or polymers	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Konstruksioni kryesor	Pjesa fillestare e impiantit të trajtimit ku influenti (që derdhet brenda impiantit) fillon të trajtohet	**Headworks**	The beginning of the treatment plant where the waste water influent begins treatment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Konsultime ndërkufitare	Kur një Shtet konsideron se implementimi në territorin e tij i një projekti, plani apo programi i cili përgatitet, ka gjasa të ketë efekte të konsiderueshme në mjedisin e një Shteti tjetër, apo me kërkesë të një Shteti i cili ka gjasë të ndikohet konsiderueshëm, Shteti tjetër në territorin e të cilit projekti, plani apo programi përgatitet, duhet që t'ia dorëzojë këtij Shteti një kopje të tyre bashkë me raportin mjedisor përkatës, përpara çfarëdo miratimi apo nënshtrimi të projektit, planit apo programit procedurave ligjore. Nëse Shtetet e tjera të ndikuara, e dëshirojnë një gjë të tillë, ato duhet të hyjnë në konsultime lidhur me efektet e mundshme mjedisore ndërkufitare që rezultojnë nga implementimi i projektit, planit apo programit, si dhe lidhur me masat e parapara për reduktimin apo eliminimin e efekteve të tilla	**Transboundary consultation**	Where a State considers that the implementation of a project, plan or programme being prepared in relation to its territory is likely to have significant effects on the environment in another State, or where a State likely to be significantly affected so requests, the State in whose territory the plan or programme is being prepared shall, before its adoption or submission to the legislative procedure, forward a copy of the draft project, plan or programme and the relevant environmental report to the other State. If the other States concerned wish it, they shall enter into consultations concerning the likely transboundary environmental effects of implementing the project, plan or programme and the measures envisaged to reduce or eliminate such effects	Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare	Direktiva 2001/42/EC, Direktiva 2003/35/EC
Kontabiliteti rregullator	Paraqet burimin kryesor të informacionit mbi pozitën dhe performancën financiare nga aspekti rregullativ i një ndërmarrjeje (kompanie)	**Regulatory accounting**	They are the primary source of information about the company's regulatory financial position and performance	Menaxhim i ujërave	
Kontrollet e emisioneve (në Shqipëri - "kontrollet e shkarkimeve")	Janë kontrollet që kërkojnë një kufizim specifik të emisionit (shkarkimit), si p.sh. një vlerë kufizuese të emisionit (shkarkimit) ose përndryshe përcaktimin e kufijve apo kushteve mbi efektet, natyrën ose karakteristikat e tjera të një emisioni apo të kushteve të operimit, të cilat ndikojnë në emisionet (shkarkimet)	**Emission controls**	Controls requiring a specific emission limitation, for instance an emission limit value, or otherwise specifying limits or conditions on the effects, nature or other characteristics of an emission or operating conditions which affect emissions	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC
Kontrolli i erërave të këqija	Procesi i kontrollit të emisioneve (në Shqipëri -shkarkimeve) të gazeve me erë të keqe nga impiantet e trajtimit të ujërave industriale, i cili proces realizohet përmes kapjes së gazeve sapo ata të shkarkohen, si dhe përmes mbulimit të zonave të emisioneve (shkarkimeve)	**Odour control**	Process to control odorous gas emissions from urban and industrial waste water treatment plants by capturing gases as soon as they are emitted and by covering emission areas	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Kontrolli i cilësisë	Kontrolli i cilësisë është një proces përmes të cilit një biznes kërkon të sigurojë që cilësia e produkteve të tija ruhet apo përmirësohet dhe gabimet në prodhim zvogëlohen apo eliminohen tërësisht	**Qulity control**	Quality control is a process through which a business seeks to ensure that product quality is maintained or improved and manufacturing errors are reduced or eliminated		
Kontrolli i përmbytjes	Masat e inxhinieruara parandaluese, të cilat zbatohen për të reduktuar dëmin e shkaktuar nga përmbytjet	**Flood control**	Engineered preventive measures implemented to reduce damage caused by flooding	Përmbytje	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Korniza e Forcës Lëvizëse, Presioneve, Gjendjes, Ndikimeve dhe Përgjigjeve/Reagimeve (Korniza DPSIR) për analizën mjedisore	Forca lëvizëse (D) -**n**jë aktivitet antropogjen që mund të ketë një efekt mjedisor (p.sh. bujqësia, industria); Presionet (P) - efekti i drejtpërdrejt i forcës lëvizëse (p.sh. një efekt që shkakton një ndryshim në rrjedhën apo kiminë e ujërave); Gjendja (S): gjendja e trupit ujor që rezulton nga veprimi i faktorëve natyror dhe antropogjen (d.m.th. karakteristikat e tij fizike, kimike dhe biologjike); Ndikimi (I): efekti mjedisor i presionit (p.sh. ngordhja e peshqve, modifikimi i ekosistemit); Përgjigja/Reagimi (R): masat e marra për të përmirësuar gjendjen e trupit ujor (p.sh. kufizimi i nxjerrjeve (abstraksioneve), kufizimi i shkarkimeve nga burimet pikore të ndotjes, zhvillimi i udhëzimeve për praktikat më të mira bujqësore)	**Driver, Pressure, State, Impact and Response framework for environmental analysis**	Driver: an anthropogenic activity that may have an environmental effect (e.g. agriculture, industry); Pressure: the direct effect of the driver (for example, an effect that causes a change in flow or a change in the water chemistry; State: the condition of the water body resulting from both natural and anthropogenic factors (i.e. physical, chemical and biological characteristics); Impact: the environmental effect of the pressure (e.g. fish killed, ecosystem modified); Response: the measures taken to improve the state of the water body (e.g. restricting abstraction, limiting point source discharges, developing best practice guidance for agriculture)	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC
Korrozion	Shpërbërja shkatërruese e lëndëve, veçanërisht e metaleve, me mjete elektromekanike. Korrozioni i hekurit dhe i aliazheve të tij siç është çeliku përgjithësisht quhet ndryshkje	**Corrosion**	The destructive disintegration of materials (specially metals) by electromechanical means. Corrosion of iron and its alloys such as steel is commonly called rusting	Industri	
Kosto mjedisore	Shpenzimet e pësuara për parandalimin dhe kufizimin e dëmtimit të mjedisit, si dhe për revitalizimin e mjedisit nga dëmtimi mjedisor	**Environmental costs**	Expenditures incurred to prevent, contain,or restore environment from environmental damage	Analizë ekonomike	Direktiva 2000/60/EC
Kripshmëri	Sasia e kripërave të tretura në një vëllim të caktuar të ujit	**Salinity**	Amount of dissolved salts in a given volume of water	Cilësi e ujërave	
Kthimi i kostos së shërbimeve të ujit	Të ardhurat totale të ofruesit të shërbimeve të ujit janë të barabarta me apo tejkalojnë koston e furnizimit. Çmimet e ujit duhet të mundësojnë një kthim (adekuat) të kostos së shërbimeve të ujit, përfshirë koston mjedisore dhe atë të resurseve (burimeve)	**Cost recovery (of water services)**	The total revenue to the water service provider equals (or exceeds) the cost of supply. Water prices must allow for the (adequate) cost recovery of water services, including environmental and resource costs	Analizë ekonomike	Direktiva 2000/60/EC
Kufi hidrogjeologjik	Diskontinuitet anësor në materialin gjeologjik, që shënon kalimin nga materiali permeabil (i depërtueshëm) i një akuiferi në një material me veçori rrënjësisht tjera hidrogjeologjike	**Hydrogeological boundary**	Lateral discontinuity in geological material, marking the transition from the permeable material of an aquifer to a material of significantly different hydrogeological properties	Trupa ujorë	
Kultivimi i peshkut / vivar	Kultivimi i peshkut apo peshkrritja përfshinë kultivimin komercial të peshqve në rezervuare apo vivarë (pellgje të rrethuara) siç janë pellgjet e peshqve, zakonisht për ushqim. Përndryshe kultivimi i peshkut paraqet formën kryesore të akuakulturës	**Fishery / fish farms**	Fish farming or pisciculture involves raising fish commercially in tanks or enclosures such as fish ponds, usually for food. It is the principal form of aquaculture		
Kullim	Largimi i (lëngut) nga diçka duke e lënë atë të rrjedh apo të derdhet jashtë	**Drain**	To remove (liquid) from something by letting it flow away or out	Hidraulikë	
Kundërpresion	Presion i cili bënë që uji të kundërrrjedhë në drejtim të furnizimit me ujë, atëherë kur presioni në sistemin e ujërave të ndotura të një përdoruesi është më i lartë sesa presioni në sistemin publik	**Backpressure**	Pressure that can cause water to backflow into the water supply when a user's waste water system is at a higher pressure than the public system	Hidraulikë	
Kundërrrjedhje	Prurja e ujit në një mjedis në drejtim të kundërt me rrjedhjen normale. Prurja zakonisht kthehet në sistem me kundërrrjedhje, kur ujërat e ndotura në një sistem pastrimi janë të kontaminuara rëndë	**Backflow**	The flow of water in a medium in a direction opposite to normal flow. Flow is often returned into the system by backflow, if the waste water in a purification system is severely contaminated	Hidraulikë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Kurbë vlerësimi	Një grafik që tregon marrëdhënien në mes të lartësisë së sipërfaqes së ujit dhe shkarkimit të një ujërrjedhe apo lumi në një vend të caktuar. Ndryshe quhet edhe si kurbë e shkarkimit në raport me horizontin e ujit në një pikë të caktuar në një ujërrjedhë, zakonisht në një stacion hidrometrik	**Rating curve**	A graph showing the relationship between water surface elevation and discharge of a stream or river at a given location. Also called a stage-discharge curve	Hidraulikë	
Kushtet referente	Vlerat e elementeve të cilësisë fiziko-kimike, hidromorfologjike dhe biologjike që normalisht i karakterizojnë tipet e trupave ujorë sipërfaqësorë në kushte natyrore, ku nuk ka fare apo ka fare pak modifikime antropogjenike. Kushtet referente, në llogaritjet e raporteve të cilësisë ekologjike dhe më pas klasifikimit të statusit ekologjik, duhet të përfaqësohen nga vlerat e elementeve të cilësisë biologjike	**Reference conditions**	Values of the physico-chemical, hydromorphological and biological quality elements for the surface water body type from those normally associated with that type under undisturbed conditions, in concordance with no, or only very minor, anthropogenic alterations. Reference conditions should be represented by values of the biological quality elements in calculation of ecological quality ratios and the subsequent classification of ecological status	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC

4.14 Ll

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Lagunë e ajruar (lagunë e ajruar aerobe apo pellg i ajruar)	1. Stabilizimi bakterial i ujërave të ndotura në një pellg natyral apo artificial të trajtimit të ujërave të ndotura, në të cilin aplikohet ajrimi mekanik apo ajrimi difuziv me ajër, për të plotësuar furnizimin me oksigjen; 2. Një pellg (rezervuar) mbajtës dhe/apo trajtues i cili e përshpejton procesin natyral të dekompozimit biologjik të mbeturinave (mbetjeve) organike duke e stimuluar rritjen dhe aktivitetin e baktereve të cilat e bëjnë degradimin organik të mbeturinave (mbetjeve)	**Aerated lagoon**	1. Bacterial stabilization of wastewater in a natural or artificial wastewater treatment pond in which mechanical or diffused air aeration is applied to supplement the oxygen supply; 2. A holding and/or treatment pond that speeds up the natural process of biological decomposition of organic waste by stimulating the growth and activity of bacteria that degrade organic waste	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lagunë fundërrimi, pellg fundërrimi	Një strukturë dheu apo betoni e cila ne anë të sedimentimit e bënë largimin e materieve të fundërrueshme dhe të turbiditetit nga ujërat e ndotura	**Settling lagoon; settling pond**	An earthen or concrete structure using sedimentation to remove settleable matter and turbidity from waste water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lagunë (pellg) me bimë ujore që pluskojnë në formë trungjesh	Sistem natyral i trajtimit të ujërave të ndotura me bimë ujore pluskuese, i cili konsiston në pellgjet (lagunat) me thellësi deri në 1.6 metra, në të cilat bimët ujore pluskuese rriten me qëllim të largimit të lëndëve ushqyese, posaçërisht të fosfateve	**Raft lagoon**	Waste water treatment system based on floating aquatic plants	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lagunë stabilizimi	Pellgjet e stabilizimit të mbeturinave (në Shqipëri - mbetjeve) apo të ujërave të ndotura të cilat janë me përmasa të mëdha, që paraqesin trupa ujorë të ndërtuar nga njeriu ku ujërat e zeza, ujërat gri apo llumrat fekale trajtohen përmes proceseve natyrore si dhe nën ndikimin e dritës së diellit, erës, mikroorganizmave dhe algave	**Stabilization lagoon**	Waste or waste water stabilization ponds are large, man-made water bodies in which blackwater , greywater or faecal sludge are treated by natural occurring processes and the influence of solar light, wind, microorganisms and algae	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Largim i azotit	Largimi i azotit nga ujërat e ndotura bëhet përmes një sërë metodash, ku ndër me kryesoret janë shkëmbimi jonik dhe denitrifikimi	**Nitrogen removal**	The removal of nitrogen from the waste water by a variety of methods, as ion exchange and denitrification	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Largim i hekurit, deferrizim	Shihni përkufizimin për " Sistem deferrizimi"	**Iron removal; deferrisation**	See the definition "Deferrisation system"	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Largimi i rërës	Proces i cili përdoret për largimin e rërës, fundërresave, dhe gurëve ranor nga uji. Largimi i gurëve ranor (dhe i rërës) shpeshherë haset në konstruksionin kryesor të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Larguesit e rërës janë të projektuar për të përballuar një shpejtësi horizontale prej 0.3 m/s në mënyrë që rëra të precipitojë nga ujërat e kontaminuara, mirëpo materiet organike mbesin aty. Largimi i gurëve ranor mund të përdoret edhe për largimin e rërës nga ujëmarrësit e ujërave të lumenjve përpara përpunimit të tyre për t'i kthyer në ujë të pijshëm, po ashtu ky proces gjen zbatim edhe në industri për largimin e abrazivëve të imtë, si dhe përdoret edhe për largimin e gurëve ranor të bartur nga lymi (llumi)	**Grit removal**	The process used to remove sand, silt and grit from water. Grit (and sand) removal is often found in the headworks of wast ewater treatment plants. Sand removers are designed to withstand a horizontal shore of 0.3 m/s so that the sand falls off contaminated water but the organic matter remains. Grit removal can also be used to remove sand from river water intakes prior to processing for potable water, use in industrial applications to remove fine abrasives, as well as being used to remove grit entrained in sludge	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Largim i vajrave, ndarje e vajrave	Proces i ndarjes së sasive të mëdha të vajrave dhe të lëndëve të ngurta të suspenduara, nga efluentët e ujërave të ndotura (zakonisht nga rafineritë e naftës, impiantet petrokimike, impiantet kimike, impiantet e përpunimit të gazit natyror dhe nga burimet e tjera të ujërave industrialë vajorë)	**Oil removal; oil separation**	Process to separate gross amounts of oil and suspended solids from the waste water effluents (usually of oil refineries, petrochemical plants, chemical plants, natural gas processing plants and other industrial oily water sources)	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lartësia e presionit hidrostatik	Energjia e brendshme e një fluidi (lëngu apo gazi) si rezultat i presionit (shtypjes) së ushtruar në rezervuarin (depozitën, enën) ku ai gjendet. Po ashtu mund të quhet edhe lartësi e presionit statik i cili vjen si rezultat i lëvizjes së brendshme të molekulave të një fluidi e cila ushtron forcë në rezervuarin (depozitën, enën) në të cilën gjendet fluidi	**Pressure head**	The internal energy of a fluid due to the pressure exerted on its container. It may also be called static pressure head or simply static head (but not static head pressure). It is due to the internal molecular motion of a fluid that exerts a force on its container.	Hidraulikë	
Lartësi mbi ujë	Distanca vertikale ndërmjet një shtrati (shtrese) të lëndës filtruese apo një materiali jonoshkëmbyes dhe një tubi shkarkues të tepricës së ujit apo një kolektori për ujërat me rrjedhje të kundërt. Lartësia mbi shtratin (shtresën) e lëndës granulare e cila është në dispozicion për zgjerimin e shtratit gjatë rrjedhjes së ujit në drejtim të kundërt. Mund të shprehet qoftë si një distancë lineare ose si një përqindje e thellësisë së shtratit	**Freeboard**	The vertical distance between a bed of filter media or ion exchange material and the overflow or collector for backwash water; the height above the bed of granular media available for bed expansion during backwashing. It may be expressed either as a linear distance or a percentage of bed depth	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lartësia normale e sipërfaqes së ujërave	Paraqet nivelin më të ultë të kreshtës së ujëshkarkimit (kapërderdhjes) në një rezervuar me një nivel të fiksuar të ujëshkarkimit (lartësia e kreshtës së kapërderdhsit (ujëshkarkuesit)). Për një rezervuar rrjedhja dalëse (derdhja) e të cilit kontrollohet tërësisht apo pjesërisht me porta lëvizëse, sifone, apo me mjete të tjera, kjo lartësi paraqet nivelin maksimal deri ku uji mund të ngritet në kushte normale operimi, duke përjashtuar çfarëdo mbingarkese të rezervuarit në rast përmbytjeje	**Normal Water Surface Elevation**	The lowest crest level of overflow on a reservoir with a fixed overflow level (spillway crest elevation). For a reservoir whose outflow is controlled wholly or partly by movable gates, siphons, or other means, it is the maximum level to which water may rise under normal operating conditions, exclusive of any provision for flood surcharge	Përmbytje	
Leje	Një vendim me shkrim i lëshuar nga autoritetet për lejimin e aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim negativ në statusin e trupave ujorë, si p.sh. shkarkimet e ujërave të ndotura, rimbushjet e trupave ujorë në mënyrë artificiale, apo nxjerrjet e ujit. Mund të përfshijë dhënien e autorizimit për të operuar në tërësi apo një pjesë të një impianti, sipas kushteve të caktuara që garantojnë se impianti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës. Një leje mund të përfshijë një apo më shumë impiante apo pjesë të impianteve në të njëjtën vendndodhje që operohen nga i njëjti operator	**Permit**	Written decision granted by the authorities that allow activities that may have an adverse impact on water bodies' status, such as waste water discharges, artificial recharges, or water abstractions. It may grant the authorization to operate all or part of an installation, subject to certain conditions which guarantee that the installation complies with the requirements of the legislation. A permit may cover one or more installations or parts of installations on the same site operated by the same operator	Aspekte institucionale dhe ligjore	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2010/75/EU
Lëndë djegëse	Çdo lëndë e ngurtë, e lëngët apo e gaztë që është e ndezshme	**Fuel**	Any solid, liquid or gaseous combustible material	Industri	Direktiva 2010/75/EU

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Lëndë djegëse determinative (përcaktuese)	Prej të gjitha lëndëve djegëse që përdoren në një impiant djegës i cili ndizet nga shumë lëndë djegëse e ku përdoren mbetjet (fundërresat) e distilimit dhe të konversionit (shndërrimit) nga rafinimi i naftës së papërpunuar për konsum vetanak, lënda djegëse determinative (përcaktuese) është lënda djegëse e cila qoftë si lëndë e vetme apo bashkë me lëndët e tjera djegëse ka vlerën më të lartë kufizuese të emisionit (në Shqipëri - vlerën kufizuese të shkarkimit), apo, në rast të shumë lëndëve djegëse që kanë të njëjtën vlerë kufizuese të emisionit, ajo paraqet lëndën djegëse me të hyrën termike më të lartë krahasuar me lëndët tjera djegëse	**Determinative fuel**	The fuel which, amongst all fuels used in a multi-fuel firing combustion plant using the distillation and conversion residues from the refining of crude-oil for own consumption, alone or with other fuels, has the highest emission limit value or, in the case of several fuels having the same emission limit value, the fuel having the highest thermal input amongst those fuels	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Lëndë e tretur	Çdo lëndë e ngurtë e cila është e tretur në një lëngë i cili paraqet tretësin	**Solute**	Any solid material that is dissolved in a liquid which is the solvent	Cilësi e ujërave	
Lëndë organike	Substancat me prejardhje nga lëndët e bimëve apo kafshëve (të ngordhura), të cilat përmbajnë një strukturë të ndërtuar nga atomet e karbonit dhe të hidrogjenit	**Organic matter**	Substances of (dead) plant or animal matter, with a carbon-hydrogen structure	Ndotje	
Lëndë të ngurta të tretura	Materiet e ngurta (mineralet, kripërat, metalet, kationet apo anionet) të cilat plotësisht treten në ujë dhe mund të largohen prej tij me anë të filtrimit	**Dissolved solids**	Solids material (minerals, salts, metals, cations or anions) that totally dissolves in water and can be removed by means of filtration	Cilësi e ujërave	
Lëndë ushqyese	Elemente si fosfori, kaliumi, magnezi, hekuri, kalciumi, bakri, squfuri, zinku etj, të cilat shërbejnë si ushqim për organizmat bimorë dhe mikroorganizmat. Edhe pse oksigjeni dhe uji janë thelbësorë për jetën ata gjithsesi nuk quhen si lëndë ushqyese	**Nutrient**	Elements such as phosphorus, potassium, magnesium, iron, calcium, copper, sulfur, zinc etc., which serve as food for plant and microbial life. Although oxygen and water are vital to life, they are not usually called nutrients	Ndotje	
Lëndët e ngurta të suspenduara (në pezulli)	Grimcat e vogla të ngurta në përbërje të ujit, të cilat nuk formojnë 'tretësirë të vërtetë' dhe të cilat shkaktojnë turbiditet. Këto lëndë përfshijnë lëndët e ngurta të sedimentueshme dhe jo të sedimentueshme. Grimcat e lëndëve të ngurta të suspenduara (në pezulli) kanë tendencë të fundërrojnë në sipërfaqet fundore, mirëpo rrymat ngjitëse tek rrjedhjet turbulente i kundërvihen fundërrimit nën veprimin e gravitetit	**Suspended solids**	The small solid particles in water that are not in true solution and cause turbidity. They include settleable and non-settleable solids. Particles of suspended solids tend to settle at the bottom, but upward currents in turbulent flow counteract gravitational settling	Status i trupave ujorë	
Lëndët e ngurta të suspenduara në një lëng (tretësirë) të përzier	Sasia e lëndëve të ngurta të biomasës në një reaktor biologjik të ujërave të ndotura të përziera me lëndët e ngurta të avullueshme dhe të pabiodegradueshme, si dhe me lëndët e ngurta inerte inorganike të suspenduara, të cilat rezultojnë pas kombinimit të lymit (llumit) të ricikluar me ujërat e ndotura të influentit në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura përmes procesit biologjik me lym (llum) aktiv	**Mixed Liquor Suspended Solids**	The amount of biomass within the reactor of and activated sludge process for waste water treatment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lëndët e ngurta totale	Të gjitha lëndët e ngurta që gjenden në ujë, përfshirë lëndët e ngurta në pezulli dhe lëndët e ngurta të filtrueshme. Këto lëndë shprehen si pesha e të gjitha lëndëve të pranishme të ngurta për njësi vëllimi të ujit, që zakonisht varet nga procesi i avullimit	**Total solids**	All the solids in water, including suspended solids and filterable solids. It is measured as the weight of all present solids per unit volume of water and it is usually determined by evaporation	Cilësi e ujërave	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Lëndët totale të ngurta në pezulli	Pesha e thatë e grimcave të ngecura në një filtër. Paraqet një parametër të cilësisë së ujërave i cili përdoret për shembull për të vlerësuar cilësinë e ujërave të ndotura pas trajtimin të tyre në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura	**Total suspended solids**	The dry-weight of particles trapped by a filter. It is a water quality parameter used for example to assess the quality of waste water after treatment in a waste water treatment plant	Cilësi e ujërave	
Lëndët totale të ngurta të tretura	Masë matëse e përbërjes së kombinuar të të gjitha substancave inorganike dhe organike, të cilat gjenden në suspension në një lëngë në formë molekulare, të jonizuar apo mikrogranulare (tretësire koloidale)	**Total dissolved solids**	A measure of the combined content of all inorganic and organic substances contained in a liquid in molecular, ionized or micro-granular (colloidal sol) suspended form	Cilësi e ujërave	
Lëng kullues	Është çdo lëng që filtrohet nëpër mbeturinat (mbetjet) e depozituara dhe që shkarkohet prej apo mbetet brenda një objekti mbeturinash (mbetjesh), përfshirë kullimin (drenazhin) e ndotur, i cili mund të ndikojë negativisht në mjedis nëse nuk trajtohet siç duhet	**Leachate**	Any liquid percolating through the deposited waste and emitted from or contained within a waste facility, including polluted drainage, which may adversely affect the environment if not appropriately treated	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC, Direktiva 1999/31/EC
Lëshim (përgatitje) i pompës	Proces në të cilin helika e një pompe centrifugale (qendërikëse) do të zhytet plotësisht në lëngë pa përmbajtur asnjë fluskë ajri brenda vetes, i cili proces kërkohet sidomos tek ndezjet fillestare	**Priming (of pump)**	The process in which the impeller of a centrifugal pump will get fully sub merged in liquid without any air trap inside. It is especially required when there is a first start up	Hidraulikë	
Lëshim vezësh peshku	Term i cili përdoret për të nënkuptuar procesin në të cilin peshqit dhe organizmat e tjerë ujor i depozitojnë apo i fertilizojnë vezët gjatë riprodhimit të tyre	**Spawning**	Term used to denote the process where fish, and other water dwelling organisms, deposit and fertilize eggs during reproduction	Zona të mbrojtura	
Lëvizje e shpejtë e baticës	Një dukuri natyrore ku një baticë me lëvizje të shpejtë kalon nëpër një ngushtim, me ç'rast rezulton në formimin e valëve (dallgëve), shtjellave (vorbullave), dhe të rrymave të rrezikshme	**Race (tidal)**	A natural occurrence whereby a fast moving tide passes through a constriction resulting in the formation of waves, eddies and hazardous currents	Hidraulikë	
Lidhje e tubave (rakord)	Pika ku dy apo më shumë tuba bashkohen	**Junction**	A point where two or more pipes are joined	Furnizim me ujë	
Lidhje me flanxhë	Bashkuese të cilat mbërthejnë dy flanxha me një mbushje (permistop) ndërmjet tyre me qëllim të ngjitjes së tyre në mënyrë hermetike	**Flanged joint**	Joints that are bolting together two flanges with a gasket between them to provide a seal	Furnizim me ujë	
Ligatinë[18]	Një zonë e cila është e ngopur me ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore, me vegjetacion të përshtatur për jetesë nën kushtet që mbizotërojnë në të	**Wetland**	An area that is saturated by surface water or groundwater, with vegetation adapted for life under those soil conditions	Zona të mbrojtura	
Ligatinë artificiale	Një ligatinë e krijuar në mënyrë artificiale zakonisht me një mbështjellës të brendshëm rezistent ndaj ujit për pastrimin e ujërave të ndotura. Ndalimi (bllokimi), prurjet, llojet e bimëve dhe parametrat e tjerë kontrollohen për të përmirësuar reduktimin e Kërkesës Biokimike për Oksigjen, dhe për të larguar materiet e ngurta të suspenduara si dhe azotin. Bimët breglumore tipike si xunkthi dhe kallami përdoren për reduktimin e ngarkesës ndotëse duke iu ofruar baktereve një zonë rrënjore oksigjenuese	**Constructed wetland**	An artificially created wetland usually with a waterproof lining for waste water purification. Detention, flow rates, types of plants and other parameters are controlled to improve Biochemical Oxygen Demand, Suspended solids and Nitrogen removal. Typical riparian plants like cattails and reeds are used to provide bacteria with an oxygenating root zone	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[18] **Ligatinat** - paraqesin zona të kënetave, moçaleve, tokave torfike, ujërave natyrore ose artificiale, të përhershëm ose të përkohshëm, me ujëra të rrjedhshëm ose amull dhe të freskët ku thellësia e rrjedhës së poshtme nuk kalon gjashtë (6) metra. (**Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Neni 7, Paragrafi 1.14, Legjislacioni i Kosovës**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ligatinë me rrjedhje nënsipërfaqësore	Paraqet një lloj ligatine artificiale në të cilën ujërat e ndotura, të cilat më parë i janë nënshtruar trajtimit primar, rrjedhin nëpër zhavorrin apo nëpër substratet e tjera poroze në thellësi të ligatinës, në të cilën është mbjellë vegjetacioni karakteristikë për të. Për më tepër, ujërat e ndotura nuk ekspozohen në ajër, çka bënë që të shmangen problemet me erën e tyre të keqe dhe kontaktin direkt me to	**Subsurface flow wetland**	A type of constructed wetland in which primarily treated waste flows through deep gravel or other porous substrate planted with wetland vegetation. The water is not exposed to the air, avoiding problems with odor and direct contact.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Liqe	Është një trup i ujërave të brendshëm sipërfaqësorë të ndenjurë (amull)	**Lake**	Lake means a body of standing inland surface water	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Lopatëz (përzierëse) ajrimi	Një pajisje e cila e shfrytëzon kontaktin ajër-ujë për të transferuar oksigjenin prej ajrit atmosferik në ujë. Kjo pajisje mund të përmbajë qoftë një bosht vertikal apo horizontal	**Aeration paddle**	A device that utilizes air-to-water contact to transfer oxygen from the air in the atmosphere to the water. It can be with vertical or horizontal axis	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Lulëzim i algave	Fenomeni i rritjes së shtuar të algave që ndikon në cilësinë e ujërave. Lulëzimi i algave tregon për ndryshimet potencialisht të rrezikshme në kiminë e ujit	**Algae bloom**	Phenomenon of enlarged algal growths that affect water quality. Algal blooms indicate potentially hazardous changes in the chemistry of water	Ndotje	
Lumare (fushë lymore)	Është sipërfaqja e ultë e tokës e puthitur me lumë, që formohet kryesisht nga sedimentet e lumit dhe që mund të përmbytet nga ujërat. Duke e mbajtur ujin, lumaret (fushat lymore) mund t'i zbusin efektet nga reshjet e mëdha, dhe kështu t'i mbrojnë veprimtaritë ekonomike dhe komunitetet që shtrihen në pjesën e poshtme nga ku është shkaktuar dëmi prej përmbytjes	**Floodplain**	An area of low-lying ground adjacent to a river, formed mainly of river sediments and subject to flooding. By retaining water, floodplains can buffer the effects of heavy rainfall and in this way protect economic activities and communities further downstream from flood damage	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Lumë	Është një trup i ujërave të brendshëm, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë	**River**	A body of inland water flowing for the most part on the surface of the land but which may flow underground for part of its course	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Lym (llum) [19]	Paraqet mbetjen e përbërë nga lëndët e ngurta, e cila fundërron në pjesën e poshtme të dekantuesve gjatë një procesi të trajtimit të ujërave të ndotura dhe e cila duhet të mënjanohet qoftë me zbërthim apo me metoda të tjera, apo përmes riciklimit në tokë	**Sludge**	Solid matter that settles to the bottom of sedimentation tanks in a sewage treatment process and must be disposed of by digestion or other methods or recycled to the land	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC, Direktiva 86/278/EEC
Lym (llum) i trajtuar	Mbetje lymi (llumi) që i është nënshtruar trajtimit biologjik, kimik apo termik, magazinimit afatgjatë apo çfarëdo procesi tjetër adekuat, për të reduktuar në masë të konsiderueshme fermentueshmërinë e tij si dhe rreziqet shëndetësore që mund të rezultojnë prej përdorimit të tij	**Sludge, treated**	Residual sludge which has undergone biological, chemical or heat treatment, long-term storage or any other appropriate process so as significantly to reduce its fermentability and the health hazards resulting from its use	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 86/278/EEC
Lym (llum) voluminoz (i stivuar)	Grumbullimi masiv i lymit mund të ndodhë në impiantet e përfitimit të lymit aktiv kur lymi nuk fundërron lehtësisht dhe ka vëllim të tepërt	**Bulking, sludge**	Bulking can occur in activated sludge plants when the sludge does not settle easily and has an excessive volume	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[19] **Llum** - nënkupton mbetje llumi, qoftë i trajtuar apo i pa trajtuar, nga impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura (**UA Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor, Neni 4, paragrafi 1.5, Legjislacioni iKosovës**)
Lym - nënkupton lymi i mbetur nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane apo shtëpiake dhe nga impiantet e tjera të ngjashme; 1.1.1. lymi i mbetur nga gropat septike dhe pajisjeve/impianteve të tjera të ngjashme për trajtimin e ujërave të ndotura; 1.1.2. lymi i mbetur nga impiantet e ujërave të ndotura të ndryshme nga ato të përmendura në nënparagrafin 1.1 dhe 1.2. të këtij neni (**UA Nr. 29/2014 për menaxhimi e lymit nga trajtimi i ujërave të ndotura, Neni 3, paragrafi 1.1**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Lym (llum) pluskues; shkumë	Flluskat dhe kontaminantët ngrihen në sipërfaqen e ujërave të ndotura të cilat trajtohen me "flotacion me tretje të ajrit" dhe formojnë një shtresë pluskuese të lëndëve, të cilat largohen përmes një shkumëheqësi sipërfaqësor drejt një kanali të brendshëm të pranimit, për trajtim të mëtejshëm	**Floating sludge; scum**	The bubbles and contaminants rise to the surface of waste water being treated by"Dissolved air flotation" treatment and form a floating bed of material that is removed by a surface skimmer into an internal hopper for further handling	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.15 Lll

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Llogaria e sasisë së ujit	Llogaria e ujit paraqet një instrument të dobishëm për udhëheqjen e politikave ujore dhe të menaxhimit të ujërave në shkallë të ndryshme të vendimmarrjes, në veçanti sa i përket menaxhimit sasior dhe alokimit efiçient të resurseve (në Shqipëri - burimeve) ujore në nivel të pellgut lumor (në Shqipëri- basenit ujor)	**Water accounts**	The Water Account represent a useful tool for guiding water policy and management at different decision making scales, in particular with regards to the quantitative management and efficient allocation of water resources at the river basin level	Analizë ekonomike	
Llojet invazive	Një lloj i bimëve, kërpudhave apo kafshëve, të cilat nuk janë lloje autoktone (vendore) të një zonë të caktuar (një lloj i introduktuar, i futur në ekosistemin e kësaj zone), të cilat kanë tendencë të shkaktojnë dëmtim të mjedisit, të veprimtarisë ekonomike apo të shëndetit të njeriut	**Invasive species**	A plant, fungus, or animal species that is not native to a specific location (an introduced species), and which has a tendency to spread to a degree believed to cause damage to the environment, human economy or human health	Probleme mjedisore	
Llojet me interes për Komunitetin	Llojet të cilat, brenda territorit të një Shteti, janë të rrezikuara, me përjashtim të atyre llojeve shtrirja natyrore e të cilave është e papërfillshme në atë territor dhe të cilat nuk janë të rrezikuara apo të cenueshme (prekshme) në regjionin palearktik perëndimor; apo të cenueshme (në Shqipri - të prekshme), d.m.th. që ka gjasa të bëhen pjesë e kategorisë "të rrezikuara" në një të ardhme të afërt nëse faktorët shkaktarë vazhdojnë të veprojnë; janë të rralla, d.m.th. janë lloje me popullacione (në Shqipëri -popullata) të vogla, që edhe pse për momentin nuk janë të rrezikuara apo të cenueshme (të prekshme), sidoqoftë janë në rrezik	**Species of Community Interest**	Species which, within the territory of a State, are endangered, except those species whose natural range is marginal in that territory and which are not endangered or vulnerable in the western palearctic region; or vulnerable, i.e. believed likely to move into the endangered category in the near future if the causal factors continue operating; or rare, i.e. with small populations that are not at present endangered or vulnerable, but are at risk	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC

4.16 Mm

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Magazinim (depozitim)	Prania e një sasie substancash të rrezikshme për qëllime ruajtjeje në depo, depozitimi të sigurt ose mbajtjeje në gjendje stoku	**Storage**	The presence of a quantity of dangerous substances for the purposes of warehousing, depositing in safe custody or keeping in stock	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU
Makrofite	Të gjitha bimët e larta ujore, myshqet dhe algat characean, me përjashtim të fitoplanktonit njëqelizorë apo të bimëve ujore diatome. Paraqet një element të cilësisë biologjike për klasifikimin e statusit ekologjik të trupave ujor sipërfaqësorë	**Macrophytes**	All aquatic higher plants, mosses and characean algae, but excluding single celled phytoplankton or diatoms. It is a biological quality element for classification of ecological status of surface water bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Makro-invertebrorë	Shtazë të vogla pa shtyllë kurrizore të cilat mund të shihen me syrin e lirë, p.sh. llojet e mizave, krimbave, shushunjave, kërmijve, etj. Këto shtazë janë bioindikator (tregues biologjikë) të nivelit të ndotjes së disa ekosistemeve ujore	**Macro-invertebrates**	Small animals without a backbone that can be seen by the unaided eye, e.g. species of flies, worms, leeches, snails, etc. These animals are good bioindicators in relation to the level of pollution of some aquatic ecosystems	Status i trupave ujorë	
Manometër	Një instrument i cili shërben për matjen e shtypjes, i përbërë nga një tub në formë të shkronjës U i cili përmban një lëngë apo sistem lëngjesh. Kur njëri krah i tubit- U i nënshtrohet një shtypjeje gazi më të lartë në sipërfaqen e tij në krahasim me krahun tjetër, atëherë niveli i lëngut në të do të jetë më i ultë sesa në krahun tjetër. Ndryshimi në mes të nivelit të lëngut në njërin dhe tjetrin krah i përgjigjet ndryshimit të shtypjes ndërmjet sipërfaqeve të lëngut në njërin dhe tjetrin krah	**Manometer**	A pressure measuring instrument consisting of a U-tube containing a liquid or system of liquids. When one leg of U is under higher gas pressure on its surface than the other, the liquid in it is correspondingly lower. The difference in liquids level corresponds to the pressure difference between the liquid surfaces	Hidraulikë	
Marrja e mostrës (mostrimi)	Procesi i marrjes së një sasie të ujit për analiza apo për testime të tjera të tij	**Sampling**	The process of taking a portion of water for analysis or other testing	Monitorim	
Masa parandaluese	Çdo masë e cila merret si përgjigje ndaj një ndodhie, akti apo mosveprimi që ka krijuar një rrezik të menjëhershëm për dëmtimin e mjedisit, e cila masë merret me qëllim të parandalimit apo minimizimit të këtij dëmtimi	**Preventive measures**	Any measures taken in response to an event, act or omission that has created an imminent threat of environmental damage, with a view to preventing or minimising that damage	Masat	Direktiva 2004/35/CE
Masat sanuese	Çdo veprim, apo kombinim veprimesh, përfshirë masat zbutëse apo të përkohshme për të përtëritur, revitalizuar apo zëvendësuar resurset (në Shqipëri - burimet) natyrore të dëmtuara dhe/apo shërbimet e dëmtuara, apo për të ofruar një alternativë ekuivalente me ato resurse apo shërbime	**Remedial measures**	Any action, or combination of actions, including mitigating or interim measures to restore, rehabilitate or replace damaged natural resources and/or impaired services, or to provide an equivalent alternative to those resources or services	Masat	Direktiva 2004/35/CE
Masa zbutëse (lehtësuese) të thatësirave	Masa të cilat mund të merren paraprakisht apo në fillim të shfaqejes së thatësirave, për të ndihmuar në zvogëlimin e ndikimeve të tyre. Këto masa janë të shumëllojshme dhe përfshijnë planifikimin e thatësirave, zbatimin e praktikave të përdorimit të tokës të cilat e rrisin përbërjen organike dhe kapacitetin ujëmbajtës të tokës (dheut), dhe hartimin e politikave bujqësore të cilat nuk mbështesin përfitimet ekonomike afatshkurtra në dëm të kapacitetit prodhues afatgjatë	**Mitigation (droughts)**	Actions that can be taken before, or at the beginning of, drought to help reduce the impacts of drought. It includes actions as diverse as drought planning, implementing land use practices that increase the organic content and water-holding capacity of soil, and designing agricultural policy that doesn't encourage short-term economic gains at the expense of long-term productive capacity	Masat	Politikat e BE-së për Pamjaftueshmëri të Ujit dhe Thatësira
Masë	Një veprim i cili merret për të ndihmuar arritjen e objektivave specifike	**Measure**	An action which will be taken to help achieve specific objectives	Masat	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Materie fekale (feçe)	Mbeturinat (në Shqipëri - mbetjet) metabolike të ngurta apo gjysmë të ngurta nga trakti tretës i një shtazë Urina dhe feçet së bashku quhen Jashtëqitje (ekskrete)	**Fecal matter**	The solid or semisolid metabolic waste from an animal's digestive tract. Urine and feces together are called excreta	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Materie inorganike	Materie e cila nuk e ka origjinën nga organizmat e gjallë dhe e cila nuk përmban karbon që prodhohet në mënyrë organike, por ajo përfshinë shkëmbinjtë, mineralet dhe metalet	**Inorganic matter**	Matter which is not derived from living organisms and contains no organically produced carbon. It includes rocks, minerals and metals	Cilësi e ujërave	
Maturim (pjekje)	Maturim i një biofiltri, procesi i përftimit të një popullate të balancuar bakteresh, etj., për të pastruar ujërat e ndotura që kalojnë nëpër këtë filtër. Një biofiltër i ri për t'u maturuar i duhen 6 muaj në periudhë dimri dhe vetëm disa javë në kohë të nxehtë.	**Maturing**	The process of acquiring a balanced population of bacteria, etc., to purify the waste water passing through it	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Mbeturina (mbetje) H12	Mbeturinat (në Shqipëri -mbetjet) të cilat lirojnë gazra toksike apo shumë toksike në kontakt me ujin, ajrin apo ndonjë acid	**Waste (H12)**	Waste which releases toxic or very toxic gases in contact with water, air or an acid	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Mbeturina inerte (në Shqipëri mbetje inerte)	Mbeturinat (mbetjet) që nuk pësojnë ndonjë transformim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbeturinat (mbetjet) inerte nuk treten, nuk digjen apo të reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk biodegradohen apo të ndikojnë negativisht në materiet e tjera me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit apo dëmtim të shëndetit të njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar (kulluar) dhe përbërja e ndotësve të mbeturinave (mbetjeve), si dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese duhet të jenë të papërfillshme, e në veçanti të mos e rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësorë dhe/ose ujërave nëntokësore	**Inert waste**	Waste that does not undergo any significant physical, chemical or biological transformations. Inert waste will not dissolve, burn or otherwise physically or chemically react, biodegrade or adversely affect other matter with which it comes into contact in a way likely to give rise to environmental pollution or harm human health. The total leachability and pollutant content of the waste and the ecotoxicity of the leachate must be insignificant, and in particular not endanger the quality of surface water and/or groundwater	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC, Direktiva 1999/31/EC
Mbeturinë (në Shqipëri - mbetje)	Është çdo substancë apo objekt që zotëruesi i saj e hedh, ka për qëllim ta hedh, apo është i detyruar ta hedh	**Waste**	Any substance or object which the holder discards or intends or is required to be discarded	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC, Direktiva 1999/31/EC, Direktiva 91/689/EEC, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Mbeturinë (mbetje) e mineralit	Lëndët e ngurta të mbeturinave (mbetjeve) apo suspensionet (pezullitë) e tyre, të cilat mbesin pas trajtimit të mineraleve me proceset e ndarjes (separimit) (p.sh. me thërmim/copëtim, bluarje, klasifikim sipas madhësisë, flotacion dhe teknika të tjera fiziko-kimike) për largimin e mineraleve të vlefshme nga gurët më pak të vlefshëm	**Tailings**	The waste solids or slurries that remain after the treatment of minerals by separation processes (e.g. crushing, grinding, size-sorting, flotation and other physico-chemical techniques) to remove the valuable minerals from the less valuable rock	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC
Mbeturinë (mbetje) e rrezikshme	Është mbeturina që shfaq një apo më shumë tipare të rrezikshme	**Hazardous waste**	Waste which displays one or more of the hazardous properties	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Mbilartësia e ujit (në kontekst të digës)	Distanca vertikale midis kurorës së argjinaturës dhe sipërfaqes së ujit të rezervuarit. Mbilartësia e ujit mund të përkufizohet në kuptime të ndryshme si "Mbilartësi normale" (dallimi në lartësi midis kurores së digës dhe nivelit normal të rezervuarit të ujit siç përcaktohet nga kërkesat e projektimit), dhe si "Mbilartësi minimale" (dallimi në lartësi midis kurorës së digës dhe nivelit maksimal të sipërfaqes së ujit të rezervuarit , e cila do të rezultonte po qe se do të ndodhte tejkalimi i konsumit të llogaritur ujëshkarkues (në rast përmbytjeje), kur ujëshkarkuesi (ujëlëshuesi) dhe kapërderdhësi funksionojnë sipas planit	**Freeboard (dam)**	The vertical distance between the crest of the embankment and the reservoir water surface. Free board can be defined in different terms such as “Normal freeboard” (the difference in elevation between the crest of the dam and the normal reservoir water level as fixed by design requirements) and “Minimum freeboard” (the difference in elevation between the crest of the dam and the maximum reservoir water surface that would result should the inflow design flood occur and the outlet works and spillway function as planned)	Përmbytje	
Mbledhja (në Shqipëri - grumbullimi)	Është mbledhja e mbeturinave (mbetjeve), përfshirë klasifikimin paraprak dhe magazinimin paraprak të mbeturinave (mbetjeve) me qëllim të transportimit të tyre deri në impiantet e trajtimit (në Shqipëri- përpunimit) të mbeturinave (mbetjeve)	**Waste collection**	The gathering of waste, including the preliminary sorting and preliminary storage of waste for the purposes of transport to a waste treatment facility	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Mbledhja e të ardhurave	I referohet vëllimeve të ujit të cilat faturohen gjatë periudhës referente pavarësisht pagesës ose mospagesës së këtyre faturave nga ana e konsumatorëve	**Revenue collection**	It refers to the volumes of water that are billed during the reference period, regardless of whether those bills are paid or not by the customers	Menaxhim i ujërave	
Mbushje me lym (llum)	Një proces në të cilin uji ndotet me sedimente me madhësi të grimcave që dominohen nga fundërresat apo balta. Ky term i referohet si rritjes së përqendrimit të sedimenteve të suspenduara (pezullive) ashtu edhe grumbullimit të përkohshëm apo të përhershëm të sedimenteve të imta në sipërfaqet fundore, aty ku ato nuk janë të dëshirueshme. Mbushja me lym më së shpeshti shkaktohet nga erozioni i tokës apo teptisja e sedimentit	**Siltation**	A process by which water becomes polluted by sediments, with a particle size dominated by silt or clay. It refers both to the increased concentration of suspended sediments, and to the increased accumulation (temporary or permanent) of fine sediments on bottoms where they are undesirable. Siltation is most often caused by soil erosion or sediment spill	Ndotje	
Mbyllës i përparmë (ballor)	Një portë kontrolli në fundin e një kanali në rrjedhën e sipërme të tij apo në fundin e një kyçi	**Head gate**	A control gate at the upstream end of a canal or lock	Furnizim me ujë	
Mbyllje (hermetizim)	Lëndë e papërshkueshme, siç është llaqi i lëngshëm i çimentos, bentoniti, apo brumi argjilor (argjila e ngjeshur) e cila vendoset në hapësirën unazore ndërmjet murit të vrimës së shpimit dhe shtresës së jashtme të një pusi uji, për të penguar rrjedhjen poshtë saj të ujërave sipërfaqësore apo përzierjen vertikale të ujërave arteziane	**Seal**	The impermeable material, such as cement grout, bentonite, or puddling clay placed in the annular space between the borehole wall and the casing of a water well to prevent the downhole movement of surface water or the vertical mixing of artesian waters	Furnizim me ujë	
Meandër (dredhë, brryl, kthesë)	Gjarpërim i kanalit të një ujërrjedhe	**Meander**	The winding of a stream channel	Trupa ujorë	
Mekanizëm	I referohet instrumenteve politike, ligjore e financiare të cilat përdoren për të ndërmarr masa (veprime). Mekanizmat përshijnë p.sh.: legjislacionin, instrumentet ekonomike, kodet e praktikave më të mira, marrëveshjet e negociuara, promovimin e efiçiencës së ujit, projektet arsimore, projektet kërkimore, zhvillimore e demonstruese	**Mechanism**	It refers to the policy, legal and financial tools which are used to bring about actions (measures). Mechanisms include for example: legislation, economic instruments; codes of good practice; negotiated agreements; promotion of water efficiency; educational projects; research; development and demonstration projects	Masat	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Menaxhim i qëndrueshëm i ujërave	Një lloj menaxhimi i ujërave ku kërkohet që resurset (në Shqipëri- burimet) ujore të alokohen në mënyrë efiçiente dhe të drejtë, dhe të përdoren për të arritur rezultate të dobishme sociale, mjedisore dhe ekonomike	**Sustainable management (of water)**	Type of water management that seeks that water resources are allocated efficiently and equitably and used to achieve socially, environmentally and economically beneficial outcomes	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC
Menaxhimi i mbeturinave (mbetjeve)	Është mbledhja (grumbullimi), transporti, rikuperimi dhe deponimi (në Shqipëri- asgjësimi) i mbeturinave (mbetjeve), përfshirë mbikëqyrjen e këtyre operacioneve dhe kujdesin e mëpastajshëm të vendeve të deponimit (asgjësimit), përshirë edhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit dhe ndërmjetësit	**Waste management**	The collection, transport, recovery and disposal of waste, including the supervision of such operations and the after-care of disposal sites, and including actions taken as a dealer or broker	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Menaxhim i ujërave	Paraqet tërësinë e aktiviteteve, vendimeve dhe masave që lidhen me ujërat, të cilat planifikohen dhe zbatohen me qëllim të arritjes së objektivave për zhvillimin e resurseve (në Shqipëri - burimeve) ujore	**Water management**	Integrity of activities, decisions and measures related to waters that are planned and implemented, with the aim of achieving the objectives for the development of water resources	Menaxhim i ujërave	
Meta-të-dhënat (Metadata)	Përshkrimi i karakteristikave të një grupi të dhënash	**Metadata**	Description of the characteristics of a set of data	Sisteme Informative	
Metalet e rënda	Metale të cilat kanë densitet të barabartë apo më të lartë se 5.0 dhe peshë të madhe elementare. Shumica prej tyre janë toksikë për njerëzit edhe në përqendrime të ulta	**Heavy metals**	Metals that have a density of 5.0 or higher and a high elemental weight. Most are toxic to humans, even in low concentrations	Ndotje	
Mezotrofik	Rezervuarët dhe liqenet të cilat përmbajnë sasi mesatare të substancave ushqyese dhe janë mesatarisht të frytshme (produktive) për sa i përket organizmave ujorë shtazorë e bimorë	**Mesotrophic**	Reservoirs and lakes which contain moderate quantities of nutrients and are moderately productive in terms of aquatic animal and plant life	Cilësi e ujërave	
Mikrofiltrim	Një lloj procesi i filtrimit fizik ku fluidi i kontaminuar kalon nëpër një membranë me pore të një madhësie specifike, për të veçuar mikroorganizmat dhe grimcat e suspenduara (pezullitë) nga lëngut që del prej këtij procesi	**Microfiltration**	A type of physical filtration process where a contaminated fluid is passed through a special pore-sized membrane to separate microorganisms and suspended particles from process liquid	Ujë i pijshëm	
Miligram për litër	Njësi e përqendrimit të një përbërësi në ujëra apo ujëra të ndotura. Paraqet 0.001 gram të një përbërësi në 1 litër ujë. Përafërsisht është i barabartë me një pjesë për milion (PPM)	**Milligrams per liter**	A unit of the concentration of a constituent in water or waste water. It represents 0.001 gram of a constituent in 1 liter of water. It is approximately equal to one part per million (PPM).	Cilësi e ujërave	
Mjedis	Uji, ajri, toka, llojet e egra të faunës dhe florës, dhe çdo raport i ndërsjellë në mes tyre, si dhe çfarëdo marrëdhënie e tyre me organizmat e gjallë	**Environment**	Water, air, land, wild species of fauna and flora, and any interrelationship between them, as well as any relationship with living organisms	Vlerësim mjedisor	
Model konceptual	Një perceptim konceptual i marrëdhënieve të ndërsjella që ndodhin brenda një sistemi, i cili vazhdimisht përsoset me kuptimin gjithnjë e më të mirë nga ana e shkencëtarëve të trupave ujor dhe të ndjeshmërisë së tyre ndaj presioneve	**Conceptual model**	A conceptual understanding of the interrelationships occurring within a system, which is continuously refined as scientists obtain an improved understanding of the water bodies concerned and their vulnerability to pressures	Menaxhim i ujërave	
Modelimi i cilësisë së ujërave	Modelimi i cilësisë së ujërave përfshinë parashikimin e ndotjes së ujit përmes përdorimit të teknikave simuluese matematikore	**Modelling, water quality**	Water quality modeling involves the prediction of water pollution using mathematical simulation techniques	Cilësi e ujërave	
Mostër (në Shqipëri - kampion)	Një sasi e vogël e ujit apo e një substance tjetër e marrë për analizë në një vend dhe kohë të caktuar, e cila konsiderohet që brenda kufijve të specifikuar statistikor e përfaqëson tërë trupin ujor apo tërë substancën prej së cilës është marrë	**Sample**	A small portion of water or other substance taken at a given place and time for analysis; it is assumed to be representative of the whole body of water or the rest of the substance within specified statistical limits	Monitorim	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Mostër (në Shqipëri - kampion)	Çdo kafshë apo bimë e një lloji, qoftë e gjallë apo e vdekur, çdo pjesë apo derivat i tyre, si dhe çdo produkt tjetër, të cilat, në dokumentin shoqërues të tyre, në paketimin apo në shenjën ose etiketën shoqëruese të tyre, apo nga çfarëdo burimi tjetër, rezultojnë se janë pjesë apo derivate të kafshëve apo bimëve të këtyre llojeve	**Specimen**	Any animal or plant, whether alive or dead, of the species, any part or derivative thereof, as well as any other goods which appear, from an accompanying document, the packaging or a mark or label, or from any other circumstances, to be parts or derivatives of animals or plants of those species	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Mot	Gjendja e atmosferës së Tokës brenda një periudhe të shkurtër kohore (brenda një dite apo një jave)	**Weather**	The condition of the earth's atmosphere over a brief period of time, like a day or a week	Rreziku	
Motor dizel	Është një motor me djegie të brendshme i cili funksionon në bazë të ciklit dizel dhe përdor ndezjen me shkëndijë për të djegur lëndën djegëse	**Diesel engine**	An internal combustion engine which operates according to the diesel cycle and uses compression ignition to burn fuel	Industri	Direktiva 2010/75/EU
Motor me gaz	Është një motor me djegie të brendshme i cili funksionon në bazë të ciklit të Otto's dhe përdorë ndezjen me shkëndijë apo, në rastin e motorëve me lëndë djegëse të dyfishtë, këta motor përdorin ndezjen me kompresion (presion të lartë) për të djegur lëndën djegëse	**Gas engine**	An internal combustion engine which operates according to the Otto cycle and uses spark ignition or, in case of dual fuel engines, compression ignition to burn fuel	Industri	Direktiva 2010/75/EU
Mungesë (pamjaftueshmëri) e ujit	Paraqet situatën e krijuar si rezultat i pamjaftueshmërisë së resurseve (në Shqipëri - burimeve) ujore për të përmbushur kërkesat afatgjate mesatare për ujë. Ky term i referohet disbalancit ujor afatgjatë, kombinimit pra të një disponueshmërie të ultë të ujërave, me një nivel të kërkesës për ujë i cili e tejkalon kapacitetin furnizues të sistemit natyror	**Scarcity (of water)**	Situation that occurs where there are insufficient water resources to satisfy long-term average requirements. It refers to long-term water imbalances, combining low water availability with a level of water demand exceeding the supply capacity of the natural system	Thatësirë	EU Blueprint[20]
Mutagjene	Substancat dhe preparatet të cilat nëse nuhaten apo gëlltiten apo nëse e depërtojnë lëkurën, mund të shkaktojnë defekte gjenetike hereditare (të trashëgueshme) apo të rrisin incidencën e tyre	**Mutagenic**	Substances and preparations which, if they are inhaled or ingested or if they penetrate the skin, may induce hereditary genetic defects or increase their incidence	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

[20] "A Blueprint to Safeguard Europe's Water Resources" - "Plani për Mbrojtjen e Resurseve Ujore te Evropës"

4.17 Nn

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Nanofiltrim	Një proces relativisht i ri i filtrimit membranor që më së shpeshti përdoret për ujërat që përmbajnë një sasi të ultë të lëndëve totale të ngurta të tretura në to (përbërja e kombinuar e substancave organike dhe inorganike që gjenden në një lëngë në formë molekulare, të jonizuar apo në formë të mikrogranulave të suspenduara), siç është rasti me ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore. Ky filtrim përdoret me qëllim të zbutjes së ujërave (heqjes së kationit polivalent) dhe largimit nga to të prekursorëve të nënprodukteve (në Shqipëri- ndërmjet produkteve) të dezinfektimit siç janë lëndët organike natyrore dhe sintetike	**Nanofiltration**	A relatively recent membrane filtration process used most often with low total dissolved solids[21] water such as surface water and fresh groundwater, with the purpose of softening (polyvalent cation removal) and removal of disinfection by-product precursors such as natural organic matter and synthetic organic matter	Ujë i pijshëm	
Ndarës (separator) hidrodinamik	Pajisje për menaxhimin e ujërave të rrëmbyeshme të reshjeve, të cilat përdorin separimin (ndarjen) ciklonike [22] për të kontrolluar ndotjen e ujërave. Ato janë të dizajnuara si struktura nëpër të cilat depërtojnë ujërat dhe që përmbajnë një njësi filtrimi apo separimi për të larguar sedimentin dhe ndotësit e tjerë. Këto pajisje konsiderohen si teknikat më të mira të trajtimit apo kontrollit, dhe përdoren për trajtimin apo trajtimin paraprak të rrjedhave të krijuara nga ujërat e rrëmbyeshme të reshjeve	**Hydrodynamic separator**	Stormwater management devices that use cyclonic separation[23] to control water pollution. They are designed as flow-through structures with a settling or separation unit to remove sediment and other pollutants. They are considered structural best management practices (BMPs) [24], and are used to treat and pre-treat stormwater runoff	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ndërkufitar	Çdo gjë që kalon një kufi ndërkombëtar politik, ashtu që origjina e tij ndodhet në një Shtet por që e shpreh efektin e vetë edhe në një Shtet tjetër fqinj (p.sh. një Rajoni të Pellgut Lumor (në Shqipëri -Rajoni të Basenit Ujor), një trupi ujor, ndikim, etj.)	**Transboundary**	Anything crossing international political border, thus its origin is in one State but it also affects to a neighbour State (e.g. River Basin District, body of water, impact, etc.)	Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare	Direktiva 2000/60/EC
Ndërprerje e shërbimit	Ndërprerje e planifikuar ose e paplanifikuar e shërbimit ndaj konsumatorëve që mund të shkaktohet si rrjedhojë e defekteve, ngecjeve, apo bllokimeve në sistemin e furnizimit apo të kanalizimit, gjithashtu mund të shkaktohet si pasojë e mangësive në mirëmbajtje apo në konstruksionin e tyre	**Service interruption**	Planned or unplanned service outage for customers that may be caused by defects, jams, or blockages of supply or sewer systems. It may also be caused by maintenance or construction deficiencies	Furnizim me ujë	
Ndihmës	Strukturat dhe njësitë që përfshijnë atë pjesë të sistemit të kanalizimit me përjashtim të gypave (tubave) të kanalizimit, siç janë stacionet e pompave, rezervuarët magazinues (të ruajtjes), etj.	**Ancillary**	Structures and units comprising the "non-sewer" part of the sewer system (pumping stations, storage tanks, etc.)	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[21] **Total dissolved solids (TDS)** is a measure of the combined content of all inorganic and organic substances contained in a liquid in molecular, ionized or micro-granular suspended form.

[22] **Separim (ndarje) ciklonike** - ndarje e thërrmijave të ngurta nga lëngjet përmes separimit shtjellor me anë të hidrociklonit, pa përdorimin e filtrave

[23] A **cyclonic separation** is a method of removing particulates from an air, gas or liquid stream, without the use of filters, through vortex separation. When removing particulate matter from liquids, a hydrocyclone is used.

[24] **Best management practices (BMP)** is a term used in the United States and Canada to describe a type of water pollution control. In stormwater management (both urban and rural) and wetland management, BMPs may refer to a principal control or treatment technique as well.

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ndikim mjedisor	Çdo ndryshimi në mjedis, qoftë negativ apo pozitiv, që pjesërisht apo plotësisht rezulton nga aktivitetet, produktet apo shërbimet e një organizate	**Environmental impact**	Any change to the environment, whether adverse or beneficial, wholly or partially resulting from an organisation's activities, products or services	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2011/92/EU, Regullorja (EC) Nr 1221/2009
Ndikim ndërkufitar	Çfarëdo efekti negativ i konsiderueshëm në mjedis, që rezulton nga një ndryshim në kushtet e ujërave ndërkufitare shkaktuar nga një aktivitet njerëzor, origjina fizike e të cilit gjendet tërësisht ose pjesërisht brenda një zone që i takon juridiksionit të një Pale, brenda një zone nën juridiksionin e një Pale tjetër. Efektet e tilla në mjedis përfshijnë efektet në shëndetin dhe sigurinë e njeriut, në florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën, peizazhin dhe monumentet historike apo në strukturat e tjera fizike, apo në bashkëveprimin në mes këtyre faktorëve; ato po ashtu përfshijnë efektet në trashëgimin kulturore apo në kushtet socio-ekonomike që rezultojnë nga ndryshimet në këta faktorë	**Transboundary impact**	Any significant adverse effect on the environment resulting from a change in the conditions of transboundary waters caused by a human activity, the physical origin of which is situated wholly or in part within an area under the jurisdiction of a Party, within an area under the jurisdiction of another Party. Such effects on the environment include effects on human health and safety, flora, fauna, soil, air, water, climate, landscape and historical monuments or other physical structures or the interaction among these factors; they also include effects on the cultural heritage or socio-economic conditions resulting from alterations to those factors	Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare	Direktiva 2000/60/EC
Ndikimi	Efekti në mjedis i një presioni (p.sh. ngordhja e peshqve, modifikimi i ekosistemeve)	**Impact**	The environmental effect of a pressure (e.g. fish killed, ecosystem modified)	Vlerësim i ndikimit	Direktiva 2000/60/EC
Ndikimi i përmbytjeve	Efekti negativ i përmbytjeve	**Impact, Flood**	The adverse effect of floods	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Ndotës	Çdo substancë e huaj dhe e padëshiruar fizike, kimike, biologjike apo radiologjike e cila është e pranishme në një mjedis natyror. Ky term në disa raste është ekuivalent me ndotjen, ku me interes është dëmi i shkallës së lartë i cili i shkaktohet njerëzve, organizmave apo mjedisit	**Contaminant**	Any foreign and unwanted physical, chemical, biological or radiological substance which is present in the natural environment. The term is in some cases equivalent to pollution, where the main interest is the harm done on a large scale to humans or to organisms or environments	Ndotje	
Ndotës	Është çdo substancë apo grup substancash të prira për të shkaktuar ndotje dhe që mund të jenë të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut fal tipareve të tyre dhe futjes së tyre në mjedis	**Pollutant**	Any substance or a group of substances liable to cause pollution and that may be harmful to the environment or to human health on account of its properties and of its introduction into the environment	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC
Ndotës estetikë	Ndotës që ndikojnë në shijen, erën, ngjyrën dhe pam jen e ujërave, por që në vetvete nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut nëse janë të pranishëm në ujin e pijes	**Aesthetic contaminants**	Pollutants that affect the taste, smell, color and appearance of the waters, without posing a risk to human health if they are present in drinking water	Cilësi e ujërave	
Ndotje	Është futja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, si rezultat i veprmitrisë së njeriut, e substancave, ndotësve mikrobiologjik apo e nxehtësisë në ajër, ujë apo tokë, e cila mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut apo cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që drejtpërdrejt varen nga ekosistemet ujore, që rezulton në dëmtimin e pronës materiale, apo në përkeqësimin ose interferimin (ndërhyrjen) në cilësinë e komoditeteve mjedisore[25] dhe përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit	**Pollution**	The direct or indirect introduction, as a result of human activity, of substances, microbiological contamination or heat into the air, water or land which may be harmful to human health or the quality of aquatic ecosystems or terrestrial which result in damage to material property, or which impair or interfere with amenities[26] and other legitimate uses of the environment	Pollution	Direktiva 2000/60/EC

[25] Një komoditet mjedisor mund të përfshijë qasjen ne ajër të pastër dhe qasjen në ujë të pastër, apo mund të përfshijë cilësinë e çfarëdo të mire tjetër mjedisore e cila mund të pakësoj efektet negative në shëndetin e banorëve dhe të rrisë mirëqenien e tyre ekonomike

[26] An environmental amenity can include access to clean air or clean water, or the quality of any other environmental good that may reduce adverse health effects for residents or increase their economic welfare

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Ndotje bujqësore	Është shkarkimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, i komponimeve të azotit nga burimet bujqësore në mjedisin ujor, që paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, shkaktojnë dëme në organizmat e gjallë dhe ekosistemet ujore, dëmtojnë cilësinë e komoditeteve mjedisore apo ndërhyjnë në përdorimet e tjera të ligjshme të ujërave	**Pollution (agricultural)**	The discharge, directly or indirectly, of nitrogen compounds from agricultural sources into the aquatic environment, causing hazards to human health, harm to living resources and to aquatic ecosystems, damage to amenities or interference with other legitimate uses of water	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 91/676/EEC
Ndotje fizike	Ndotje e ujërave e shkaktuar për shkak të ngjyrave (lëngjet, acidet zierëse që shkarkohen nga impiantet e celulozës), lëndëve të ngurta të suspenduara (pezullive), shkumëformuesve (detergjenteve), ndryshimeve të temperaturës (ndotja termale për shkak të shkarkimit të ujërave të nxehta nga impiantet industriale), si dhe ndotja e ujërave nga radioaktiviteti	**Physical pollution**	Pollution caused by colour (change), suspended solids, foaming, temperature conditions or radioactivity	Ndotje	
Ndotje ndërkufitare	Ndotje e cila origjinon në një shtet por duke e kaluar kufirin përmes shtigjeve ujore është në gjendje të shkaktojë dëmtim të mjedisit në një shtet tjetër	**Pollution (Transboundary)**	Pollution that originates in one country but, by crossing the border through pathways of water, is able to cause damage to the environment in another country	Ndotje	
Ndotje termale	Një zvogëlim i cilësisë së ujërave që shkaktohet nga rritja e temperaturës në to, shpeshherë si rezultat i lirimit në to të nxehtësisë nga proceset industriale apo nga proceset e gjenerimit të energjisë elektrike, duke shkaktuar kështu vdekjen apo dëmtimin e organizmave ujorë	**Thermal pollution**	A reduction in water quality caused by increasing its temperature, often due to disposal of waste heat from industrial or power generation processes, causing death or injury of aquatic organisms	Ndotje	
Ndryshimet klimatike	Një ndryshim në modelet klimatike globale apo rajonale, një ndryshim i vërejtur veçanërisht që prej mesit të shekullit XX e këtej, dhe që i është atribuuar kryesisht niveleve të shtuara të gazeve serrë të prodhuara nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile. Ndryshe njihen edhe me emrin "Ndryshimet klimatike globale"	**Climate change**	A change in global or regional climate patterns, in particular a change apparent from the mid to late 20th century onwards and attributed largely to the increased levels of atmospheric greenhouse gases produced by the use of fossil fuels. Also known as "Global climate change"	Probleme mjedisore	
Neutralizim	Shtimi i substancave për neutralizimin e ujit, ashtu që uji më të mos jetë as acidik e as bazik. Neutralizimi nuk nënkupton medoemos një pH prej 7.0, por thjeshtë nënkupton një pikë ekuivalente në një reaksion acido-bazik	**Neutralisation**	The addition of substances to neutralize water, so that it is neither acid, nor basic. Neutralization does not specifically mean a pH of 7.0, it just means the equivalent point of an acid-base reaction	Cilësi e ujërave	
Në det të hapur	Është ajo sipërfaqe e detit dhe shtratit të detit që shtrihet në drejtim të jashtëm prej shenjës së poshtme të nivelit të ujit të baticave të rëndomta apo mesatare	**Off-shore**	That area of the sea and seabed extending from the low water mark of ordinary or medium tides outwards	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2006/21/EC
Nën pellg (në Shqipëri - "Nën-basen ujor")	Sipërfaqja e tokës prej ku, nëpërmjet një numri të ujërrjedhave ("përrenjve"), lumenjve, dhe eventualisht liqeneve, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një pikë të posaçme në një rrjedhë uji (normalisht në një liqen apo në një bashkim lumenjsh)	**Sub-basin**	The area of land from which all surface run-off flows through a series of streams, rivers and, possibly, lakes to a particular point in a water course (normally a lake or a river confluence) and that is a portion of a river basin	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC
Ngarkesa	Bartja e lëndëve të tretura apo në formë grimcash në rrjedhën e ujërave. Në kontekst të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, ngarkesa e cila futet në impiantin e trajtimit, e shprehur në ekuivalent popullsie (p.e.), duhet të llogaritet duke e marrë parasysh ngarkesën mesatare maksimale javore gjatë vitit, përjashtuar situatat e pazakonta me reshje të fuqishme	**Load**	The transfer of material, dissolved or particulate, associated with a flow of water. In the context of waste water treatment plants, the load entering the treatment plant, expressed in population equivalent (p.e.), shall be calculated on the basis of the maximum average weekly load during the year, excluding unusual situations such as those due to heavy rain	Ndotje	Direktiva 91/271/EEC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ngarkesë e vdekur (konstante)	Ngarkesa që mbesin realtivisht konstante me kalimin e kohës. Ngarkesa e vdekur paraqet shumën e peshës së rezervuarit, gypave (tubave) dhe pajisjeve të tija përcjellëse, si dhe të pjesëve ndihmëse fikse	**Dead load**	Loads that are relatively constant over time. Dead loads are the sum of the weights of the tank, its associated piping and equipment and other fixed appurtenances	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ngarkesë (mbushje) hidraulike	1.Prurja e ujërave apo e ujërave të ndotura në një rezervuar apo në një proces trajtimi pjesëtuar për vëllimin e rezervuarit apo të reaktorit; 2.Pprurja e ujërave apo e ujërave të ndotura në një rezervuar apo në një proces trajtimi pjesëtuar për sipërfaqen e rezervuarit apo të reaktorit, d.m.th ***shpejtësinë e ngarkimit të sipërfaqes*** apo ***shkallën e njomjes***; 3.Prurja e ujërave apo e efluentit në apo mbi tokë pjesëtuar për sipërfaqen e tokës mbi të cilën aplikohet lëngu	**Hydraulic loading**	1. The water or wastewater flow in a tank or treatment process divided by the volume of the tank or reactor; 2. The water or wastewater flow in (or onto) the tank or treatment process divided by the surface area of the tank or reactor, i.e. ***the surface loading rate*** or ***wetting rate;*** 3. The flow of water or effluent onto (or into) a soil divided by the surface area of land onto which the liquid is being applied	Hidraulikë	
Nitrat	Një komponim kimik i cili përfshinë azotin dhe oksigjenin	**Nitrate**	A chemical compound that includes nitrogen and oxygen.	Ndotje	
Nitrifikim	Oksidimi biologjik i amoniakut dhe i joneve të amonit në nitrit, që pasohet me oksidimin e nitritit në nitrat. Shndërrimi i amoniakut në nitrit zakonisht paraqet hapin kufizues të shpejtësisë së nitrifikimit, i cili është i ngadalshëm në temperatura nën 10 °C dhe mund të ngadalësohet ose të ndërpritet krejtësisht si proces për shkak të ndotësve toksikë	**Nitrification**	The biological oxidation of ammonia or ammonium to nitrite followed by the oxidation of the nitrite to nitrate. The transformation of ammonia to nitrite is usually the rate limiting step of nitrification. It is slow at temperatures below 10 ° C and can be slowed down or stopped as a process due to toxic pollutants	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Nitritet	Komponime të NO_2 të cilat janë në gjendje të paqëndrueshme e të përkohshme dhe lehtësisht të oksidueshme në nitrate NO_3. Në ujërat e ndotura shtëpiake përqendrimet e nitriteve rrallëherë e tejkalojnë vlerën prej 1 mg/l, ndërsa në ujërat nëntokësore kjo vlerë është shumë më e ulët, rreth 0.1 mg/l. Amoniaku shndërrohet në nitrite me ndihmën e baktereve, kryesisht Nitrosococcus dhe Nitrosomonas	**Nitrites**	NO_2 compounds which are in a volatile, temporary and easily oxidising state in NO_3 nitrate. In domestic waste water, concentrations of nitrite rarely exceed 1 mg / l, while in groundwater this value is much lower, about 0.1 mg / l. Ammonia is converted into nitrite by bacteria, mainly Nitrosococcus and Nitrosomonas	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Nitrobaktere	Baktere nitrifikuese që bëjnë shndërrimin e nitriteve në nitrate, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ciklin e azotit me oksidimin e nitriteve në nitrate në sistemet detare dhe tokësore	**Nitrobacter**	Nitrifying bacteria that convert the nitrite into nitrates, playin an important role in the nitrogen cycle by oxidizing nitrite into nitrate in soil and marine systems	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Nivelet e emisionit (shkarkimit) të lidhura me teknikat më të mira të mundshme (në Shqipëri-të disponueshme)	Paraqesin diapazonin e niveleve të emisionit (shkarkimit) që arrihen në kushte normale të operimit kur përdoret një teknikë më e mirë e mundshme (e disponueshme) apo një kombinim i teknikave më të mira të mundshme (të disponueshme), që shprehen si mesatarja përgjatë një periudhe kohore të caktuar, nën kushtet e specifikuara referente	**Emission levels associated with the best available techniques**	The range of emission levels obtained under normal operating conditions using a best available technique or a combination of best available techniques, expressed as an average over a given period of time, under specified reference conditions	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Nivelet natyrore (gjeokimike)	Nivelet e larta të natyrshme të substancave ose joneve apo të indikatorëve të tyre, të cilat i përmban qoftë një trup ujor nëntokësor apo trupat ujorë sipërfaqësorë përkatës, që rezultojnë si pasojë e kushteve specifike hidrogjeologjike, e të cilat nuk përfshihen në përkufizimin për "***Ndotjen***"	**Background levels (geochemical)**	High naturally-occurring levels of substances or ions or their indicators, contained either in a body of groundwater or in associated bodies of surface water, due to specific hydro-geological conditions, which are not covered by the definition of "***Pollution***"	Vlerësim i ndikimit	Directiva 2006/118/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Niveli natyror	Përqendrimi i një substance apo vlera e një indikatori në një trup ujor, i cili nuk i përgjigjet fare ose i përgjigjet fare pak alterimeve antropogjenike të kushteve natyrore intakte	**Background level**	Concentration of a substance or the value of an indicator in a body of water corresponding to no, or only very minor, anthropogenic alterations to undisturbed conditions	Vlerësim i ndikimit	Directiva 2000/60/EC, Direktiva 2006/118/EC
Niveli themelor (referent)	Vlera mesatare e matur së paku gjatë dy viteve referente në bazë të programeve monitoruese të implementuara nën planet për menaxhimin e pellgjeve lumore (në Shqipëri -Baseneve ujore)	**Baseline level**	The average value measured at least during the two reference years on the basis of monitoring programmes implemented under the river basin management plans	Vlerësim i ndikimit	Direktiva 2006/118/EC
Nxjerrja	Procesi i m arrjes së ujit nga ujërat sipërfaqëso re apo ujërat nëntokësore, qoftë përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, me qëllim të shfrytëzimit të tij	**Abstraction**	The process of taking water from surface waters or groundwaters, either temporarily or permanently in order to be used	Furnizim me ujë	Directiva 2000/60/EC
Nxjerrje (marrje) e ujit	Uji i cili merret nga burimet e ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore me qëllim përdorimi	**Withdrawal (water)**	Water removed from a ground- or surface-water source for use	Furnizim me ujë	

4.18 Oo

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Objekt	Një apo më shumë objekte në të njëjtën vendndodhje të cilat operohen nga i njëjti person fizik apo juridik	**Facility**	One or more installations on the same site that are operated by the same natural or legal person	Vlerësim mjedisor	Rregullorja (EC) Nr 166/2006
Objekt i mbeturinave (në Shqipëri - mbetjeve)	Çfarëdo hapësire e caktuar për akumulimin apo depozitimin e mbeturinave (mbetjeve) nga industria ekstraktive, qoftë në gjendje të ngurtë apo të lëngët, apo qoftë në tretësirë apo suspension	**Waste facility**	Any area designated for the accumulation or deposit of extractive waste, whether in a solid or liquid state or in solution or suspension	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC
Objektiva mjedisore	Një qëllim i përgjithshëm mjedisor që rrjedh nga politikat mjedisore, të cilat një organizatë ia vë vetes për qëllim që t'i përmbushë, dhe të cilat përcaktohen në aspektin sasior kurdo që një gjë e tillë është e mundshme praktikisht	**Environmental objectives**	An overall environmental goal, arising from the environmental policy, that an organisation sets itself to achieve, and which is quantified where practicable	Objektiva mjedisore	Direktiva 2000/60/EC
Ofruesi i shërbimeve të ujit	Çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit e ujit me shumicë, veprimtaria e të cilëve rregullohet nga autoriteti rregullator për shërbimet e ujit. Të gjitha këto shërbime i ofrohen shfrytëzuesve shtëpiak, komercial, industrial dhe publik	**Public water supply**	Water withdrawn by public governments and agencies, such as a county water department, and by private companies that is then delivered to users. Public suppliers provide water for domestic, commercial, thermoelectric power, industrial, and public water users	Furnizim me ujë	
Oksidim	Një reaksion kimik ku bëhet kalimi i elektroneve prej një joni në tjetrin dhe rritet valenca pozitive	**Oxidation**	A chemical reaction in which ions are transferring electrons, to increase positive valence	Cilësi e ujërave	
Oksiduese (H2)	Substancat dhe preparatet të cilat shfaqin reaksione jashtëzakonisht ekzotermike në kontakt me substancat e tjera, posaçërisht me substanca të ndezshme	**Oxidazing**	Substances and preparations which exhibit highly exothermic reactions when in contact with other substances, particularly flammable substances	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Oksigjen i tretur	Flluska mikroskopike të oksigjenit të gaztë (O_2) të cilat janë të përziera me ujë dhe në dispozicion për t'u thithur nga organizmat ujor	**Dissolved oxygen**	Microscopic bubbles of gaseous oxygen (O2) that are mixed in water and available to aquatic organisms for respiration	Cilësi e ujërave	
Oligotrofike	Akumulimet (në Shqipëri - rezervuarët) dhe liqenet e kthjellta gjerë në thelllësi të tyre, të cilat përmbajnë sasi të vogla të lëndëve ushqyese, sasi të pakta të lëndëve organike dhe që posedojnë nivel të lartë të oksigjenit të tretur	**Oligotrophic**	Reservoirs and lakes deep clear, with few nutrients, little organic matter and a high dissolved-oxygen level	Cilësi e ujërave	
Operator	Nënkupton çdo person fizik apo juridik i cili operon ose kontrollon një impiant (në Shqipëri - ndërmarrje), një instalim (në Shqipëri - njësi), objekt apo një aktivitet apo, të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare ose fuqi vendim-marrëse, me legjislacionin vendor në fuqi, për operimin teknik të impiantit (ndërmarrjes) apo instalimit (njësisë), objektit apo aktivitetit të tillë	**Operator**	Any natural or legal, private or public person or corporate body who operates, hold or controls an establishment, installation, facility or an activity or, where this is provided for in national legislation, to whom decisive economic power over the technical functioning of such establishment, installation, facility or activity has been delegated	Aspekte institucionale dhe ligjore	Direktiva 2004/35/CE , Direktiva 2006/21/EC, Direktiva 2010/75/EU, Direktiva 2012/18/EU, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Operimi dhe mirëmbajtja	O&M përfshinë tërë spektrin e gjerë të shërbimeve të kërkuara për të siguruar që një strukturë (objekt) i ndërtuar do t'i kryej funksionet për të cilat është projektuar dhe ndërtuar. Operimi dhe mirëmbajtja përfshijnë aktivitetet dhe proceset e kërkuara për të mbajtur tërë strukturën/objektin e ndërtuar bashkë me infrastrukturën e tyre mbështetëse (siç është sistemi elektrik, i ujësjellësit dhe kanalizimit, i lëndëve djegëse, i telekomunikimit, etj,) vendparkingjet, rrugët, strukturat drenazhuese si dhe sipërfaqet rrethuese të tyre, në kushte të tilla që këto të funksionojnë gjatë gjithë cilkit të jetës së tyre ashtu siç janë planifikuar.	**Operation and maintenance**	All that broad spectrum of services required to assure the built environment will perform the functions for which a facility was designed and constructed. It includes the supporting infrastructure, such as the utility systems[27], parking lots, roads, drainage structures and grounds in a condition to be used to meet their intended function during their life cycle. O&M is a crucial element of sustainability, covering not only technical issues, but also managerial, social, financial and institutional issues	Masat	
Orët e operimit	- është koha, e shprehur në orë, gjatë së cilës një objekt (impiant, fabrikë), në tërësi apo pjesërisht, operon dhe shkarkon emisione në ajër, me përjashtim të periudhës së ndezjes dhe ndaljes së tij	**Operating hours**	The time, expressed in hours, during which a facility, in whole or in part, is operating and discharging emissions, excluding start-up and shut-down periods	Industri	Direktiva 2010/75/EU
Organizëm aerob	Një organizëm i cili mund të mbijetojë dhe të rritet në një mjedis të oksigjenuar. Eksitojnë disa kategori të organizmave aerob si p.sh. aerobet e detyruara dhe aerobet fakultative	**Aerobic organism**	An organism that can survive and grow in an oxygenated environment. There are several categories of aerobics such as Obligate aerobes and Facultative anaerobes	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Organizëm anaerob	Çdo organizëm i cili për rritjen e vetë nuk kërkon oksigjen, por që në prani të tij reagon negativisht apo edhe vdes	**Anaerobic organism**	Any organism that does not require oxygen for growth. It may react negatively or even dies if oxygen is present	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Organizëm autotrof	Një organizëm i cili prodhon komponime (bashkëdyzime) të përbëra organike dhe që është i aftë të sintetizojë ushqimin e vetë nga substancat inorganike duke shfrytëzuar dritën, ujin, dioksidin e karbonit apo kemikatet e tjera	**Autotroph organism**	An organism that produces complex organic compounds. It is capable of synthesizing its own food from inorganic substances using light, water, carbon dioxide, or other chemicals	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Osmozë	Lëvizja (depërtimi) i molekulave të ujit nëpër një membranë të hollë. Procesi i osmozës është njëra prej metodave që përdoren për shkripëzimin e ujit të njelmët	**Osmosis**	The movement of water molecules through a thin membrane. The osmosis process is one method of desalinating saline water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Osmozë reverse (e kthyeshme)	Një metodë e trajtimit të ujërave ku uji nën presion të caktuar e përshkon një membranë semipermeabile (gjysmë të përshkueshme) e cila i filtron papastërtitë	**Reverse osmosis**	A water treatment method whereby water is forced through a semi-permeable membrane which filters out impurities	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ozon	Një agjent oksidues i paqëndrueshëm, i cili përbëhet prej tri atomeve të oksigjenit dhe i cili mund të gjendet në shtresën e ozonit në atmosferë. Prodhohet me nënshtrimin e oksigjenit ndaj rrymës me voltazh të lartë apo përmes UV-llambave të projektuara në mënyë specifike për përfitimin e ozonit	**Ozone**	An unstable oxidizing agent, that consists of three oxygen atoms and can be found in the ozone layer in the atmosphere. It is produced by electrical discharge through oxygen or by specifically designed UV-lamps	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ozonizim, ozonim	Procesi i prodhimit të ozonit duke e ekspozuar oksigjenin në temperatura të larta. Kjo teknikë përdoret si një trajtim i avancuar i ujërave të ndotura ku bëhet inaktivizimi i agjensëve viral dhe bakterial pa prodhim të nënprodukteve të dëmshme, mirëpo ka kosto shumë të lartë meqë për të nevojitet një sasi e madhe e energjisë elektrike	**Ozonisation**	The process of producing ozone by exposing oxygen to high temperatures. This technique is used as advanced treatment of waste water after performing virulence and bacteria offset without producing harmful byproducts, having a very high cost because it requires a high amount of electricity	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[27] **Utility Systems** - service several buildings an/or other structures of an installation, including HVAC, sewage, fuel, water, electrical systems, telecommunication systems, satellite dishes, switching devices, and cabling/wiring for these systems

4.19 Pp

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Pagesat (tarifat) e ujit	Vënia e tarifës për ujë (tarifimi) përfshinë një varg instrumentesh politike të ndryshme të cilat mundësisht duhet të pasqyrojnë kostot financiare të shërbimit që e ofron infrastrukturën ujore, pastaj kostot mjedisore që rrjedhin nga dëmet e shkaktuara në ekosisteme dhe në shërbimet e ekosistemeve, si dhe kostot e resurseve (burimeve) të shfrytëzuara	**Water charges**	Water charges/pricing embraces a range of distinct policy instruments that ideally, should reflect financial costs of service delivering water infrastructure, environmental costs arising from harm induced to ecosystems and ecosystem services, and resource costs	Analizë ekonomike	
Pajisje për kontrollin e ujërave të rrebeshta	Një strukturë e ndërtuar në një sistem të veçantë të kolektorëve të ujërave të rrebeshta, për t'i shkarkuar ato në një rrjedhë ujore pritëse apo në një sistem shkarkimi	**Storm overflow device**	Structure that is built on a separate storm sewer system to spill to a receiving water course or a relief system	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Parametër	Një faktor numerik apo faktor tjetër i matshëm që është pjesë përbërëse e një grupi faktorësh, të cilët e përcaktojnë një sistem apo i përcaktojnë kushtet e operimit të këtij sistemi. Në kuptim të statusit të trupave ujor, parametrat monitorohen dhe rezultatet e monitorimit të tyre janë treguesit e elementeve të cilësisë së statusit ekologjik të trupave ujorë sipërfaqësorë	**Parameter**	A numerical or other measurable factor forming one of a set that defines a system or sets the conditions of its operation. In the context of the status of water bodies, parameters are monitored and the results are indicative of quality elements of the ecological status of surface water bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Parametrat e rutimit	Koeficientë të cilët bashkë me ekuacionet matematikore të rutimit, përdoren për të vlerësuar dobësimin (zvogëlimin e shpejtësisë) dhe prapambetjen (vonesën kohore) lidhur me lëvizjen e prurjes nëpër gjatësinë e një kanali ujërrjedhës	**Routing parameters**	Coefficients that, along with mathematical routing equations, can be used to estimate the attenuation and lag (time delay) associated with the movement of flow through a length of stream channel	Përmbytje	
Parandalimi i ndotjes	Parandalimi i ndotjes redukton sasinë e ndotjes së gjeneruar nga industritë, bujqësia apo konsumatorët	**Pollution prevention**	Pollution prevention reduces the amount of pollution generated by industries, agriculture, or consumers	Ndotje	
Parimi i parandalimit	Një parim që zbatohet në kontrollin e ndotjes, i cili parasheh ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të matura për të shmangur apo zvogëluar rrezikun mjedisor, si dhe që këto të merren përpara se të ndodh ndonjë problem serioz mjedisor	**Precautionary principle**	A principle in pollution control that prudent action should be taken to avoid or reduce environmental risk and taken before any serious environmental problem is encountered.	Masat	
Pasqyrë uji	Sipërfaqja ndërmjet zonës së saturuar (të ngopur) dhe të pasaturuar (të pangopur). Pasqyra e ujit paraqet kufirin e sipërm të një akuiferi të pakonturuar (të pakufizuar). Hartat e pasqyrave të ujit tregojnë drejtimin e rrjedhjes së ujërave nëntokësore	**Water table**	The surface between the saturated and unsaturated zones. It is the top of an unconfined aquifer. Watertable maps indicate groundwater flow direction	Trupa ujorë	
Pastrim	Largimi i substancave të padëshiruara nga ujërat apo ujërat e ndotura, përfshirë dezinfektimin e ujërave përmes asgjësimit të ndotësve mikrobik si p.sh. të baktereve koliforme	**Purification**	The removal of undesirable substances from water or waste water. It includes the disinfection of water by killing of microbial contaminants, such as coliform bacteria	Cilësi e ujërave	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Pastrim, Sedimentim	Proces në të cilin pastruesit (dekantuesit) - rezervuarët apo pellgjet (basenet) të cilat mbajnë ujë apo ujëra të ndotura për një periudhë të mjaftueshme sa për të mundësuar fundërrimin në fundin e tyre të flok-ut (grumbull papastërtish dhe bakteresh të formuara në fund të procesit të flokulimit) dhe të materieve tjera të suspenduara, i nënshtrohen procesit të pastrimit i cili e pastron ujin duke i larguar të gjitha llojet e grimcave, sedimenteve, vajrave, materieve organike natyrore dhe ngjyrave	**Clarification; sedimentation**	A process in which the clarifiers - tanks or basins which hold water or waste water for a period sufficient to allow the floc and other suspended materials to settle to the bottom- undergo the clarification process which makes the water clear by removing all kinds of particles, sediments, oil, natural organic matter and color	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Pastrimi fiziko-kimik	Proces i cili përdoret për të përqendruar mbetjet e shëllirës së gjeneruar pas një procesi trajtimi, si dhe për të larguar lëndët organike të ngurta dhe amoniakun nga tretësirat ujore. Trajtimi fizik konsiston në osmozën reverse (të kundërt), dializën, elektrodializën, avullimin, karbonin, adsorbimin (ndajthithjen), shpërthithjen e amoniakut nga ujërat e ndotura, filtrimin, sedimentimin dhe flokulimin (flokëformimin). Ndërkaq, trajtimi kimik konsiston në shkëmbimin e joneve, neutralizimin, oksidimin, reduktimin, precipitimin dhe kalcinimin (djegien, shkrumbëzimin)	**Physico-chemical purification**	Process used to concentrate waste brine and to remove solid organics and ammonia from aqueous solutions. Physical treatment consists of reverse osmosis, dialysis, electrodialysis, evaporation, carbon, adsorption, ammonia stripping, filtration, sedimentation, and flocculation. Chemical treatment consists of ion exchange, neutralization, oxidation, reduction, precipitation, and calcination	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Pasurim me lëndë ushqyese	*R*itja e përqendrimeve të lëndëve ushqyese në ujë, veçanërisht i komponimeve të azotit dhe/apo fosforit (*shihni përkufizimin për 'eutrophication'- 'eutrofikim'*)	**Nutrient enrichment**	The increase of nutrients concentrations in water, especially compounds of nitrogen and/or phosphorus (see "eutrophication")	Probleme mjedisore	
Patogjen	Agjent që shkakton sëmundje tek organizmat e gjallë. Në përgjithësi, përfshinë çdo virus, bakter, apo kërpudhë që shkakton sëmundje	**Pathogen**	A disease-producing agent; usually applied to a living organism. Generally, any viruses, bacteria, or fungi that cause disease	Shëndet publik	
Pellg (basen)	Paraqet sipërfaqen ujëmbledhëse të një lumi të caktuar si dhe të degëve të tija, apo të një liqeni apo deti	**Basin**	It is the catchment area of a particular river and its tributaries or of a lake or sea	Pellg lumor (Basen ujor)	Direktiva e BE-së
Pellg (pond, rezervuar)	Në kontekst të menaxhimit të mbeturinave, paraqet një objekt natyror apo të inxhinieruar për deponimin (në Shqipëri - asgjësimin) e mbeturinave (mbetjeve) të granuluara imtë, zakonisht të 'mbeturinave të mineraleve, bashkë me sasi të ndryshme të ujit të lirë (të palidhur), që rezulton prej trajtimit të burimeve minerare dhe prej pastrimit dhe riciklimit të 'ujit të prodhimit'	**Pond (management of waste)**	Natural or engineered facility for disposing of fine-grained waste, normally tailings, along with varying amounts of free water, resulting from the treatment of mineral resources and from the clearing and recycling of process water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 2006/21/EC
Pellg lumi (në Shqipëri - "Basen ujor")	Sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri të rrëkeve ("përrenjve"), lumenjve, dhe eventualisht liqeneve, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në det përmes një grykëderdhjeje të vetme lumi, estuarë (grykëderdhjeje të gjerë) apo delte	**River basin**	The area of land from which all surface run-off flows through a sequence of streams, rivers and, possibly, lakes into the sea at a single river mouth, estuary or delta	Pellg lumor (Basen Ujor)	Direktiva 2000/60/EC
Pellg oksidimi, pellg stabilizimi	Një trup ujor i ndërtuar nga dora e njeriut në të cilin mbeturinat (në Shqipëri - mbetjet) konsumohen nga bakteret. Ky term përfshinë lagunat e ajruara, pellgjet (pondet) aerobe ose pellgjet (pondet, rezervuarët) e maturimit	**Oxidation pond; stabilisation pond**	A man-made body of water in which waste is consumed by bacteria. The term includes aerated lagoons, aerobic ponds or a maturation ponds	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Pellgore (rezervuar) fakultativ	Pellgore (rezervuar) e ujërave të ndotura që posedon një formë ajrimi me qëllim të pasurimit me oksigjen. Po ashtu këto pellgore mund të përdorin alga apo bimë të tjera për pasurim me oksigjen	**Facultative pond**	Waste water ponds with some form of aeration for oxygen replenishment. Can also use algae and other plants for oxygen replenishment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Pellgore ujëmbajtëse	Një pellgore apo liqe që zakonisht është artificial, i cili përdoret për të grumbulluar dhe mbajtur rrjedhat e ujërave të rrebeshta të reshjeve, si dhe për të zvogëluar rrjedhjen e tyre në rrjedhën e poshtme të pellgores, e që në këtë mënyrë i minimizon përmbytjet	**Retention pond**	A pond or lake, which is typically artificial, that is used to collect and store stormwater runoff and reduce stormflows downstream of the pond and alleviate flooding	Përmbytje	
Performanca e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura	Raportimi i integruar mbi performancën e Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) paraqet një instrument të rëndësishëm për ndërmarrjet (kompanitë) e ujit në gjetjen e aktiviteteve me performancë të dobët duke i mundësuar kështu këtyre ndërmarrjeve që të ndërmarrin masa për kontrollin e tyre	**Performance of the wastewater treatment plants**	The integrated reporting of the WWTPs performance may provide to water utilities a tool which supports the management in finding activities with poor performance, and allowing them to take measures of control	Menaxhim i ujërave	
Performancë mjedisore	Rezultatet e matshme të menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate	**Environmental performance**	The measurable results of an organisation's management of its environmental aspects	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Periudha e kthimit	Një vlerësim i mundësisë së ndodhjes se një ngjarjeje, të tilla si një tërmet, përmbytje, rrëshqitje të tokës ose një rrjedhje lumore. Gjithashtu njihet edhe si intervali përsëritës i një ngjarje	**Return period**	An estimate of the likelihood of an event, such as an earthquake, flood, landslide, or a river discharge flow to occur. It is also known as a recurrence interval	Përmbytje	
Permeabiliteti (përshkueshmëria)	Aftësia e një lënde për të lejuar depërtimin e një lëngu nëpër të, siç është p.sh. depërtimi i ujit nëpër shkëmbinj. Lëndët permeabile (të përshkueshme), si zhavorri apo rëra, lejojnë kalimin e shpejtë të ujit nëpër to, ndërsa lëndët jopermeabile (të papërshkueshme), siç është p.sh. argjila, nuk e lejojnë kalimin e lirshëm të ujit nëpër to	**Permeability**	The ability of a material to allow the passage of a liquid, such as water through rocks. Permeable materials, such as gravel and sand, allow water to move quickly through them, whereas unpermeable material, such as clay, don't allow water to flow freely	Bujqësi dhe ujitje	
Përçueshmëria	Sasia e energjisë elektrike të cilën uji mund ta përçojë. Shprehet me madhësi kimike (në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive, njësia e saj matëse është mikrosiemens). Sa më shumë kripëra që gjenden të tretura në ujë aq më e lartë është vlera e përçueshmërisë elektrike	**Conductivity**	The amount of electricity the water can conduct. It is expressed in a chemical magnitude (in the International System of Units its unit is microsiemens). The more salts are dissolved in the water, the higher is the value of the electric conductivity	Hidraulikë	
Përçueshmëria hidraulike	Një koeficient i proporcionalitetit që shpreh shpejtësinë me të cilën uji mund të lëvizë nëpër një mjedis permeabil (të depërtueshëm). Mund të përcaktohet duke e pjesëtuar përshkueshmërinë (depërtueshmërinë) e akuiferit me trashësinë e akuiferit	**Hydraulic conductivity**	A coefficient of proportionality describing the rate at which water can move through a permeable medium. It can be determined by dividing the transmissivity of the aquifer by the aquifer thickness	Hidraulikë	
Përdorim i lymit (llumit)	Shpërndarja e lymit në tokë apo çfarëdo aplikimi tjetër i tij mbi tokë apo në të	**Sludge use**	The spreading of sludge on the soil or any other application of sludge on and in the soil	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Përdorimi (shfrytëzimi) i ujit	Shfrytëzimi i ujit në bujqësi, industri, prodhim të energjisë dhe amvisëri, përfshirë - përdorimin e ujit në ujërrjedha si p.sh. për peshkim, rekreacion, transport dhe deponim (në Shqipëri- asgjësim) të mbeturinave (mbetjeve)	**Water use**	Water use refers to use of water by agriculture, industry, energy production and households, including in—stream uses such as fishing, recreation, transportation and waste disposal	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Përdorimi i ujit për rekreacion	Përdorimi i ujit për rekreacion në ujërat e ëmbla dhe ujërat bregdetar, si dhe në pishina dhe llixha mund t'i sjellë dobi të shumta shëndetit dhe mirëqenies së njeriut	**Recreational use of water**	Recreational use of water in fresh and coastal waters as well as pools and spas can deliver important benefits to health and well-being	Menaxhim i ujërave	
Përdorimi konsumues i ujit	Ajo pjesë e ujit të marrë e cila avullon, transpiron (djersinë) nga bimët, inkorporohet në produkte dhe drithëra, konsumohet nga njerëzit apo bagëtia, apo që largohet në tjera mënyra nga mjedisi ujor i drejtpërdrejtë, ashtu që më nuk kthehet në sistemin e resurseve ujore (në Shqipëri - burimeve ujore)	**Consumptive water use**	That part of water withdrawn that is evaporated, transpired by plants, incorporated into products or crops, consumed by humans or livestock, or otherwise removed from the immediate water environment, thus without return to a water resources system	Menaxhim i ujërave	
Përjashtimet	Përjashtimet nga objektivat e përgjithshme të një Plani Menaxhues të Pellgjeve Lumore (në Shqipëri - Baseneve Ujore) të cilat lejojnë objektiva më pak të rrepta, zgjatje të afateve përfundimtare apo zbatimin e projekteve të reja. E përbashkëta e të gjitha këtyre përjashtimeve janë kushtet e rrepta të cilat duhet të përmbushen si dhe përfshirja e një justifikimi në planin menaxhues të pellgut lumor (basenit ujor)	**Exemptions**	Exemptions to the general objectives of a River Basin Management Plan that allow for less stringent objectives, extension of deadline or the implementation of new projects. Common to all these exemptions are strict conditions that must be met and a justification must be included in the river basin management plan	Objektiva mjedisore	
Përmbytje	Është mbulimi i përkohshëm me ujë i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Këtu përfshihen përmbytjet nga lumenjtë, rrëket (përrenjtë) malore, nga rrjedhat ujore mesdhetare kohëshkurtëra, dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura	**Flood**	The temporary covering by water of land not normally covered by water. This shall include floods from rivers, mountain torrents, ephemeral water courses, and floods from the sea in coastal areas, and may exclude floods from sewerage systems	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Përmirësim i mjedisit	Revitalizimi apo krijimi i ligatinave, parqeve ujore, etj. të cilat e përmirësojnë mjedisin lokal	**Environmental enhancement**	The restoration or creation of wetlands, water parks etc that enhance the local environment	Masat	
Përpikëri	Vërtetësia dhe përpikëria e metodave dhe rezultateve të matjes, llogaritjes apo specifikimeve, të cilën e tregon numri i shifrave të fituara. Saktësia paraqet një masë matëse të pasigurisë statistikore	**Precision**	Refinement in a measurement, calculation, or specification, especially as represented by the number of digits given. It is a measure of the statistical uncertainty	Cilësi e ujërave	
Përputhshmëri ligjore	Zbatimi i plotë i kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë kushtet e lejeve, të cilat ndërlidhen me mjedisin	**Legal compliance**	Full implementation of applicable legal requirements, including permit conditions, relating to the environment	Aspekte institucionale dhe ligjore	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Përqendrimi i ndotësve në ujë	Ndotësit të cilët janë qoftë të tretur apo të suspenduar (në formë të pezullive) në ujë, në shumicën e rasteve maten apo shprehen në formë të "përqendrimit", dhe atë zakonisht në miligram për litër (mg/l) apo mikrogram për litër (µg/l)	**Concentration of pollutants in water**	Pollutants which are either dissolved or suspended in water are often measured or expressed in terms of “concentration,” typically milligrams per liter (mg/l) or micrograms per liter (µg/l)	Ndotje	
Përshkueshmëri (depërtue-shmëri)	Shkalla e rrjedhjes së ujërave nëntokësore nëpër njësinë e prerjes së tërthortë të një akuiferi nën njësinë e gradientit hidraulik. Përshkueshmëria tregon për aftësinë e akuiferit për të shpërndarë ujërat nëntokësore nëpër gjithë trashësinë e saturimit të vetë	**Transmissivity**	The rate at which groundwater can flow through an aquifer section of unit width under a unit hydraulic gradient. It describes the ability of the aquifer to transmit groundwater throughout its entire saturated thickness	Hidraulikë	
Përvijimi i trupave ujor	Mundëson identifikimin fillestar të "trupave ujorë" në rajonet e pellgjeve lumore, me përshkrimin e saktë të statusit të ujërave sipërfaqësore përmes rezultateve nga analiza e presioneve dhe ndikimeve në këta trupa ujorë	**Delineation of water bodies**	Delineation of water bodies enables a first identification of “water bodies” in the river basin (districts), with the status of surface waters accurately described, making use of the results of the pressure and impact analysis	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Përzgjedhja	Procedurë që përdoret për të përcaktuar nëse një projekt, plan apo program i propozuar ka gjasa të ketë ndikime të konsiderueshme në mjedis. Kjo procedurë normalisht duhet të zhvillohet në një fazë të hershme të hartimit të një projekti, plani apo programi të tillë	**Screening**	Procedure used to determine whether a proposed project, plan or programme is likely to have significant effects on the environment; it should normally take place at an early stage in the design of the project, plan or programme	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2001/42/EC
Përzierje	Nënkupton një kombinim lëndësh të ndryshme, ku elementet përbërëse të saj janë të ndryshme nga njëra tjetra	**Mixture**[28]	A combination of different things in which the component elements are individually distinct	Cilësi e ujërave	Direktiva 2012/18/EU
pH	Njësi matëse e aciditetit apo alkalinitetit relativ të ujërave. Uji me ph 7.0 është neutral; vlerat më të ulta të pH-së tregojnë për aciditet në rritje, ndërsa vlerat më të larta të pH-së (mbi 7.0) tregojnë për një alkalinitet të shtuar	**pH**	Measure of the relative acidity or alkalinity of water. Water with a pH of 7 is neutral; lower pH levels indicate increasing acidity, while pH levels higher than 7 indicate increasingly basic solutions	Cilësi e ujërave	
Phragmites australis, P. Communis	Paraqet kallamin e rëndomtë, e cila është një bimë shumëvjeçare me kërcell të lartë që gjendet në ligatina, në rajonet me klimë të butë e tropikale të botës. Përdoret për trajtimin e ujërave përmes teknologjisë së trajtimit me shtretër me kallam	**Phragmites australis, P. communis**	The common reed, large perennial grass found in wetlands throughout temperate and tropical regions of the world. It is used for water treatment in bedding technology	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Pikë monitorimi	Një lokacion brenda një trupi ujor ku maten parametrat e ndryshëm mjedisor, përfshirë parametrat biologjikë, kimikë, hidromorfologjikë, fiziko-kimik, si dhe matjen në ujërat sipërfaqësore të substancave prioritare dhe substancave prioritare të rrezikshme	**Monitoring point**	A location within a water body where different environmental parameters are measured, including biological, chemical, hydromorphologcal, physico-chemical, and priority and priority-hazardous substances for surface waters	Monitorim	Direktiva 2000/60/EC
Piku i Përmbytjes	Vlera më e lartë e akumulimit apo e shkarkimit e arritur nga një përmbytje	**Flood peak**	The highest value of the storage or discharge attained by a flood.	Përmbytje	
Pjerrësia e shtratit	Këndi të cilin sipërfaqja e shtratit të një lumi apo kanali e formon me rrafshin horizontal, ashtu që disa pika në të janë më të larta se të tjerat	**Bed slope**	The angle that the bed surface of a river or channel has to the horizontal so that some points on it are higher than others	Hidraulikë	
Pjesë për milion	Shprehet me ppm dhe është njësi matëse e përqendrimit, zakonisht në ujë apo tokë. Një ppm është ekuivalent me 1 mg të 'substancës (apo diçkaje) që matet' për 1 litër ujë (mg/l) apo një ppm është ekuivalent me 1mg të 'substancës (apo diçkaje) që matet' për kilogram të tokës (dheut) (mg/kg)	**Parts per million (ppm)**	It describes the concentration of something, usually in water or soil. One ppm is equivalent to 1 milligram of something per liter of water (mg/l) or 1 milligram of something per kilogram soil (mg/kg)	Cilësi e ujërave	

[28] **Përzierje** - përzierje ose tretësirë e përbërë nga dy ose më shumë substanca kimike. Fjala "Preparat" e përdorur deri me tani ka kuptimin e njejtë dhe duhet të zavendësohet me fjalen "përzierje" sipas Rregullores EC 1272/2008 (**Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate, Neni 3, paragrafi 1.3, Legjislacioni i Kosovës**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Pjesëmarrja e publikut	Proces i cili i ofron publikut një mundësi të dobishme për të marrë pjesë qysh në fillim në përgatitjen dhe modifikimin apo shqyrtimin e planeve apo programeve përkatëse. Ku, publiku, qoftë përmes njoftimeve publike apo përmes formave të tjera siç janë p.sh. mediet elektronike (kudo që këto janë në dispozicion), informohet për çdo propozim të planeve apo programeve të tilla, apo për modifikimin ose shqyrtimin e tyre. Ky informacion vihet në dispozicion për publikun, përfshirë në mes tjerash informatat mbi të drejtën për të marrë pjesë në vendim-marrje, si dhe informatat për autoritetin kompetent të cilit mund t'i dorëzohen komentet apo pyetjet. Pra, publiku ka të drejtë t'i shpreh komentet dhe opinionet e veta atëherë kur shpalosen të gjitha opsionet, përpara se të merren vendimet mbi planet dhe programet përkatëse	**Public participation**	The process that let the public to have an early and effective opportunity to participate in the preparation and modification or review of the plans or programmes. To that end, the public is informed, whether by public notices or other appropriate means such as electronic media where available, about any proposals for such plans or programmes or for their modification or review and that relevant information about such proposals is made available to the public including inter alia information about the right to participate in decision-making and about the competent authority to which comments or questions may be submitted; and the public is entitled to express comments and opinions when all options are open before decisions on the plans and programmes are made	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2003/35/EC
Pjezometër	Një instrument i cili përdoret për të matur lartësinë e shtypjes hidrostatike në një tub uji, rezervuarë, në dhé, etj.	**Piezometer**	An instrument used to measure pressure head in a conduit, tank, soil, etc.	Monitorim	
Plakja e liqeneve	Proces natyral me anë të të cilit një liqe gjatë kohës gjeolgjike mbushet me materie nga erozioni të mbartura nga rrjedhat e degëve që derdhen në të, si dhe me materie të depozituara drejtpërdrejt nga atmosfera, dhe me materie të krijuara brenda vetë liqenit	**Aging of lakes**	Natural process by which a lake fills in over geologic time with erosional materials carried in by tributary streams, with materials deposited directly from the atmosphere, and with materials produced within the lake itself	Probleme mjedisore	
Plakja e liqeneve	Proces i plakjes së liqeneve, i cili i përshkruan liqenet apo trupat e tjerë ujor në fazat e avancuara të eutrofikimit të tyre	**Senescence**	The aging process of lakes. It describes lakes or other bodies of water in advanced stages of eutrophication	Probleme mjedisore	
Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor (në Shqipëri - "basenit ujor")	Një plan i përgatitur për Autoritetin Kompetent për një Rajon të Pellgut Lumor (Rajon të Basenit Ujor), i cili i përcakton objektivat mjedisore për të gjithë trupat ujorë brenda Rajonit të Pellgut Lumor si dhe se si do të arrihen ato objektiva. Këto plane bazohen në një analizë të detajuar të presioneve të ushtruara në trupat ujorë si dhe në vlerësimin e ndikimeve të tyre. Planet e Menaxhimit të Pellgut Lumor rishikohen dhe përditësohen çdo gjashtë vite	**River Basin Management Plan**	A Plan prepared for the Competent Authority for a River Basin District, that sets out the environmental objectives for all the water bodies within the River Basin District and how they will be achieved. The plans are based upon a detailed analysis of the pressures on the water bodies and an assessment of their impacts, and it is reviewed and updated every six years	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC
Plani i Menaxhimit të Rreziqeve nga Përmbytjet (PMRP)	Plan i hartuar për Rajonin e Pellgut Lumor (në Shqipëri- basenit ujor) i cili i përcakton objektivat e duhura për menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet për zonat për të cilat është konkluduar se ekzistojnë rreziqe me potencial të konsiderueshëm për përmbytje, apo që konsiderohet se ka gjasa të ndodhin. PMRP-të fokusohen në reduktimin e pasojave potenciale negative të përmbytjeve për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgimin kulturore dhe veprimtarinë ekonomik, dhe, nëse konsiderohet e përshtatshme, ato fokusohen edhe në iniciativat jostrukturore dhe/apo reduktimin e gjasës për përmbytje	**Flood risk management plan**	Plan, developed for a River Basin District, that establishes appropriate objectives for the management of flood risks for the areas for which have been conclude that potential significant flood risks exist or might be considered likely to occur. FRMPs focus on the reduction of potential adverse consequences of flooding for human health, the environment, cultural heritage and economic activity, and, if considered appropriate, on nonstructural initiatives and/or on the reduction of the likelihood of flooding	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Pleh	Një kimikat apo substancë natyrore e cila i shtohet tokës për të shtuar pjellorinë e saj si dhe për të shtuar rritjen e bimësisë; mund të përfshijë plehun e bagëtisë, mbetjet nga fermat e peshqve dhe lymi (llumi) i ujërave të ndotura shtëpiake	**Fertilizer**	A chemical or natural substance added to soil or land to increase its fertility and to enhance growth of vegetation; it may include livestock manure, the residues from fish farms and sewage sludge	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 91/676/EEC
Pleh i bagëtisë	Produktet mbeturinë të ekskretuara (jashtëqitura) nga bagëtia, apo një përzierje e plehut të stallës me produktet mbeturinë të ekskretuara (jashtëqitura) nga bagëtia, qoftë edhe në formën e tyre të përpunuar	**Livestock manure**	Waste products excreted by livestock or a mixture of litter and waste products excreted by livestock, even in processed form	Ndotje	Direktiva 91/676/EEC
Pleh kimik	Çdo pleh i cili prodhohet përmes një procesi industrial	**Chemical fertilizer**	Any fertilizer which is manufactured by an industrial process	Bujqësi dhe ujitje	Direktiva 91/676/EEC
Pllakë shkumëheqëse	Një platformë gjysmë e zhytur në ujërat e ndotura rrjedhëse, e cila e pengon shkumën që t'i bashkohet prurjes së efluentit në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura. Platformat që ndodhen në dalje të dekantuesve (kulluesve) janë rreth 0.45m të larta dhe 75-100mm të zgjatura mbi sipërfaqe, si dhe e përshkojnë gjithë gjerësinë e kanalit	**Scumboard**	A platform partly immersed in flowing water to hold back foam, thus it prevents foam from joining the flow of effluent in a waste water treatment plant. Platforms at the exit of the settling tank or decanter are about 0.45m high, projected 75-100mm over the surface and saturate the entire width of the canal	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Polielektrolitë	Polimer (një molekulë e madhe apo makromolekulë e përbërë nga shumë nën-njësi të përsëritura), nën-njësitë e përsëritura të të cilit mbartin një grup elektrolitesh. Këto grupe disociojnë në tretësira ujore (në ujë) duke rezultuar kështu në polimerë të ngarkuar	**Polyelectrolytes**	Polymers (a large molecule, or macromolecule, composed of many repeated subunits) whose repeating units bear an electrolyte group. These groups dissociate in aqueous solutions (water), making the polymers charged	Cilësi e ujërave	
Politikë mjedisore	Qëllimet e përgjithshme dhe orientimi i një organizate që lidhen me performancën e saj mjedisore, ashtu siç deklarohen zyrtarisht nga menaxhmenti i saj i nivelit të lartë, përfshirë përputhshmërinë me të gjitha kërkesat ligjore në fuqi që lidhen me mjedisin, si edhe një zotim për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Politika mjedisore ofron një kornizë veprimi (në Shqipëri - kuadër veprimi) si dhe për përcaktimin e objektivave dhe caqeve (synimeve) mjedisore	**Environmental policy**	The overall intentions and direction of an organisation relating to its environmental performance as formally expressed by top management including compliance with all applicable legal requirements relating to the environment and also a commitment to continuous improvement of environmental performance. It provides a framework for action and for the setting of environmental objectives and targets	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Pompë	Një pajisje mekanike e cila përmes thithjes apo presionit i vë lëngjet në lëvizje apo i tërheq ato në lartësi, i kompreson (ngjesh) gazet, apo e fryn ajrin në objekte që fryhen me ajër siç janë p.sh. gomat	**Pump**	A mechanical device using suction or pressure to raise or move liquids, compress gases, or force air into inflatable objects such as tyres	Hidraulikë	
Pompë centrifugale, radiale	Pompë rotodinamike e cila përdor një helikë rrotulluese për të rritë presionin dhe shpejtësinë e rrjedhjes së një lëngu, ku lëngu i cili pompohet nxirret jashtë në mënyrë radiale, d.m.th nën kënd të drejtë me boshtin e pompës. Pompat centrifugale funksionojnë duke e konvertuar energjinë kinetike në energji potenciale që matet si presion statik i lëngut në dalje të pompës	**Centrifugal pump, radial flow pump**	A rotodynamic pump that uses a rotating impeller to increase the pressure and flow rate of a fluid, where the fluid being pumped is discharged radially, i.e. at right angles to the pump shaft. Centrifugal pumps work by converting kinetic energy into potential energy measurable as static fluid pressure at the outlet of the pump	Hidraulikë	
Pompë me prurje radiale	Pompë në të cilën uji lëviz në mënyre rrethore me anë të rrotullimeve rreth një boshti, si në një pompë centrifugale	**Radial flow pump**	A centrifugal pump in which the water moves circularly by means of rotations around an axis, as in a centrifugal spike	Hidraulikë	
Pompë ujëngritëse	Një pompë e thjeshtë që përbëhet prej një piston i cili lëvizë brenda një cilindri, ku që të dyja pjesët e përbajnë nga një valvul	**Lift pump**	A simple pump consisting of a piston moving in a cylinder, both parts incorporating a valve.	Furnizim me ujë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Pompë vakumi	Një pajisje e cila i largon molekulat e gazit nga një vëllim i mbyllur me qëllim të krijimit të një vakumi të pjesërishëm	**Vacuum pump**	A device that removes gas molecules from a sealed volume in order to leave behind a partial vacuum	Hidraulikë	
Pompim i ujit në drejtim të kundërt nëpër filtra (mediume filtruese)	Në kuptim të trajtimit të ujërave, përfshirë pastrimin e ujit dhe trajtimin e lymit (llumit), kundërrrymimi i referohet pompimit të ujit në drejtim të kundërt nëpër filtra (mediume filtruese), që nganjëherë përfshinë edhe përdorimin e kohëpaskohshëm të ajrit të kompresuar gjatë procesit	**Filter backwash**	In terms of water treatment, including water purification and sewage treatment, backwashing refers to pumping water backwards through the filters media, sometimes including intermittent use of compressed air during the process.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Pond (pellg, rezervuar) maturimi	Një pond aerob i stabilizimit të ujërave të ndotura, që rëndomë është shumë i cektë (0.9 - 1 m thellësi), duke mundësuar kështu depërtimin e dritës deri në fundin e tij, si dhe duke krijuar kushte aerobe gjatë gjithë thellësisë së vetë. Është projektuar kryesisht për trajtimin terciar të ujërave të ndotura, që zakonisht gjendet pas një pondi fakultativ primar ose sekondar	**Maturation pond**	An aerobic waste water stabilisation pond, which is usually very shallow (0.9 – 1 m depth), to allow light penetration to the bottom and aerobic conditions throughout the whole depth. Primarily designed for tertiary waste water treatment, generally following either a primary or a secondary facultative pond	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Popullsi maksimale	Numri maksimal I popullsisë rezidente dhe jo-rezidente në një sipërfaqe të caktuar, të cilës I ofrohen shërbimet e ujit (shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë)	**Peak population**	The maximum number of resident and non-resident population in a given area which is provided with water services.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Porozitet	Raporti i vëllimit të hapësirave të zbrazëta në një shkëmb apo sediment ndaj vëllimit të përgjithshëm të shkëmbit apo sedimentit, i cili shërben për matjen e kapacitetit ujëmbajtës të tyre. Sa i përket lëvizjes së ujit, nuk është me rëndësi thjesht vetëm shkalla e përgjithshme e porozitetit, mirëpo madhësia e zbrazëtive (poreve) si dhe deri në ç'masë ato janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, sepse poret në një formacion mund të jenë të hapura, të ndërlidhura, apo të mbyllura dhe të izoluara	**Porosity**	The ratio of the volume of void spaces in a rock or sediment to the total volume of the rock or sediment, so it measures the water-bearing capacity of the material. With respect to water movement, it is not just the total magnitude of porosity that is important, but the size of the voids and the extent to which they are interconnected, as the pores in a formation may be open, or interconnected, or closed and isolated	Hidraulikë	
Post-ajrim	Ajrimi i efluentëve përpara shkarkimit të tyre në mjedisin ujor pritës, ashtu që efluenti të përmbajë përqendrime të larta të oksigjenit të tretur. Kjo metodë mund të jetë e dobishme në mbajtjen e niveleve të larta të oksigjenit të tretur në ujërat pritës afër pikës së shkarkimit të efluentëve. Post-ajrimi mund të arrihet me derdhjen e efluentit poshtë një kaskade apo përmes ajrimit mekanik ose ajrimit difuziv me ajër	**Post aeration**	The aeration of effluents prior to discharge to the water course so that the effluent is high in dissolved oxygen. It can be achieved by flowing the effluent down a cascade or by mechanical aeration or diffused aeration	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Potencial ekologjik	Është statusi i një trupi ujor të modifikuar konsiderueshëm (në Shqipëri "tepër të modifikuar") apo i një trupi ujor artificial, i matur kundrejt cilësisë maksimale ekologjike që ai trup mund ta arrijë (e që është e nevojshme për përdorimin e tij), duke i marrë parasysh kufizimet e imponuara mbi të nga ato karakteristika të modifikuara konsiderueshëm (tepër) apo artificiale. Ekzistojnë pesë klasë të potencialit ekologjik për Trupat Ujor të Modifikuar Konsiderueshëm/Trupat Ujor Artificial (maksimal, i mirë, mesatar, i dobët (i varfër) dhe i keq)	**Ecological potential**	The status of a heavily modified or artificial water body measured against the maximum ecological quality it could achieve given the constraints imposed upon it by those heavily modified or artificial characteristics necessary for its use. There are five ecological potential classes for Heavily Modified Water Bodies/Artificial Water Bodies (maximum, good, moderate, poor and bad)	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Potencial evapotran-spirues	Largimi i ujit nga sipërfaqja drejt atmosferës përmes avullimit dhe transpirimit, nëse konsiderohet se nuk ka kufizime në sasinë e ujit të cilën e përmban toka	**Potential evapo-transpiration**	The removal of water from the surface into the atmosphere by evaporation and transpiration assuming no limitation ow water in the soil	Bujqësi dhe ujitje	
Potencial i mirë	Është statusi i arritur nga një trup ujor i modifikuar konsiderueshëm (në Shqipëri "tepër i modifikuar") apo nga një trup ujor artificial ku edhe potenciali i tij ekologjik (shihni 'potencialin e mirë ekologjik') edhe statusi i tij kimik (shihni 'statusi i mirë kimik i ujërave sipërfaqësorë') konsiderohen së paku si "të mirë"	**Good potential**	The status achieved by a heavily modified or an artificial body of water when both the ecological potential (see good ecological potential) and its chemical status (see 'Good surface water chemical status') are at least good	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Potencial i mirë ekologjik	Ujërat sipërfaqësore që identifikohen si Trupa Ujorë të Modifikuar Konsiderueshëm (në Shqipëri "Tepër të Modifikuar") dhe si Trupa Ujorë Artificial, duhet të arrijnë një 'potencial të mirë ekologjik' (potenciali i mirë na bënë të kuptojmë se ndryshimet në morfologji mund ta vështirësojë arritjen e një statusi të mirë ekologjik)	**Good ecological potential**	Those surface waters which are identified as Heavily Modified Water Bodies and Artificial Water Bodies must achieve 'good ecological potential' (good potential is a recognition that changes to morphology may make good ecological status very difficult to meet)	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Potometër	Një pajisje që përdoret për të matur ritmin e transpirimit (shkallën e thithjes së ujit nga një bimë gjethore prej rrënjëve e gjerë tek fidanët e saj). Arsyeja kryesore që e shtyn ngjitjen e ujit gjerë tek fidanët është transpirimi (avullimi) nga gjethet e bimës, ku përthithja dhe ngjitja e ujit nëpër bimë realizohet përmes rrymës së transpirimit (ngjitjes së ujit nëpër bimë prej rrënjëve nëpër enët e ksilemës e gjerë tek gjethet e saja)	**Potometer**	A device used for measuring the rate of water uptake of a leafy plant shoot. The main reason for water uptake by a cut shoot is transpiration (evaporation in plants) and is effected by the transpiration stream	Bujqësi dhe ujitje	
Praktika më e mirë e menaxhimit mjedisor	Forma më efektive e zbatimit të sistemit për menaxhimin mjedisor nga organizatat në një sektorë relevant, dhe që mund të rezultojë në performancën më të mirë mjedisore nën kushtet e caktuara ekonomike dhe teknike	**Best environmental management practice**	The most effective way to implement the environmental management system by organisations in a relevant sector and that can result in best environmental performance under given economic and technical conditions	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Precipitimi i fosfateve	Proces i cili përdoret për të larguar format inorganike të fosfateve me shtimin e një koaguluesi dhe me përzierjen e ujërave të ndotura me koagulues në një mikser (përzierëse) statik. Jonet shumëvalente të metaleve që më së shpeshti përdoren në këtë proces janë jonet e kalciumit, të aluminit dhe të hekurit. Ky proces është i shtrenjtë dhe shkakton një rritje të vëllimit të lymit (llumit) deri në 40%. Si alternativë e këtij procesi është largimi biologjik i fosfateve	**Phosphate precipitation**	Process used to remove the inorganic forms of phosphate by the addition of a coagulant and a mixing of waste water and coagulant. The multivalent metal ions most commonly used are calcium, aluminium and iron. It is expensive and causes an increase of sludge volume by up to 40%. An alternative is the biological phosphate removal	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Presion dinamik	Paraqet energjinë kinetike për njësi të vëllimit të një grimce fluidi	**Dynamic pressure**	The kinetic energy per unit volume of a fluid particle	Hidraulikë	
Presion i konsiderueshëm	Një presion, i cili si i vetëm, apo në kombinim me presionet e tjera, ka gjasa të shkaktojë një dështim në arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuar në planet e menaxhimit të pellgjeve lumore (në Shqipëri- të baseneve ujore)	**Significant pressure**	A pressure that, on its own, or in combination with other pressures, would be liable to cause a failure to achieve the environmental objectives set out in the river basin management plan	Vlerësim i presioneve	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Presionet (P)	Efekti i drejtpërdrejt i forcës lëvizëse. Presionet zakonisht paraqesin efektet negative në mjedis (shihni përkufizimin për 'Driver, Pressure, State, Impact and Response Frameowork for Environmental Analysis' - 'Korniza e Forcës Lëvizëse, Presioneve, Gjendjes, Ndikimeve dhe Përgjigjeve/Reagimeve (Korniza DPSIR) për analizën mjedisore'	**Pressure**	The direct effect of the driver (see "Driver, Pressure, State, Impact and Response"). Usually they are adverse effects on the environment	Vlerësim i presioneve	Diective 2000/60/EC
Pritë (digë)	Një mur artificial, argjinaturë, kreshtë (ujëndarje), apo stom, zakonisht nga dheu apo gurët, e ndërtuar rreth një sipërfaqe relativisht të rrafshët me lartësi të ultë mbidetare për ta mbrojtur atë nga përmbytjet; një sfrat (ledh). Prita mund të ngrihet edhe përgjatë bregut apo kufirit të një liqeni për të ndaluar derdhjen brenda tij të ujërave të padëshiruara	**Dyke**	An artificial wall, embankment, ridge, or mound, usually of earth or rock fill, built around a relatively flat, low-lying area to protect it from flooding; a levee. A dyke may be also be constructed on the shore or border of a lake to prevent inflow of undesirable water	Përmbytje	
Probabiliteti i një përmbytjeje	Përcaktimi statistikor se ndodhia e një përmbytjeje me magnitudë të caktuar do të barazohet apo do të tejkalohet brenda një periudhe të caktuar kohore	**Flood probability**	The statistical determination that the occurrence of a flood of a specified magnitude will be equaled or exceeded within a given period of time	Përmbytje	
Proces	Në inxhinieri procesi paraqet një grup detyrash të ndërlidhura nëpërmjet të cilave inputet shndërrohen në produkte (rezultate) përfundimtare	**Process**	Process (engineering) is a set of interrelated tasks that transforms inputs into outputs	Menaxhim i ujërave	
Proceset apo ndikimet antropogjene	Efektet, proceset, objektet apo lëndët antropogjene janë ato që rjedhin nga veprimtaritë njerëzore, për dallim prej atyre që ndodhin në mjediset natyrore pa ndikimet njerëzore	**Anthropogenic processes or impacts**	Anthropogenic effects, processes, objects, or materials are those that are derived from human activities, as opposed to those occurring in natural environments without human influences	Probleme mjedisore	
Procesi i fundërrimit, fundërrimi	Paraqet mbajtjen e ujërave të ndotura shtëpiake në një rezervuar për një periudhë kohore (koha e retencionit), ashtu që grimcat më të mëdha dhe më të rënda në përbërjen e tyre të fundërrojnë në fund të rezervuarit, para se ujërat e ndotura (që përmbajnë lëndë të tretura në to dhe grimca më të vogla) të dërgohen për trajtim të mëtejshëm, apo para se këto të shkarkohen drejtpërdrejt në mjedis	**Settlement process; settling**	Retain sewage or waste water in a tank for a period of time (retention time) while the larger and heavier particles settle to the bottom before the liquid with its solutes and some smaller particulates is sent for further treatment or directly to the environment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Procesi i përfitimit të lymit (llumit) aktiv	Proces biologjik i varur nga prania e oksigjenit që shërben për shndërrimin e materieve të tretshme organike në biomasë solide, që mund të largohet me gravitet apo filtrim	**Activated sludge process**	Oxygen dependent biological process that serves to convert soluble organic matter to solid biomass, that is removable by gravity or filtration	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Prodhim specifik	Paraqet vëllimin e ujit të cilin një akuiferi i pakufizuar (i pakonturuar) e shkarkon (lëshon) nga depozita e tij, për njësi të sipërfaqes së akuiferit, si dhe për njësi të rënies së tablos ujore	**Yield (specific)**	The volume of water released from storage by unconfined aquifer per unit surface area of aquifer per unit decline of the water table	Hidraulikë	
Prodhuesi i mbeturinës (në Shqipëri - krijuesi i mbetjeve)	Është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbeturina (mbetje) (prodhuesi/krijuesi fillestar i mbeturinave/mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së kësaj mbeturine (mbetjeje)	**Waste producer**	Anyone whose activities produce waste (original waste producer) or anyone who carries out pre-processing, mixing or other operations resulting in a change in the nature or composition of this waste	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Program masash	Një grup masash të përpiluara për të përmirësuar mjedisin në një rajon të pellgut lumor (në Shqipëri - basenit ujor) dhe për të përmbushur objektivat e Planit të Menaxhimit të Pellgut Lumor	**Programme of Measures**	A group of actions designed to improve the environment in a river basin district and meet the objectives of the River Basin Management Plan	Masat	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Program mjedisor	Një përshkrim i masave, përgjegjësive dhe i mjeteve të ndërmarra ose të parashikuara për t'i arritur objektivat dhe caqet (synimet) mjedisore, si dhe afatet kohore për arritjen e objektivave dhe caqeve (synimeve) mjedisore	**Environmental programme**	A description of the measures, responsibilities and means taken or envisaged to achieve environmental objectives and targets and the deadlines for achieving the environmental objectives and targets	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Program Veprimi	Grup masash të përcaktuara në pajtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar apo të BE-së, për arritjen e objektivave përkatëse	**Action Programme**	Set of measures established according to the provisions of the national or EU legislation, to reach the respective objectives	Masat	Directiva 91/676/EEC
Programi i monitorimit operacional të ujërave nëntokësore	Monitorimi i ndërmarr në periudhat ndërmjet programeve të monitorimit mbikëqyrës me qëllim të përcaktimit të statusit kimik të të gjithë trupave ujorë nëntokësorë apo të grupeve të trupave ujorë të cilët është konstatuar se janë në rrezik, si dhe monitorimi me qëllim të përcaktimit të pranisë afatgjate të trendeve në rritje të përqendrimeve të ndotësve si pasojë e aktivitetit antropogjenik	**Operational monitoring programme (groundwater)**	Monitoring undertaken in the periods between surveillance monitoring programmes in order to establish the chemical status of all groundwater bodies or groups of bodies determined as being at risk and establish the presence of any long term anthropogenically induced upward trend in the concentration of any pollutant	Monitorim	Direktiva 2000/60/EC
Programi i monitorimit operacional të ujërave sipërfaqësorë	Monitorimi i ndërmarr në periudhat ndërmjet programeve të monitorimit mbikëqyrës. Parametrat të cilët përdoren duhet të jenë parametra tregues të elementeve të cilësisë biologjike dhe hidromorfologjike të cilat janë më të ndjeshmet ndaj presioneve të cilave iu nënshtrohet trupi ujor, si dhe të jenë parametra tregues të të gjitha substancave prioritare e substancave të tjera të shkarkuara në sasi të konsiderueshme në trupin ujor	**Operational monitoring programme (surface water)**	Monitoring undertaken in the periods between surveillance monitoring programmes. The parameters used should be those indicative of the biological and hydro-morphological quality elements most sensitive to the pressures to which the body is subject, as well as all priority substances discharged and other substances discharged in significant quantities	Monitorim	Direktiva 2000/60/EC
Programi monitorues mbikëqyrës	Vendosja e monitorimit për karakterizimin dhe vlerësimin e ndikimit në mënyrë që të sigurohet informacioni për: (a) plotësimin dhe vërtetimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit, e cila procedurë aplikohet për trupat ujorë të përcaktuar në planin e menaxhimit të pellgut lumor (në Shqipëri - basenit ujor), (b) hartimin eficient dhe efektiv të programeve të ardhshme të monitorimit, (c) vlerësimin e ndryshimeve afatgjate në kushtet natyrore, dhe (d) vlerësimin e ndryshimeve afatgjate që rezultojnë nga një aktivitet antropogjenik i gjithëmbarshëm	**Surveillance monitoring programme**	Monitoring established for the characterization and impact assessment to provide information for: supplementing and validating the impact assessment procedure applied to the bodies of water designated in the river basin management plan; the efficient and effective design of future monitoring programmes, the assessment of long-term changes in natural conditions, and the assessment of long-term changes resulting from widespread anthropogenic activity	Monitorim	Direktiva 2000/60/EC
Prurje	Shkalla e shkarkimit të një resursi (në Shqipëri - burimi), shprehur në vëllim për një periudhe të caktuar kohore	**Flow**	The discharge rate of a resource, expressed in volume during a certain period of time	Hidraulikë	
Prurja maksimale ditore	Vëllimi maksimal i prurjes që parashihet të ndodh brenda periudhës një ditore, e shprehur si mesatare ditore	**Maximum daily flow**	The largest volume of flow anticipated to occur during a one-day period, expressed as a daily average	Hidraulikë	
Prurja maksimale për orë	Vëllimi maksimal i prurjes që parashihet të ndodh brenda periudhës njëorëshe, e shprehur si mesatare njëorëshe	**Maximum hourly flow**	The largest volume of flow anticipated to occur during a one-hour period, expressed as a daily or hourly average	Hidraulikë	
Prurje e sigurt	Sasia vjetore e ujit i cili mund të merret nga një burim furnizimi brenda një periudhe disavjeçare, pa e shterur atë burim përtej aftësisë së tij për t'u rimbushur në mënyrë natyrore gjatë "viteve me reshje të shumta"	**Safe yield**	The annual amount of water that can be taken from a source of supply over a period of years without depleting that source beyond its ability to be replenished naturally in “wet years"	Furnizim me ujë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Publiku	Nënkupton një apo më shumë persona fizikë apo juridikë dhe, në përputhje me legjislacionin apo praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat apo grupimet e tyre	**Public**	One or more natural or legal persons and, in accordance with national law or practice, their associations, organisations or groups	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2003/4/EC, Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2001/42/EC, Direktiva 2012/18/EU, Direktiva 2006/21/EC
Publiku i interesuar (në Shqipëri - publiku i ndikuar)	Është publiku i ndikuar apo që mund të ndikohet, apo që është i interesuar në proceset e vendimmarrjes mjedisore, për qëllimet e këtij përkufizimi, organizatat joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe që përmbushin cilatdo kërkesa që dalin nga ligjet vendore në fuqi duhet të konsiderohen të interesuara	**Public (concerned)**	The public affected or likely to be affected by, or having an interest in, the environmental decision-making procedures; for the purposes of this definition, non-governmental organisations promoting environmental protection and meeting any requirements under national law shall be deemed to have an interest	Informim, konsultim, dhe pjesëmarrje publike	Direktiva 2003/35/EC, Direktiva 85/337/EEC, Direktiva 2006/21/EC
Pudlingim	Nënkupton si materialin ashtu edhe vetë procesin me të cilin veshet nga brenda një trup ujor, siç është një kanal apo pellg (rezervuarë), të cilët veshen nga brenda me argjilë të shtypur (brumë argjilor) - e cila është një lëndë e papërshkueshëm nga uji (me përçueshmëri të ultë hidraulike) e përbërë nga argjila dhe uji të cilët janë përzier për t'u bërë kësisoj të shfrytëzueshëm	**Puddling**	It is both the material and the process of lining a water body such as a channel or pond with puddle clay (puddle, puddling) - a watertight (low hydraulic conductivity) material based on clay and water mixed to be workable	Bujqësi dhe ujitje	
Pus	Një gropë e thellë dhe e ngushtë e gërmuar në mënyrë artificiale me çfarëdo metode që ka për qëllim nxjerrjen e ujit nga akuiferët nëntokësorë	**Well**	An artificial excavation put down by any method for the purposes of withdrawing water from the underground aquifers	Furnizim me ujë	
Pus grumbullues	Një pus qendror me gypa kolektor horizontal të perforuar dhe të mbështjellë me sitë, të cilët janë të renditur në mënyrë radiale për të rritur sasinë e ujit që sillet në pus. Këto puse gjenden në apo afër lumenjve dhe trupave të tjerë ujor sipërfaqësorë	**Collector well**	A central well with horizontal pereforated collector pipes surrounded by a screen and arranged radially to increase yield. They are located at or close to rivers and other surface-water bodies	Furnizim me ujë	
Pus pompimi	Tek pusi pompues përdoren pompa të cilat e nxjerrin ujin nga pusi	**Pumping well**	A water well pump is a pump that is used in extracting water from a water well		
Pus vrojtues	Pus i cili përdoret për të monitoruar ndryshimet në nivelet e ujërave nëntokësore gjatë një periudhe të caktuar apo gjatë fazës së pompimit të ujit	**Observation well**	Well that is used to monitor changes in groundwater levels during a given period or during a water pumping phase	Monitorim	
Pusetë (vrimë hyrjeje)	Një hapje (hyrje, dritare) që mundëson qasjen në një rezervuar, bojler (kaldajë), etj., e cila është mjaft e madhe sa për të lejuar që një person të kalojë nëpër të	**Manhole**	An access opening into any tank, boiler, etc., large enough for a person to pass through	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.20 Qq

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Qasja ekosistemike	Menaxhimi i integruar gjithëpërfshirës i veprimtarisë njerëzore bazuar në njohuritë më të mira shkencore në dispozicion rreth ekosistemit dhe dinamikave të tij, me qëllim të identifikimit dhe marrjes së masave për ndikimet të cilat janë të rrezikshme për shëndetin e ekosistemeve, duke arritur në këtë mënyrë një shfrytëzim të qëndrueshëm të të mirave dhe shërbimeve të ekosistemit, si dhe ruajtjen e integritetit të ekosistemit	**Ecosystem approach**	The comprehensive integrated management of human activities based on the best available scientific knowledge about the ecosystem and its dynamics, in order to identify and take action on influences which are critical to the health of the ecosystems, thereby achieving sustainable use of ecosystem goods and services and maintenance of ecosystem integrity	Masat	
Qasje e kombinuar (në Shqipëri - "Trajtim i kombinuar")	Kontrolli i shkarkimeve dhe i emisioneve në ujërat sipërfaqësore me përcaktimin dhe/apo zbatimin e cilës do prej të mëposhtmeve: kontrollet e emisioneve bazuar në teknikat më të mira të mundshme (në Shqipëri - teknikat më të mira të disponueshme), apo të vlerave përkatëse kufizuese të emisionit (vlerave kufizuese të shkarkimeve), apo në rast të ndikimeve difuze (të shpërndara) kontrollet që përfshijnë praktikat më të mira mjedisore të përcaktuara në legjislacion	**Combined approach**	The control of discharges and emissions into surface waters through the establishment and/or implementation of any of the following: the emission controls based on best available techniques (BAT), or the relevant emission limit values, or in the case of diffuse impacts the controls including, as appropriate, best environmental practices set out in the legislation	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC

4.21 Rr

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Rajon i pellgut lumor (në Shqipëri - "Rajon i basenit ujor")	Sipërfaqja e tokës dhe e detit, e përbërë nga një apo më shumë pellgje lumenjsh fqinjë (basene ujore fqinje) përfshirë ujërat e tyre nëntokësore dhe ujërat bregdetare, i cili është identifikuar në legjislacionin përkatës si njësia kyçe për menaxhimin e pellgjeve lumore (baseneve ujore)	**River basin district**	The area of land and sea, made up of one or more neighbouring river basins together with their associated groundwaters and coastal waters, which is identified as the main unit for management of river basins	Pellg lumor (Basen Ujor)	Direktiva 2000/60/EC
Rajon ndërkombëtar i pellgut lumor (në Shqipëri - "Rajon i basenit ujor")	Sipërfaqja e tokës dhe e detit e cila shtrihet brenda territorit të më shumë se dy shteteve, e përbërë nga një apo më shumë pellgje lumenjsh fqinjë (basene ujore fqinje) përfshirë ujërat e tyre nëntokësore dhe ujërat bregdetare, i cili është identifikuar në legjislacionin përkatës si njësia kyçe për menaxhimin e pellgjeve lumore (baseneve ujore)	**River basin district (international)**	The area of land and sea lying within the territory of more than one State, made up of one or more neighbouring river basins together with their associated ground-waters and coastal waters, which is identified as the main unit for management of river basins	Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare	Direktiva 2000/60/EC
Raporti bazë	Informacioni mbi gjendjen e kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore nga substancat e rrezikshme përkatëse	**Baseline report**	Information on the state of soil and groundwater contamination by relevant hazardous substances	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Raport i cilësisë ekologjike	Një raport i cili paraqet marrëdhënien në mes të vlerave të parametrave biologjikë të vrojtuar për një trup ujor sipërfaqësor të caktuar dhe vlerave për këta parametra në kushte referente që vlejnë për atë trup ujor sipërfaqësor. Raporti duhet të paraqitet në formë të vlerës numerike ndërmjet 0 dhe 1, me një status të lartë ekologjik që shprehet me vlera afër 1 (njëshit) dhe statusit të keq ekologjik me vlera aftër 0 (zeros)	**Ecological quality ratio**	Ratio representing the relationship between the values of the biological parameters observed for a given body of surface water and values for these parameters in the reference conditions applicable to that body. The ratio shall be represented as a numerical value between zero and one, with high ecological status represented by values close to one and bad ecological status by values close to zero	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Raporti mjedisor	Identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet e mundshme domethënëse në mjedis, (përfshirë shëndetin e njeriut), me rastin e zbatimit të një plani apo programi dhe të alternativave të tij të arsyeshme duke i marrë parasysh objektivat dhe fushëveprimin gjeografik të planit apo programit	**Environmental report**	It identifies, describes and evaluates the likely significant environmental effects including health, of implementing the plan or programme and its reasonable alternatives taking into account the objectives and the geographical scope of the plan or programme	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2001/42/EC
Reaktant	Substancë e cila merr pjesë në një reaksion kimik dhe gjatë të cilit shndërrohet në një apo më shumë substanca (produkte)	**Reactant**	Chemical reaction, a process in which one or more substances, the reactants, are converted to one or more different substances, the products	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Reaktor me shtrat fluidizues	Një lloj reaktori i cili mund të përdoret për të kryer një varg reaksionesh kimike shumëfazore. Një rrymë fluidi (gazi apo lëngu) kalon nëpër një material granular solid (zakonisht një katalizator në formë të sferave të imta) me shpejtësi mjaft të madhe sa për të suspenduar lëndët e ngurta, duke i "lëngëzuar" ato (pra i bënë të sillen sikur të ishin fluid)	**Reactor, fluidized bed**	A type of reactor device that can be used to carry out a variety of multiphase chemical reactions. A fluid (gas or liquid) is passed through a solid granular material (usually a catalyst possibly shaped as tiny spheres) at high enough velocities to suspend the solid and cause it to behave as though it were a fluid	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Reaktor me shtrat fluidizues	Një lloj reaktori i cili mund të përdoret për të kryer një varg reaksionesh kimike shumëfazore bazuar në një proces me shtrat të fluidizuar	**Fluidized bed reactor**	A type of reactor device that can be used to carry out a variety of multiphase chemical reactions based on a fluidized bed process	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Reaktor i zhytur me biofilm mbi shtrat të fiksuar	Një proces në trajtimin e ujërave të ndotura ku përdoren mjete plastike të ajruara, të fiksuara, me strukturë të hapur e që janë të zhytura dhe për të cilat është i ngjitur biofilmi. Në përgjithësi operojnë pa riqarkullimin e lymit (llumit) me qëllim që të shmanget bllokimi i këtyre mjeteve ndihmëse (mbajtëse)	**Fixed bed biofilm reactor**	A process in waste water treatment in which is used aerated submerged fixed open structured plastic media for the support of the biofilm. These systems are generally operated without sludge recirculation in order to avoid clogging of the support media	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Redukto, ripërdor, riciklo	Këto tri R paraqesin një metodologji dhe strategji mjedisore për minimizimin (pakësimin) e mbeturinave (në Shqipëri - mbetjeve), e cila është një kornizë hierarkike e mbeturinave (mbetjeve) që përdoret për të gjeneruar përfitime maksimale nga produktet por duke krijuar sa më pak mbeturina (mbetje), parim ky i cili aplikohet nga njerëzit dhe organizatat për të vlerësuar opsionet e mundshme dhe ekologjike të blerjes	**Reduce, reuse recycle**	R3 is an environmental methodology and strategy for waste minimization, a hierarchical waste framework that is used to generate maximum product benefit with minimal waste, and a principle applied by people and organizations to evaluate viable and ecologically sound purchasing options	Ndotje	
Regjim hidrologjik	Variacionet në gjendjen dhe karakteristikat e një trupi ujor të cilat përsëriten në mënyrë të rregullt në kohë dhe hapësirë, dhe të cilat kalojnë nëpër faza, p.sh. sezonale. Po ashtu konsiderohet edhe si një element hidromorfologjik që mbështetë elementët biologjik, ku ky regjim hidrologjik karakterizohet me anë të sasisë dhe dinamikës së rrjedhjes së ujërave, si dhe me lidhjen rezultuese me trupat ujorë nëntokësorë	**Hydrological regime**	Variations in the state and characteristics of a water body which are regularly repeated in time and space and which pass through phases, e.g. seasonal. It is also considered as an hydromorphological element supporting the biological elements of water bodies status which is characterized through the quantity and dynamics of water flow and the connection to groundwater bodies	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Regjistrim i të dhënave të prurjematësit	Matja e prurjes horizontale dhe vertikale të ujit, e cila bëhet si në ujërrjedha ashtu edhe në vrima dhe puse, me anë të sondës së shpimit që zbret poshtë tyre	**Flow-meter logging**	The measurement of horizontal and vertical flow of water. Conducted in both streams and downhole in boreholes and wells	Përmbytje	
Rehabilitimi, përtëritja (sanimi)	Masat e ndërmarra për rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës p.sh. të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, për të përmirësuar performancën e tyre. Procesi i rehabilitimit përfshinë riparimin, dhe renovimin e objekteve ekzistuese. Në kontekst të menaxhimit të mjedisit, përtëritja (sanimi) apo kthimi në gjendjen e mëparshme, paraqet trajtimin e tokës së ndikuar nga një objekt (impiant) ashtu që të bëhet revitalizimi i tokës në gjendje të kënaqshme, duke i kushtuar rëndësi të posaçme cilësisë së dheut, kafshëve të egra, vendbanimeve (habitateve) natyrore, sistemeve të ujërave të ëmbla, peizazhit dhe përdorimeve të tyre të dobishme	**Rehabilitation**	Measures undertaken for the reconstruction and upgrading of infrastructures, such as waste watr treatment plants, to increase their performance. The rehabilitation process involves repairingand renovating existing facilities. In the context of the environmental management, it is the treatment of the land affected by a facility in such a way as to restore the land to a satisfactory state, with particular regard to soil quality, wild life, natural habitats, freshwater systems, landscape and appropriate beneficial uses	Masat	
Resurse ujore (në Shqipëri - burime ujore[29])	Janë të gjitha ujërat e brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe reshjet atmosferike të cilat janë potencialisht të përdorshme	**Water resources**	All inland surface and underground waters and atmospheric rainfalls that are potentially useful	Menaxhim i ujërave	

[29] **Burimet ujore -** janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë (**Ligji Nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Neni 4, paragafi 9, Legjislacioni i Shqipërisë**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Resurset (në Shqipëri - "burimet") natyrore	Janë llojet e mbrojtura dhe vendbanimet (habitatet) natyrore, ujërat dhe toka	**Natural resource**	Protected species and natural habitats, water and land	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2004/35/CE
Resurset (në Shqipëri "burimet") ujore nëntokësore të disponueshme	Norma mesatare vjetore afatgjate e rimbushjes së plotë të një trupi ujor nëntokësor pa normën vjetore afatgjate të prurjes së kërkuar për të arritur objektivat ekologjike të cilësisë për ujërat sipërfaqësore përkatës	**Available groundwater resource**	The long-term annual average rate of overall recharge of the body of groundwater less the long-term annual rate of flow required to achieve the ecological quality objectives for associated surface waters	Status i trupave ujorë	Directiva 2000/60/EC
Reshjet	Cilido produkt i kondensimit të avujve atmosferikë të ujit i cili depozitohet në sipërfaqen e Tokës: shiu, vesa, bora, breshëri, bora me shi, etj., dhe që matet me shi matës ndërsa shprehet me milimetra	**Precipitation**	Any product of the condensation of atmospheric water vapor that is deposited on the earth's surface: rain, dew, snow, hail, sleet, etc., and measured as millimetres of rain	Menaxhim i ujërave	
Rezervuar (basen)	Një rezervuar (basen) natyral apo artificial që përdoret për grumbullimin dhe mbajtjen e ujit, që përfshinë: depozitat (cisternat, rezervuarët), zonat me pengim me pendë (kaptazhet), liqenet apo akuiferët nëntokësorë, në të cilat grumbullohet uji dhe të cilat përdoren për magazinimin, rregullimin dhe kontrollin e ujit. Trupat ujorë nëntokësorë të mëdhenj quhen rezervuarë të ujërave nëntokësore, ndërsa uji i cili pengohet me digë quhet rezervuarë sipërfaqësorë (akumulim)	**Reservoir, basin**	A natural or artificial basin for collecting and holding a supply of water: tanks, dammed areas, lakes or underground aquifers, where water is collected and used for water storage, regulation and control. Large bodies of ground water are called ground water reservoirs, water behind a dam is called a surface reservoir	Menaxhim i ujërave	
Rezervuar ajrimi	Rezervuar zakonisht 3-5 m i thellë që përdoret për përzierjen dhe shpërndarjen e ujit të kontaminuar në një proces me lym (llum) aktiv duke e injektuar ajrin në ujë	**Aeration tank**	A tank (usually 3-5 m deep) that is used for mixing and dispersing contaminated water in an active sludge process by injecting air into water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar akumulues (grumbullues)	Enë apo rezervuar në të cilin uji magazinohet (ruhet) për përdorim sipas kërkesës	**Accumulation Tank**	Container or reservoir in which water is stored for use upon request	Furnizim me ujë	
Rezervuar balancues (barazues)	Rezervuar me vëllim të mjaftueshëm për të mundësuar që një rrjedhje jo e njëtrajtshme e ujërave të ndotura, të grumbullohet, përzihet dhe pompohet në sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura në mënyrë më uniforme. Kështu ky rezervuar karakterizohet me një prurje dhe/apo shkallë të përqendrimit hyrës të luhatshme, si dhe një prurje dhe/apo shkallë të përqendrimit në dalje mjaft konstante	**Balancing tank; equalization tank**	Tank with a sufficient volume to permit a nonuniform flow of waste water to be collected, mixed and pumped to a treatment system at a more uniform rate. Thus it is characterised by a fluctuating input flow rates and/or concentration with fairly constant output flow rates and/or concentrations	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar depozitues (grumbullues)	Një rezervuar i mbyllur, i nëndheshëm që përdoret për t'i mbajtur mbeturinat (në Shqipëri - mbetjet) e një shtëpie apo të një ndërtese tjetër	**Holding tank**	A sealed, buried tank used to hold waste from a house or other building	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Rezervuar dozimi	Rezervuar i papërshkueshëm nga uji që gjendet ndërmjet gropës septik dhe zonave deponuese (drenuese)[30] të këtyre ujërave të ndotura, i cili rezervuar është i pajisur me një pompë apo sifon, dhe shërben për të magazinuar dhe transferuar doza të efluentit nga gropa septike për në zonën deponuese (drenuese)	**Dosing tank**	A watertight tank located between the septic tank and disposal field[31] and equipped with a pump or siphon, to store and deliver doses of septic tank effluent to the disposal field	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar flotacioni	Një rezervuar i cili përdoret në procesin e trajtimit të ujërave të ndotura me "flotacion me tretje të ajrit". Uji me të cilin furnizohet "rezervuari me rregullues pluskues" zakonisht dozohet me një koagulant për t'i koaguluar (ngjizur) grimcat koloidale, dhe/apo me një flokulues (flokëformues) për t'i konglomeruar (grumbulluar) grimcat në grumbuj më të mëdha	**Flotation tank**	Tank that is used in the process for waste water treatment of "Dissolved air flotation". The feed water to the "float tank" is often dosed with a coagulant to coagulate the colloidal particles and/or a flocculant to conglomerate the particles into bigger clusters	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar grumbullues (depozitues)	Shihni përkufizimin për "Balancing tank" - "Rezervuari balancues (barazues)"	**Collection tank**	See the definition for "Balancing tank"	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar humusi	Rezervuar sedimentimi (dekantues) që gjendet i vendosur pas filtrave me pikim që përdoret për të veçuar biomasën e formuar në filtrin me pikim nga efluenti i trajtuar në një proces të përftimit të lymit (llumit) aktiv. Kjo biomasë njihet si lym (llum) humusor	**Humus tank**	Sedimentation tank that comes after drip filters used to separate the biomass formed in the dew point filter from the effluent treated in an activated sludge process. This biomass is known as humus sludge	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar i fundërrimit përfundimtar	Përdoret për të stabilizuar (fundërruar) lëndët biologjike të cilat dalin prej impiantit të trajtimit sekondar	**Final settlement tank**	Used to settle out the biological material flowing from the secondary treatment plant.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar (pond) magazinimi	Një strukturë artificiale që rregullon rrjedhjen e ujërave e që përdoret për magazinimin për një periudhë të kufizuar kohore të ujërave të shiut dhe ujërave të ndotura. Rezervuari (pondi) i magazinimit mund të inkorporohet në sistemin e rrjetit të kanalizimit në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura apo në fabrikat (uzinat)	**Detention tank**	An artificial flow-control structure that is used to contain stormwater and waste water for a limited period of a time. The detention tank can be incorporated into the sewer network system at the waste water treatment plant or at factories	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar nivelues, rezervuar barazimi	Një tub i ngritur vertikalisht apo një rezervuar magazinues (ujëmbajtës) në fundin e rrjedhës së poshtme të një kanali ujësjellës të mbyllur, të një kanali prurës, dige, tubi barazhi (pengues), i cili shërben për të absorbuar rritjet e papritshme të presionit, si dhe për të ofruar ujë shtesë gjatë një rënieje të shkurtër të presionit	**Surge tank, Surge chamber**	A standpipe or storage reservoir at the downstream end of a closed aqueduct, feeder, dam, barrage pipe to absorb sudden rises of pressure, as well as to quickly provide extra water during a brief drop in pressure	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rezervuar shumëqëllimësh	Një rezervuar i ndërtuar dhe i pajisur për të magazinuar dhe shkarkuar ujin për dy apo më shumë qëllime, si p.sh. për kontrollin e përmbytjeve, gjenerimin e energjisë, për lundrim, ujitje, rekreacion, zvogëlim të ndotjes, furnizim me ujë të ekonomive shtëpiake, etj.	**Multipurpose reservoir**	A reservoir constructed and equipped to provide storage and release of water for two or more purposes such as flood control, power development, navigation, irrigation, recreation, pollution abatement, domestic water supply, etc.	Menaxhim i ujërave	

[30] Zonë deponuese (drenuese) - sipërfaqja e tokës nën të cilën ujërat e ndotura që rrjedhin nga gropa septike shpërndahen nëpërmjet tubave (gypave) drenazhues në tokë, prej ku më pas absorbohen

[31] Disposal field - an area of ground under whose surface the overflow from a septic tank is distributed in drain tile to be absorbed in the soil

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Rënie termike	Një shpejtësi e ndryshimit të menjëhershëm të temperaturës në një trup ujor siç është p.sh. një liqe, i cili karakterizohet me një shtresë mbi dhe nën të cilën uji ka temperaturë të ndryshme	**Thermocline**	An abrupt temperature gradient in a body of water such as a lake, marked by a layer above and below which the water is at different temperatures	Cilësi e ujërave	
Riajrosja	Paraqet futjen e ajrit në shtresat më të poshtme të një rezervuari, me ç'rast formohen flluskat e ajrit të cilat ngjiten lart duke kaluar nëpër ujë, dhe ku oksigjeni tretet në ujë duke e kompensuar kështu oksigjenin e shpërbërë	**Reaeration**	It is the introduction of air into the lower layers of a reservoir, when the air bubbles form and rise through the water, and the oxygen dissolves into the water and replenishes the dissolved oxygen	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rikarbonizim	Proces ku në ujin i cili trajtohet për të ulur pH flluskoset dioksidi i karbonit (d.m.th. CO_2 futet në këtë ujë në formë flluskash)	**Recarbonization**	Process in which carbon dioxide is bubbled into water being treated to lower the pH	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Rikuperim	Në kontekst të ujit, të llojeve të mbrojtura dhe të vendbanimeve (habitateve) natyrore, rikuperimi (përfshirë rikuperimin natyror) nënkupton kthimin e resurseve natyrore të dëmtuara dhe/apo të shërbimeve të dëmtuara në gjendjen e përafërt burimore, ndërsa në rastin e dëmtimit të tokës, rikuperimi nënkupton eliminimin e çdo rreziku domethënës i cili mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut	**Recovery**	In the case of water, protected species and natural habitats, recovery, including natural recovery, means the return of damaged natural resources and/or impaired services to baseline condition and in the case of land damage, the elimination of any significant risk of adversely affecting human health	Masat	Direktiva 2004/35/CE
Rimbushje	Proces në të cilin ujërat nëntokësore pasurohen (rimbushen) me ujëra të cilët depërtojnë në sistemin e ujërave nëntokësore. Rimbushja nuk përshinë ujërat të cilët i mban dheu në zonën e pasaturuar të tij, të cilët mund të avullojë, të përthithen nga bimët apo të shkarkohen në zonat topografike të ulëta	**Recharge**	The process whereby groundwater is replenished by water entering the groundwater system. Recharge does not include water held in the soil in the unsaturated zone that may be evaporated, taken up by plants, or discharge at topographic lows	Hidraulikë	
Rimbushje artificiale	Procesi i injektimit (apo rimbushjes) të ujërave në ujërat nëntokësore në mënyrë të kontrolluar me anë të puseve të posaçëm rimbushës	**Artificial recharge**	The process of injecting (or recharging) water into the groundwater in a controlled way, by means of special recharge wells	Masat	Direktiva 2000/60/EC
Rinovim (riparim)	Aktivitetet e ndërmarra për rindërtimin e objekteve ekzistuese me qëllim të arritjes së efiçiencës dhe performancës së kërkuar të tyre	**Refurbishment**	Activities conducted to reconstruct existing facilities in order to achieve the required efficiency and performance	Furnizim me ujë	
Ripërdorimi i ujërave të ndotura	Procesi i shndërrimit të ujit të ndotur në ujë i cili mund të ripërdoret për qëllime të tjera. Ripërdorimi i ujërave të ndotura mund të përfshijë p.sh. ujitjen e kopshteve dhe të tokave bujqësore apo rimbushjen (pasurimin) e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	**Waste water reuse**	The process of converting waste water into water that can be reused for other purposes. Reuse may include irrigation of gardens and agricultural fields or replenishing surface water and groundwater	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	EU Blueprint[32]
Ripërdorimi i drejtpërdrejtë	Përdorimi i dobishëm i ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë adekuate pa magazinim të përkohshëm në një trup ujor sipërfaqësor apo në një akuifer.Shndërrrimi i ujërave të ndotura drejtpërdrejtë në ujë të ricikluar, ujë për ujitje, në ujë prodhimi apo ujë për ftohje, pa asnjë lloj magazinimi të përkohshëm	**Direct reuse**	The beneficial use of appropriatly treated waste water without interim storage in a surface water body or aquifer. The conversion of waste water directly into recycled water, irrigation water, process water or cooling water without any interim storage	Menaxhim i ujërave	

[32] "A Blueprint to Safeguard Europe's Water Resources" - "Plani për Mbrojtjen e Resurseve Ujore te Evropës"

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
RIpërdorimi indirekt (jo i drejtpërdrejt)	Përdorimi i dobishëm i ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë adekuate, përmes magazinimit të tyre të përkohshëm në një trup ujor sipërfaqësor apo akuifer, apo përdorimi i ujit të ricikluar[33] për ujitje apo për përdorime të tjera me përjashtim të përdorimit të tij për pije, pas një periudhe të magazinimit të tij në një trup ujor sipërfaqësor apo nëntokësor	**Indirect reuse**	The beneficial use of appropriatly treated waste water with interim storage in a surface water body or aquifer, or the use of reclaimed water[34] for irrigation or other non potable applications after a period of storage in surface or a groundwater body	Menaxhim i ujërave	
Riqarkullim (qarkullim me cikël të mbyllur)	Sistemi i qarkullimit me cikël të mbyllur siguron që uji vazhdimisht të rrjedhë nëpër gypa (tuba), i tërhequr qoftë nga graviteti apo nga një pompë prej pikës më të largët të sistemit hidraulik për tek ngrohësi i ujit	**Recirculation**	A recirculation system ensures that water flows continually through the piping, drawn either by gravity or a pump back to the water heater from the farthest point in the plumbing	Furnizim me ujë	
Riqarkullim i lymit (llumit) aktiv	Rikthimi i lymit (llumit) aktiv në një rezervuar ajrimi për t'u përzier aty me ujin e ndotur. Riqarkullimi i lymit (llumit) aktiv zakonisht përdoret për të ruajtur kushtet e ekuilibrit në rezervuarin e ajrimit në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura	**Return activated sludge**	Active sludge recovery from the settling tanks returned to the head of the aeration system to be mixed with waste water. It is used to maintain balance conditions in the aeration tank in waste water treatment plants	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[33] **Ujë i ricikluar (rigjeneruar)** - ujërat e ndotura të trajtuara në atë mënyrë që iu hiqen lëndët e ngurta dhe papastërtitë

[34] **Reclaimed water** or **recycled water**, is former wastewater (sewage) that is treated to remove solids and impurities, and used in sustainable landscaping irrigation, to recharge groundwater aquifers, to meet commercial and industrial water needs, and for drinking.

4.22 RRrr

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Rregullat e përgjithshme detyruese	Nënkuptojnë vlerat kufizuese të emisionit (në Shqipëri- shkarkimit) apo kushtet e tjera, të paktën në nivel sektori, të cilat miratohen me qëllim që të përdoren drejtpërsëdrejti për të përcaktuar kushtet e lejes	**General binding rules**	Emission limit values or other conditions, at least at sector level, that are adopted with the intention of being used directly to set permit conditions	Aspekte institucionale dhe ligjore	Direktiva 2010/75/EU
Rregullatori	Një agjenci rregullatore (që ndryshe quhet edhe autoritet rregullator, organ rregullator apo thjeshtë vetëm rregullator) paraqet autoritetin publik apo agjencinë qeveritare përgjegjëse për të ushtruar autoritetin autonom mbi disa fusha të veprimtarisë njerëzore në rolin e saj rregullator apo mbikëqyrës	**Regulator**	A regulatory agency (also regulatory authority, regulatory body or regulator) is a public authority or government agency responsible for exercising autonomous authority over some area of human activity in a regulatory or supervisory capacity	Menaxhim i ujërave	
Rregullator i kreut të një kanali	Strukturë për kontrollin e rrjedhjes nëpër një kanal	**Head regulator**	Structure for controlling the flow through a canal	Furnizim me ujë	
Rregullues i prurjes (dinamik/statik)	Pajisje që përdoret për të rregulluar prurjen e cila hynë në një sistem duke siguruar kështu një prurje konstante dhe maksimale. Këta rregullues të prurjes mund të klasifikohen në rregullues dinamik dhe statik	**Flow regulator (dynamic/static)**	Device used to regulate the flow input into a system by providing constant and maximum flow rates. These flow regulators can be classified into dynamic and static	Hidraulikë	
Rrezik	Nënkupton karakteristikën e brendshme të një substance të rrezikshme apo të një situate fizike, me potencial për t'i shkaktuar dëm shëndetit të njeriut apo mjedisit	**Hazard**	Intrinsic property of a dangerous substance or physical situation, with a potential for creating damage to human health and/or the environment	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU
Rrezik i menjëhershëm për dëmtim të mjedisit	Gjasë e mjaftueshme se do të ndodh një dëmtim i mjedisit në të ardhmen e afërt	**Imminent threat of damage**	Sufficient likelihood that environmental damage will occur in the near future	Rreziku	Direktiva 2004/35/CE
Rrezikshmëri	Është probabiliteti i një efekti specifik që të ndodh brenda një periudhe të caktuar apo në rrethana të caktuara	**Risk**	The likelihood of a specific effect occurring within a specified period or in specified circumstances	Probleme mjedisore	Direktiva 2012/18/EU
Rreziku nga përmbytja	Paraqet kombinimin e probabilitetit të një ndodhie përmbytjeje dhe të pasojave të mundshme negative për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe veprimtarinë ekonomike që lidhet me një ndodhi përmbytjeje	**Risk, flood**	The combination of the probability of a flood event and of the potential adverse consequences for human health, the environment, cultural heritage and economic activity associated with a flood event	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Rrjedhë e poshtme	Që gjendet apo lëvizë në drejtimin e njëjtë me atë në të cilin rrjedhë një ujërrjedhë apo lumë, d.m.th. tutje prej burimit të tyre	**Downstream**	Situated or moving in the direction in which a stream or river flows	Hidraulikë	
Rrjedhë e sipërme	Pjesa e siperme e rrjedhes se lumit - Levizja në drejtim të kundërt nga ai në të cilin rrjedhë një ujërrjedhë apo lumë, do të thotë më afër burimit	**Upstream**	Moving or situated in the opposite direction from that in which a stream or river flows; nearer to the source	Hidraulikë	
Rrjedhë devijuese	Ujërat sipërfaqësore të cilët kthehen në mjedisin natyror pas devijimit të tyre për përdorim të dobishëm të tyre, p.sh. për ujitje	**Return flow**	Surface water that returns to the natural environment after diversion for beneficial uses, such as for irrigation	Menaxhim i ujërave	
Rrjedhja (derdhja) brenda	Sasia e ujërave që futen në një sistem apo në një trup ujor (p.sh. në një rezervuar)	**Inflow**	The amount of water entering a system or a body of water (e.g. a reservoir)	Hidraulikë	
Rrjedhja nëpër një tub (gyp)	Rrjedhja nëpër një tub e cila zhvillohet e papengesë	**Pipeflow**	Flow through a pipe that runs full	Furnizim me ujë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Rrjedhje	Rrjedhja sipërfaqësore paraqet ujërat sipërfaqësore të krijuara nga reshjet, shkrirja e borës apo ujitja, të cilat rrjedhin në mënyrë të pakontrolluar në formë rrëkesh (përrenjsh) e të cilat derdhen në lumenj, kanalet për kullimin e ujit (drenazhe) apo në tubat (kolektorët) e ujërave të ndotura	**Runoff**	Runoff is that part of the precipitation, snow melt, or irrigation water that appears in uncontrolled surface streams, rivers, drains, or sewers	Menaxhim i ujërave	
Rrjedhje bazike	Një rrjedhje e pandërprerë e një rrjedhe (rrëkeje) në mungesë të një rrjedhje direkte sipërfaqësore. Përfshinë rrjedhjen e rrjedhave (rrëkeve) natyrore apo atyre të shkaktuara nga njeriu. Rrjedhja bazike natyrore ushqehet në masë të madhe nga prurjet volumetrike të ujërave nëntokësore	**Base flow, Basic flow**	Sustained flow of a stream in the absence of direct runoff. It includes natural and human-induced stream flows. Natural base flow is sustained largely by groundwater discharges	Trupa ujorë	
Rrjedhje e qëndrueshme	Një rrjedhje në të cilën shpejtësia e lëvizjes së thërrmijave nuk varet nga koha. Ky term i referohet gjendjes ku karakteristikat e fluidit në një pikë të caktuar brenda sistemit nuk ndryshojnë me kalimin e kohës	**Steady flow**	A flow that is not a function of time. It refers to the condition where the fluid properties at a point in the system do not change over time	Hidraulikë	
Rrjedhje (rrymë) e shpejtë	Një rrymë e fuqishme dhe e shpejtë e ujit e cila rrjedh nëpër një kanal të ngushtë	**Race**	A strong or rapid current of water flowing through a narrow channel	Hidraulikë	
Rrjedhje e ujërave nëntokësore	Ajo pjesë e rrjedhjeve sipërfaqësore e cila ka kaluar nën tokë, zhvillohet në rrjedhë nëntokësore, dhe shkarkohet në një kanal ujërrjedhe si burim i ujit të filtruar	**Groundwater runoff**	That part of the runoff which has passed into the ground, becomes groundwater, and is discharged into a stream channel as spring of percolation water	Trupa ujorë	
Rrjedhje e ujit	Një shteg (zakonisht një e hapur) përmes së cilës një fluid del prej një depozite (kontejneri) apo një sistemi fluidmbajtës, siç është një rezervuar (cisternë) apo trup anijeje, ku përmes kësaj hapjeje përmbajtja e depozitës (rezervuarit) mund të del jashtë saj apo në të mund të futen lëndët nga jashtë	**Leak (of water)**	A way (usually an opening) for fluid to escape a container or fluid-containing system, such as a tank or a ship's hull, through which the contents of the container can escape or outside matter can enter the container.	Furnizim me ujë	
Rrjedhje kritike	Rrjedhja e cila ndodh kur shpejtësia e rrjedhjes në një kanal lumi është e barabartë me shpejtësinë e valës që krijohet nga një trazim apo obstruksion	**Critical flow**	The flow that occurs when the flow velocity in a river channel equals the wave velocity generated by a disturbance or obstruction.	Hidraulikë	
Rrjedhje kritike (ujërrjedhat mjedisore)	Në kuptim të ujërrjedhave mjedisore, konsiderohet si rrjedhja minimale e nevojshme për mbajtjen në jetë të ekosistemeve të ujërave të ëmbla	**Critical flow (environmental flow)**	In the context of environmental flows, it is considered as the minimum flow needed for sustainability of freshwater ecosystems	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Rrjedhje laminare	Një regjim i rrymimit të fluidit që karakterizohet me një shpërndarje të lartë të sasisë së lëvizjes dhe një konveksion të ultë të sasisë së lëvizjes. Kur një fluid rrjedh nëpër një kanal të mbyllur si p.sh. nëpër një tub apo ndërmjet dy pllakave të rrafshëta, varësisht nga shpejtësia dhe viskoziteti i fluidit mund të ndodh njëra prej këtyre dy llojeve të rrjedhjes: rrjedhja laminare apo rrjedhja turbulente	**Laminar flow**	A flow regime characterized by high momentum[35] diffusion and low momentum convection. When a fluid is flowing through a closed channel such as a pipe or between two flat plates, either of two types of flow may occur depending on the velocity and viscosity of the fluid: laminar flow or turbulent flow	Hidraulikë	
Rrjedhje maksimale, shkarkim maksimal	Shkarkimi maksimal i atypëratyshëm i një ujërrjedhe apo lumi në një vend të caktuar, që zakonisht ndodh afërsisht apo fiks në kohën e nivelit maksimal të ujit në të	**Peakflow, peak discharge**	The maximum instantaneous discharge of a stream or river at a given location. It usually occurs at or near the time of maximum stage	Hidraulikë	

[35] Linear momentum, translational momentum, or simply momentum (pl. momenta) is the product of the mass and velocity of an object (p=m*v) Prodhimi në mes të masës dhe shpejtësisë përktëse quhet '**sasi e lëvizjes**'.

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Rrjedhje me ngjitje lart	Një formë e rrjedhjes së ujit ku një tretësirë (zakonisht ujë) futet në pjesën e poshtme të një ene apo një shtylle dhe rrjedh duke u ngjitur prej poshtë lart, gjerë tek pjesa e sipërme e saj, në çdo etapë të ciklit të operimit të njësisë së trajtimit të këtij uji	**Up flow**	A pattern of water flow in which a solution (water usually) enters at the bottom of the vessel or column and flows out at the top of the vessel or column during any phase of the treatment unit's operating cycle	Hidraulikë	
Rrjedhje nëpër një kanal të hapur	Rrjedhja e ujërave me sipërfaqen e lirë të tyre të hapur kah atmosfera, siç janë p.sh. përrenjt (rrëketë), lumenjt dhe ujëprurësit (tubat e ujit, të drenazhimit) të cilët nuk janë tërësisht të mbushur	**Open channel flow**	Fluid flow with a free surface open to the atmosphere, such as streams, rivers and culverts not flowing full	Furnizim me ujë	
Rrjedhje paralele	Një formë e lëvizjes së lëngjeve apo gazeve teknologjike në një shkëmbyes nxehtësie ku fluidet (lëngjet apo gazet) të ndara në mes vete me një mur rrjedhin në drejtime identike dhe ku shkëmbimi i nxehtësisë ndodh nëpër këtë mur. Tek rrjedhja paralele, ndryshimi i temperaturës mesatare ndërmjet lëngjeve teknologjike është thelbësisht më i ultë sesa tek kundërrrjedhja (rrjedhja e kundërt), posaçërisht nëse ndryshimi i temperaturës është i vogël në anën e vrimës shkarkuese	**Parallel flow**	A pattern of movement of working liquids or gases in a heat exchanger whereby fluids divided by a wall flow in identical directions; the heat transfer occurs through the wall. With parallel flow the average temperature difference between the working liquids is substantially less than with counterflow, especially if the temperature difference at the outlet side is small	Hidraulikë	
Rrjedhje sipërfaqësore urbane	Rrjedhja sipërfaqësore e ujërave të reshjeve e cila është krijuar si rezultat i urbanizimit, ku uji i reshjeve në vend se të kullohet në tokë ai derdhet nëpër kanalet e drenazhimit të ujërave të shiut, gjë që ndikon në reduktimin e tablos ujore nëntokësore (meqë ujërat nëntokësore nuk rimbushen) dhe për pasojë shkakton përmbytje. Andaj rrjedhjet sipërfaqësore urbane konsiderohen si një ndër shkaktarët kryesorë të përmbytjeve dhe të ndotjes së ujit në zonat urbane	**Urban runoff**	Surface runoff of rainwater caused by urbanization. Impervious surfaces (roads, parking lots and sidewalks, built from materials such as asphalt and concrete), along with rooftops, carry polluted stormwater to storm drains, instead of allowing the water to percolate through soil, therefore urban runoff is a major source of flooding and water pollution in urban communities	Probleme mjedisore	
Rrjedhje turbulente	Një regjim i rrjedhjes në dinamikën e fluideve që karakterizohet me ndryshime kaotike në shtypjen dhe shpejtësinë e rrjedhjes (rrymimit) të një fluidi. Kjo rrjedhje është e kundërt me regjimin e rrjedhjes laminare, e cila ndodh kur një fluid rrjedh në shtresa paralele pa asnjë pengesë që do të çrregullonte rrjedhjen e këtillë të tyre	**Turbulent flow**	A flow regime in fluid dynamics characterized by chaotic changes in pressure and flow velocity. It is in contrast to a laminar flow regime, which occurs when a fluid flows in parallel layers, with no disruption between those layers	Hidraulikë	
Rrjedhshmëri e përmbytjes	Procesi i llogaritjes së stadit të rezervuarit, vëllimit magazinues dhe shpejtësisë së rrjedhjes dalëse që i përgjigjen një hidrografi të caktuar të rrjedhës hyrëse. Në një sistem të parashikimit të përmbytjeve, studimet e 'rrjedhshmërisë' së përmbytjes përdoren për të llogaritur nivelet e mundshme të përmbytjes në lidhje me kohën në pikat poshtë rrjedhës	**Flood routing**	The process of computing the reservoir stage, storage volume and outflow rates corresponding to a particular hydrograph of inflow. In a flood forecasting system, routing studies are used to compute the probable flood levels with respect to time at dowstream points	Përmbytje	
Rrjet shpërndarës	Rrjeti i shpërndarjes paraqet një grup të ndërlidhur të objekteve magazinuese (akumuluese) dhe sistemeve të transportimit, të cilat pranojnë inventarë mallrash dhe më pas i dërgojnë ato tek konsumatorët	**Distribution network**	A distribution network is an interconnected group of storage facilities and transportation systems that receive inventories of goods and then deliver them to customers	Menaxhim i ujërave	
Rrjetë (Sitë) me grila (vrima) të trasha (sitë e rrallë)	Paisje që përdoret në Impiantet e trajtimit të ujërave të ndoturapër të larguar nga uji i ndotur lëndët e ngurta, fragmentet, dhe copëzat me përmasa të mëdha ashtu që të pengohet dëmtimi dhe bllokimi i pajsjeve, tubacioneve dhe i pajisjeve shtesë në pjesën e poshtme të rrjedhës. Shihni përkufizimin për “Screening - Filtrim përmes sitave (sitje) e ujërave të ndotura”	**Coarse screen**	Device used for screening at waste water treatment plants. See “screening”	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.23 Ss

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Saktësia	Afërsi e përputhshmërisë ndërmjet një rezultati testi dhe vlerës së pranuar referente	**Accuracy**	Closeness of an agreement between a test result and the accepted reference value	Cilësi e ujërave	Directiva 2000/60/EC
Saturim (ngopje)	Gjendja e një lëngu në të cilin është tretur në sasi maksimale një substancë e caktuar, në një temperaturë dhe presion të caktuar	**Saturation**	The condition of a liquid when it has taken into solution the maximum possible quantity of a given substance at a given temperature and pressure	Cilësi e ujërave	
Sediment i shtratit	Grimcat e sedimentit që shtrihen mbi apo afër fundit të kanalit, të cilat rrjedha e ujit i shtyn apo i rrokullisë nëpër këtë kanal	**Bed material, Bed sediment**	Sediment particles resting on or near the channel bottom that are pushed or rolled along by the flow of water	Trupa ujorë	
Sedimente (precipitat, fundërresë)	Grimcat e patretura të dheut, rërës dhe mineraleve të shpëlara nga sipërfaqja e tokës në sistemet ujore si rezultat i aktiviteteve natyrore dhe i veprimtarisë së njeriut. Ky term zakonisht i referohet lëndëve në suspension (pezullive) që gjenden në ujëra apo lëndëve rishtazi të depozituara nga gjendja e tyre në suspension	**Sediments**	Undissolved soil particles, sand and minerals washed from the land into aquatic systems as a result of natural and human activities. Usually applied to material in suspension in water or recently deposited from suspension	Cilësi e ujërave	
Sedimentim (fundërrim)	Një proces i trajtimit gjithëpërfshirës të ujërave të ndotura ku lëndët e ngurta të suspenduara fundërrojnë në pjesën e poshtme të një dekantuesi (rezervuari sedimentimi)	**Sedimentation**	A large scale water treatment process where suspended solids settle to the bottom of a sedimentation tank	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Segment	Një trup ujor apo një pjesë e një trupi ujor i cili përcaktohet dhe klasifikohet në mënyrë individuale. Një segment i këtillë ka karakteristika kimike, fizike dhe hidrologjike relativisht homogjene	**Segment**	A water body or portion of a water body that is individually defined and classified. A segment is intended to have relatively homogenous chemical, physical, and hydrological characteristics	Trupa ujorë	
Sensitivizuese	Substancat dhe preparatet të cilat, po qe se nuhaten apo e depërtojnë lëkurën, kanë aftësi të shkaktojnë një reaksion hipersenzitiviteti (të tejndjeshmërisë), ashtu që gjatë ekspozimit të mëpasshëm ndaj këtyre substancave apo preparateve, vjen deri te shfaqja e efekteve anësore karakteristike	**Sensitizing**	Substances and preparations which, if they are inhaled or if they penetrate the skin, are capable of eliciting a reaction of hypersensitization such that on further exposure to the substance or preparation, characteristic adverse effects are produced	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Separator (veçues) yndyrash	Një pajisje e dizajnuar për të ndarë vajrat nga yndyrat gjatë trajtimit të ujërave të ndotura	**Fat separator**	A device designed to separate oils and fats in waste water treatment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sezoni i larjes	Periudha gjatë së cilës mund të pritet numër i madh i larësve	**Bathing season**	The period during which large numbers of bathers can be expected	Shëndet publik	Direktiva 2006/7/EC
Sifon	Paraqet një tub që vetvetiu, pra pa ndihmë nga jashtë, i transporton lëngjet nga një rezervuar në drejtim nga poshtë lartë dhe më pas tatëpjetë në nivel më të ultë. Me t'u futur lëngu në tub, zakonisht përmes thithjes apo zhytjes (imersionit), rrjedhja e tij vazhdon vetvetiu pa u ndihmuar nga asgjë	**Siphon**	A tube used to convey liquid upwards from a reservoir and then down to a lower level of its own accord. Once the liquid has been forced into the tube, typically by suction or immersion, flow continues unaided	Furnizim me ujë	
Sifon dozues	Një pajisje hidraulike e projektuar për të shkarkuar shpejtë përbërjen e një rezervuari dozimi ndërmjet niveleve të paracaktuara të ujit apo ujërave të ndotura shtëpiake	**Dosing siphon**	A hydraulic device designed to discharge rapidly the contents of a dosing tank between predetermined water or sewage levels	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Siguria e Digës	Siguria e digës nënkupton se digat ndërtohen, mirëmbahen, funksionojnë, dhe dekomisionohen në mënyrë të sigurt në përputhje me udhëzuesit dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare	**Dam safety**	Dams safety means that dams are built, maintained, operated and decommissioned in a safe manner that is aligned with national and international guidelines and best practices	Hidraulikë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Sigurimi I cilësisë	Procedurat e zbatuara për të siguruar që rezultatet e programeve të monitorimit i përmbushin nivelet e synuara të precizitetit dhe besueshmërisë të cilat kërkohen. Mund të jetë në formë të metodave të standardizuar të marrjes së mostrave dhe të metodave të standardizuara analitike, analizave të përsëritura, kontrolleve të ekuilibrit të joneve dhe skemave të akreditimit laboratorik	**Quality Assurance**	Procedures implemented to ensure that the results of monitoring programmes meet the required target levels of precision and confidence. It can take the form of standardised sampling and analytical methods, replicate analyses, ionic balance checks and laboratory accreditation schemes	Monitorim	
Sipërfaqe potenciometrike	Sipërfaqja deri në të cilën mund të ngritët uji në një akuifer me anë të shtypjes hidrostatike	**Potentiometric surface**	The surface to which water in an aquifer can rise by hydrostatic pressure	Hidraulikë	
Sipërfaqe ujëmbledhëse (pellg ujëmbledhës)	Një sipërfaqe drenimi (kullimi) apo pellg (basen) ujëmbledhës paraqet një sipërfaqe toke ku të gjitha ujërat sipërfaqësore nga të rreshurat, bora apo akulli i shkrirë konvergjojnë në një pikë të vetme në një lartësi më të ultë, zakonisht në dalje të pellgut (basenit), aty ku ujërat bashkohen me një trup tjetër ujor, siç është p.sh. një lum, liqe, akumulim (në Shqipëri - rezervuar), estuarë, ligatinë, det apo oqean	**Catchment area**	A drainage basin or catchment basin is an extent or an area of land where all surface water from rain, melting snow or ice converges to a single point at a lower elevation, usually the exit of the basin, where the waters join another body of water, such as a river, lake, reservoir, estuary, wetland, sea, or ocean	Pellg lumor (Basen Ujor)	
Sistem deferrizimi	Sistem për largimin e komponimeve (bashkëdyzimeve) të hekurit nga uji. Gjatë trajtimit të ujërave, oksigjeni atmosferik e oksidon hekurin bivalent Fe2+(hekuri ferroz) në hekur trevalent Fe3+ (hekuri ferrik), i cili është vështirë i tretshëm si hidroksid ferrik Fe(OH)3 me ngjyrë kafe, por që në shumicën e rasteve filtrohet mjaft mirë	**Deferrisation system**	System for the removal of ferrous compounds in water. In the course of water treatment (atmospheric) oxygen will oxidise bivalent iron to trivalent iron, which is hardly soluble as brown metal oxide hydrate. This is often filterable quite well	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sistem grumbullues	Është një sistem i tubave i cili i grumbullon dhe i përçon ujërat e ndotura urbane	**Collecting system**	System of conduits which collects and conducts urban waste water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Sistem i furnizimit me ujë	Sistem i komponenteve të inxhinieruara hidrologjike dhe hidraulike të cilat sigurojnë furnizimin me ujë për përdorime të ndryshme. Furnizimi me ujë është një shërbim me interes të përgjithshëm	**Supply System, Water**	System of engineered hydrologic and hydraulic components which provide water supply for different uses. The supply of water is a service of general interest	Furnizim me ujë	
Sistem I kombinuar kanalizimesh	Sistem i tubacioneve të kanalizimit të projektuara për të pranuar ujërat e shirave, ujërat e ndotura shtëpiake, dje ujërat e ndotura industriale në të njëjtin sistem kanalizimi. Në shumicën e rasteve sistemet e kombinuara të kanalizimit i transportojnë të gjitha ujërat e ndotura në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, ku ato trajtohen dhe më pas shkarkohen në një trup ujor	**Combined sewer system**	Sewers that are designed to collect rainwater runoff, domestic sewage, and industrial waste water in the same pipe. Most of the time, combined sewer systems transport all of their waste water to a sewage treatment plant, where it is treated and then discharged to a water body	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sistem (rrjet) tubash	Një sistem tubash të ndërlidhur mes vete, që i nënshtrohet të njëjtit grup apo grupeve të kushteve të projektimit, dhe i cili përdoret për të përçuar, shpërndarë, përzier, ndarë, shkarkuar, matur, kontrolluar, apo ndaluar (bllokuar) rrjedhjen e fluideve. Po ashtu sistemi i tubave përfshinë edhe elementet mbështetëse të tubave por nuk përfshinë konstruksionin mbajtës (mbështetës) të tyre siç janë skeletet dhe bazamentet strukturore	**Pipe network**	An assembly of interconnected piping that is subject to the same set or sets of design conditions and is used to convey, distribute, mix, separate, discharge, meter, control, or snub fluids flows. It also includes pipe-supporting elements but does not include support structures, such as structural frames and foundations	Furnizim me ujë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Sistemi Informativ për menaxhimin e resurseve ujore (në Shqipëri-burimeve ujore)	Një sistem kompjuterik i cili mundëson grumbullimin, organizimin, ruajtjen dhe komunikimin e të dhënave, i cili përdoret me sukses në vendim-marrje nga institucionet që merren me menaxhimin e ujërave si dhe, po ashtu përdoret për të vënë informacionet në dispozicion për publikun e gjerë dhe palët e interesit	**Information System (for water resources management)**	Computer based system that allows the collection, organization, storage and communication of information and is used effectively in decision-making by water management institutions and, eventually, in making information accessible to the general public and stakeholders	Sisteme Informative	
Sistemi i menaxhimit mjedisor	Pjesë e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit që përfshinë strukturën organizative, aktivitetet e planifikimit, përgjegjësitë, praktikat, procedurat, proceset dhe resurset (burimet) për zhvillimin, implementimin, arritjen, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e politikave mjedisore dhe menaxhimin e aspekteve mjedisore	**Environmental management system**	The part of the overall management system that includes the organisational structure, planning activities, responsibilities, practices, procedures, processes and resources for developing, implementing, achieving, reviewing and maintaining the environmental policy and managing the environmental aspects	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Sistem i paralajmërimit të hershëm[36]	Sistemi i alarmimit dhe paralajmërimit ka për qëllim të parashoh profilet-kohore të rrjedhjes nëpër shtretërit e lumenjve, përrenjve dhe kanaleve të tjera, apo të nivelit të lumenjve nëpër lokacione të ndryshme të një pellgu lumor (në Shqipëri - baseni ujor), dhe në bazë të këtyre parashikimeve të vendos nëse paralajmërimet e përmbytjeve duhet t'i bëhen me dije publikut të gjerë. Sistemet e paralajmërimit të hershëm, si dhe të gjitha aspektet e menaxhimit të rreziqeve nga përmbytjet me fokus në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë edhe parashikimet e përmbytjeve, duhet të jenë pjesë përbërëse e Planeve të Menaxhimit të Rreziqeve nga Përmbytjet	**Early warning system**	The alarm and warning system seeks to forecast time-profiles of channel flows or river levels at various locations of a river basin and based on these forecasts to make decisions about whether warnings of floods should be issued to the general public. Early warning systems, as well as all aspects of flood risk management focusing on prevention, protection, preparedness, including flood forecasts, shall be part of Flood Risk Management Plans	Thatësirë, Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Sistemi shpërndarës shtëpiak[37]	Është sistemi i tubave, rakorderve (pjesëve bashkuese), dhe i pajisjeve të cilat instalohen ndërmjet rubinetëve, që normalisht përdoren për konsum nga njerëzit, dhe rrjetit shpërndarës, mirëpo vetëm nëse nuk janë nën përgjegjësinë e furnizuesit të ujit, në kapacitetin e tij si furnizues i ujit, në përputhje me legjislationin kombëtar përkatës	**Domestic distribution system**	The pipework, fittings and appliances which are installed between the taps that are normally used for human consumption and the distribution network but only if they are not the responsibility of the water supplier, in its capacity as a water supplier, according to the relevant national law	Furnizim me ujë	Direktiva 98/83/EC
Sistem transportimi (bartjeje)	Një pjesë e përbashkët e pajisjeve për manovrim mekanik, e cila transporton lëndë zakonisht të rënda apo masive. Tek impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura ky sistem përdoret për të bartuar biosolidet e thara, lymin (llumin), mbeturinat e sitjes apo gritin[38]	**Conveyor system**	A common piece of mechanical handling equipment that trasnports materials (usually heavy or bulky). In waste water treatment plants is used to convey dewatered biosolids, sludge, screenings or grit	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[36] Këshilli i basenit ujor harton për rrethet e basenit ujor të tij planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, i cili fokusohet në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë parashikimin e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, të cilin e paraqet për miratim në strukturat përgjegjëse për emergjencat civile.(**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 70, Paragrafi 2 (Legjislacioni i Shqipërisë**)

[37] Sistemi shtëpiak i shpërndarjes - nënkupton sistemin e tubave dhe pajisjet që instalohen mes rubineteve që zakonisht përdoren për konsum nga njeriu dhe rrjeti qendror i shpërndarjes, por vetëm nëse nuk janë përgjegjësi e furnizuesit të ujit (Udhëzimi Adiministrativ Nr.16/2012 **për cilësinë e ujit që synohet të përdoret për konsum njerëzor, Neni 2, paragrafi 1.2 (Legjislacioni i Kosovës)**)

[38] Grit - grimca të forta të aglomeruara të ingredientit

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Sistemi i kolektorëve të ujërave të ndotura shtëpiake	Sistem tubacioni dhe i pompave që përdoren për të transportuar ujërat e ndotura shtëpiake nga vendi i gjenerimit të tyre gjerë tek infrastruktura përkatëse për trajtimin e tyre, përfshirë këtu edhe transportimin gjerë tek vend-deponimi i tyre nëntokë apo transportimin e tyre gjerë në mjedisin natyror	**Sewer**	A system of pipes, conduits and pumps used to convey sewage from its source generally to a treatment infrastructure but also to a ground disposal site or the natural environment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sistemi i shpërndarjes së ujit	Sistemet publike të shpërndarjes së ujit ofrojnë një furnizim të papenguar me ujë të sigurt të pijes për të gjithë konsumatorët	**Water distribution system**	Public water distribution systems provide an uninterrupted supply of pressurized safe drinking water to all consumers	Furnizim me ujë	
Sitë filtruese	Pajisje për trajtimin e ujërave të ndotura e cila i largon copëzat me përmasa të mëdha nga rrjedha hyrëse e ujërave të ndotura. Grilat e këtyre sitave mund të jenë me vendosje vertikale, horizontale apo të pjerrët, si dhe pastrimi i tyre mund të bëhet në mënyrë mekanike apo manuale	**Screen**	Wastewater treatment equipment that removes large size objects from the inflow. The blinds can be vertical, horizontal or inclined and their cleaning can be done mechanically or manually	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sitë me vrima të vogla	Pajisje në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të cilat shërbejnë për të larguar ndotësit e ngurtë me përmasa të vogla. Vrimat e këtyre sitave zakonisht sillen prej 1.5 deri në 6 mm. Vetëm sitat me vrima shumë të vogla (ku vrimat e tyre kapin madhësinë prej 0.2 deri në 1.5 mm) të cilat gjenden të vendosura pas sitave me vrima të mëdha apo me vrima të vogla, kanë mundësi t'i reduktojnë lëndët e ngurta të suspenduara deri në nivele të afërta me ato të arritura përmes pastrimit (filtrimit) primar	**Fine screen**	Appliances in waste water treatment plants that serve to remove solid pollutants of small size. Fine screen openings typically range from 1,5 to 6 mm. Very fine screens with openings of 0.2 to 1.5 mm placed after coarse or fine screens can reduce suspended solids to levels near those achieved by primary clarification	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Sitë-shirit	Një sitë që paraqet një shirit konvejeri transportues me vrima (rreth 6 mm të gjëra dhe 20 mm apo më shumë të gjata) të cilat mundësojnë kalimin e ujit nëpër shirit, e cila përdoret në proceset e trajtimit të ujërave dhe ujërave të ndotura. Grimcat e ngurta mbesin në shirit dhe bien në një kontejner (enë) që gjendet në majë të shiritit	**Belt screen**	A screen that is a sloping conveyor belt with holes (about 6 mm wide and 20 mm or more in length) in the belt to allow the water to flow through, that is used in water and waste water treatment processes. The solids are caught on the belt and drop off into a container at the top of the belt	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Skenari bazë (referent)	Parashikimi i zhvillimit të një grupi të përzgjedhur supozimesh në mungesë të ndërhyrjeve të politikave	**Baseline scenario**	Projection of the development of a chosen set of assumptions in the absence of policy interventions	Masat	
Skruberë të njomë (pastrues gazesh)	Pastruesit e gazeve apo skruberët e njomë janë pajisje efektive në kontrollin e ndotjes së ajrit ashtu që bëjnë largimin e grimcave dhe/apo gazeve nga tubat industrial të shkarkimit të gazeve. Skruberët e njomë funksionojnë duke e njomur rrymën e gazeve të ndyta me një lëngë pastrues - zakonisht me ujë	**Wet scrubbers**	Wet scrubbers are effective air pollution control devices for removing particles and/or gases from industrial exhaust streams, operating by introducing the dirty gas stream with a scrubbing liquid – typically water	Menaxhim i ujërave	
Stabilizim i lymit (llumit)	Një proces kimik apo biologjik i cili e ndërpret fermentimin natyror të lymit ashtu që i stabilizon lëndët e ngurta në përbërje të tij me largimin e erërave të këqija dhe patogjenëve. Ky proces zakonisht përfshinë një magazinim të tyrin të prolonguar (të zgjatur) qoftë në rezervuarët e mëdhenj buferikë të projektuar në mënyrë specifike, apo edhe në basenet e pastrimit (sedimentimit) që gjenden në vendndodhjen e sistemit të trajtimit	**Stabilisation (stabilization) of sludge**	A chemical or biological process that stops the natural fermentation of the sludge so that it will stabilize the solids in terms of odor and pathogen removal. Usually the process involves prolonged storage in either specially designed large process buffer tank or even clarification basins depending on the size of treatment system	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Stabilizim i prurjes	Stabilizimi i prurjes është metodë për të tejkaluar problemet lidhur me fluktuimet (lëkundjet) në prurje (shpejtësinë e rrjedhjes)	**Flow equalization**	Flow equalization is a method to overcome problems related to fluctuations in flow rate	Hidraulikë	
Stabilizimi i tokës (dheut) me gëlqere	Stabilizimi i tokës (dheut) me gëlqere është një mënyrë e trajtimit të tokës me kosto efektive si dhe fqinjësore për mjedisin e cila përdoret me qëllim të përmirësimit të tokës në vendin e aplikimit të saj	**Lime stabilization**	Lime Stabilisation is a cost effective and environmentally beneficial way of treating soils in order to improve them in-situ	Probleme mjedisore	
Stacion pompimi	Objektet përfshirë pompat dhe pajisjet për pompimin e ujërave apo të ujërave të ndotura prej një vendi në një vend tjetër. Përdoren për një sërë sistemesh infrastrukturore, si p.sh. për furnizimin me ujë të kanaleve, për kullimin (drenazhimin) e tokave që gjenden në lartësi të ulëta mbidetare, si dhe për largimin dhe transportimin e ujërave të ndotura shtëpiake drejt vendeve të përpunimit të tyre	**Pumping station**	Facilities including pumps and equipment for pumping water or waste water from one place to another. They are used for a variety of infrastructure systems, such as the supply of water to canals, the drainage of low-lying land, and the removal of sewage to processing sites	Hidraulikë	
Stacion hidrometrik	Teknikë që përdoret për të matur shkarkimin, apo vëllimin e ujit që lëvizë nëpër një kanal për njësinë e kohës në një lokacion specifik të një ujërrjedhe	**Gauging station**	Technique used to measure the discharge, or the volume of water moving through a channel per unit time in a specific location of a stream	Monitorim	
Stacion observimi i baticë-zbaticës	Lokacioni ku bëhen observimet e ciklit të baticë-zbaticës. Ekzistojnë stacione të këtilla primare dhe sekondare. Stacion primar quhet ai stacion ku bëhen observime të vazhdueshme përgjatë disa viteve me qëllim të fitimit të të dhënave bazike mbi ciklet e baticë-zbaticës në një zonë. Ndërkaq, një stacion sekondar quhet ai stacion i cili shërben për grumbullimin e të dhënave për qëllime të caktuara për periudha më të shkurtra kohore	**Tidal station**	Location where tidal observations are made. There are both primary and secondary tidal stations. A primary tidal station is the name used for a tidal station where continued observations are to be taken over a number of years to gain basic data on the tides for the area. A secondary tidal station is used over a shorter time frame to gather data for a particular purpose	Monitorim	
Stagnim (amulli)	Mungesë e lëvizjes në ujëra e cila i mban ndotësit në vend	**Stagnation**	Lack of motion in water that holds pollutants in place	Cilësi e ujërave	
Standard pranimi	Kufizimi në përbërjen fizike, kimike, dhe biologjike të një shkarkimi, shprehur në vlerat numerike të pragut për to, të cilat nuk duhet të tejkalohen	**Consent standard**	Limitation in the physical, chemical and biological content of a discharge, given by numerical threshold values which are not to be exceeded	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Standarde rregullatore	Organi rregullator përcakton kufijtë rregullator për sasitë e disa ndotësve të caktuar në ujë të shkaktuara nga sistemet publike të ujit	**Regulatory standards**	The Regulator Body sets regulatory limits for the amounts of certain contaminants in water provided by public water systems	Masa	
Standarde të Cilësisë Mjedisore[39] (SCM)	Grup kërkesash të cilat duhet të përmbushen në një periudhë të caktuar nga një mjedis i caktuar. Po ashtu mund të përkufizohet si: përqendrimi i një ndotësi të veçantë apo grupi ndotësish në ujë, në sediment ose biotë, i cili nuk duhet të tejkalohet, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit njerëzor dhe të mjedisit	**Environmental quality standards**	The set of requirements which must be fulfilled at a given time by a given environment. It can also be defined as the concentration of a particular pollutant or group of pollutants in water, sediment or biota which should not be exceeded in order to protect human health and the environment	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2008/105/EC, Direktiva 2012/18/EU

[39] **Standardi i cilësisë së mjedisit** - nënkupton tërësinë e kushteve dhe kërkesave të cilat mjedisi ose një pjesë e caktuar e tij duhet t'i plotësoj në kohën e caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. (**Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndojes, Neni 2, Legjislacioni i Kosovës**)
Standarde të cilësisë mjedisore - është përqendrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota, i cili nuk duhet të tejkalohet, me qëllim mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe të mjedisit (**Ligji Nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Neni 4, paragrafi 59, Legjislacioni i Shqipërisë**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Standarde të cilësisë së ujërave	Standardet e cilësisë lidhur me praninë në ujërat sipërfaqësore të disa substancave të caktuara apo grupeve të substancave të identifikuara si ndotëse prioritare	**Water quality standards**	The quality standards concerning the presence in surface water of certain substances or groups of substances identified as priority pollutants	Cilësi e ujërave	Direktiva për Standardet e Cilësisë Mjedisore
Status ekologjik[40]	Është një shprehje e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore që lidhen me ujërat sipërfaqësore. Vlen për trupat ujorë sipërfaqësorë dhe bazohet në elementet e cilësisë si në vijim: elementet e cilësisë biologjike, elementet e cilësisë së përgjithshme kimike dhe fiziko-kimike, elementet e cilësisë së ujit lidhur me ndotësit specifik (sintetik dhe jo sintetik), dhe elementet e cilësisë hidromorfologjike. Statusi ekologjik klasifikohet në pesë klasa (i lartë, i mirë, mesatar, i dobët (i varfër) dhe i keq). Statusi ekologjik bashkë me statusin kimik e përcaktojnë statusin e përgjithshëm të ujërave sipërfaqësorë të një trupi ujor	**Ecological status**	It is an expression of the quality of the structure and functioning of aquatic ecosystems associated with surface waters. It applies to surface water bodies and is based on the following quality elements: biological quality, general chemical and physical-chemical quality, water quality with respect to specific pollutants (synthetic and non synthetic), and hydro-morphological quality. There are five classes of ecological status (high, good, moderate, poor or bad). Ecological status and chemical status together define the overall surface water status of a water body	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Status i mirë ekologjik[41]	Është statusi i një trupi ujor sipërfaqësor (lumenjve, liqeneve, ujërave kalimtare dhe ujërave bregdetare), që përfshinë konstatimin në vijim: "Vlerat e elementeve biologjike të cilësisë për llojin e trupit ujor sipërfaqësor tregojnë nivele të ulëta të ndotjes si rezultat i veprimtarisë së njeriut, por devijojnë shumë pak nga vlerat që normalisht e karakterizojnë llojin e trupit ujor sipërfaqësor në kushte kur ai është i pacenuar"	**Good ecological status**	The status of a body of surface water, (rivers, lakes, transitional waters and coastal waters) that complies the following: "The values of the biological quality elements for the surface water body type show low levels of distortion resulting from human activity, but deviate only slightly from those normally associated with the surface water body type under undisturbed conditions"	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Status i mirë i ujërave sipërfaqësorë[42] **Status i mirë i ujërave nëntokësore**[43]	Është statusi i arritur nga një trup ujor sipërfaqësor, ku edhe statusi i tij ekologjik edhe statusi i tij kimik konsiderohen të paktën si të mirë Është statusi i arritur nga një trup ujor nëntokësor, ku edhe statusi i tij sasior edhe statusi i tij kimik konsiderohen të paktën si të mirë	**Good status (surface and groundwater)**	The status achieved by a surface water body when both the ecological status and its chemical status are at least good or, for groundwater, when both its quantitative status and chemical status are at good status	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC

[40] Statusi Ekologjik - nënkupton cilësinë e struktures dhe funksionimit të ekosistemeve ujore që lidhet me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet me akt nënligjor (**Rregullorja MMPH Nr.02/2016 mbi mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike, Neni 3, paragrafi 1.9, Legjislacioni i Kosovës**)
Status ekologjik - është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore, që lidhen me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet në përputhje me akte të veçanta ligjore. (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 49, Legjislacioni i Shqipërisë**)

[41] **Status i mirë ekologjik** - është statusi ekologjik i arritur nga një trup ujor sipërfaqësor që vlerësohet po aq "i mirë" sa është përcaktuar në akte të veçanta ligjore (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 50, Legjislacioni i Shqipërisë**)

[42] **Status i mirë i ujërave sipërfaqësore** - është gjendja e arritur nga një trup ujor sipërfaqësor, ku si gjendja e tij ekologjike, ashtu edhe gjendja e tij kimike janë vlerësuar të paktën po aq "të mira", siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 52, Legjislacioni i Shqipërisë**)

[43] **Status i mirë i ujërave nëntokësore** - është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën po aq "të mirë", siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi. (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 51**).

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Statusi i mirë kimik i ujërave nëntokësore	Është statusi kimik i një trupi ujor nëntokësor, që i përmbush të gjitha kushtet në vijim: përqendrimet e ndotësve nuk shfaqin efekte kripe apo të ndërhyrjeve të tjera; nuk i tejkalojnë standardet e cilësisë mjedisore të përcaktuara në legjislacionin tjetër përkatës; nuk janë të tilla sa të shkaktojnë dështim në arritjen e objektivave mjedisore për ujërat sipërfaqësore përkatëse, as ndonjë zvogëlim të konsiderueshëm të cilësisë ekologjike apo kimike të këtyre trupave, si dhe as të shkaktojnë ndonjë dëm të konsiderueshëm në ekosistemet tokësore të cilat varen drejtpërdrejt nga trupi ujor nëntokësor; si dhe ndryshimet në përçueshmëri nuk janë tregues të ndonjë ndërhyrjeje me natyrë kripore apo të ndonjë ndërhyrjeje tjetër në trupin ujor nëntokësor	**Good groundwater chemical status**	The chemical status of a body of groundwater, which meets all the following conditions: concentrations of pollutants do not exhibit the effects of saline or other intrusions do not exceed the quality standards applicable under other relevant legislation are not such as would result in failure to achieve the environmental objectives for associated surface waters nor any significant diminution of the ecological or chemical quality of such bodies nor in any significant damage to terrestrial ecosystems which depend directly on the groundwater body; changes in conductivity are not indicative of saline or other intrusion into the groundwater body	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2006/118/EC
Status i mirë kimik i ujërave sipërfaqësore	Është statusi kimik i arritur nga një trup ujor sipërfaqësor ku përqendrimet e ndotësve nuk tejkalojnë standardet e cilësisë mjedisore	**Good surface water chemical status**	The chemical status achieved by a body of surface water in which concentrations of pollutants do not exceed the environmental quality standards	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Statusi i mirë sasior[44]	Është statusi i një trupi ujor nëntokësor që përfshinë konstatimin në vijim: "niveli i ujërave nëntokësore në trupin ujor nëntokësor është i tillë që resursi i disponueshëm i ujërave nëntokësore nuk tejkalohet nga norma mesatare vjetore afatgjate e nxjerrjes së ujit"	**Good quantitative status**	The status of a body of groundwater that compiles the following: The level of groundwater in the groundwater body is such that the available groundwater resource is not exceeded by the long-term annual average rate of abstraction	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Statusi kimik i ujërave nëntokësore	Është masë matëse e shkallës së përmbushjes së kushteve të përcaktuara me legjislacionin kombëtar dhe atë të BE-së	**Chemical Status (groundwaters)**	Measure of degree of compliance with the conditions set out by the national or EU legislation	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC Direktiva 2006/118/EC
Statusi kimik i ujërave sipërfaqësore	Është matje shkallës së përmbushjes së standarteve mjedisore për kimikate, të cilat përfshijnë substancat prioritare, substancat prioritare të rrezikshme dhe tetë ndotës të tjerë. Statusi kimik regjistrohet si 'i mirë' apo 'i dështuar'. Klasifikimi i statusit kimik për trupat ujorë, dhe besueshmëria në këtë (e lartë apo e ultë), përcaktohet me resultatin më të keq të testit	**Chemical Status (surface waters)**	Measure of degree of compliance with the environmental standards for chemicals, which include priority substances, priority hazardous substances and eight other pollutants. Chemical status is recorded as good or fails. The chemical status classification for the water body, and the confidence in this (high or low), is determined by the worst test result	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC Direktiva 2008/105/EC
Statusi i ruajtjes së llojeve	Tërësia e ndikimeve që veprojnë mbi llojet, të cilat mund të ndikojnë në shpërndarjen afatgjate të tyre dhe në begatinë e popullacioneve të tyre	**Conservation status (species)**	The sum of the influences acting on the species that may affect the long-term distribution and abundance of its populations	Probleme mjedisore	Direktiva 2004/35/CE , Direktiva 92/43/EEC
Statusi i ruajtjes së vendbanimeve natyrore (habitateve)	Tërësia e ndikimeve që veprojnë mbi një vendbanim natyror (habitat) dhe mbi llojet e tij tipike, të cilat mund të ndikojnë në shtrirjen e tij natyrore afatgjate, në strukturën dhe funksionet e tija, si dhe në mbijetesën afatgjate të llojeve të tij tipike	**Conservation status (natural habitat)**	The sum of the influences acting on a natural habitat and its typical species that may affect its long-term natural distribution, structure and functions as well as the long-term survival of its typical species	Probleme mjedisore	Direktiva 2004/35/CE , Direktiva 92/43/EEC

[44] **Status i mirë sasior i ujërave nëntokësore** - është statusi sasior i një trupi ujor nëntokësor që vlerësohet po aq "i mirë", siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 55, Legjislacioni i Shqipërisë**).

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Statusi i ujërave sipërfaqësore	Është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujor sipërfaqësor, që përcaktohet nga statusi i tij ekologjik dhe kimik më i varfër	**Surface water status**	The general expression of the status of a body of surface water, determined by the poorer of its ecological status and its chemical status	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Statusi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	**Statusi i ujërave sipërfaqësore** - është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujor sipërfaqësor, që përcaktohet nga statusi i tij ekologjik dhe kimik më i varfër **Statusi i ujërave nëntokësore** - është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujor nëntokësor, që përcaktohet nga statusi i tij sasior dhe kimik më i varfër	**Status (surface waters and groundwater)**	Status of a body of surface water, determined by the poorer of its ecological status and its chemical status, or for groundwater, determined by the poorer of its quantitative status and its chemical status	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Statusi sasior	Është një shprehje e shkallës deri në të cilën një trup ujor nëntokësor ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të ujërave	**Quantitative status**	An expression of the degree to which a body of groundwater is affected by direct and indirect abstractions	Status i trupave ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Stresi (tensioni) ujor	Kur kërkesa për ujë tejkalon sasinë e disponueshme gjatë një periudhe të caktuar ose kur cilësia e dobët e tij e kufizon përdorimin e tij	**Water stress**	When the demand for water exceeds the available amount during a certain period or when poor quality restricts its use	Menaxhim i ujërave	
Strukturë e ujëshkarkuesit	Mbron skajin e poshtëm të një tubi shkarkues nga erozioni, dhe shpeshherë është i projektuar për të ngadalësuar shpejtësinë e ujërave të shkarkuara për të parandaluar erozionin e kanalit të ujërrjedhës	**Outlet discharge structure**	Protects the downstream end of the outlet pipe from erosion and is often designed to slow down the velocity of released water to prevent erosion of the stream channel	Hidraulikë	
Studimi	Procesi i identifikimit të çështjeve kyçe mjedisore në kuadër të vlerësimit mjedisor të projekteve, planeve dhe programeve	**Scoping**	The process of identifying the key environmental issues in the context of environmental assessment of projects, plans and programmes	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2001/42/EC
Sublimim	Ndryshimi i gjendjes agregate të ujit nga gjendja e ngurtë në të gaztë	**Sublimation**	The change of state of water from solid directly to gas	Cilësi e ujërave	
Substanca	Paraqet çdo element kimik dhe komponimet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive	**Substance**	Any chemical element and its compounds, with the exception of radioactive substances	Ndotje	Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Substanca prioritare	Substanca të cilar paraqesin rrezik të konsiderueshëm për mjedisin ujor apo nëpërmjet mjedisit ujor, dhe të cilat prioritizohen në bazë të këtij rreziku me qëllim të ndërmarrjes së masave për ndërprerjen apo ndalimin e emisioneve, shkarkimeve dhe humbjeve të tyre	**Priority substances**	Substances which present a significant risk to or via the aquatic environment, and are prioritised for action on the basis of risk to or via the aquatic environment	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2008/105/EC
Substanca prioritare të rrezikshme	Substancat prioritare të rrezikshme (gjithsej 13) i takojnë listës së substancave prioritare dhe paraqesin substanca të cilat janë helmuese (toksike), persistente (të qëndrueshme) dhe me prirje për t'u bioakumuluar, bashkë me substancat e tjera që shfaqin rrezik të njëjtë. Emisionet, shkarkimet dhe humbjet e këtyre substancave duhet të ndërpriten apo të ndalohen	**Priority hazardous substances**	The priority hazardous substances (13) belong to the priority substance list and are substances which are toxic, persistent and likely to bioacumulate, and other substances which give rise to equal concern. The emissions, discharges and losses of these substances need to be ceased or phased out	Ndotje	Direktiva 2008/105/EC
Substanca të rrezikshme	Substanca apo grupe substancash, të cilat janë helmuese (toksike), persistente (të qëndrueshme) dhe me prirje për t'u bioakumuluar, si dhe substanca të tjera apo grupe të tjera substancash, të cilat shkaktojnë nivel të njëjtë të rrezikut	**Hazardous substances**	Substances or groups of substances that are toxic, persistent and liable to bio-accumulate, and other substances or groups of substances which give rise to an equivalent level of concern	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2006/118/EC, Direktiva 2010/75/EU
Substanca teratogjene (reprotoksike)	Substancat dhe preparatet të cilat nëse nuhaten apo gëlltiten, apo nëse e depërtojnë lëkurën, mund të shkaktojnë malformacione kongjenitale johereditare (jo të trashëgueshme) ose mund të rrisin incidencën e tyre	**Toxic for reproduction**	Substances and preparations which, if they are inhaled or ingested or if they penetrate the skin, may induce non-hereditary congenital malformations or increase their incidence	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Substancë e rrezikshme	Substanca të klasifikuara në një apo disa klasa të rrezikut, të cilat e karakterizojnë llojin dhe seriozitetin e efekteve negative që i shkaktojnë. Paketimi i substancave të rrezikshme i mbron individët nga rreziqet e njohura të një substance, ndërsa etiketimi i substancave të rrezikshme jep informata për natyrën e rreziqeve të substancës si dhe për masat e sigurisë që duhen aplikuar gjatë përdorimit të tyre dhe manipuitmit me to	**Dangerous substance**	Substances classified into one or several defined classes of danger and can characterise the type and severity of the adverse effects that they can cause. The packaging of dangerous substances protects individuals from their known risks, and the labelling of dangerous substances provides information about the nature of the substance's risks and about the safety measures to apply during handling and use	Ndotje	Direktiva 2012/18/EU
Suspension koloidal	Përzierje ku grimcat shumë të imta të një komponenti (ndërmjet 10-5 deri 10-7 inç në diametër) janë të shpërndara në një gaz apo lëng	**Colloidal suspension**	Mixture in which very small particles of one component (in the range of 10-5 to 10-7 in diameter) are dispersed throughout a gas or liquid	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.24 SHsh

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Shërbime të ujit	Janë të gjitha shërbimet që sigurojnë për ekonomitë familjare, institucionet publike apo për çfarëdo veprimtarie ekonomike: nxjerrjen, mbajtjen, ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore; impiantet për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujërat sipërfaqësore	**Water services**	All services which provide, for households, public institutions or any economic activity, the following: abstraction, impoundment, storage, treatment and distribution of surface water or groundwater and waste-water collection and treatment facilities which subsequently discharge into surface water	Menaxhim i ujërave	Direktiva 2000/60/EC
Shërbimet e resurseve (burimeve) natyrore	Funksionet e kryera nga një resurs (burim) natyror (shihni përkufizimin për 'Natural Resource' - 'Resurset natyrore') në dobi të një resursi tjetër natyror apo në dobi të publikut	**Natural resources services**	Functions performed by a natural resource for the benefit of another natural resource or the public	Analizë ekonomike	Direktiva 2004/35/CE
Shi	Ujë i cili kondensohet nga avujt atmosferik të ujit dhe bie në tokë në formë pikash me diametër prej më shumë se 0.5 mm (1/50 e inçit)	**Rain**	Water that is condensed from the aqueous vapor in the atmosphere and falls to earth in drops more than 1/50 inch (0.5 mm) in diameter	Menaxhim i ujërave	
Shi acidic	Shiu i cili ka nivel jashtëzakonisht të ultë të pH-së, si pasojë e kontaktit me ndotësit atmosferik siç janë oksidet e squfurit	**Acid rain**	Rain that has a flamboyantly low pH, due to contact with atmospheric pollutants such as sulphuric oxides	Objektiva mjedisore	
Shkalla e desulfurimit	Paraqet raportin, për një periudhë të caktuar kohore, në mes të sasisë së squfurit i cili nuk emetohet në ajër nga një impiant djegës dhe të sasisë së squfurit që gjendet në lëndën djegëse të ngurtë e cila futet në pajisjet e impiantit djegës dhe e cila përdoret në impiant gjatë po kësaj periudhë kohore	**Rate of desulphurisation**	The ratio over a given period of time of the quantity of sulphur which is not emitted into air by a combustion plant to the quantity of sulphur contained in the solid fuel which is introduced into the combustion plant facilities and which is used in the plant over the same period of time	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Shkarkim	Vëllimi i ujërave që kalojnë nëpër një lokacion të caktuar brenda një periudhe të caktuar kohore	**Discharge**	The volume of water that passes a given location within a given period of time	Trupa ujorë	
Shkarkim (në Shqipëri - çlirim)	Çdo futje e ndotësve në mjedis si rezultat i veprimtarisë së njeriut, qoftë kjo e qëllimtë apo e paqëllimtë, rutinore apo jorutinore, që përfshinë derdhjen, emetimin, shkarkimin, injektimin, deponimin (asgjësimin) apo hedhjen, apo nëpërmjet të sistemeve të kanalizimit pa u bërë trajtimi përfundimtar i ujërave të ndotura	**Release**	Any introduction of pollutants into the environment as a result of any human activity, whether deliberate or accidental, routine or non-routine, including spilling, emitting, discharging, injecting, disposing or dumping, or through sewer systems without final waste water treatment	Ndotje	Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Shkarkim (në kontekst të ndotjes)	Lirimi i substancave ndotëse, nga burimet pikore (individuale) apo difuze (të shpërndara) të ndotjes, nëpërmjet të efluentit drejtpërsëdrejti apo jo-drejtpërsëdrejti në mjedis	**Discharge (pollution)**	The release of polluting substances from individual or diffuse sources through effluent directly or indirectly into environment	Vlerësim i presioneve	Direktiva 2000/60/EC
Shkarkim i drejtpërdrejtë në ujërat nëntokësore	Shkarkim i ndotësve në ujërat nëntokësore pa u filtruar nëpër tokë apo nëntokë	**Discharge (direct to groundwater)**	Discharge of pollutants into groundwater without percolation throughout the soil or subsoil	Vlerësim i presioneve	Direktiva 2000/60/EC
Shkarkim i ujërave të ndotura	Ujërat e ndotura që shkarkohen në një pikë të caktuar brenda një periudhe kohore	**Discharge (of waste water)**	Waste water that is evacuated to a given point within a period of time	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Shkarkim i ujërave të rrebeshta (të rrëmbyeshme)	Reshjet të cilat nuk depërtojnë nën tokë dhe nuk avullojnë për shkak të sipërfaqeve tokësore të papërshkueshme, por që rrjedhin nëpër sipërfaqet e afërta të tokës apo ujit, dhe që më pas drejtohen për në sistemet e drenimit/sistemet e kolektorëve	**Storm discharge**	Precipitation that does not infiltrate into the ground or evaporate due to impervious land surfaces but instead flows onto adjacent land or water areas and is routed into drain/sewer systems	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Shkarkim zero i ujërave të ndotura	Nënkupton ripërdorimin e efluentit nga një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura, në vend të shkarkimit të tij në një mjedis ujor	**Zero discharge water**	Expression that implies the reuse of the effluent from a waste water treatment plant instead of being discharged into the water environment	Ndotje	
Shkretëzim	Stadi përfundimtar në procesin e degradimit jonatyror të tokës, ku pjelloria e tokës është shkatërruar plotsisht dhe në mënyrë të pakthyeshme	**Desertification**	The ultimate stage in the process of unnatural land degradation, when the fertility of the the soil has been completely and irreversibly destroyed	Probleme mjedisore	
Shkripëzim	Largimi nga një tretësir ë si p.sh. nga uji, i lëndëve të ngurta (kripërave) inorganike të tretura në të, për ta pastruar atë nga to. Normalisht kjo arrihet përmes osmozës reverse, distilimit apo elektrodializës	**Desalination**	The removal of dissolved inorganic solids (salts) from a solution such as water to make it free of dissolved salts. Typically accomplished by reverse osmosis, distillation, or electrodialysis	Furnizim me ujë	
Shpenzimi kimik i oksigjenit-SHKO	Sasia e oksigjenit e cila shpenzohet në oksidimin e materieve organike dhe materieve inorganike të oksidueshme, në kushte prove, e shprehur në mg/l. Përdoret për matjen e sasisë së përgjithshme të ndotjes organike dhe inorganike në ujërat e ndotura	**Chemical Oxygen Demand (COD)**	The amount of oxygen (measured in mg/L) that is consumed in the oxidation of organic and oxidisable inorganic matter, under test conditions. It is used to measure the total amount of organic and inorganic pollution in waste water.	Ndotje	
Shpeshtësia e monitorimit	Përzgjedhja e shpeshtësisë së marrjes së mostrave (mostrimit) është njëra prej detyrave më të rëndësishme në përpilimin e një programi rregullator të monitorimit të cilësisë së ujërave me qëllim të zbulimit të shkeljeve (mosrespektimit) të standardeve të cilësisë së ujërave	**Monitoring frequency**	Selecting the sampling frequency is one of the most important tasks in the design of a regulatory water quality monitoring program, aiming to detect violations of water quality standards.	Cilësi e ujërave	
Shpëlarës i gurëve ranor; Klasifikues (klasifikator) i gurëve ranor	Pajisje e cila përdoret në procesin e largimit të gurëve ranor në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, ku lëndët organike ndahen prej grimcave minerale. Pas largimit të lëndëve organike në shpëlarësit e gurëve ranor, gurët ranor të pastër largohen përmes një helike klasifikuese, iu hiqet uji në mënyrë statike dhe shkarkohen në një kontejner	**Grit washer; grit classifier**	Device used in the process of grit removal in a waste water treatment plant, in which the organics are separated from the mineral particles. After removal of the organic material in the grit washers, the clean grit is removed through a classifying screw, statically dewatered and discharged into a container	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shpëlarja e parë e rrebeshtë	Pjesa e parë e rrjedhjes së ujërave të rrebeshta të shiut. Në fazat e hershme të një stuhie, rrjedhja e ujërave të rrëmbyeshëm të shiut nëpër kolektorët e ujërave të ndotura do t'i shpërlajë ndotësit e grumbulluar në sipërfaqe apo lëndët e ngurta të fundërruara në kolektor, etj. Si rezultat shpëlarja e pare e rrebeshtë mund të jetë tejet e ndotur	**First flush**	First part of the storm flow[45]. In the early stages of a storm, the stormwater flow in the sewer will wash off pollutants accumulated on the surface or flush out solids that have settled in the sewer etc. Consequently, the first flush may be heavily polluted	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shpyllëzim	Largimi i një pylli apo i një grumbulli pyjor[46] me që rast toka pyjore shndërrohet në tokë për përdorim jopyjor	**Deforestation**	The removal of a forest or stand of trees where the land is thereafter converted to a non-forest use	Probleme mjedisore	
Shqyrtim mjedisor (në Shqipëri - analizë mjedisore)	Një analizë fillestare gjithëpërfshirëse e aspekteve mjedisore, ndikimeve mjedisore dhe e performancës mjedisore në lidhje me aktivitetet, produktet dhe shërbimet e një organizate	**Environmental review**	An initial comprehensive analysis of environmental aspects, environmental impacts and environmental performance related to an organisation's activities, products and services	Masat	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009
Shtangësi diametrale e një gypi (tubi)	Karakteristike për një gyp (tub), çka i mundëon atij t'i rezistojë defleksionit diametral gjatë ngarkimit (mbushjes)	**Diametral stiffness (of a pipe)**	Characteristic of a pipe which allows it to resist diametral deflection under loading	Furnizim me ujë	

[45] **Stormflow** - the runoff of surfacewater from rainfall; **Ujëra të rrebeshta (të rrëmbyeshme)** - rrjedhja sipërfaqësore e ujërave nga reshjet

[46] **Grumbull pyjor** - është një sipërfaqe pyjore, homogjene nga pikëpamja e përbërjes së llojeve, moshës, klasës së prodhimit, dendësisë, kushteve mjedisore dhe mënyrës së trajtimit silvikulturor (**Ligji Nr.9385 për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor të Republikës së Shqipërisë, Neni 2, paragrafi 8**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Shtrat	Në masë grimcash rrëshire jonoshkëmbyese apo lëndësh filtruese që i përmban një shtyllë (kolonë) që përdoret për trajtimin e ujit të pijshëm	**Bed**	A mass of ion exchange resin particles or filter media contained in a column used for drinking water treatment	Ujë i pijshëm	
Shtrat (Lumë)	Sipërfaqja e fundit të një lumi apo kanali	**Bed (river)**	The surface of the bottom of a river or channel	Trupa ujorë	
Shtrat (shtresë) bakteresh	Një shtresë rëre apo zhavorri që përdoret për ta ekspozuar në ajër si dhe për t'ia nënshtruar veprimit të mikroorganizmave efluentin e ujërave të ndotura shtëpiake në fazat e tij përfundimtare	**Bacteria bed**	A layer of sand or gravel used to expose sewage effluent, in its final stages, to air and the action of microorganisms	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shtrat biologjik i fluidizuar (pseudo-lëngështuar)	Proces i trajtimit biologjik të ujërave ku uji ose uji i ndotur kalon nëpër një rezervuar (pellg, basen) i cili përmban një shtresë të hollë lëndësh të ngurta, si psh rërë ose karbon aktiv, mbi të cilën rritet biomasa. Në trajtimin e ujërave të ndotura ky proces mund të zhvillohet në kushte anaerobe për trajtimin e ujërave me ngarkesë të lartë ndotëse, gjithashtu mund të zhvillohet në kushte anoksike (në mungesë të oksigjenit) për denitrifikimin e efluentëve të ujërave të ndotura	**Biological fluidised (fluidized) bed**	The process of biological treatment of waters in which the water or waste water moves through a basin which contains a thin layer of solid material such as sand or activated carbon over which biomass is grown. In the treatment of waste waters this process can occur under anaerobic conditions for the treatment of high-polluting waters, also it can occur under anoxic conditions for denitrification of effluents of contaminated waters	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shtrat i fluidizuar	Dukuri fizike që ndodh kur një sasi e një substance të ngurtë me natyrë grimcore (zakonisht e pranishme në një enë mbajtëse) vendoset në kushte të përshtatshme për të shtyrë që një përzierje e ngurtë/lëngët të sillet si një fluid	**Fluidized bed**	Physical phenomenon occurring when a quantity of a solid particulate substance (usually present in a holding vessel) is placed under appropriate conditions to cause a solid/fluid mixture to behave as a fluid	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shtrat i shtresës	Masivi i shkëmbit që shtrihet nën tokë, sedimentet e lirshme (të shkrifta), apo lëndët e tjera të pangurtësuara (të shkrifta)	**Bedrock**	The solid rock that lies beneath soil, loose sediments, or other unconsolidated material	Trupa ujorë	
Shtrat i tharjes së lymit (llumit)	Një sipërfaqe e hapur në të cilën hidhet lymi për tu tharë, e cila paraqet një lagunë drejtkëndëshe me dysheme prej betoni dhe e rrethuar me mure rreth 0.9 metra të larta, e cila përmban tuba të perforuar drenazhues që shtrihen mbi dyshemenë e saj të betonit, e ndonjëherë përmban edhe një valvul dekantimi	**Sludge drying bed**	An open area consisting of rectangular, concrete floored lagoons surrounded by walls (around 0.9 m high) and provided with land drains over the concrete, sometimes also with a decanting valve, for drying the digested sludge	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shtresë mbuluese (ngjyrë mbrojtëse)	Çfarëdo preparati, duke përfshirë të gjithë tretësit organik apo preparatet që përmbajnë tretës organik të nevojshëm për aplikimin adekuat të saj, që përdoret si film (shtresë) me efekt dekorativ, mbrojtës apo ndonjë efekt tjetër funksional mbi një sipërfaqe	**Coating**	Any preparation, including all the organic solvents or preparations containing organic solvents necessary for its proper application, which is used to provide a film with decorative, protective or other functional effect on a surface	Industri	Direktiva 2010/75/EU, Direktiva 2004/42/EC
Shtresë filtruese (fushë filtrimi)	Një rezervuar apo pellgore që përmban një shtresë rëre apo zhavorri, që përdoret për të filtruar sasi të mëdha lëngu	**Filter bed**	A tank or pond containing a layer of sand or gravel, used for filtering large quantities of liquid	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Shtresëzim (stratifikim)	Ndarja vertikale në shtresa e trupave ujorë, ku këto shtresa kanë karakteristika të ndryshme të shkaktuara nga temperatura dhe densiteti i ndryshëm i tyre	**Stratification**	Vertical separation of water bodies into layers with different characteristics caused by different temperature and density of the layers	Menaxhim i ujërave	
Shtypje intersticiale	Shtypja intersticiale e ujit përbrenda një mase dheu, shkëmbinjsh, apo betoni, konkretisht në poret (zbrazëtitë) ndërmjet grimcave përbërëse të tyre	**Pore pressure**	The interstitial pressure of water within a mass of soil, rock, or concrete in gaps between particles	Hidraulikë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Shtypje parciale	Shtypja e cila do të ushtrohejë nga njëri prej gazeve në përbërje të një përzierje, në qoftë se ai gaz si i vetëm do të zinte të njëjtin vëllim me atë të përzierjes. Sipas Ligjit të Daltonit për shtypjet parciale, shtypja totale e një përzierjeje të gazeve është e barabartë me shumën e shtypjeve parciale të gazeve përbërëse të saj	**Partial pressure**	The pressure that would be exerted by one of the gases in a mixture if it occupied the same volume on its own. Dalton's law of partial pressures states that the total pressure of a mixture of gases is the sum of the partial pressures of its components	Hidraulikë	
Shtypje (trysni) pompuese	Energjia që i jepet një fluidi me anë të një pompe, që zakonisht shprehet në metra të lartësisë së fluidit që pompohet	**Pumping head**	Energy given to a fluid by a pump, usually expressed in meters of fluid	Hidraulikë	
Shumë të ndezshme	Substancat dhe preparatet e lëngshme që kanë pikë të ndezjes nën 21 °C (përfshirë lëngjet jashtëzakonisht të ndezshme); apo substancat dhe preparatet të cilat mund të nxehen dhe në fund të ndizen (të marrin flakë) në kontakt me ajrin në temperaturë të mjedisit pa aplikuar fare energji; apo-substancat dhe preparatet e ngurta të cilat mund të ndizen lehtë pas kontaktit të shkurtë me një burim të ndezjes dhe që vazhdojnë të digjen apo të konsumohen edhe pas largimit të burimit të ndezjes; apo substancat dhe preparatet e gazta të cilat janë të ndezshme në ajër në presion normal; apo substancat dhe preparatet të cilat, në kontakt me ujin apo me ajrin e njomë, evoluojnë në gazra jashtëzakonisht të ndezshme në sasi të rrezikshme	**Highly flammable**	Liquid substances and preparations having a flash point below 21 °C (including extremely flammable liquids); or substances and preparations which may become hot and finally catch fire in contact with air at ambient temperature without any application of energy; or solid substances and preparations which may readily catch fire after brief contact with a source of ignition and which continue to burn or to be consumed after removal of the source of ignition; or gaseous substances and preparations which are flammable in air at normal pressure; or substances and preparations which, in contact with water or damp air, evolve highly flammable gases in dangerous quantities	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

4.25 Tt

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Tarifë	Tarifa e ujit paraqet çmimin e caktuar për ujin me të cilin furnizohen konsumatorët nga një ndërmarrje (kompani) publike nëpërmjet rrjetit të saj shpërndarës. Po i njëjti term po ashtu aplikohet edhe për tarifat e ujërave të ndotura	**Tariff**	A water tariff is a price assigned to water supplied by a public utility through a piped network to its customers. The term is also often applied to wastewater tariffs	Analizë ekonomike	
Tarifimi i ujit	Caktimi i çmimit të ujit është instrument kyç i cili përdoret për të mbështetur vendimet lidhur me menaxhimin e ujërave; për të kthyer koston e shërbimeve të ujit si mënyrë e promovimit të përdorimit efiçient dhe të qëndrueshëm të ujerave	**Water pricing**	Setting the price of water is a key tool used to support water management decisions; to recover the cost of water services as a means of promoting sustainable and efficient water use	Analizë ekonomike	
Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD)	Është stadi më efektiv dhe më i avancuar i zhvillimit të aktiviteteve dhe i metodave të tyre të operimit, që tregon për përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar bazën për vlerat kufizuese të emisionit (në Shqipëri - vlerat kufizuese të shkarkimit) dhe për kushtet e tjera të lejes, të përcaktuara për të parandaluar dhe, kur kjo nuk është e mundshme praktikisht, për të reduktuar emisionet (në Shqipëri -shkarkimet) dhe ndikimin në mjedis në tërësi	**Best Available Techniques (BAT)**	The most effective and advanced stage in the development of activities and their methods of operation which indicates the practical suitability of particular techniques for providing the basis for emission limit values and other permit conditions designed to prevent and, where that is not practicable, to reduce emissions and the impact on the environment as a whole	Industri	Direktiva 2010/75/EU
Teknikë e re	Është një teknikë e re për një aktivitet industrial që, nëse zhvillohet komercialisht, mund të sigurojë qoftë një nivel të përgjithshëm më të lartë të mbrojtjes së mjedisit apo së paku një nivel të njejtë mbrojtjeje mjedisore dhe kursim më të lartë në shpenzime sesa teknikat më të mira të mundshme (të disponueshme) ekzistuese	**Emerging technique**	A novel technique for an industrial activity that, if commercially developed, could provide either a higher general level of protection of the environment or at least the same level of protection of the environment and higher cost savings than existing best available techniques	Ndotje	Direktiva 2010/75/EU
Terrikon (pirg hedhurinash)	Një objekt inxhinierik për depozitimin e mbeturinave (mbetjeve) të ngurta në sipërfaqe	**Heap**	An engineered facility for the deposit of solid waste on the surface	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC
Test i pompimit	Testi i pompimit është një eksperiment i cili realizohet në terren, në të cilin një pus pompohet nën një ritëm të kontrolluar dhe ku reaksioni i përgjigjes së nivelit të ujit (boshatisjes së pusit) matet në një apo më shumë puse vrojtuese që gjenden përreth, si dhe në mënyrë opsionale mund të matet edhe në vet pusin e pompuar. Të dhënat e fituara nga testet e pompimit shfrytëzohen për të vlerësuar cilësitë hidraulike të akuiferëve, performancën e puseve, si dhe për përcaktimin e kufijve të akuiferëve	**Pumping test**	A pumping test is a field experiment in which a well is pumped at a controlled rate and water-level response (drawdown) is measured in one or more surrounding observation wells and optionally in the pumped well (control well) itself; response data from pumping tests are used to estimate the hydraulic properties of aquifers, evaluate well performance and identify aquifer boundaries	Monitorim	
Testi Kubel	Test për të analizuar përqendrimet e ulëta të lëndëve organike në ujë, siç është zierja e ujit me permanganat kaliumi për 10 minuta. Vlera është rreth 3-fish më e lartë sesa ajo që përfitohet nga zierja për 4 orë në temperaturë 27 °C	**Kubel test**	Test to analyze low concentrations of organic substances in water, such as potassium permanganate water for 10 minutes. The value is about 3-fold higher than that obtained by craving for 4 hours at a temperature of 27 ° C	Ndotje	
Të dëmshme	Substancat dhe preparatet të cilat po qe se nuhaten apo gëlltiten, apo nëse e depërtojnë lëkurën, mund të paraqesin rreziqe të kufizuara për shëndetin	**Harmfull**	Substances and preparations which, if they are inhaled or ingested or if they penetrate the skin, may involve limited health risks	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Të ndezshme	Substancat dhe preparatet e lëngshme që kanë pikë të ndezjes të barabart me apo më të madhe se 21°C, dhe më të vogël apo të barabart me 55°C	**Flammable**	Liquid substances and preparations having a flash point equal to or greater than 21 °C and less than or equal to 55 °C	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Tipat e vendbanimeve (habitateve) natyrore me prioritet	Tipat e vendbanimeve (habitateve) natyrore në rrezik zhdukjeje, për ruajtjen e të cilave Komuniteti Evropian ka përgjegjësi të posaçme duke marrë parasysh proporcionin e shtrirjes së tyre natyrore	**Natural habitat types (priority)**	Natural habitat types in danger of disappearance and for the conservation of which the European Community has particular responsibility in view of the proportion of their natural range	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Tipat e vendbanimeve (në Shqipëri - habitateve) natyrore me interes për Komunitetin Evropian	Vendbanimet (habitatet) të cilat, brenda territorit të një Shteti, janë në rrezik zhdukjeje në shtrirjen e tyre natyrore; apo kanë një shtrirje të vogël natyrore si pasojë e regresit të tyre ose sipërfaqes së tyre të kufizuar; apo përfaqësojnë shembuj të jashtëzakonshëm të karakteristikave tipike të një apo disa prej pesë rajoneve biogjeografike në vijim: rajoni Alpin, Atlantik, Kontinental, Makaronezian dhe Mesdhetar	**Natural habitat types of Community interest**	Those which, within the territory of a State, are in danger of disappearance in their natural range; or have a small natural range following their regression or by reason of their intrinsically restricted area; or present outstanding examples of typical characteristics of one or more of the five following biogeographical regions: Alpine, Atlantic, Continental, Macaronesian and Mediterranean	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Toksike	Substancat dhe preparatet (përfshirë substancat dhe preparatet shumë toksike), të cilat nëse nuhaten apo gëlltiten apo nëse e depërtojnë lëkurën, mund të paraqesin rreziqe serioze, akute apo kronike për shëndetin e njeriut përfshirë edhe vdekjen	**Toxic**	Substances and preparations (including very toxic substances and preparations) which, if they are inhaled or ingested or if they penetrate the skin, may involve serious, acute or chronic health risks and even death	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Torfë	Lëndë me ngjyrë të murrme në të zezë, që paraqet një grumbullim në shtresa të ngjeshura të mbeturinave të bimëve apo lëndëve organike pjesërisht të kalbura, të cilat janë unike për zonat natyrore të quajtura toka torfike, këneta torfike, moçale, shqopishte (këneta me shqopë, strugë), apo në troje torfike të lëngëta (këneta liqenore). Ekosistemi i tokave torfike paraqet absorbuesin (thithësin) më efiçient të karbonit në planetin tonë, sepse bimët e tokave torfike e kapin dioksidin e karbonit i cili më pas lirohet nga torfa në mënyrë natyrore	**Peat**	An accumulation of partially decayed vegetation or organic matter that is unique to natural areas called peatlands, bogs, mires, moors, or muskegs. The peatland ecosystem is the most efficient carbon sink on the planet because peatland plants capture the CO2 which is naturally released from the peat	Zona të mbrojtura	
Trajtim	Proceset mekanike, fizike, biologjike, termike apo kimike, apo kombinimi i proceseve që aplikohen në lëndët apo lëngjet (p.sh. burimet minerare, mbeturinat (mbetjet) e ngurta, ujërat e ndotura, etj.), të cilat i ndryshojnë karakteristikat e tyre me qëllim të zvogëlimit të vëllimit të tyre dhe përqendrimit të ndotësve në to, apo me qëllim të ndryshimit të karakterit të rrezikshëm të tyre, lehtësimit të manovrimit me to apo për të shtuar rikuperimin e tyre	**Treatment**	The mechanical, physical, biological, thermal or chemical process or combination of processes carried out on materials or liquids (e.g. mineral resources, solid waste, waste water, etc.), that change its characteristics in order to reduce its volume, concentrations of pollutants or hazardous nature, facilitate its handling or enhance recovery	Masat	
Trajtim biologjik	Cilido proces i trajtimit të ujërave të ndotura në të cilin përdoren mikroorganizmat për largimin e ndotësve të padëshiruar organik dhe inorganik	**Biological treatment**	Any waste water treatment process that uses microorganisms to remove unwanted organic and inorganic pollutants	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Trajtim biologjik aerob	Çdo proces i trajtimit të ujërave të ndotura që përdor mikroorganizmat aerob për biodegradimin apo largimin e komponimeve (bashkëdyzimeve) organike dhe inorganike	**Aerobic biological treatment**	Any waste water treatment process using aerobic microorganisms for biodegradation or removal of organic and inorganic compounds	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Trajtim dytësor[47]	Është trajtimi i ujërave të ndotura urbane me anë të një procesi fizik dhe/apo kimik që përfshin fundërrimin e lëndëve të ngurta të suspenduara (pezullive), apo proceset e tjera ku $SHBO_5$ (BOD_5) i ujërave të ndotura hyrëse zvogëlohet për së paku 20% përpara se ato të shkarkohen (mirëpo, përgjithësisht $SHBO_5$ (BOD_5) zvogëlohet për 80 deri në 95%), dhe ku lëndët e ngurta totale të suspenduara të ujërave të ndotura hyrëse reduktohen për së paku 50%. Lymi (llumi) aktiv dhe biofiltrat janë dy prej metodave më të shpeshta të trajtimit dytësor	**Secondary treatment**	Treatment of urban waste water by a physical and/or chemical process involving settlement of suspended solids, or other processes in which the BOD_5 of the incoming waste water is reduced by at least 20 % (but generally removes 80 to 95 %) before discharge and the total suspended solids of the incoming waste water are reduced by at least 50 %. Activated sludge and trickling filters are two of the most common means of secondary treatment	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Trajtim i duhur	Çdo proces dhe/apo sistem shkarkues, i cili bënë që mjediset (ujërat) pritëse edhe pas shkarkimit t'i plotësojnë objektivat përkatëse të cilësisë, si dhe dispozitat përkatëse të parapara me legjislacion	**Appropriate treatment**	Any process and/or disposal system which after discharge allows the receiving waters to meet the relevant quality objectives and the relevant provisions of legislation	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Trajtimi fiziko-kimik (i ujërave të ndotura)	Proces i trajtimit të ujërave të ndotura i cili fokusohet kryesisht në ndarjen (separimin) e grimcave koloidale. Kjo arrihet përmes shtimit të kimikateve të quajtura koagulues (ngjizës) dhe flokulues (flokëformues), të cilat e ndryshojnë gjendjen fizike të koloideve duke lejuar që ato për kohë të pacaktuar të mbesin në formë stabile, për të formuar më pas grimca apo flokë me tipare sedimetuese. Ky proces fiziko-kimik përbëhet nga faza e koagulimit (ngjizjes), flokulimit (flokëformimit) dhe nga faza e sedimentimit	**Physico-chemical treatment (waste water)**	Process of waste water treatment that focuses primarily on the separation of colloidal particles. This is achieved through the addition of chemicals (called coagulants and flocculants). These change the physical state of the colloids allowing them to remain in an indefinitely stable form and therefore form into particles or flocs with settling properties. The physico-chemical process consists of coagulation, flocculation and sedimentation stages	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Trajtim i ujërve të ndotura në vendgjenerimin e tyre	Sistem me anë të së cilit ujërat e ndotura që gjenerohen, trajtohen lokalisht përmes gropave septike, shtretërve të tharjes, shtretërve me kallamishte, etj. apo ato trajtohen në vendgjenerimin e tyre si p.sh. në një vendndodhje industriale	**On-site treatment of waste water**	System by which the waste water is treated locally by septic tanks, drying beds, reed beds, etc. or the treatment at source such as on an industrial site	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Trajtim kimik	Trajtimi i ujërave duke përdorur kimikate në proceset si koagulimi (ngjizja), rregullimi i pH-së, precipitimi i metaleve të rënda, precipitimi i fosfateve, dezinfektimi me klor ose ozon, kondicionimi i lymit (llumit) etj.	**Chemical treatment**	Treatment of water by using chemicals in processes such as coagulation, pH regulation, precipitation of heavy metals, precipitation of phosphates, chlorine or ozone disinfection, sludge conditioning, etc	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Trajtim paraprak (paratrajtim)	Çdo trajtim i ujërave të ndotura I cili i paraprin sedimentimit primar, që pjesërisht ka për qëllim largimin e çdo gjëje që do të pengonte procesin pasues të trajtimit të tyre. Varësisht nga cilësia e ujërave që do të trajtohen, një varg procesesh mund të jenë të nevojshme, përfshirë (a) filtrimin me sitë me grila apo vrima të madhësive të ndryshme, (b) kullimin (filtrimin) përmes sitës cilindrike (sitës në formë tamburi), (c) largimin e gurëve ranor (rërës), (d) veçimin e yndyrave, etj.	**Preliminary treatment (pre-treatment)**	Any treatment of waste water that precedes primary sedimentation, partly aimed to remove anything that could hamper subsequent treatment processes. Depending on the quality of the water to be treated, several processes could be required, including screening, straining with a drum, grit removal, fat separation, etc.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

[47] **Trajtim dytësor** - nënkupton trajtimin e ujërave të ndotura urbane me anë të proceseve të përgjithshme përfshirë trajtimin biologjik me procese sekondare apo procese të tjera (**UA Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor, Neni 4, paragrafi 1.14, Legjislacioni i Kosovës**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Trajtim parësor (i ujërave të ndotura)	Është trajtimi i ujërave të ndotura urbane me anë të një procesi fizik dhe/apo kimik që përfshin sedimentimin e materieve të ngurta të suspenduara (pezullive), apo proceseve të tjera në të cilat $SHBO_5$ (BOD_5) e ujërave të ndotura hyrëse reduktohet me së paku 20% përpara shkarkimit, dhe totali i materieve të ngurta të suspenduara (pezullive) të ujërave të ndotura hyrëse reduktohet me së paku 50%	**Primary waste water treatment**	Treatment of urban waste water by a physical and/or chemical process involving settlement of suspended solids, or other processes in which the BOD5 of the incoming waste water is reduced by at least 20 % before discharge and the total suspended solids of the incoming waste water are reduced by at least 50 %	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Trajtim terciar	Është trajtimi i ujërave të ndotura urbane për largimin e elementeve të padëshiruara siç janë lëndët e ngurta inorganike (SS), NKO (Nevoja Kimike për Oksigjen), komponimet e fosforit, si dhe komponimet specifike (pesticidet, metalet, detergjentet, etj.). Ky trajtim është i paraparë të përmirësojë cilësinë e ujërave të pastruara, ashtu që ato të mund të shkarkohen në mjedisin natyror apo të ripërdoren	**Tertiary treatment**	Treatment of urban waste water to remove unwanted elements such as SS, COD (solid and colloidal), phosphorus and specific compounds (pesticides, metals, detergents, etc.). It is designed to improve the quality of purified water so that it can be discharged into the natural environment or re-used	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Transferim jashtë vendndodhjes	Zhvendosja përtej kufijve të një objekti (impianti): (a) i ndotësve apo i mbeturinave (në Shqipëri - mbetjeve) të destinuara për rikuperim apo deponim (në Shqipëri - asgjësim), dhe (b) i ndotësve në ujërat e ndotura të destinuara për trajtim	**Off-site transfer**	The movement beyond the boundaries of a facility of either pollutants orwaste destined for recovery or disposal and of pollutants in waste water destined for waste-water treatment	Ndotje	Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Trend-në-rritje i konsiderueshëm dhe i qëndrueshëm	Çdo rritje e konsiderueshme statistikore dhe mjedisore e përqendrimit të një ndotësi, grupi ndotësish, apo treguesi të ndotjes në ujërat nëntokësore për të cilat përmbysja e këtij trendi është identifikuar të jetë e nevojshme	**Significant and sustained upward trend**	Any statistically and environmentally significant increase of concentration of a pollutant, group of pollutants, or indicator of pollution in groundwater for which trend reversal is identified as being necessary	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2006/118/EC
Tregues niveli (nivelmatës)	Pajisje për matjen e thellësisë së ujit në puse, vrima shpimi, tuba vertikal (tuba ushqyes të kolonave të ujit) dhe në rezervuare	**Level meter**	Device to measure the depth to water in wells, boreholes, standpipes, and tanks	Hidraulikë	
Tretës	Lëngu, zakonisht uji, në të cilin gjenden lëndët e tretura, një substancë e cila i tret substancat e tjera ashtu që formon një tretësirë	**Solvent**	The liquid, usually water, in which solutes are dissolved, a substance that dissolves other substances, thus forming a solution	Cilësi e ujërave	
Tretës organik	Çdo tretës me bazë karboni, i cili në strukturën e vet përmban atome të karbonit, dhe është i aftë të tret substancat e tjera. I cili përdoret: (a) si i vetëm apo në kombinim me agjent të tjerë, pa iu nënshtruar asnjë ndryshimi kimik, për tretjen e lëndëve të para, produkteve apo materialeve mbeturinë (mbetje); (b) si lëndë kulluese për tretjen e papastërtive; (c) si tretës; (d) si mjedis shpërhapës (shpërndarës); (e) si rregullues viskoziteti; (f) si rregullues i tensionit sipërfaqësor; (g) si plastifikues; (h) si lëndë konservuese	**Organic solvent**	Any carbon-based solvent, which have carbon atoms present in the structure, and are capable of dissolving other substances. It is used alone or in combination with other agents, and without undergoing a chemical change, to dissolve raw materials, products or waste materials; as a cleaning agent to dissolve contaminants; as a dissolver; as a dispersion medium; as a viscosity adjuster; as a surface tension adjuster; as a plasticiser and as a preservative	Industri	Direktiva 2010/75/EU
Tretje (zbërthim) aerobe	Një proces bakterial i trajtimit të ujërave të ndotura në prani të oksigjenit, i dizajnuar për zvogëlimin e vëllimit të lymit (llumit) të ujërave të ndotura ashtu që të jetë i përshtatshëm për përdorim të mëtejmë	**Aerobic digestion**	A bacterial process of waste water treatment in the presence of oxygen designed to reduce the volume of sewage sludge to be suitable for subsequent use	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Trup ujor artificial	Është një trup ujor sipërfaqësor i krijuar nga veprimtaria njerëzore	**Artificial water body**	Body of surface water created by human activity	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Trup ujor i modifikuar rëndë [48]	Është një trup ujor sipërfaqësor, i cili si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor ndryshon rrënjësisht karakterin e tij. Trupat ujor sipërfaqësorë brenda rajonit të pellgut lumor (në Shqipëri - rajonit te basenit ujor) klasifikohen në njërën prej kategorive në vijim të ujërave sipërfaqësorë - lumenj, liqene, ujëra kalimtare apo ujëra bregdetare - apo si trupa ujorë artificial apo trupa ujorë të modifikuar konsiderueshëm	**Heavily modified water body**	Body of surface water which as a result of physical alterations by human activity is substantially changed in character. The surface water bodies within the river basin district are identified as falling within either one of the following surface water categories - rivers, lakes, transitional waters or coastal waters - or as artificial surface water bodies or heavily modified surface water bodies	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Trup ujor pritës	Ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat kalimtare dhe ujërat bregdetare, të cilat e pranojnë një shkarkim specifik	**Receiving body of water**	Surface waters, groundwater, transitional waters and coastal water that are receiving a specific discharge	Trupa ujorë	Direktiva 2006/21/EC
Trup ujor nëntokësor	Është një vëllim i caktuar i ujërave nëntokësore brenda një akuiferi apo disa akuiferëve	**Body of groundwater**	A distinct volume of groundwater within an aquifer or aquifers	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Trup ujor sipërfaqësor	Është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësorë si p.sh. një liqen, akumulim (në Shqipëri "rezervuar"), përrua, lumë ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujërat kalimtare ose një shtrirje e ujërave bregdetare	**Body of surface water**	A discrete and significant element of surface water such as a lake, a reservoir, a stream, river or canal, part of a stream, river or canal, a transitional water or a stretch of coastal water	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Tub (gyp)	Një cilindër i papërshkueshëm nga ajri (hermetik) i cili përdoret për të përçuar një fluid apo për të transmetuar shtypjen hidrostatike, dhe i cili zakonisht në specifikimet (kushtet teknike) të materialeve të aplikueshme emërtohet si "tub" ose "gyp"	**Pipe**	A pressure-tight cylinder used to convey a fluid or to transmit a fluid pressure and that is ordinarily designated "pipe" in applicable material specifications	Furnizim me ujë	
Tub shkarkimi i sistemit të kombinuar të kanalizimit	Një pajisje, në një sistem kanalizimi të kombinuar apo pjesërisht të ndarë, e cila e liron sistemin nga prurjet e tepërta	**Combined sewer overflow**	Device, on a combined or partially separate sewer system, that relieves the system of excess flow	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Tub thithjeje	Tub i cili shtrihet nga fundi i një cilindri pompe, trupi pompe deri tek pusi, cisterna, apo rezervuari, prej nga uji apo ndonjë lëngë tjetër tërhiqet apo nxirret	**Suction pipe**	The pipe leading from the bottom of a pump-barrel or cylinder to the well, cistern, or reservoir from which the water or other liquid is to be drawn up	Furnizim me ujë	
Tubacion	Një tub i gjatë, zakonisht nën sipërfaqe të tokës, që shërben për transportimin e ujit në distanca të gjata	**Pipeline**	A long pipe, typically underground, for conveying water over long distances	Furnizim me ujë	
Turbiditet	Sasia e grimcave të ngurta të cilat janë të suspenduara në ujë, të cilat bëjnë shpërhapjen e rrezeve të dritës që depërtojnë nëpër ujë. Andaj, turbiditeti shkakton turbullim të ujit apo në raste ekstreme i bënë ato të patejdukshme. Turbiditeti shprehet në njësinë neflometrike të turbiditetit (NTU)	**Turbidity**	The amount of solid particles that are suspended in water and that cause light rays shining through the water to scatter. Thus, turbidity makes the water cloudy or even opaque in extreme cases. Turbidity is measured in nephelometric turbidity units (NTU)	Cilësi e ujërave	
Turbinë me gaz[49]	Çdo makinë rrotulluese e cila e shndërron energjinë termike në punë mekanike, që kryesisht përbëhet nga një turbinë dhe një kompresor, i cili paraqet një pajisje termike në të cilën lënda djegëse oksidohet me qëllim të nxehjes së fluidit punues (lëngut apo gazit nën presion që vë në funksion një makinë)	**Gas turbine**	Any rotating machine which converts thermal energy into mechanical work, consisting mainly of a compressor, a thermal device in which fuel is oxidised in order to heat the working fluid[50], and a turbine	Industri	Direktiva 2010/75/EU

[48] **Trup ujor i modifikuar rëndë** - nënkupton një trup ujor sipërfaqësor i cili si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktivitetet njerëzore ka ndryshuar substancialisht në karakter dhe që është klasifikuar si i tillë me akt nënligjor (**Rregullorja Nr. 02/2016 "për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike ", Neni 3, paragrafi 1.10, Legjislacion i i Kosovës**)
Trup ujor tepër i modifikuar - është trupi ujor sipërfaqësor, i cili, si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor, ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij në krahasim me atë që është shpallur me legjislacionin përkatës nga autoriteti kompetent (**Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 74, Legjislacion i Shqipërisë**)

[49] **Turbinë me gaz** - paisje me të cilën gazrat e nxehtë, të krijuara nga djegia, për t'u shndëruar në energji mekanike, direkt futen nëpër turbinë. Në qoftëse gazrat e nxehtë pas kalimit nëpër turbinën me gaz përdoren për prodhimin e avullit, për futjen në lëvizje të turbinës së avullit, ky lloj stabilimenti i kombinuar quhet"kombi-bllok i gazit" (**UA Nr. 06/2007-MMPH për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes, Neni 4, Legjislacioni i Kosovës**)

[50] **Working fluid** - a pressurized gas or liquid that actuates a machine; **Fluidi punues** -lëngu apo gazi nën presion që vë në funksion një makinë

4.26 THth

ENGLISH		ALBANIAN		Topic	Main references
Term	Definition	Term	Definition		
Thatësirë[51]	Një rënie e përkohshme e disponueshmërisë mesatare të ujërave p.sh. për shkak të mungesës së reshjeve	**Drought**	A temporary decrease of the average water availability due to e.g. rainfall deficiency	Thatësirë	EU Blueprint[52]
Thellësi kritike (e rrjedhës)	Paraqet thellësinë e një rrjedhe ku energjia e një shkarkimi të caktuar është me vlerë minimale. Thellësia kritike zakonisht ndodh në atë pikë ku ka një rënie të papritur të rrëpirë të pjerrësisë së kanaleve, siç janë rrëmbesat	**Critical depth**	The depth of flow where energy is at a minimum for a particular discharge. Critical depth usually occurs at the point corresponding to an abrupt steepening of channel slopes, such as rapids	Hidraulikë	
Thellësia e shtratit	Lartësia e rrëshirës apo e lëndëve filtëruese në një shtyllë (kolonë) pas përgatitjes së tyre në mënyrë të duhur për një funksionim efektiv, që zakonisht shprehet në inç. Sasia e rrëshirës së nevojshme varet nga rrjedhja e ujit, fortësia e përgjithshme e ujit si dhe nga koha ndërmjet cikleve të rigjenerimit	**Bed depth**	The height of the resin or filter media in a column after it has been properly conditioned for effective operation, usually expressed in inches. The quantity of resin required depends on the water flow, total hardness and time desired between regeneration cycles	Ujë i pijshëm	
Thithje	Një term i përgjithshëm për procesin e absorbimit (përthithjes) dhe adsorbimit (ndajthithjes), që shpeshherë përdoret për të nënkuptuar që të dyja këto procese	**Sorption**	A general term for the process of absorption and adsorption, often used to denote the occurrence of both	Cilësi e ujërave	

[51] **Thatësirë** - është periudha e gjatë kohore me prurje të vogla, të cilat janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat për ujë të një kategorie përdoruesish.(**Ligji Nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Neni 4, Paragrafi 75 (Legjislacioni i Shqipërisë))**

[52] "A Blueprint to Safeguard Europe's Water Resources" - "Plani për Mbrojtjen e Resurseve Ujore te Evropës"

4.27 Uu

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Ujë adheziv (lidhës)	Uji që mbahet nga përbërësit e dheut si rezultat i tërheqjes molekulare ndërmjet ujit dhe dheut	**Adhesive water**	Water retained by soil constituents as a result of the molecular attraction between the water and the soil	Bujqësi dhe ujitje	
Ujë burimi	Uji i cili buron nga toka aty ku tabloja e ujit e ndërpret sipërfaqen e tokës. Burimet mund të ndodhen në pjesët e ulta të peizazhit, ku një shkëmb me permeabilitet (përshkueshmëri) të lartë shtrihet mbi një shkëmb me permeabilitet (përshkueshmëri) të ultë, dhe ku plasaritjet apo të çarat sigurojnë shtigjet e preferuara për rrjedhjen e ujërave nëntokësorë. Uji i burimit zakonisht është ujë i destinuar për konsum nga njerëzit në gjendjen e tij natyrore, dhe i cili ambalazhohet në shishe në vendin e burimit në përputhje me legjislacionin specifik evropian mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale	**Spring water**	Water that flows out of the ground where the water table intersects the land surface. Springs can occur in the low parts of the landscape, where a high permeability rock overlies a low permeability rock and where faults or fractures provide preferred pathways for groundwater flow. Spring water is usually water intended for human consumption in its natural state, and bottled at source according to the specific European legislation on the exploitation and marketing of natural mineral waters	Ujë i pijshëm	Direktiva 2009/54/EC
Ujë ftohës	Ujë i cili përdoret për të shpërndarë nxehtësinë dhe që gjithherë gjen përdorim kurdo që proceset kanë nevojë të ftohen. Meqë sistemet me rrjedhje të hapur kanë kërkesë të lartë për ujë dhe bëjnë që ujërat pritëse të ballafaqohen me një ngarkesë të lartë temperature, sot përdoret një numër gjithnjë e më i madh i sistemeve me qarkullim me ciklë të mbyllur të qarkullimit	**Cooling water**	Water used to dissipate heat and is always in use where processes need to be cooled down. As open flow systems have a high demand of water and pose a temperature burden for receiving waters increased numbers of recirculation systems are in use today	Industri	
Ujë fundar	Masa e ujit që shtrihet në pjesën më të poshtme të një trupi ujor, në fundin e tij, me karakteristika dalluese në aspektin fizik, kimik dhe ekologjik	**Bottom water**	The lowermost water mass in a water body, by its bottom, with distinct characteristics, in terms of physics, chemistry, and ecology	Trupa ujorë	
Ujë gravitacioni, ujë i lirë	Ujë i cili lëvizë nëpër tokë nën veprimin e gravitetit (forcës së rëndesës) dhe i cili duhet të largohet nga toka përpara se të arrihet ngopja e dheut me ujë[53]	**Gravitational water, Free water**	Water that moves through soil under the influence of gravity and must be removed from the soil before this can attain field capacity[54]	Bujqësi dhe ujitje	
Ujë higroskopik	Ujë të cilin e absorbon toka nga atmosfera dhe i cili mbahet fuqishëm nga grimcat e dheut, ashtu që nuk është në dispozicion në sasi të mjaftueshme për mbijetesën e bimëve	**Hygroscopic water**	Water absorbed from the atmosphere and held very tightly by the soil particles, so that it is unavailable to plants in amounts sufficient for them to survive	Bujqësi dhe ujitje	
Ujë i butë	Çdo lloj uji i cili nuk përmban sasi të konsiderueshme të mineraleve të tretura në të, si p.sh. të kripërave të kalciumit apo magnezit	**Soft water**	Any water that does not contain a significant amount of dissolved minerals such as salts of calcium or magnesium	Menaxhim i ujërave	

[53] **Ngopja e dheut me ujë** - uji i cili mbetet në tokë pasi që lagështia e tepërt është drenuar (kulluar) lirshëm nga toka. Zakonisht matet si përqindje e peshës apo vëllimit të dheut të tharë-në-furrë

[54] **Field Capacity** - water that remains in soil after excess moisture has drained freely from that soil. Usually it is measured as the percentage of the weight or volume of oven-dry soil

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Uji i destinuar për konsum nga njerëzit	Përfshinë cilëndo nga të mëposhtmet: (a) të gjitha ujërat qoftë në gjendjen e tyre fillestare apo pas trajtimit, të destinuara për pije, gatim, përgatitje të ushqimit apo për qëllime të tjera shtëpiake, pavarësisht origjinës së tyre, si dhe nga se furnizohen: nga ndonjë rrjet i shpërndarjes, cisternë, apo në shishe ose kontejner (depozitë); (b) të gjitha ujërat që përdoren në cilëndo ndërmarrje të prodhimit ushqimor për prodhimin, përpunimin, konservimin apo reklamimin e produkteve apo substancave që synohen për konsum nga njeriu, përveç nëse autoritetet kompetente kombëtare janë të kënaqura me atë që cilësia e ujit nuk mund të ketë ndikim mbi shëndetshmërinë e gjërave ushqimore në formën e tyre të fundit. Këtu përjashtohet furnizimi i ujit të destinuar për konsum nga njerëzit nga një furnizues individual i cili ofron mesatarisht më pak se 10 m^3 ujë në ditë apo i cili i shërben me ujë më pak se 50 persona, përveç nëse uji furnizohet në kuadër të një veprimtarie komerciale apo publike	**Water intended for human consumption**	Any of the following: all water either in its original state or after treatment, intended for drinking, cooking, food preparation or other domestic purposes, regardless of its origin and whether it is supplied from a distribution network, from a tanker, or in bottles or containers; all water used in any food-production undertaking for the manufacture, processing, preservation or marketing of products or substances intended for human consumption unless the competent national authorities are satisfied that the quality of the water cannot affect the wholesomeness of the foodstuff in its finished form. This excludes water intended for human consumption from an individual supply providing less than 10 m3 a day as an average or serving fewer than 50 persons, unless the water is supplied as part of a commercial or public activity	Furnizim me ujë	Direktiva 98/83/EC, Direktiva 2000/60/EC
Ujë i kripur	Ujë i cili as nuk i takon kategorisë së ujërave të kripur e as kategorisë së ujërave të ëmbël, por qëndron në mes këtyre dy kategorive	**Brackish water**	Water that neither falls in the category of salt water, nor in the category of fresh water. It holds the middle between either one of the categories	Cilësi e ujërave	
Ujë i ndenjur (amull)	Një pjesë e lumit ku uji nuk rrjedh, ashtu që uji rri i ndenjur dhe i referohet qoftë një dege të një lumi kryesor, e cila shtrihet përgjatë këtij lumi duke iu ribashkuar më pas, ose i referohet një trupi ujor në një lum kryesor, të cilit i ndihmon batica apo një obstruksion (pengesë) siç është p.sh. diga	**Backwater**	A part of a river where the water does not flow, thus the water is stagnant. It refers either to a branch of a main river, which lies alongside it and then rejoins it, or to a body of water in a main river, backed up by the tide or by an obstruction such as a dam	Përmbytje	
Ujë i njelmët	Ujë i cili përmban më shumë se 1.000 pjesë për milion (ppm) të lëndëve të ngurta të çfarëdoshme të tretura në të	**Saline water**	Water containing more than 1.000 parts per million (ppm) of dissolved solids of any type	Ujë i pijshëm	
Ujë i paambalazhuar	1) Ujë i furnizuar nga një furnizues uji tek një furnizues tjetër uji; 2) Ujë i destinuar për pije i cii transportohet me autobot (autocisternë)	**Bulk water**	1) water supplied by a water provider to another water provider; 2) water intended for potable uses which is transported by tank trucks	Furnizim me ujë	
Ujë i pafaturuar	Uji i pafaturuar është uji i cili është prodhuar dhe i cili humbet përpara se të arrijë tek konsumatori	**Non-revenue water**	Non revenue water (NRW) is water that has been produced and is "lost" before it reaches the customer.	Menaxhim i ujërave	
Ujë I patrajtuar	Ujë i marrë përmes ujëmarrësve përpara çfarëdo trajtimi apo përdorimi. Cilësia e ujit të patrajtuar variron varësisht prej burimit të tij	**Raw water**	Intake water before any treatment or use. The quality of raw water varies depending on its source	Menaxhim i ujërave	
Ujë i pijshëm	Ujë për konsum nga njerëzit kërkesat e cilësisë së të cilit janë në pajtim me cilësinë e ujit për pije	**Drinking water**	Water for human consumption which quality demands are in accordance with drinking water quality. It is also called potable water	Ujë i pijshëm	
Ujë i pijshëm	Shihni përkufizimin për 'Water intended for human consumption' - 'Ujë i destinuar për konsum nga njerëzit'	**Potable water**	See "Water intended for human consumption"	Ujë i pijshëm	
Ujë i ricikluar	Ujërat e ndotura shtëpiake të cilat janë nën kontrollin e drejtpërdrejt të një zotëruesi/operatori të një impianti të trajtimit të ujërave të ndotura, ku këto ujëra trajtohen deri në atë cilësi sa për të qenë të përshtatshme për t'u ripërdorë	**Reclaimed water**	Domestic waste water that is under the direct control of a treatment plant owner/operator which has been treated to a quality suitable for a use	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Ujë i ricikluar	Ujë i cili përdorët disa herë, qoftë si i trajtuar apo i patrajtuar, përpara se të kthehet në një mjedis natyror	**Recycled water; reclaimed water**	Water that is used multiple times (either treated or non treated) before returning it to the natural environment	Furnizim me ujë	
Ujë i rrebeshtë (i rrëmbyeshëm)	Ujë i cili kryesisht paraqet një rrjedhë sipërfaqësore të ujërave të reshjeve që rrjedhin nëpër rrugë dhe sipërfaqe të tjera të papërshkueshme nga uji, e që ndërlidhen me urbanizimin dhe me aktivitetet e tjera antropogjene	**Stormwater**	Water which is primarily surface runoff from streets and other impervious surfaces associated with urbanization or other anthropogenic activities	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ujë intersticial	Uji i cili gjendet në poret (zbrazëtitë) ndërmjet grimcave në brendësi të një mase dheu, shkëmbinjsh, apo betoni	**Pore water**	Water in gaps between particles (pores) within a mass of soil, rock, or concrete	Bujqësi dhe ujitje	
Ujë kaldaje (ujëngrohësi)	Faza e lëngët e avullit brenda një kaldaje (ujëngrohësi). Ky term po ashtu mund të përdoret edhe për "ujin e papërpunuar" që synohet të përdoret në kaldajë, po ashtu edhe për "ujin e përpunuar me të cilin mbushet kaldaja", "kondesatin e avullit që kthehet në kaldajë",apo për "ujin që zbrazet nga kaldaja" me qëllim të shmangies së papastërtive gjatë avullimit të vazhdueshëm të avullit	**Boiler water**	The liquid phase of steam within a boiler. The term may also be applied to raw water intended for use in boilers, treated boiler feedwater, steam condensate being returned to a boiler, or boiler blowdown being removed from a boiler	Industri	
Ujë kapilar	Uji që mbetet në tokë pasi që uji gravitacional drenazhohet, dhe i cili i nënshtrohet ligjeve të lëvizjes kapilare, dhe që gjendet në formë të një filmi (cipe) rreth strukturës granulare të tokës	**Capilliary water**	Water that remains in the soil after gravitational water is drained out, that is subject to the laws of capillary movement, and that is in the form of a film around the soil grains	Bujqësi dhe ujitje	
Ujëndarëse	Sipërfaqja e tokës e cila i kullon (drenazhon) ujërat në një ujërrjedhë të caktuar, lumë apo liqe. Paraqet një veçori të tokës e cila mund të identifikohet me gjurmimin e një linje (vije) përgjatë lartësive më të larta midis dy zonave në një hartë, që shpeshherë paraqet një vargmal	**Watershed**	The land area that drains water to a particular stream, river, or lake. It is a land feature that can be identified by tracing a line along the highest elevations between two areas on a map, often a ridge	Menaxhim i ujërave	
Ujëra batice	Çdo ujë niveli i të cilit ndryshon periodikisht në saje të veprmit të rrymës së baticës	**Tidal waters**	Any water whose level changes periodically due to tidal action	Trupa ujorë	
Ujëra bregdetare	Janë ujëra sipërfaqësore, të cilët ndodhen në anën e brendshme (kah territori) të një vije imagjinare, e cila është e baraslarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare (në drejtim të detit) nga pika më e afërt e vijës-bazë, prej ku matet gjerësia e ujërave territoriale, me mundësinë e shtrirjes gjer në kufirin e jashtëm të ujërave kalimtare	**Coastal water**	Surface water on the landward side of a line, every point of which is at a distance of one nautical mile on the seaward side from the nearest point of the baseline from which the breadth of territorial waters is measured, extending where appropriate up to the outer limit of transitional waters	Trupa ujorë	Direktiva 2006/118/EC, Direktiva 91/271/EEC
Ujëra ciprinide	Ujëra të cilat janë apo bëhen të afta për të mbajtur në jetë peshqit që i takojnë ciprinideve (Cyprinidae), apo llojet e tjera si mlyshin (Esox lucius), sharrmakun (Perca fluviatilis) dhe ngjalën (Anguilla anguilla)	**Cyprinid waters**	Waters which support or become capable of supporting fish belonging to the cyprinids (Cyprinidae), or other species such as pike (Esox lucius), perch (Perca fluviatilis) and eel (Anguilla anguilla)	Zona të mbrojtura	Direktiva 2006/44/EC
Ujëra gri	Të gjitha ujërat e ndotura të gjeneruara nga ekonomitë shtëpiake apo nga ndërtesat zyrë të cilat nuk janë të kontaminuara me fekale (ujërat e ndotura nga lavamanët në kuzhinë, nga banjat e dushet, me përjashtim të ujit nga tualetet)	**Grey water (sullage)**	All waste water generated in households or office buildings from streams without fecal contamination	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ujëra hipoksike	Ujëra me përqendrim të ultë të oksigjenit të tretur prej më pak se 2 mg/l, nivel ky që përgjithësisht pranohet si niveli minimal i kërkuar për jetën dhe riprodhimin e organizmave ujor	**Hypoxic waters**	Waters with dissolved oxygen concentrations of less than 2 mg/l, the level generally accepted as the minimum required for life and reproduction of aquatic organisms	Probleme mjedisore	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ujëra salmonide	Ujëra në të cilat jetojnë apo të cilat bëhen të të përshtatshme që të mundësojnë jetesën e peshqve që i takojnë llojeve si Salmonit (*Salmo salar*), Troftës (*Salmo trutta*), Losesë (*Thmallus thmallus*) - lloj i peshkut të hirtë në të argjend, si dhe peshkut të bardhë	**Salmonid waters**	Waters which support or become capable of supporting fish belonging to species such as salmon (*Salmo salar*), trout (*Salmo trutta*), grayling (*Thymallus thymallus*) and whitefish	Zona të mbrojtura	Direktiva 2006/44/EC
Ujëra të ëmbla	Ujë i ndodhur natyrshëm, i cili përmban përqendrim të ultë të kripërave, që shpeshherë është i pranueshëm si i përshtatshëm për nxjerrje apo trajtim, me qëllim të prodhimit të ujit të pijshëm	**Freshwater**	Naturally occurring water having a low concentration of salts, or generally accepted as suitable for abstraction and treatment to produce potable water	Ujë i pijshëm	Direktiva 91/676/EEC, Direktiva 2000/60/EC
Ujëra të zeza (ujëra shkarkimi)	Shihni përkufizimin për"Ujërat e ndotura shtëpiake"	**Sewage**	See the definition "Waste water (domestic)"	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ujërat e brendshëm	Të gjithë ujërat e ndenjura (amull) ose ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e tokës, dhe të gjithë ujërat nëntokësore në anën e brendshme (kah territori) i vijës-bazë, prej së cilës matet gjerësia e ujërave territoriale	**Inland water**	All standing or flowing water on the surface of the land, and all groundwater on the landward side of the baseline from which the breadth of territorial waters is measured	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Ujërat e ndotura	Ujërat e ndotura shtëpiake, ujërat e ndotura urbane dhe ujërat e ndotura industriale, si dhe çdo ujë tjetër i përdorur, të cilat ujëra i nështrohen ligjeve rregulluese për shkak të substancave dhe objeteve që ato përbajnë	**Waste water**	Urban, domestic and industrial waste water and any other used water which is subject, because of the substances or objects it contains, to regulation laws	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006
Ujërat e ndotura shtëpiake[55]	Janë ujërat e ndotura nga vendbanimet dhe shërbimet rezidenciale, të cilët ujëra origjinojnë kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe nga aktivitetet shtëpiake	**Waste water (domestic)**	Waste water from residential settlements and services which originates predominantly from the human metabolism and from household activities	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Ujërat e ndotura industriale	Janë të gjitha ujërat e ndotura që shkarkohen nga objektet në të cilat kryhen veprimtari tregtare apo industriale, me përjashtim të ujërave të ndotura shtëpiake dhe rrjedhjeve të ujërave të shirave	**Waste water (industrial)**	Any waste water which is discharged from premises used for carrying on any trade or industry, other than domestic waste water and run-off rain water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Ujërat e ndotura urbane	Janë ujërat e ndotura shtëpiake, apo përzierja e ujërave të ndotura shtëpiake me ujërat e ndotura industriale dhe/apo me ujërat e shirave	**Waste water (urban)**	Domestic waste water or a mixture of domestic waste water with waste water which is discharged from premises used for carrying on any trade or industry (industrial waste water) and/or run-off rain water	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	Direktiva 91/271/EEC
Ujërat e ndotura të papërpunuara	Ujërat e ndotura të patrajtuara, përfshirë edhe përbërësit e tyre	**Raw sewage**	Untreated waste water and its contents	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Ujërat e zonës së pasaturuar (zonës së cektë)	Shihni përkufizimin për 'gravitational water'- 'ujë gravitacioni"	**Vadose water**	See the definition "gravitational water"	Bujqësi dhe ujitje	

[55] a) **Ujërat e ndotura shtëpiake** - nënkupton ujërat e ndotura nga banorët e atyre vendbanimeve dhe shërbimeve të cilat kryesisht kanë origjinë nga metabolizmi i njerëzve dhe nga aktivitetet shtëpiake (**A UA Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor, Neni 4, paragrafi 1.16, Legjislacioni i Kosovës**)
b) **Ujërat e ndotura shtëpiake** - janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë e sektorit shtëpiak (**Ligji për Menaxhimin e Integuar të Burimeve Ujore Nr.111/2012, Neni 4, paragrafi 78**)

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Ujëra natyrale minerale	Ujëra mikrobiologjikisht të pastra të cilat burojnë nga një tablo ujore nëntokësore apo nga një depozitë nëntokësore, dhe të cilat nxirren në sipërfaqe nga një burim uji përmes një apo më shumë puseve natyrore apo të shpuara. Ujërat natyrale minerale dallohen qartë nga uji i zakonshëm për pije, në bazë të: (a) natyrës së tyre të cilën e karakterizon përmbajtja e tyre minerare, elementet në gjurmë apo përbërësit e tjerë, si dhe sipas nevojës edhe efektet e caktuara; si dhe në bazë të (b) pastërtisë së tyre origjinale, ku që të dy këto karakteristika janë ruajtur të pacenuara për shkak të origjinës nëntokësore të këtyre ujërave, të cilat janë mbrojtur nga çdo rrezik i ndotjes së tyre	**Natural mineral water**	Microbiologically wholesome water originating in an underground water table or deposit and emerging from a spring tapped at one or more natural or bore exits. Natural mineral water can be clearly distinguished from ordinary drinking water by its nature, which is characterised by its mineral content, trace elements or other constituents and, where appropriate, by certain effects and by its original purity, both characteristics having been preserved intact because of the underground origin of such water, which has been protected from all risk of pollution	Ujë i pijshëm	Direktiva 2009/54/EC
Ujëra ndërkufitare	Janë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilët shënojnë, përshkojnë ose janë të lokalizuara në kufijtë midis dy ose më shumë shteteve; kudo që këto ujëra ndërkufitare derdhen drejtëpërdrejtë në det, këto ujëra ndërkufitare përfundojnë në një vijë të drejtë që kalon mespërmes grykëderdhjeve të tyre përkatëse, ndërmjet pikave në vijën-ujore-të-poshtme të brigjeve të tyre	**Transboundary waters**	Any surface or ground waters which mark, cross or are located on boundaries between two or more States; wherever transboundary waters flow directly into the sea, these transboundary waters end at a straight line across their respective mouths between points on the low-water line of their banks	Çështje ndërkufitare, marrëveshje ndërkombëtare	Direktiva 2000/60/EC
Ujëra sipërfaqësore	Ujërat e brendshme, përveç ujërave nëntokësore; ujërat kalimtare (në Shqipëri - "ujërat e përkohshme") dhe ujërat bregdetare, përveç kur ka të bëjë me statusin kimik me ç'rast duhet të përfshijë edhe ujërat territoriale	**Surface water**	Inland waters, except groundwater; transitional waters and coastal waters, except in respect of chemical status for which it shall also include territorial waters	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Ujërat kalimtare	Trupa ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve në det, që për nga karakteri janë pjesërisht të kripshme, për shkak të afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që në masë të madhe ndikohen nga rrjedha e ujërave të ëmbla	**Transitional waters**	Bodies of surface water in the vicinity of river mouths which are partly saline in character as a result of their proximity to coastal waters but which are substantially influenced by freshwater flows	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC
Ujërat nëntokësore	Janë të gjithë ujërat që gjenden nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes (ujëmbajtëse) dhe në kontakt direkt me tokën ose nëntokën (tabanin)	**Groundwater**	All water which is below the surface of the ground in the saturation zone and in direct contact with the ground or subsoil	Trupa ujorë	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 91/676/EEC
Ujërat nëntokësore të varura	Zona lokalisht të saturuara që gjenden mbi tablon ujore, të cilat shtrihen mbi një shtresë të papërshkueshme me shtrirje të kufizuar	**Perched groundwater**	Local saturated zones above the water table which exist above an impervious layer of limited extent	Trupa ujorë	
Ujërat për larje	Cilido element i ujërave sipërfaqësorë në të cilin autoriteti kompetent pret që një numër i madh i njerëzve të lahen, dhe për të cilën zonë nuk ka vendosur masë të ndalimit të përhershëm për larje, apo për të cilën nuk ka lëshuar ndonjë këshillë të përhershme për moslarje. Pishinat publike për larje dhe pishinat me ujëra termale (llixhat) përjashtohen nga ky përkufizim	**Bathing water**	Any element of surface water where the competent authority expects a large number of people to bath and it has not imposed a permanent bathing prohibition, or issued permanent advice against bathing. Public swimming pools and spa pools are excluded from this definition	Shëndet publik	Direktiva 2006/7/EC

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Ujërrjedhat mjedisore	Paraqesin sasinë dhe cilësinë e rrjedhave të ujërave brenda një periudhe kohore të caktuar, të cilat janë të nevojshme për të mbajtur në jetë ekosistemet e ujërave të ëmbla dhe të estuarëve, si dhe të jetës së njerëzve dhe të sigurojnë mirëqenien e të gjithë atyre që varen nga këto ekosisteme. Sasia e ujërave, që në kontekst të vlerësimit të rrjedhave mjedisore, ndryshe quhet 'regjim i rrjedhjes', zakonisht karakterizohet nga një varg komponentësh, të cilët mund të ndryshojnë varësisht prej stinës: rrjedhje jashtëzakonisht të ulëta, rrjedhje të vogla, pulse të larta të rrjedhjes, etj.	**Environmental flows**	The quantity, timing, and quality of water flow required to sustain freshwater and estuarine ecosystems and the human livelihoods and well being that depend on these ecosystems. The amount of water that, in the context of environmental flow assessment, is sometimes referred to as a "flow regime", is usually characterized by several components, which vary seasonally: Extreme low flows, Low flows, High flow pulses, etc.	Status i trupave ujorë	
Ujërrjedhë	Një term i përgjithshëm që përdoret për një trup të ujërave rrjedhëse. Përndryshe paraqet një rrjedhë ujore natyrore e cila është e mbushur me ujë të paktën për një pjesë të vitit. Ndërsa, në aspektin hidrologjik, ky term kryesisht i referohet ujërave që rrjedhin nëpër një kanal natyror ndryshe prej rrjedhjes së tyre nëpër një tub (kanal artificial)	**Stream**	A general term for a body of flowing water; natural water course containing water at least part of the year. In hydrology, it is generally applied to the water flowing in a natural channel as distinct from a canal	Trupa ujorë	
Ujërrjedhë gjithëvjetore	Një ujërrjedhë e cila rrjedh gjatë gjithë vitit	**Perennial stream**	A stream that flows all year round	Trupa ujorë	
Ujitje	Furnizimi i tokave bujqësore dhe i kulturave bujqësore me ujë për të ndihmuar rritjen e tyre, që kryesisht realizohet me anë të tubave ose kanaleve	**Irrigation**	The supply of water to agricultural land or crops to help growth, typically by pipes or channels	Bujqësi dhe ujitje	
Ulje e dheut	Rrëshqitje poshtë e një pjesë të korës së Tokës për shkak të gërmimit nëntokësor, si p.sh. për shkak të largimit të ujërave nëntokësore	**Subsidence**	Sinking down of part of the earth's crust due to underground excavation, such as removal of the groundwater	Probleme mjedisore	
Ultrafiltrim	Një varg filtrimesh membranore ku forcat: si gradienti i presionit (shtypjes) apo gradienti i përqendrimit, çojnë në ndarjen e substancave me anë të një membrane semipermeabile (gjysmë të përshkueshme). Lëndët e ngurta të suspenduara (pezullitë) dhe substancat e tretura me peshë të madhe molekulare mbesin në të ashtuquajturin retentat, ndërkaq uji dhe substancat e tretura me peshë të ultë molekulare depërtojnë nëpërmjet të membranës në filtrat. Presioni nën të cilin funksionon filtri sillet prej 3 deri në 12 bar, i cili është më i ultë sesa te nanofiltrimi dhe më i lartë sesa tek mikrofiltrimi. Ultrafiltrimi mund të përdoret gjatë trajtimit të ujërave të kontaminuara (ndotura) për largimin e ngjyrave dhe të mikroorganizmave nga uji	**Ultra-filtration**	A variety of membrane filtration in which forces like pressure or concentration gradients lead to a separation through a semi-permeable membrane. Suspended solids and solutes of high molecular weight are retained in the so-called retentate, while water and low molecular weight solutes pass through the membrane in the permeate (filtrate). The pressure at which the filter works is 3 to 12 bar, which is lower than nanofiltration and is higher than microfiltration. Ultrafiltration can be used during the treatment of contaminated waters to remove the colors and microorganisms from the water	Ujë i pijshëm	
Urëkanal	Tub apo kanal, zakonisht në formë të një ure që shtrihet nëpër një luginë apo hapësirë tjetër, e projektuar për të transportuar ujë përgjatë një distance të gjatë zakonisht nën veprimin e gravitetit	**Aqueduct**	Conduit or channel, typically in the form of a bridge across a valley or other gap, designed to transport water over a long distance usually by gravity	Furnizim me ujë	

4.28 Vv

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Vajrat mbeturinë (në Shqipëri - vajrat e përdorura)	Janë të gjithë vajrat mineralë, vajrat lubrifikues sintetikë apo vajrat industrialë të cilët janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin për të cilin ishin destinuar fillimisht, siç janë vajrat e përdorur të motorëve me djegie të brendshme, vajrat e përdorur të kutisë së ndërruesit të shpejtësisë (në Shqipëri - të ndërrimit të marsheve), vajrat lubrifikues, vajrat për turbina dhe vajrat hidraulike	**Waste oils**	Any mineral or synthetic lubrication or industrial oils which have become unfit for the use for which they were originally intended, such as used combustion engine oils and gearbox oils, lubricating oils, oils for turbines and hydraulic oils	Ndotje	Direktiva 2008/98/EC
Valë e përmbytjes	Një ngritje e shpejtë e nivelit të ujit në një lumë, e cila ndodh kur zhvillohet një rrjedhje sipërfaqësore e ujërave të rrëmbyeshme të reshjeve, e cila lëvizë poshtë rrjedhës së lumit. Përmbytja udhëton përgjatë një lumi në formë vale, me shpejtësi dhe thellësi që ndryshojnë vazhdimisht me kalimin e kohës dhe të distancës	**Flood wave**	A rapid rise of water in a river that occurs when a head of storm runoff develops and moves downstream. The flood travels along a river as a wave, with velocity and depth continuously changing with time and distance	Përmbytje	
Valvul ajri	Një pajisje për kontrollimin e qarkullimit të ajrit në një gyp (tub)	**Air valve**	A device for controlling the flow of air in a pipe	Furnizim me ujë	
Valvul ajrimi	Pajisje e cila e aktivizon dhe e deaktivizon ajrimin e ujit në një sistem ajrimi	**Aeration valve**	Device that activates and desactivates the aeration of water in an aeration system	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Valvul dekantuese, valvul teleskopike	Valvule të projektuara për përdorim në rezervuare, laguna, pellgje, struktura ujëmbajtëse dhe në impiante të trajtimit të ujërave dhe të ujërave të ndotura, të cilat janë ideale për sifonimin e ujit të pastër nga sipërfaqja e një rezervuari apo trupi në tjetrin ,meqë nuk e trazojnë sedimentin i cili fundërron në fund. Po ashtu përdoren edhe për rregullimin e niveleve të lëngjeve, qoftë me drenimin e njërit rezervuar në tjetrin, apo me mbushjen e një rezervuari fqinj me një nivel më të lartë uji	**Decanting valve, telescopic valve**	Valves designed for use in tanks, lagoons, ponds, water containment structures and waste water treatment plants, that are ideal for siphoning clean water from the surface of one tank or body into another, as they will not disturb the sediment that sinks to the bottom. They are also used for regulating fluid levels, either by draining one tank into another or filling an adjacent tank with a higher water level	Hidraulikë	
Valvul e nyjëtuar	Valvule të vendosura në fund të një tubi flanxhë që lejojnë rrjedhjen e ujit jashtë tubit, por pengojnë që çfarëdo tjetër të futet brenda	**Flap valve**	Valves put on the end of a flanged pipe to allow the flow of water out of the pipe, but prevent anything from flowing back in	Furnizim me ujë	
Valvul flutur (droseluese)	Valvul në formë disku i cili e rregullon prurjen brenda tubacionit. Ky disk rrotullohet rreth një boshti i cili formon këndë të drejtë me drejtimin e prurjes dhe, kur disku është në të njëjtin drejtim me prurjen, valvuli qëndron i hapur plotësisht	**Butterfly valve**	A flow regulating disc valve. Its obturator rotates around an axis at right angles to the direction of flow and, in the open position flow passes around the obturator	Hidraulikë	
Valvul izoluese	Një valvul në një sistem manovrimi me fluide, i cili e bllokon rrjedhjen drejt një vendi të caktuar të lëndëve të dala pas një procesi, zakonisht për qëllime mirëmbajtjeje apo sigurie. Po ashtu këto valvule mund të përdoren për të bërë përzgjedhjen logjike (përzgjedhjen e një trajektoreje të rrjedhjes krahas një tjetre), si dhe për lidhjen e pajisjeve të jashtme me një sistem	**Isolating valve**	A valve in a fluid handling system that stops the flow of process media to a given location, usually for maintenance or safety purposes. They can also be used to provide flow logic (selecting one flow path versus another), and to connect external equipment to a system	Hidraulikë	
Valvul kontrolli (valvul e pakthyeshme, bllokuese)	Valvul e cila ia mundëson ujit të kalojë në një drejtim të caktuar dhe më pas mbyllet për të parandaluar rrjedhjen e ujit në drejtim të kundërt	**Check valve (non-return valve)**	A valve that allows water to stream in one direction and will then close to prevent development of a back-flow	Hidraulikë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Varfërim i sasive të oksigjenit	Zvogëlimi i nivelit të oksigjenit të tretur në një trup ujor	**Oxygen depletion**	The reduction of the dissolved oxygen level in a water body	Cilësi e ujërave	
Vend kënetor i mbyllur me pendë	Një zonë e një ultësire, e bonifikuar nga deti apo ndonjë trup tjetër ujor, e cila mbrohet me prita (penda), dhe e cila nuk ka komunikim me ujërat jashtë territorit të saj përveç përmes pajisjeve të cilat manovrohen manualisht	**Polder**	A tract of low land, reclaimed from the sea or other body of water and protected by dikes, with no connection with outside water other than through manually operated devices	Përmbytje	
Vendbanim (habitat) i një lloji	Një mjedis që përcaktohet nga faktorë specifikë abiotikë dhe biotikë, në të cilin lloji jeton në çdo fazë të ciklit të tij biologjik	**Habitat (of species)**	An environment defined by specific abiotic and biotic factors, in which the species lives at any stage of its biological cycle	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Vendbanime (habitate) natyrore	Janë sipërfaqet tokësore ose ujore, të dallueshme për nga tiparet gjeografike, abiotike dhe biotike, pavarësisht nëse janë tërësisht natyrore ose gjysmënatyrore	**Natural habitat**	Terrestrial or aquatic areas distinguished by geographic, abiotic and biotic features, whether entirely natural or semi-natural	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Vendnodhje	Një zonë e përcaktuar gjeografikisht gjerësia e së cilës është e kufizuar qartë. Në kontekst të menaxhimit mjedisor, paraqet një lokacion të veçantë gjeografik nën kontrollin menaxhues të një operatori, që përfshinë të gjitha aktivitetet, produktet dhe shërbimet e saja bashkë me të gjithë infrastrukturën, pajisjet dhe lëndët që ai i përdorë	**Site**	A geographically defined area whose extent is clearly delineated. Within the context of environmental management, it is a distinct geographic location under the management control of an organisation covering activities, products and services, including all infrastructure, equipment and materials	Industri	Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009, Rregullorja (EC) Nr. 166/2006, Direktiva 2006/21/EC, Direktiva 92/43/EEC
Venturi	Reduktimi i shtypjes së fluidit kur një fluid rrjedh nëpër një seksion të ngushtuar të një tubi (gypi)	**Venturi**	The reduction in fluid pressure that results when a fluid flows through a constricted section (or choke) of a pipe	Hidraulikë	
Veprimtari profesionale	Çdo aktivitet i kryer gjatë një veprimtarie ekonomike, biznesore apo sipërmarrëse, pavarësisht karakterit të tij privat apo publik, fitimprurës apo jofitimprurës	**Occupational activity**	Any activity carried out in the course of an economic activity, a business or an undertaking, irrespectively of its private or public, profit or non-profit character	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2004/35/CE
Vetëpastrimi, pastrimi natyror	Një proces natyror i lumenjve, liqeneve apo kanaleve për të rikuperuar vlerat e oksigjenit të tretur, i cili paraqet njërin prej treguesve më të mirë të cilësisë së ujit. Ky proces përfshin proceset biologjike, kimike dhe fizike që veprojnë njëherësh në të gjithë ndotësit biologjik duke i oksiduar ata	**Self purification, natural purification**	A natural process of rivers, lakes or canals to recover the dissolved oxygen (DO) values (which is one of the best indicators of water quality), involving biological, chemical and physical processes working simultaneously on biological pollutants, oxidizing them	Cilësi e ujërave	
Vëllim i vdekur i depozitës së ujit	Vëllimi i ujit në një rezervuar nën nivelin e ujëshkarkuesit (ujëlëshuesit) më të ultë (nivelin minimal të furnizimit), ashtu që nuk mund të drenazhohet me anë të gravitetit nëpër ujëshkarkuesin e thellësisë, konstruksionet ujëshkarkuese apo ujëmarrësin e termocentralit, por ky vëllim vetëm mund të pompohet jashtë	**Dead storage capacity, Dead storage**	The volume of water in a reservoir below the level of the lowest outlet (the minimum supply level), thus it cannot be drained by gravity through a dam's outlet works, spillway or power plant intake and can only be pumped out	Furnizim me ujë	
Vija e rrjedhjes	Përdoret në një pajisje shpimi, paraqet një tub me diametër të madh i cili është i lidhur me rakord (nipel) në formë kambane (nën horizontin e shpimit) dhe shtrihet deri tek 'barku i oposumit'[56] (në rezervuarët e tretësirës së shpimit), dhe shërben si tub kthyes për tretësirën e shpimit sapo kjo të del nga vrima e shpimit, duke e çuar atë drejt rezervuarëve të tretësirës së shpimit	**Flow line**	Used on a drilling rig, is a large diameter pipe that is connected to the bell nipple (under the drill floor) and extends to the possum belly (on the mud tanks) and acts as a return line, (for the drilling fluid as it comes out of the hole), to the mud tanks	Furnizim me ujë	

[56] Në një pajisje shpimi, '***barku i oposumi***'t paraqet një kontejner (enë) metalike në kokën e sitës shkundëse të argjilës shistore që pranon prurjet e tretësirës së shpimit dhe që është e lidhur direkt në fundin e linjës së rrjedhjes

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Viskozitet	Viskoziteti i një fluidi paraqet rezistencën e tij ndaj deformimit gradual nën veprimin e forcave të tendosjes apo forcave elastike. Viskoziteti është veti e fluidit i cili shprehë rezistencë ndaj lëvizjes relative ndërmjet dy sipërfaqeve të fluidit që lëvizin me shpejtësi të ndryshme	**Viscosity**	A fluid is a measure of its resistance to gradual deformation by shear stress or tensile stress. It is a property of the fluid which opposes the relative motion between the two surfaces of the fluid in a fluid that are moving at different velocities	Hidraulikë	
Vlerat kufizuese të emisionit (në Shqipëri - "Vlerat kufizuese të shkarkimit")	Masa, e shprehur në kuptim të parametrave specifikë të caktuar, përqendrimi dhe/ose niveli i një emisioni (shkarkimi), i cili nuk mund të tejkalohet gjatë një ose më shumë afatesh (periudhash) kohore. Vlerat kufizuese të emisionit (shkarkimit) mund të përcaktohen edhe për grupe të caktuara, familje apo kategori të caktuara substancash, në veçanti për ato të përcaktuara në legjislacionin e BE-së. Vlerat kufizuese të emisionit (shkarkimit) të substancave, normalisht duhet të aplikohen në pikën ku emisionet (shkarkimet) dalin prej impiantit, ndërsa hollimi i tyre shpërfillet gjatë përcaktimit të tyre	**Emission limit values**	The mass, expressed in terms of certain specific parameters, concentration and/or level of an emission, which may not be exceeded during any one or more periods of time. Emission limit values may also be laid down for certain groups, families or categories of substances, in particular for those identified under the EU legislation. The emission limit values for substances shall normally apply at the point where the emissions leave the installation, dilution being disregarded when determining them	Ndotje	Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2010/75/EU
Vlerë e pragut	Një standard specifik i cilësisë mjedisore i përcaktuar nga Shtetet Anëtare në legjislacionin përkatës të tyre (shihni përkufizimin për " environmental quality standard" - "standard i cilësisë mjedisore")	**Threshold value**	A specific environmental quality standard (EQS) set by States in legislation (see environmental quality standard)	Vlerësim i ndikimit	Direktiva 2006/118/EC
Vlerë referente	Përqendrimi apo masa matëse e një karakteristike të cilësisë së ujërave e cila bazuar në njohuritë e deritanishme nuk paraqet ndonjë rrezik domethënës për shëndetin e konsumatorit (apo të përdoruesve) (vlerë referente që ndërlidhet me shëndetin), ose e cila ka të bëjë me ujë të cilësisë së mirë (vlerë referente estetike)	**Guideline value**	The concentration or measure of a water quality characteristic that, based on present knowledge, either does not result in any significant risk to health of the consumer (or users) (health-related guideline value), or is associated with good quality water (aesthetic guideline value)	Cilësi e ujërave	
Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet	Një vlerësim i ndërmarr me qëllim të ofrimit të një vlerësimi mbi rreziqet potenciale nga përmbytjet, i cili bëhet në bazë të informacioneve të disponueshme apo lehtësisht të qasshme, siç janë të dhënat dhe studimet mbi zhvillimet afatgjate e sidomos mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike në shfaqjen e përmbytjeve	**Preliminary flood risk assessment**	Assessment, based on available or readily derivable information, such as records and studies on long term developments, in particular impacts of climate change on the occurrence of floods, undertaken to provide an assessment of potential flood risks	Përmbytje	Direktiva 2007/60/EC
Vlerësimi i cilësisë së ujit për larje	Procesi i vlerësimit të cilësisë së ujit për larje duke përdorur një metodë vlerësimi	**Bathing water quality assessment**	The process of evaluating bathing water quality, using an assessment method	Shëndet publik	Direktiva 2006/7/EC
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)	Shihni Vlerësimin Mjedisor	**Environmental Impact Assessment (EIA)**	See Environmental Assessment		
Vlerësimi i popullsisë	Vlerësimi i popullsisë zakonisht rezidente të një vendi sipas moshës dhe gjinisë	**Population estimates**	Estimates of the usually resident population of a country, by age and sex		

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Vlerësimi mjedisor	Vlerësimi i pasojave mjedisore (pozitive dhe negative) të një plani, politike, programi, apo i projekteve aktuale përpara vendimit për të vazhduar përpara me veprimin e propozuar. Në këtë kontekst, kur përdoret termi "vlerësimi i ndikimit në mjedis" (VNM) zakonisht vlen për projektet aktuale të individëve ose kompanive, ndërsa kur përdoret termi "vlerësimi strategjik mjedisor" (VSM) atëherë ky vlen për politikat, planet dhe programet, që në të shumtën e rasteve propozohen nga institucionet shtetërore. Vlerësimet mjedisore mund të rregullohen përmes rregullave të procedurës administrative në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe dokumentacionin e vendimmarrjes, dhe mund t'i nënshtrohen shqyrtimit juridik	**Environmental assessment**	The assessment of the environmental consequences (positive and negative) of a plan, policy, program, or actual projects prior to the decision to move forward with the proposed action. In this context, the term "environmental impact assessment" (EIA) is usually used when applied to actual projects by individuals or companies and the term "strategic environmental assessment" (SEA) applies to policies, plans and programmes most often proposed by organs of state. Environmental assessments may be governed by rules of administrative procedure regarding public participation and documentation of decision making, and may be subject to judicial review	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2001/42/EC, Direktiva 2011/92/EU
Vlerësimi strategjik mjedisor	Nënkupton hartimin e një raporti mjedisor ku vlerësohen pasojat e mundshme në mjedis (përfshirë shëndetin e njeriut) të një plani apo programi, realizimin e konsultimeve publike me grupet e interesit, si dhe marrjen parasysh të rezultateve të këtij raporti mjedisor dhe të konsultimeve në marrjen e vendimit përfundimtar për planin apo programin, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj	**Strategic environmental assessment**	The evaluation of the likely environmental, including health, effects, which comprises the determination of the scope of an environmental report and its preparation, the carrying out of public participation and consultations, and the taking into account of the environmental report and the results of the public participation and consultations in a plan or programme	Vlerësim mjedisor	Direktiva 2001/42/EC
Vrimë lëshimi	Një hapje nëpërmjet së cilës uji lirshëm shkakohet nga një rezervuar	**Outlet**	An opening through which water can be freely discharged from a reservoir	Përmbytje	

4.29 Xx

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		

4.30 Yy

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Yndyrëndarës (veçues yndyrash, yndyrëkapës)	Një rezervuar i vogël yndyrëheqës me kohë të retencionit zakonisht prej 10 deri në 30 minuta, me madhësi të mjaftueshme për të mbajtur dhe ftohur yndyrën në përbërje të ujërave të ndotura. Kanali (tubi) hyrës i këtij rezervuari gjendet nën sipërfaqe, ndërsa kanali (tubi) nxjerrës gjendet në fundin e rezervuarit, që normalisht është i ndarë mga kanali hyrës me një mburojë ndarëse e cila e mban yndyrën dhe nuk e lë të kalojë nëpër të	**Grease trap**	A small skimming tank typically with a retention time of 10 to 30 min, large enough to hold and cool the grease delivered in the waste water. The inlet is below the surface and the outlet is at the bottom, normally separated from the inlet by a baffle that holds back the grease	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	

4.31 Zz

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	Përkufizimi	Termi	Përkufizimi		
Zbërthim anaerob	Një varg procesesh biologjike të trajtimit të ujërave të ndotura ku mikroorganizmat i zbërthejnë materiet e biodegradueshme në mungesë të oksigjenit	**Anaerobic digestion**	A series of biological processes of waste water treatment in which microorganisms break down biodegradable material in the absence of oxygen.	Kanalizim dhe trajtim i ujërave të ndotura	
Zona me presion	Në furnizimin me ujë, ky term i referohet një zone të caktuar në të cilën cilësia e ujit mbahet nën monitorim. Lartësia e shtypjes normale maksimale në një zonë të këtillë është 70 m dhe lartësia e shtypjes minimale është 30 m	**Pressure zones**	In water supply, a distinct zone in which the quality of water is monitored. The normal maximum head in a zone is 70 m and the minimum head 30 m.	Hidraulikë	
Zona të ndjeshme	**Zona të ndjeshme** - trupat ujorë të cilët i përmbushin kriteret në vijim: (a) liqenet natyrore të ujërave të ëmbla, trupat e tjerë të ujërave të ëmbla, estuaret dhe ujërat bregdetare, të cilët janë në gjendje eutrofike ose mund të bëhen të tillë në një të ardhme të afërt nëse nuk ndërmereen masa mbrojtëse; (b) ujërat sipërfaqësore të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijes, i cili mund të përmbajë një përqendrim më të madh të nitrateve sesa përqendrimi i tyre i specifikuar në legjislacionin përkatës (mbi cilësinë e kërkuar të ujërave sipërfaqësore të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijes) në qoftë se nuk ndërmerren masa mbrojtëse; si dhe (c) zonat në të cilat është i nevojshëm një trajtim i mëtejshëm krahasuar me atë që është specifikuar në legjislacionin përkatës, për të qenë në pajtim me legjislacionin e BE-së	**Sensitive areas**	Water bodies that meet the following criteria: natural freshwater lakes, other freshwater bodies, estuaries and coastal waters which are found to be eutrophic or which in the near future may become eutrophic if protective action is not taken; surface freshwaters intended for the abstraction of drinking water which could contain more than the concentration of nitrate laid down under the relevant legislation concerning the quality required of surface water intended for the abstraction of drinking water if action is not taken; and areas where further treatment than that prescribed in the specific legislation is necessary to fulfil European legislation	Zona të mbrojtura	Direktiva 91/271/EEC
Zonat e mbrojtura ujore	Këto zona përcaktohen për burimet e ujërave nëntokësore siç janë puset, vrimat e shpuara dhe burimet e ujit të cilat përdoren për qëllime të furnizimit publik me ujë të pijshëm, apo zonat e mbrojtura ujore përcaktohen përgjatë lumenjve	**Water protection zones**	These zones are defined for groundwater sources such as wells, boreholes and springs used for public drinking water supply or along the rivers		
Zonat e përziera	Zona të cilat gjenden afër pikave të shkarkimit, ku përqendrimet e një apo më shumë substancave, të renditura në legjislacionin specifik, mund t'i tejkalojnë Standardet përkatëse të Cilësisë Mjedisore (SCM-të) brenda këtyre zonave të përziera, po qe se nuk ndikojnë në përmbushjen e këtyre standardeve nga pjesa e mbetur e trupit ujor sipërfaqësor	**Mixing zones**	Zones that are adjacent to points of discharge in which concentrations of one or more substances listed in the specific legislation may exceed the relevant environmental quality standards within such mixing zones if they do not affect the compliance of the rest of the body of surface water with those standards	Ndotje	Direktiva 2008/105/EC
Zonë bentonike	Është një prej regjioneve ekologjike të një trupi ujor. Përfshinë fundin (siç është p.sh. fundi i oqeanit apo fundi i një liqeni), sipërfaqen e sedimentit, si dhe disa shtresa nën-sipërfaqësore	**Benthic zone**	It is one of the ecological regions of a body of water. It comprises the bottom—such as the ocean floor or the bottom of a lake—the sediment surface, and some sub-surface layers.	Trupa ujorë	
Zonë bregore	Një ujërrjedhë bashkë me gjithë vegjetacionin që shtrihet në brigjet e saja gjerë tek shenja më e lartë e nivelit të ujit	**Riparian zone**	A stream and all the vegetation on its banks out to the high water mark	Trupa ujorë	

SHQIP		ANGLISHT		Tema	Referencat kyçe
Termi	**Përkufizimi**	**Termi**	**Përkufizimi**		
Zonë e ndjeshme	Sipërfaqet e tokës që kontribuojnë në ndotje dhe të cilat kullohen (drenazhohen) në ujërat e ndikuara nga ndotja, si dhe në ujërat të cilat mund të ndikohen nga ndotja po qe se nuk ndërmerret ndonjë veprim (shihni përkufizimin për 'action programme' - 'programi i veprimit')	**Vulnerable zone**	Areas of land which contribute to pollution and drain into the waters affected by pollution and waters which could be affected by pollution if action is not taken (see "action programme")	Ndotje	Direktiva 91/676/EEC
Zonë eufotike (zona e rrezeve të diellit)	Shtresë që shtrihet më afër sipërfaqes së një rezervuari, e cila merr mjaftë dritë sa për të mundësuar zhvillimin e fotosintezës	**Euphotic zone**	The layer closer to the surface in a reservoir that receives enough light for photosynthesis to occur	Trupa ujorë	
Zonë e saturuar (e ngopur)	Sipërfaqja nën tablon e ujit ku të gjitha zgavrat e hapura në tokë (poret e tokës) janë të mbushura me ujë nën një shtypje të barabartë apo më të lartë se shtypja atmosferike	**Saturated zone**	The area below the water table where all open spaces (in soil) are filled with water under pressure equal to or greater than that of the atmosphere	Menaxhim i ujërave	
Zonë e veçantë e ruajtjes	Zonë me rëndësi për Komunitetin, e përcaktuar si e tillë nga Shtetet Anëtare me një akt normativ, administrativ dhe/ose kontraktual, ku zbatohen masat e nevojshme të ruajtjes me qëllim të mbajtjes apo rivendosjes në një status të favorshëm ruajtjeje vendbanimet (habitatet) natyrore dhe/apo popullacionet (në Shqipëri - popullatat) e llojeve për të cilat zona është përcaktuar	**Special area of conservation**	A site of Community importance designated by the States through a statutory, administrative and/or contractual act where the necessary conservation measures are applied for the maintenance or restoration, at a favourable conservation status, of the natural habitats and/or the populations of the species for which the site is designated	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Zonë freatike, nëntokësore	Ndryshe quhet edhe si zonë e saturimit, e cila gjendet nën tablon ujore ku poret e dheut janë të mbushura me ujë	**Phreatic Zone**	It is also called the zone of saturation, below the water table where soil pores are filled with water	Trupa ujorë	
Zonë me rëndësi për Komunitetin	Është zona e cila, në rajonin apo rajonet biogjeografike të cilave u takon, kontribuon konsiderueshëm në mbajtjen apo rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje një tip të vendbanimit (habitatit) natyror apo të llojit ashtu siç përcaktohen në legjislacionin përkatës, e cila po ashtu mund të kontribuojë në koherencën e zonave të "Natura 2000"[57] të përcaktuara sipas legjislacionin përkatës, dhe/apo që kontribuon konsiderueshëm në ruajtjen e larmisë biologjike (biodiversitetit) brenda rajonit apo rajoneve biogjeografike në fjalë.Për llojet e kafshëve që shtrihen në zona me shtrirje të gjerë, zonat me rëndësi për Komunitetin i përgjigjen vendeve të shtrirjes natyrore të këtyre kafshëve, të cilat përmbajnë faktorët fizikë apo biologjikë thelbësor për jetën dhe riprodhimin e tyre	**Site of Community Importance**	A site which, in the biogeographical region or regions to which it belongs, contributes significantly to the maintenance or restoration at a favorable conservation status of certain natural habitat types set out in the legislation and may also contribute significantly to the maintenance of biological diversity within the biogeographic region or regions concerned. For animal species ranging over wide areas, sites of Community importance shall correspond to the places within the natural range of such species which present the physical or biological factors essential to their life and reproduction	Zona të mbrojtura	Direktiva 92/43/EEC
Zooplankton	Organizma shumë të vegjël të cilët pluskojnë në ujërat e oqeaneve, deteve, dhe trupave të ujërave të ëmbla	**Zooplankton**	Very small organisms drifting in oceans, seas, and bodies of fresh water	Status i trupave ujorë	
Zotërues i mbeturinës (në Shqipëri- zotërues i mbetjeve)	Është prodhuesi (krijuesi) i mbeturinave (mbetjeve) ose çdo person që e posedon (zotëron) mbeturinën (mbetjen)	**Waste holder**	The producer of the waste or the natural or legal person who is in possession of it	Ndotje	Direktiva 2006/21/EC

[57] "Natura 2000" - Rrjeti Ekologjik i Zonave të Mbrojtura

5 REFERENCAT

[1] D. J. Poehls, Gregory J. Smith. 2009. Encyclopedic Dictionary of Hydrogeology
[2] European Water Stewardship. 2011. Glossary v2.10.
[3] Goulburn-Murray water. 2015. Groundwater. Terms and definitions, version 8.
[4] He Chen, Lekuan Ma, Wei Guo, Ying Yang, Tong Guo, and Cheng Feng. Linking Water Quality and Quantity in Environmental Flow Assessment in Deteriorated Ecosystems: A Food Web View. In https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3722155/
[5] Megh R. Goyal. 2014. Sustainable Micro Irrigation: Principles and Practices
[6] Michael Allaby. 2015. A Dictionary of Ecology. Fifth Edition
[7] In http://oxfordindex.oup.com/view/10.1093/oi/authority.20110803095904742
[8] Paul G Smith. 2005. Dictionary of Water and Waste Management
[9] United States Environmental Protection Agency, Water Office. 2003. Wastewater Technology Fact Sheet.
[10] Polytechnic Dictionary, Sabaudin Kurti, Ramazan Hysa, Çezar Kurti
[11] http://drought.unl.edu/DroughtBasics/Glossary.aspx
[12] http://ec.europa.eu/environment/water
[13] http://wst.iwaponline.com/content/55/8-9/83
[14] http://www.apf-aquasystem.de/en/information
[15] http://www.lenntech.com/water-glossary.htm
[16] http://www.water.ca.gov/groundwater/groundwater_basics/groundwater_glossary.cfm
[17] http://www.wcponline.com/glossary/freeboard/
[18] https://www.aquascience.net/glossary/
[19] https://www.cdc.gov
[20] https://www.eea.europa.eu/help/glossary#c0=all&c4=10&b_start=0&c2=aquifer
[21] https://water.usgs.gov/edu/dictionary.html
[22] Viola Saliasi, “Water Sector Technical Dictionary”, GIZ, September 2012

REPUBLIKA E KOSOVËS

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Këshilli Ndër-Ministror për Ujëra

Programi Kornizë Mjedisor i Sida-s për Kosovën

C8
A8.03
D8.03.01

Asistenca Teknike e ofruar nga
FCG (Kompania Udhëheqëse) në Konzorcium me EPTISA Servicios de Ingenieria (Partner)
Adresa:
Dalagatan 7 – 11123 Stockolm (Suedi)
Tel.: +46-(0)8-4067627 /
Fax: +46-(0)8-210269

Projekti financohet nga
Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe menaxhohet nga **Ambasada Suedeze në Kosovë**
Adresa:
Rr. Perandori Justinian, Nr. 111, Pejton – 10000 Prishtinë
Tel.:+381-(0)38-245795
Fax:+381-(0)38-245791